

LIGJ
Nr.9817, datë 22.10.2007

PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton objektivat, masat dhe programimin e politikave bujqësore e të zhvillimit rural, të shërbimeve publike bujqësore, të kërkimit dhe trajnimit profesional, si dhe bazën e të dhënave dhe informacionin për politikatat në sektorët e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Bujqësia” është veprimtaria ekonomike, e cila ka si objektiv prodhimin e ushqimit për njerëzit, të ushqimit për blegtorinë, të bimëve industriale dhe të karburanteve bio, si dhe të produkteve të tjera, nëpërmjet kultivimit sistematik të bimëve dhe mbarështimit të kafshëve.

2. “Fermë” është njësi ekonomike bazë në bujqësi dhe në veprimtaritë ekonomike që lidhen të. Është një sipërfaqe toke apo veprimtari që kryesisht i kushtohet prodhimit dhe menaxhimit të ushqimit ose prodhimit blegtoral.

3. “Produkt bujqësor” është një produkt bimor apo shtazor, i cili prodhohet në fermë, si dhe produktet që rrjedhin nga faza e parë e përpunimit të këtij produkti bimor apo shtazor.

4. “Produkt agroushqimor” është produkti bujqësor dhe produkte të tjera ushqimore të përpunuara.

5. “Politikat bujqësore” janë politika shtetërore, që përqendrohen në objektivat dhe masat, që veprojnë drejtpërsëdrejti në tregjet agroushqimore dhe të ardhurat nga ferma.

6. “Politikë e zhvillimit rural” është një politikë shtetërore, që përqendrohet në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, në konvergjencën e tyre ekonomike dhe sociale, si dhe në mbrojtjen e mjedisit.

7. “Plani Kombëtar” është plani kombëtar i bujqësisë dhe zhvillimit rural.

8. “Plani i veprimit” është plani i veprimit të zbatimit të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural.

9. “Strategjia e bujqësisë dhe strategjia e zhvillimit rural” janë objektivat afatmesme të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, programimi, masat dhe mënyrat se si Qeveria planifikon mbështetjen financiare në një periudhë kohore të dhënë, në të mirë të bujqësisë dhe zonave rurale.

10. “Plan veprimi” është dokumenti i programimit, që përshkruan se si Qeveria do të zbatojë strategjitë në zona të ndryshme dhe periudha të ndryshme kohore.

11. “Masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural” janë instrumentet ligjore dhe financiare për arritjen e objektivave, në përputhje me dokumentet programuese.

12. “Zonat më pak të favorizuara” janë zona malore ose zona të tjera, ku pozicioni gjeografik dhe pengesat natyrore rezultojnë në koston e lartë të prodhimit.

13. “Bujqësi e qëndrueshme” është bujqësia, e cila, nga ana ekonomike dhe sociale, është e aftë të

mbijetojë dhe që për një periudhë të gjatë nuk e degradon mjedisin. Koncepti i bujqësisë së qëndrueshme është i bazuar në parimin e shumëfunktionalitetit, duke nënkuptuar se bujqësia, krahas produkteve fitimprurëse (ekonomike), prodhon edhe të mira publike, që lidhen me mjedisin, sigurimin e ushqimit, sigurinë ushqimore dhe konvergjencën rajonale dhe sociale. Këto funksione të jashtme të bujqësisë nuk drejtohen drejtpërdrejt tek tregjet dhe, për këtë arsye, duhen mbështetur me masa gjithëpërfshirëse të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural.

14. “Shërbime publike në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural” janë politikat qeveritare për garantimin dhe ofrimin e shërbimit, nëpërmjet programeve qeveritare.

15. “Kooperativë” është një bashkim vullnetar personash, për të plotësuar nevoja dhe qëllime të përbashkëta ekonomike, përmes një biznesi të zotëruar bashkërisht. Ligjërisht kooperativa është person juridik.

16. “Ministri” është ministri përgjegjës për çështjet e bujqësisë.

17. “Ministria” është ministria përgjegjëse për çështjet e bujqësisë.

Neni 3

Objektivat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural

Me masat për zbatimin e politikave bujqësore dhe zhvillimit të zonave rurale synohet të arrihen objektivat e përgjithshëm, si më poshtë:

a) rritja e të ardhurave për popullsinë rurale, duke rritur mirëqenien e saj, nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës dhe të jetesës, si dhe duke krijuar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë;

b) rritja e prodhimit nëpërmjet nxitjes së konkurrueshmërisë dhe të progresit teknik, si dhe garantimit të një përdorimi optimal të faktorëve të prodhimit dhe në veçanti të punës;

c) stabiliteti i tregut, duke garantuar qëndrueshmëri në prodhimin bujqësor;

ç) cilësia dhe siguria ushqimore, duke garantuar që zinxhiri ushqimor të ketë një cilësi të qëndrueshme dhe të mos shkaktojë pasoja të dëmshme në shëndetin e njerëzve;

d) mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit, duke garantuar që bujqësia të ruajë burimet natyrore;

dh) ulja e varfërisë, e cila synon zvogëlimin e pabarazive ndërmjet niveleve të zhvillimit të rajoneve të ndryshme, si edhe të prapambetjes së zonave rurale, më pak të favorizuara, duke zhvilluar veprimtari alternative dhe plotësuese, që gjenerojnë punësim, me synim ngadalësimin e largimit të popullsisë nga fshatrat, si dhe duke fuqizuar biznesin e vogël dhe të mesëm.

KREU II

PROGRAMIMI, ZBATIMI DHE FINANCIMI I POLITIKAVE BUJQËSORE DHE TË ZHVILLIMIT RURAL

Neni 4

Plani Kombëtar

Plani Kombëtar përbëhet nga:

a) strategjia e bujqësisë;

b) strategjia e zhvillimit të zonave rurale.

Plani Kombëtar bazohet në objektivat afatmesëm të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, në masat, programet dhe veprimtaritë për realizimin e këtyre objektivave, në vlerësimet efektive të mëpasshme, si dhe në fondet publike të nevojshme, të përdorura për zbatimin e politikave bujqësore dhe zhvillimit rural.

Plani kombëtar hartohet nga ministria, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse për zhvillimin rural dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave për një periudhë 7-vjeçare.

Neni 5

Plani i veprimit

Këshilli i Ministrave, në përputhje me Planin Kombëtar, miraton planin e veprimit dyvjeçar, për zbatimin e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural.

Plani i veprimit përfshin një pjesë ose të tërë paketën e masave të politikave bujqësore dhe të

zhvillimit rural.

Plani i veprimit përfshin:

- a) kushtet, kriteret dhe procedurat e paraqitjes e të zbatimit të masave, si dhe të çdo mase specifike të politikave bujqësore e të zhvillimit rural;
- b) planin financiar për zbatimin e masave dhe të çdo mase specifike të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural;
- c) mjetet dhe mënyrat e zbatimit dhe të kontrollit të politikave bujqësore e të zhvillimit rural;
- ç) procedurat e monitorimit dhe të vlerësimit të politikave bujqësore e të zhvillimit rural.

Neni 6

Programi për bujqësinë dhe zhvillimin rural

1. Krijohet programi për bujqësinë dhe zhvillimin rural, më poshtë programi, i cili ka si qëllim të mbështesë zhvillimin e bujqësisë në vend, të garantojë, në mënyrë graduale, efektivitetin e masave të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, duke i kushtuar vëmendje nevojës së planifikimit të zbatimit të projekteve dhe të masave mbështetëse.

2. Burimet financiare të programit sigurohen nga:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) donatorët ndërkombëtarë, sipas marrëveshjeve përkatëse;
- c) buxheti i bashkisë/komunës;

Programi për bujqësinë dhe zhvillimin rural është i përhershëm dhe administrohet nga ministria, nëpërmjet agjencisë së pagesave.

3. Kriteret bazë, sektorët që do të mbështeten dhe masa e përfitimit nga fondi i programit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Procedura dhe mënyra e administrimit të fondit të programit përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e bujqësisë dhe Ministrit të Financave.

Neni 7

Përfituesit nga fondi i programit

Përfituesit nga fondi i programit nëpërmjet masave, që ndërmerren në kuadër të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, janë:

- a) fermerët, grupet e fermerëve, personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë veprimtari bujqësore ose veprimtari ekonomike të lidhur me të;
- b) personat fizikë apo juridikë, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë në industrinë agroushqimore;
- c) personat fizikë apo juridikë, të cilët ofrojnë shërbime për veprimtari bujqësore dhe veprimtari të tjera rurale.

Neni 8

Aplikimet

Aplikimet për të përfituar nga programi, nëpërmjet politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, mund të paraqiten nga një fermer, grup fermerësh dhe persona fizikë apo juridikë, siç parashikohet në këtë ligj.

Neni 9

Dokumentet që duhen ruajtur

Përfituesit që kanë marrë fonde nga programi, duhet të ruajnë të gjithë dokumentacionin për përfitimin e fondeve, për një periudhë 4-vjeçare, duke filluar nga data e livrimit të tyre.

KREU III
MASAT E POLITIKAVE BUJQËSORE

Neni 10
Parimet e masave të politikave bujqësore

Masat e politikave bujqësore duhet të harmonizohen dhe të zbatohen në përputhje me parimet e barazisë dhe të efijencës.

Neni 11
Format e mbështetjes së brendshme

Mbështetja e brendshme për produktet bujqësore dhe agroushqimore zbatohet nëpërmjet:

- a) masave për stabilizimin e tregjeve;
- b) pagesave të drejtpërdrejta.

Neni 12
Masat për stabilizimin e tregjeve

Masat për stabilizimin e tregjeve synojnë të mbështesin bujqësinë në kohën e kushteve tepër të paqëndrueshme të tregut. Forma dhe llojet e masave propozohen në Planin Kombëtar dhe zbatohen nëpërmjet planit të veprimit. Në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë, mund të zbatohen edhe masa të tjera, veç atyre të parashikuara në këtë ligj.

Neni 13
Pagesat e drejtpërdrejta

1. Pagesat e drejtpërdrejta janë pagesa, që bëhen drejtpërsëdrejti nga Qeveria te prodhuesit, për të arritur objektivat e politikës, kryesisht, për të rritur konkurrueshmërinë dhe për të mbështetur të ardhurat në fermë.

2. Kriteret e përfitimit, procedura dhe mënyra e administrimit të këtyre pagesave përcaktohen sipas pikës 3 të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 14
Kriteret për mbështetjen e brendshme

Masat e mbështetjes së brendshme të prodhimit bujqësor duhet të plotësojnë këto kriteret:

1. Mbështetja nuk duhet të japë efektin e mbështetjes së çmimit për prodhuesit.
2. Mbështetja e dhënë për një produkt të specifikuar, gjatë vitit në fjalë, nuk duhet të kalojë masën 5 për qind të vlerës së përgjithshme të produktit në prodhimin e përgjithshëm bruto.
3. Mbështetja, e cila jepet për një produkt jo të specifikuar, gjatë vitit në fjalë, nuk duhet të kalojë masën 5 për qind të vlerës së përgjithshme të këtij produkti në prodhimin e përgjithshëm bruto.

KREU IV
MASAT E POLITIKËS SË ZHVILLIMIT RURAL

Neni 15
Objekti i masave

1. Masat e politikës së zhvillimit rural mbështesin:

- a) përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore në zonat rurale;
- b) menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e mjedisit;

c) përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në këto zona;

ç) përmirësimin e qeverisjes dhe mobilizimin e potencialeve vendore zhvilluese të zonave rurale, si dhe ndërmarrjen e nismave vendore.

2. Masat propozohen nëpërmjet Planit Kombëtar dhe zbatohen nëpërmjet planit të veprimit.
3. Mënyra e zbatimit të këtyre masave dhe kriteret e mbështetjes përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 16

Mbështetja për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore

Mbështetja për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore bazohet në masa të ndryshme investuese nëpërmjet projekteve, që përmirësojnë situatën, në lidhje me:

- a) burimet njerëzore;
- b) menaxhimin e tokës;
- c) kapitalin fizik;
- ç) standardet e prodhimit, në lidhje me mjedisin, sigurinë ushqimore dhe mirëqenien e kafshëve;
- d) zinxhirin agroushqimor;

Neni 17

Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e mjedisit

Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e mjedisit bazohet në masa të ndryshme të pagesave të drejtpërdrejta, nëpërmjet projekteve, që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe përmirësojnë situatën, në lidhje me:

- a) kushtet më pak të favorizuara të prodhimit;
- b) ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit;
- c) ruajtjen e peizazhit.

Neni 18

Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale

Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale ndihmon në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike në zonat më të largëta rurale, që ndeshen me fenomenin e largimit të popullatës. Kjo mbështetje bazohet në masa të ndryshme investuese, nëpërmjet projekteve, të cilat fuqizojnë investimet në ekonominë e gjerë rurale dhe përmirësojnë situatën, në lidhje me:

- a) shumëllojshmërinë e ekonomive rurale në veprimtarinë bujqësore dhe jobujqësore, në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- b) përmirësimin e cilësisë së jetës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe ruajtjes së trashëgimisë rurale;
- c) trajnimet.

Neni 19

Mbështetja për ndërmarrjen e nismave vendore

Mbështetja stimulon nismat, që përfshijnë fermerët, punonjësit e pyjeve dhe aktorët e tjerë ruralë, të cilët mund të ruajnë dhe të rrisin më tej trashëgiminë vendore, natyrore dhe kulturore, të rrisin ndërgjegjësimin mjedisor dhe të promovojnë produktet tipike, turizmin dhe burimet e rinovueshme të energjisë. Veprimet kryesore të mbështetjes në këto zona përfshijnë:

- a) krijimin e kapaciteteve vendore të partneritetit, gjallërimin dhe promovimin e aftësive të thitjes, të cilat mund të ndihmojnë në mobilizimin e potencialit vendor;
- b) promovimin e partneritetit publik-privat;
- c) promovimin e bashkëpunimit, nxitjen e aftësisë së sipërmarrjes dhe promovimin e përfshirjes e të

shërbimeve vendore.

KREU V
KUADRI INSTITUCIONAL PËR POLITIKAT BUJQËSORE
DHE TË ZHVILLIMIT RURAL

Neni 20

Komiteti Ndërmintor për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

1. Komiteti Ndërmintor për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural është një organ këshillimor i Këshillit të Ministrave, sipas nenit 11 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.

2. Komiteti Ndërmintor për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, përveç detyrave që i caktohen në aktin e krijimit, jep mendim për vendimet më të rëndësishme, në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, veçanërisht:

- a) bën propozime për Planin Kombëtar;
- b) jep mendim për mënyrën e monitorimit dhe zbatimit të Planit Kombëtar;
- c) bën propozime për aktet ligjore më të rëndësishme në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- ç) jep mendim për marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- d) jep mendim për vendime të tjera, shumë të rëndësishme, në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

Neni 21

Agjencia e pagesave

1. Agjencia e pagesave krijohet si ent publik buxhetor, me statusin e personit juridik, publik, në varësi të ministrit.

2. Agjencia e pagesave ka për detyrë:

- a) të vërë në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural;
- b) të hartojë raportet dhe analizat, në përputhje me zhvillimin e bujqësisë;
- c) të organizojë ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit;
- ç) të organizojë ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të informimit të tregut;
- d) të krijojë dhe të mirëmbajë bazën e të dhënave të nevojshme;
- dh) të zbatojë masat e kontrollit dhe të auditit të brendshëm;
- e) të inspektojë fermerët dhe subjektet, që kanë përfituar nga fondet e programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Fermerët, grupet e fermerëve, personat fizikë dhe juridikë duhet t'i krijojnë mundësi kësaj agjencie për të kryer inspektimet e saj, duke i ofruar dhe vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin, të dhënat, shpjegimet dhe çdo gjë tjetër që kërkohet.

3. Organizimi, funksionimi, shtrirja territoriale, si dhe mënyra e rekrutimit të punonjësve të agjencisë së pagesave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Drejtori i agjencisë së pagesave emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozim të ministrit përgjegjës për çështjet e bujqësisë.

KREU VI
BAZAT E TË DHËNAVE DHE SISTEMET E INFORMACIONIT

Neni 22

Bazat e të dhënave

1. Agjencia e pagesave krijon dhe mirëmban:

- a) regjistrin e fermave;
- b) regjistrin e prodhuesve dhe të përpunuesve të produkteve bujqësore ose ushqimore;
- c) regjistrin e aplikimeve për mbështetje financiare;
- ç) regjistrin e përdorimit dhe shfrytëzimit të tokës;
- d) regjistrin e blegtorisë;
- dh) regjistrin e tregtarëve të produkteve agrobujqësore dhe inputeve bujqësore;
- e) regjistrin e zonave më pak të favorizuara.

2. Krahas me bazën e të dhënave, siç përshkruhen në pikën 1 të këtij neni, agjencia e pagesave, nëse gjykohet e nevojshme, mund të mbajë edhe baza të tjera të dhënash.

3. Bazat e të dhënave, të cilave u referohet ligji, duhet të mbahen në formë elektronike.

4. Kushtet dhe mënyra e mbajtjes së tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 23

Marrja dhe përdorimi i bazave të tjera të të dhënave

Për të ngritur dhe mbajtur bazën e të dhënave, agjencia e pagesave mund të përdorë edhe baza të tjera të dhënash, të cilat mbahen nga ente shtetërore të autorizuara, institucionet, agjenci publike, koncesionare dhe autoritete të tjera të autorizuara.

Administruesit e këtyre bazave të të dhënave, të hartave dhe fotove ortodixhitale, janë të detyruar t'ia japin, pa pagesë, çdo informacion të përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji, agjencisë së pagesave, por, nga ana tjetër, i ngarkojnë ministrinë shpenzimet e drejtpërdrejta të materialeve, kopjeve ekstra, si dhe për përpunimin e të dhënave.

Neni 24

Financimi i bazës së të dhënave

Baza e të dhënave, që sigurohen dhe menaxhohen nga agjencia e pagesave, në përputhje me përcaktimin e bërë në këtë ligj, financohet nga Buxheti i Shtetit.

Neni 25

Vënia në dispozicion e të dhënave

Të dhënat e krijuara, në përputhje me këtë ligj, janë publike, përveç të dhënave që vlerësohen të dhëna personale dhe përbëjnë sekret të biznesit.

Në këtë rast, të dhënat u vihen në dispozicion të tretëve, në përputhje me ligjin e mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 26

Sistemi i informacionit për çmimet e tregut

Sistemi i informacionit për çmimet e tregut përbëhet nga analizat dhe metodologjitë përkatëse, që lidhen me grumbullimin, zbatimin dhe publikimin e të dhënave për çmimet e produkteve bujqësore dhe ushqimore.

Sistemi i informacionit për çmimet e tregut krijohet dhe zbatohet nga ministria, sipas udhëzimit të ministrit.

Neni 27

Kontabiliteti në fermë

1. Për miratimin dhe analizimin e masave të politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, përfituesit nga fondi i programit duhet të mbajnë në mënyrë të detyrueshme kontabilitet.

2. Mbajtja e kontabilitetit bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Të dhënat e përfituara nga mbajtja e kontabilitetit në fermat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni

mund të përdoren në përputhje me dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU VII
FORMAT E ORGANIZIMIT TË PRODHUESVE, TË PËRPUNUESVE DHE TREGTARËVE TË
PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE AGROUSHQIMORE

Neni 28

Organizatat e prodhuesve, të përpunuesve dhe tregtarëve
të produkteve bujqësore dhe agroushqimore

Për të vënë në zbatim objektivat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural, nxiten, përmes financimit, organizatat, shoqatat dhe kooperativat e prodhuesve bujqësore dhe ato të përpunimit e tregtimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore, të ngritura në baza vullnetare.

Neni 29

Kriteret për mbështetjen e organizatave, shoqatave dhe kooperativave

Kriteret që duhet të përmbushin organizatat, shoqatat dhe kooperativat prodhuese e përpunuese të produkteve bujqësore dhe agroushqimore, për të përfituar mbështetje, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Rregullat dhe mënyrat e përfitimit të kësaj mbështetjeje përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU VIII
SHËRBIMET PUBLIKE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË ZHVILLIMIT RURAL

Neni 30

Objekti i shërbimeve publike

Objekti i shërbimeve publike në bujqësi dhe për zhvillimin rural, më poshtë shërbimet publike, është të mbështesin zbatimin e Planit Kombëtar, duke ofruar shërbime afatgjata e të përhershme në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, aty ku nismat private nuk mund të përmbushin nevojat publike.

Shërbimet publike në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural përfshijnë:

- a) shërbimin këshillimor në bujqësi dhe për zhvillimin rural;
- b) kërkimin bujqësor dhe kontrollin/analizat laboratorike;
- c) shërbimin racor në bujqësi e blegtori;
- ç) analizën e politikave bujqësore;
- d) shërbimet në infrastrukturën e tregut (marketingut).

Neni 31

Detyrimet e një shërbimi publik

Detyrimet e një shërbimi publik janë:

- a) realizimi i vazhdueshëm e pa ndërprerje i veprimtarisë së shërbimit të përcaktuar;
- b) realizimi i këtij shërbimi për çdo fermer, grup fermerësh, person fizik apo juridik, të angazhuar në veprimtarinë bujqësore në përputhje me këtë ligj;
- c) ofrimi i shërbimit me pagesë, me përjashtim të shërbimeve që janë në përputhje me një program të caktuar.

Neni 32

Financimi i shërbimeve publike

Shërbimet publike në bujqësi financohen nga:

- a) të ardhurat nga pagesat e plota ose të pjesshme të shërbimeve të ofruara;
- b) Buxheti i Shtetit.

Neni 33

Programi i shërbimeve publike

Programi i shërbimit publik në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural hartohet dhe miratohet nga ministria, në përputhje me Planin Kombëtar. Ky program duhet të përcaktojë:

- a) tipin dhe vëllimin e shërbimit publik që ofrohet;
- b) mënyrat, rrugët dhe dinamikën e realizimit të shërbimit publik, në zbatim të akteve ligjore; c) vëllimin dhe mjetet financiare ose bashkëfinancimin e shërbimit publik.

Neni 34

Monitorimi i shërbimit publik

Monitorimi teknik dhe profesional për ofrimin e shërbimit publik realizohet nga ministria, e cila mund të autorizojë një organizatë ose persona të tjerë për realizimin e kontrollit teknik.

Monitorimi teknik dhe profesional, në rastin e autorizimit publik, realizohet nga personat, të cilët kanë kualifikimin e nevojshëm për ushtrimin e kontrollit në një fushë të veçantë të shërbimit publik.

Kushtet që zbatohen dhe që kërkohen për kualifikimin profesional të kontrollorit përcaktohen nga ministri.

KREU IX

MBËSHTETJA PËR KËRKIMIN, ARSIMIMIN DHE TRAJNIMIN

Neni 35

Kërkimi bujqësor

Në përputhje me Planin Kombëtar, ministri ushtron kompetencat, në bashkëpunim me ministrinë respektive, me institucionet e arsimit të lartë dhe me strukturat shkencore të tyre, në bashkëfinancimin e kërkimit dhe të projekteve zhvillimore në fushën e bujqësisë, të zhvillimit rural dhe të infrastrukturës përkatëse.

Neni 36

Arsimimi dhe trajnimi për nevojat e bujqësisë dhe të zhvillimit rural

1. Ministria duhet të propozojë dhe të ndërmarrë nisma për mënyra të ndryshme të arsimit dhe trajnimit për nevojat e bujqësisë, agroindustrisë dhe zonave rurale, në bashkëpunim me universitetet dhe shkollat e larta me drejtim bujqësor.

2. Ministria mund të bashkëfinancojë nisma për krijimin e stabilimenteve të zbatimit praktik të arsimit dhe të trajnimit për nevojat e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

3. Përfitues të këtyre trajnimeve do të jenë fermerët, punonjësit dhe specialistët e bujqësisë dhe të agroindustrisë.

Neni 37

Studimet analitike dhe zhvillimore

Ministria mbështet kryerjen e studimeve analitike dhe zhvillimore nga institucionet e arsimit të lartë dhe strukturat shkencore të tyre, kryesisht për:

- a) realizimin e analizave ekonomike dhe të tjera të impaktit në fushën e bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore;
- b) realizimin e analizave dhe të veprimtarive planifikuese në fushën e bujqësisë dhe industrisë agroushqimore;
- c) përmbushjen e përgjegjësisë të rëndësishme për trajnimin dhe monitorimin e çështjeve zhvillimore në fushën e bujqësisë, të industrisë agroushqimore dhe të zhvillimit rural.

KREU X KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 38

Rastet e kundërvajtjeve administrative

Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative rastet e:

1. Mospërdorimit të fondeve të dhëna përfituesve, në përputhje me qëllimin për të cilin ato janë dhënë.
2. Mosmbajtjes së dokumentacionit të përdorur për përfitimin e fondeve për një periudhë 4-vjeçare.

Neni 39

Sanksionet

1. Kundërvajtjet administrative, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 38 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 30 000 - 40 000 lekë, si dhe kthimin e financimit të përfituar.
2. Kundërvajtjet administrative, të përcaktuara në pikën 2 të nenit 38 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 10 000 - 15 000 lekë.

Dënimet jepen nga inspektorët e agjencisë së pagesave.

Neni 40

Ankimi

1. Kundërvajtësi, brenda 10 ditëve nga vënia e gjobës, bën ankim në agjencinë e pagesave, e cila shqyrton ankimin dhe, brenda 5 ditëve, njofton subjektin ankues.
2. Kundër vendimit të titullarit të agjencisë së pagesave subjekti ankues mund të bëjë ankim, brenda 10 ditëve nga marrja njoftim, te ministri, i cili duhet të shprehet për lënien në fuqi të gjobës ose shfuqizimin e saj brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.
3. Kundër vendimit të ministrit, subjekti ankues mund t'i drejtohet, brenda 30 ditëve, gjykatës së rrethit gjyqësor.

Neni 41

Vjelja e gjobave

1. Gjobat për kundërvajtje administrative, sipas këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi në llogarinë e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, brenda 30 ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë.
2. Për çdo ditë vonesë, pas plotësimit të këtij afati dhe deri në një afat prej 30 ditësh, kundërvajtësi detyrohet të paguajë, përveç gjobës, edhe një shumë të barabartë me 2 për qind të gjobës.

Neni 42

Të ardhurat e krijuara nga vendosja e gjobave kalojnë në masën 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

KREU XI DISPOZITA TË
FUNDIT

Neni 43

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, 5, 6 pika 3, 13 pika 2, 21 pika 3 dhe 29 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6 pika 3, 13 pika 2, 15 pika 3, 22 pika 4, 26, 29 e 34 të këtij ligji.

Neni 44

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5495, datë 31.10.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE KUADËR

NDËRMJET

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TË PËRFAQËSUAR NGA

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

KOMISIONIT EVROPIAN

PËR

*Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë
Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie
Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service*

**RREGULLAT E ZBATIMIT TË ASISTENCËS FINANCIARE TË BE-së
PËR SHQIPËRINË NË KUADËR TË INSTRUMENTIT PËR ASISTENCËN
E PARA-ANËTARËSIMIT (IPA II)**

E DATËS ()

Pasqyra e Lëndës

SEKSIONI I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	7
Neni 1	Interpretimi	7
Neni 2	Pavlefshmëria e pjeshme dhe mangësitë e paqëllimshme	7
Neni 3	Përkufizimet.....	7
Neni 4	Qëllimi dhe objektivi	8
Neni 5	Parimet e përgjithshme për asistencën financiare	9
Neni 6	Parimi i pronësisë.....	11
Neni 7	Metodat e zbatimit	12
Neni 8	Marrëveshjet e financimit.....	12
Neni 9	Marrëveshjet sektoriale	13
SEKSIONI II	RREGULLAT E MENAXHIMIT INDIREKT NGA PËRFITUESI IPA II.....	14
TITULLI I	SISTEMET E MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT	14
Neni 10	Ngritja e strukturave dhe autoriteteve për menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA II	14
Neni 11	Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave dhe autoriteteve	14
TITULLI II	DISPOZITA SPECIFIKE PËR T'I BESUAR PËRFITUESIT IPA II DETYRA TË ZBATIMIT	
TË BUXHETIT	15	
Neni 12	Kushtet për t'i besuar Përfituesit IPA II detyrat e zbatimit të buxhetit	15
Neni 13	Besimi i detyrave të zbatimit të buxhetit	17
Neni 14	Masat nëse struktura menaxhuese dhe strukturat operuese nuk përmbushin dispozitat e pikave (a), (b) dhe (d) të nenit 12(3) dhe ato të Shtojcës B të kësaj Marrëveshjeje	18
Neni 15	Pezullimi ose anulimi i disa pjesëve të Marrëveshjes së Financimit në lidhje me detyrat e besuara për zbatimin e buxhetit.....	18
SEKSIONI III	RREGULLAT E PROGRAMIMIT	18
Neni 16	Programimi i asistencës.....	18
Neni 17	Miratimi i programeve dhe ndryshimet	20
SEKSIONI IV	RREGULLAT E ZBATIMIT	20
TITULLI I	RREGULLAT E PËRGJITHSHME DHE PARIMET E ZBATIMIT.....	20
Neni 18	Rregullat për prokurimin dhe dhënien e granteve.....	20
Neni 19	Rregullat e shtetësisë dhe origjinës për prokurimin publik, grantet dhe procedurat e tjera të kontraktimit	21
Neni 20	Pjesëmarrja në programet dhe agjencitë e BE-së.....	23
Neni 21	Parimet e zbatimit të mbështetjes buxhetore për Përfituesin IPA II	23
Neni 22	Parimet e zbatimit për binjakëzimin	24
TITULLI II	TRANSPARENCA DHE VIZIBILITETI.....	24
Neni 23	Informimi, publiciteti dhe transparenca	24
Neni 24	Vizibiliteti dhe komunikimi.....	26
TITULLI III	MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE KONFIDENCIALITETI	26
Neni 25	Mbrojtja e të dhënave	26
Neni 26	Konfidencialiteti	27
TITULLI VI	OFRIMI I LEHTËSIRAVE DHE TAKSIMI	27
Neni 27	Ofrimi i lehtësirave për zbatimin e programeve dhe ekzekutimin e kontratave	27
Neni 28	Rregullat për taksat, tarifat doganore dhe fiskale	29
SEKSIONI V	RREGULLAT PËR MENAXHIMIN FINANCIAR TË ASISTENCËS IPA II.....	32

TITULLI I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	32
Neni 29	Pranueshmëria e shpenzimeve.....	32
Neni 30	Intensiteti i ndihmës dhe norma e kontributit të BE-së	33
TITULLI II	RREGULLAT QË LIDHEN ME MENAXHIMIN INDIREKT NGA PËRFITUESI IPA II.	33
Neni 31	Pranueshmëria e shpenzimeve në kuadrin e menaxhimit indirekt	33
Neni 32	Gjurma e auditit	33
Neni 33	Pagesat e kontributit të BE-së	33
Neni 34	Parafinancimi	35
Neni 35	Pagesat e ndërmjetme	35
Neni 36	Procedura e shqyrtimit dhe pranimit të llogarive	36
Neni 37	Pagimi i bilancit përfundimtar	37
Neni 38	Anulimi i fondeve të përdorura në rastin e programeve shumëvjeçare me buxhet të ndarë	38
Neni 39	Ndërprerja e pagesave.....	38
Neni 40	Pezullimi i pagesave	39
Neni 41	Rikuperimi i fondeve	39
Neni 42	Rregullimet financiare nga Përfituesi IPA II	39
Neni 43	Korrigjimet financiare nga Komisioni	39
Neni 44	Procedura për korrigjimet financiare dhe pranimin e llogarive	40
Neni 45	Ripërdorimi i kontributit të BE-së.....	41
Neni 46	Shlyerja	41
TITULLI III	MBYLLJA E PROGRAMIT	42
Neni 47	Mbyllja e programit me menaxhim indirekt nga Përfituesi IPA II	42
Neni 48	Mbyllja e programit me menaxhim direkt dhe indirekt me subjekte të ndryshme nga Përfituesi IPA II	42
Neni 49	Ruajtja e dokumenteve	42
TITULLI IV	MBIKËQYRJA, KONTROLLI, AUDITI DHE MBROJTJA E	43
INTERESAVE FINANCIARE		43
Neni 50	Mbikëqyrja, kontrolli dhe auditimi nga Komisioni dhe Gjykata Evropiane e Auditëve.....	43
Neni 51	Mbrojtja e interesave financiare të BE-së	45
SEKSIONI VI	MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI	47
Neni 52	Komiteti Monitorues IPA.....	47
Neni 53	Komiteti Monitorues Sektorial	48
Neni 54	Aktivitete monitoruese të tjera	49
TITULLI II	VLERËSIMI	50
Neni 55	Parimet e përgjithshme për vlerësimin e asistencës IPA II	50
Neni 56	Vlerësimet nga Komisioni	51
Neni 57	Vlerësimet nga Përfituesi IPA II në kuadrin e menaxhimit indirekt	51
TITULLI III	RAPORTIMI.....	52
Neni 58	Kërkesat bazë për raportimin pranë Komisionit	52
Neni 59	Kërkesat e raportimit pranë Komisionit në kuadrin e menaxhimit indirekt nga Përfituesi IPA II sipas nenit 60(5) të Rregullores Financiare	52
Neni 60	Raportet nga strukturat operuese në kuadrin e menaxhimit indirekt nga Përfituesi IPA II	54
Neni 61	Gjuha.....	54

SEKSIONI VII	DISPOZITAT PËR PROGRAMET ME AKSIONE SHUMËVJEÇARE ME ANGAZHIME FINANCIARE TË NDARA	54
Neni 62	Parimet e zbatimit për programet me aksione shumëvjeçare me angazhime financiare të ndara të zbatuara me menaxhim indirekt nga Përfituesi IPA II.....	54
SEKSIONI VIII	DISPOZITAT PËR PROGRAMET E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR	56
TITULLI I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	56
Neni 63	Format e bashkëpunimit ndërkufitar	56
Neni 64	Përkufizime shtesë për bashkëpunimin ndërkufitar.....	57
Neni 65	Intensiteti i ndihmës dhe norma e asistencës IPA II	57
TITULLI II	RREGULLAT PËR PROGRAMIMIN	57
Neni 66	Prioritetet tematike dhe përqendrimi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA	57
Neni 67	Shtrirja gjeografike.....	58
Neni 68	Përgatitja, vlerësimi, miratimi dhe ndryshimet në programet e bashkëpunimit ndërkufitar	58
Neni 69	Marrëveshjet dypalëshe ndërmjet vendeve pjesëmarrëse për menaxhimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar të zbatuara me menaxhim indirekt.....	59
TITULLI III	OPERACIONET	60
Neni 70	Përzgjedhja e operacioneve.....	60
Neni 71	Përfituesit	60
Neni 72	Asistenca teknike.....	60
TITULLI IV	ZBATIMI	61
Neni 73	Modalitetet e zbatimit.....	61
TITULLI V	STRUKTURAT DHE AUTORITETET E PROGRAMIT DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE .	61
Neni 74	Strukturat dhe autoritetet për menaxhimin e BNK-së	61
Neni 75	KKIPA.....	62
Neni 76	Strukturat operuese	62
Neni 77	Autoriteti Auditues.....	64
Neni 78	Komiteti i Përbashkët Monitorues (KPM)	64
Neni 79	Sekretariati i Përbashkët Teknik (SPT).....	65
TITULLI VI	RAPORTIMI.....	66
Neni 80	Raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit	66
SEKSIONI IX	DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE.....	67
Neni 81	Komunikimi	67
Neni 82	Konsultimi.....	68
Neni 83	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, arbitrazhi	68
Neni 84	Mosmarrëveshjet me palët e treta	68
Neni 85	Njoftimet.....	69
Neni 86	Shtojcat.....	69
Neni 87	Hyrja në fuqi	69
Neni 88	Zbatueshmëria e Marrëveshjes Kuadër për IPA-n	70
Neni 89	Ndryshimet	70
Neni 90	Afati i Marrëveshjes.....	70

Shtojcat:

- SHTOJCA A: Funkcionet dhe përgjegjësitë e strukturave, autoriteteve dhe organeve sipas nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje Kuadër
- SHTOJCA B: Kuadri i kontrollit të brendshëm
- SHTOJCA C: Model Deklarate e Menaxhimit
- SHTOJCA D: Model Raporti Vjetor të Aktivitetit Auditues
- SHTOJCA E: Model Opinioni Auditit Vjetor
- SHTOJCA F: Model Opinioni Auditit për pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve
- SHTOJCA G: Modeli i Strategjisë së Auditit
- SHTOJCA H: Raportimi për mashtrimin e dyshuar dhe parregullsi të tjera në lidhje me Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II)
- SHTOJCA I: Prioritetet tematike për asistencë
- SHTOJCA J: Prioritetet tematike për asistencë për bashkëpunimin territorial.

Komisioni Evropian, më poshtë i referuar si **“Komisioni”**, i cili vepron për dhe në emër të Bashkimit Evropian

nga njëra anë,

dhe

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë, më poshtë i referuar si **“Përfituesi IPA II”**,

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht të referuara si **“Palët”**.

Duke marrë parasysh se:

- (1) Më 11 mars 2014, Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratuan Rregulloren (BE) Nr. 231/2014 mbi krijimin e instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit¹ (më poshtë e referuar si “Rregullorja IPA II”). Ky instrument përbën bazën ligjore për dhënien e asistencës financiare përfituesve të renditur në Shtojcën I të Rregullores IPA II (më poshtë të referuar si “Përfituesit IPA II”), për t'i ndihmuar në miratimin dhe zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike që kërkohen nga këta përfitues për të qenë në pajtim me vlerat e BE-së dhe për të përafuar gradualisht rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së, me synimin për t'u bërë anëtarë të BE-së;
- (2) Më 11 mars 2014, Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratuan Rregulloren (BE) Nr. 236/2014 që përcakton procedura dhe rregulla të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të BE-së për financimin e masave të jashtme² (më poshtë e referuar si “Rregullorja e Përbashkët Zbatuese”);
- (3) Më 2 maj 2014, Komisioni miratoi Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 447/2014 mbi rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II)³ (më poshtë e referuar si “Rregullorja Zbatuese IPA II”), ku përcaktohen dispozitat e zbatueshme për menaxhimin dhe kontrollin;

¹ Rregullorja (BE) Nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 mars 2014 mbi krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II) (GZ L 77, 15 mars 2014, faqe 11).

² Rregullorja (BE) Nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 mars 2014 që përcakton procedura dhe rregulla të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të BE-së për financimin e masave të jashtme (GZ L 77, 15 mars 2014, faqe 95).

³ Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) Nr. 447/2014 mbi rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II) (GZ L 132, 3 maj 2014, faqe 32).

- (4) Përfituesi IPA II ka të drejtë të përfitojë fonde nga IPA II, siç parashikon Rregullorja IPA II;
- (5) Neni 8 i Rregullores IPA II kërkon që Komisioni dhe përfituesit IPA II të lidhin Marrëveshje Kuadër për zbatimin e asistencës;
- (6) Si rrjedhojë, nevojitet të përcaktohen rregullat për zbatimin e asistencës financiare të BE-së në kuadrin e IPA II;

BIEN DAKORD SI MË POSHTË:

SEKSIONI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Interpretimi

- (1) Në rast të ndonjë dispozite të shprehur që bie ndesh me këtë Marrëveshje, termat e përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që iu atribuohet në Rregulloren IPA II, Rregulloren e Përbashkët Zbatuese dhe Rregulloren Zbatuese IPA II.
- (2) Në rast të ndonjë dispozite të shprehur që bie ndesh me këtë Marrëveshje, referencat për këtë Marrëveshje konsiderohen ashtu siç janë ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar herë pas here.
- (3) Çdo referencë ndaj Rregulloreve të Parlamentit Evropian dhe Këshillit apo ndaj Rregulloreve të Komisionit konsiderohen si referenca të këtyre akteve normative ashtu siç janë ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar herë pas here.
- (4) Nëntitujt e kësaj Marrëveshjeje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

Neni 2 Pavlefshmëria e pjesshme dhe mangësitë e paqëllimshme

Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme apo nëse kjo Marrëveshje përmban mangësi të paqëllimshme, kjo nuk cenon vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme apo akt mirëkuptimi që i afrohet sa të jetë e mundur qëllimit dhe objektivit të dispozitës së pavlefshme. Palët plotësojnë çdo mangësi të paqëllimtë me një dispozitë apo akt mirëkuptimi që i përshtatet siç duhet qëllimit dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me Rregulloren IPA II dhe Rregulloren Zbatuese IPA II.

Neni 3 Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, këto përkufizime kanë këtë kuptim:

- a) "Program" do të thotë një program masash individuale, të posaçme apo mbështetëse, të parashikuara në nenet 2 dhe 3 të Rregullores së Përbashkët Zbatuese;
- b) "Marrëveshje Sektoriale" do të thotë një marrëveshje që lidhet ndërmjet Komisionit dhe përfituesit IPA II për një fushë apo program specifik të IPA II, ku përcaktohen rregullat dhe procedurat që duhen respektuar të cilat nuk përfshihen në këtë Marrëveshje apo në Marrëveshjet e Financimit;
- c) "Marrëveshje Financimi" do të thotë një marrëveshje njëvjeçare ose shumëvjeçare që lidhet ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit IPA II, për zbatimin e asistencës financiare të BE-së nëpërmjet aktiviteteve që janë brenda fushës së veprimit të Rregullores Zbatuese IPA II;
- d) "Vendet pjesëmarrëse" do të thotë vetëm përfituesit IPA II ose përfituesit IPA II bashkë me Shtetin/Shtetet Anëtare ose me vendet që janë brenda fushës së veprimit të Instrumentit Evropian të Fqinjësisë⁴ të cilat marrin pjesë në një program shumëvjeçar për bashkëpunimin ndërkufitar, i cili është hartuar bashkërisht nga vendet pjesëmarrëse;
- e) "Marrës" do të thotë përfituesi i grantit (përfshirë një kontraktues binjakëzimi), kontraktuesi që përfiton kontratë shërbimi, furnizimi ose punimesh, përfituesi në kuadrin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, pala kontraktuese në një marrëveshje delegimi në kuadrin e menaxhimit indirekt apo çdo person fizik apo juridik që merr asistencë IPA II.
- f) "Vit financiar" do të thotë periudha nga 1 janari deri më 31 dhjetor të një vitit të caktuar.

Neni 4 Qëllimi dhe objektivi

- (1) Me qëllimin për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet Palëve dhe për të ndihmuar Përfituesin IPA II në përafrimin gradual me standardet dhe politikat e BE-së, përfshirë *acquis*, në kuadrin e procesit të anëtarësimit, Palët bien dakord të zbatojnë aktivitete në fushat e mëposhtme të parashikuara për Përfituesit IPA II, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të Rregullores IPA II;
 - a) reformat në përgatitjen për anëtarësim në BE dhe forcimi institucional dhe i kapaciteteve për këtë qëllim;
 - b) zhvillimi socio-ekonomik dhe rajonal;

⁴ Rregullorja (BE) Nr. 232/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 mars 2014 që krijon Instrumentin Evropian të Fqinjësisë (GZ L 77, 15 mars 2014, faqe 27).

- c) punësimi, politikat sociale, arsimi, nxitja e barazisë gjinore dhe zhvillimi i burimeve njerëzore;
 - d) bujqësia dhe zhvillimi rural;
 - e) bashkëpunimi rajonal dhe territorial.
- (2) Aktivitetet financohen dhe zbatohen brenda kuadrit ligjor, administrativ dhe teknik të parashikuar në këtë Marrëveshje dhe të përcaktuar më hollësisht në Marrëveshjet Sektoriale dhe/ose Marrëveshjet e Financimit, nëse ka.
- (3) Kur Fondi Evropian për Zhvillimin Rajonal kontribuon në programe apo masa të krijuara në kuadrin e Rregullores IPA II për bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet përfituesve IPA II dhe Shteteve Anëtare në zbatim të nenit 9(2) të Rregullores IPA II, kjo asistencë zbatohet sipas Rregullores Zbatuese IPA.
- (4) Kur asistenca IPA II kontribuon në masa apo programe bashkëpunimi transkombëtar dhe ndër-rajonal të ngritur në kuadrin e Rregullores (BE) Nr. 1299/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit⁵ në zbatim të nenit 9(3) të Rregullores IPA II, kjo asistencë zbatohet sipas kësaj Rregulloreje.
- (5) Kur asistenca IPA II kontribuon në masa apo programe bashkëpunimi ndërkufitar të krijuara në kuadrin e Rregullores (BE) Nr. 232/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit⁶ dhe në zbatim të nenit 9(4) të Rregullores IPA II, kjo pjesëmarrje zbatohet sipas asaj Rregulloreje.
- (6) Kur është e përshtatshme, asistenca IPA II mund të kontribuojë në masa dhe programe që miratohen si pjesë e një strategjie makrorajonale.
- (7) Administrata e përfituesit IPA II merr të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e programeve përkatëse.

Neni 5 Parimet e përgjithshme për asistencën financiare

- (1) Parimet që udhëheqin asistencën financiare të BE-së në kuadrin e IPA II janë:
- a) asistenca duhet të respektojë parimet e koherencës, komplementaritetit, bashkërendimit, partneritetit dhe përqendrimit;

⁵ Rregullorja (BE) Nr. 1299/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 17 dhjetorit 2013 mbi dispozitat specifike për mbështetjen nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal për objektivin e bashkëpunimit territorial evropian (GZ L 347, 20 dhjetor 2013, faqe 259).

⁶ Rregullorja (BE) Nr. 232/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit që krijon Instrumentin Evropian të Fqinjësisë Evropiane (GZ L 77, 15.3.2014, faqe 27).

- b) asistenca duhet të jetë në koherencë me politikat e BE-së dhe mbështet përafrimin gradual me *acquis*;
 - c) asistenca zbaton parimet buxhetore të përcaktuara në Rregulloren (BE, Euratom) Nr. 966/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit⁷ (më poshtë e referuar si “Rregullore Financiare”) dhe në Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) Nr. 1268/2012 (më poshtë të referuara si “Rregullat e Zbatimit të Rregullores Financiare”)⁸;
 - d) asistenca duhet të jetë në përputhje me nevojat e identifikuar gjatë procesit të zgjerimit dhe kapaciteteve përthithëse të Përfituesit IPA II. Gjithashtu, do të mbahen parasysh mësimet e nxjerra nga asistenca e mëparshme;
 - e) të nxitë fuqimisht pronësinë e Përfituesit IPA II të programimit dhe zbatimit të asistencës, si dhe të garantohet vizibilitet i mjaftueshëm i ndërhyrjeve të BE-së;
 - f) operacionet duhet të planifikohen me objektiva të qarta dhe të verifikueshme që duhen arritur brenda një periudhe të caktuar; rezultatet e arritura duhet të vlerësohen me tregues specifikë, të matshëm, të miratuar, realistë dhe kohorë (SMART);
 - g) gjatë zbatimit të asistencës, ndalohet çdo diskriminim mbi bazë gjinie, race, përkatësie etnike, feje apo besimi, aftësie të kufizuar, moshe apo orientimi seksual;
 - h) objektivat e asistencës së para-anëtarësimit duhet të jenë në koherencë me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, përfshirë zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
- (2) Asistenca për Përfituesin IPA II jepet mbi bazën e prioriteteve të identifikuar në kuadrin e politikave të zgjerimit të përcaktuara nga Këshilli Evropian dhe Këshilli, duke pasur parasysh siç duhet Komunikatën për Strategjinë e Zgjerimit dhe Progres-Raportet që përmbajnë paketat vjetore të zgjerimit të Komisionit, si edhe rezolutat përkatëse të Parlamentit Evropian.

Në përputhje me objektivat specifike të përcaktuara në nenin 2(1) të Rregullores IPA II, prioritetet tematike të asistencës sipas nevojave dhe kapaciteteve të Përfituesve IPA II

⁷ Rregullorja (BE, Euratom) Nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 tetor 2012 mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të BE-së dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) Nr. 1605/2002 (GZ L 298, 26 tetor 2012, faqe 1).

⁸ Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) Nr. 1268/2012 e datës 29 tetor 2012 mbi rregullat e zbatimit të Rregullores (BE, Euratom) Nr. 966/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 tetor 2012 mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të BE-së (GZ L 362, 31 dhjetor 2012, faqe 1).

përcaktohen në Shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje. Secili prioritet tematik mund të kontribuojë në arritjen e një apo më shumë objektivave specifike.

Në përputhje me objektivat specifike të përcaktuara në pikën (d) të nenit 2(1) të Rregullores IPA II, asistenca mbështet bashkëpunimin ndërkufitar, si ndërmjet Përfituesve IPA II, ashtu edhe ndërmjet tyre dhe Shteteve Anëtare apo vendeve në kuadrin e Instrumentit Evropian të Fqinjësisë, me qëllim nxitjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, fuqizimin e integritimit evropian dhe nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik. Prioritetet tematike që përfitojnë asistencë për bashkëpunim territorial përcaktohen në Shtojcën J të kësaj Marrëveshjeje.

- (3) Asistenca IPA II jepet mbi bazën e dokumenteve strategjike kombëtare ose shumëvendëshe (më poshtë të referuara si “dokumente strategjike”) të hartuar nga Komisioni me bashkëpunimin me Përfituesit IPA II, për kohëzgjatjen e kuadrit financiar shumëvjeçar të BE-së për periudhën 2014-2020.
- (4) Kusht për dhënien e asistencës IPA II është plotësimi nga Përfituesi IPA II i të gjitha detyrimeve që parashikon kjo Marrëveshje, si dhe Marrëveshjet Sektoriale dhe Marrëveshjet e Financimit, nëse ka.

Neni 6 Parimi i pronësisë

- (1) Përfituesi IPA II ka kryesisht pronësinë për programimin dhe zbatimin e asistencës IPA II.
- (2) Përfituesi IPA II emëron Koordinatorin Kombëtar IPA (KKIPA) që shërben si strukturë homologe e Komisionit për të gjithë procesin e planifikimit strategjik, bashkërendimin e programimit, monitorimin e zbatimit, vlerësimin dhe raportimin e asistencës IPA II.

KKIPA ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) garanton bashkërendimin brenda administratës së Përfituesit IPA II dhe me donatorët e tjerë, si dhe shërben dhe harmonizon përdorimin e asistencës IPA II me procesin e anëtarësimit në BE;
 - b) bashkërendon pjesëmarrjen e Përfituesve IPA II në programet përkatëse të bashkëpunimit territorial, konkretisht programet e bashkëpunimit ndërkufitar të përcaktuara në nenin 27 të Rregullores Zbatuese IPA si edhe, sipas rastit, në programet e bashkëpunimit transkombëtar dhe ndër-rajonal të krijuara dhe të zbatuara në kuadrin e Rregullores (BE) Nr. 1299/2013, si edhe programet e bashkëpunimit ndërkufitar të ngritura dhe të zbatuara në kuadrin e Rregullore (BE) Nr. 232/2014. KKIPA mund të delegojë këtë detyrë bashkërendimi te një koordinator apo strukturë operuese përgjegjëse për bashkëpunimin territorial, sipas rastit;
-

- c) përpiqet që administrata e Përfituesit IPA II të marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e programeve përkatëse;
- (3) KKIPA është përfaqësues i lartë i qeverisë apo i administratës kombëtare të Përfituesit IPA II që gëzon autoritetin e duhur.
- (4) Komisioni dhe Përfituesi IPA II vendosin dialog për menaxhimin financiar publik, me qëllim menaxhimin e qëndrueshëm të asistencës së para-anëtarësimit dhe fondeve kombëtare. Në këtë drejtim, Komisioni vlerëson se në ç'masë administrata e Përfituesit IPA II përmbush parimet e një sistemi menaxhimi financiar publik të hapur dhe të rregullt. Nëse administrata përmbush këto kërkesa vetëm pjesërisht, Përfituesi IPA II dhe Komisioni miratojnë masat e nevojshme për trajtimin e mangësive të identifikuara në këtë drejtim.

Neni 7 Metodatat e zbatimit

Komisioni zbaton asistencën IPA II në Republikën e Shqipërisë, siç parashikon Rregullorja Financiare, me:

- a) menaxhim direkt nga departamentet e Komisionit, përfshirë personelin e vet në Delegacionet e BE-së dhe/ose përmes agjencive zbatuese, sipas pikës (a) të nenit 58(1) të Rregullores Financiare;
- b) menaxhim indirekt, ku Komisioni ia beson Përfituesit IPA II detyrat e zbatimit të buxhetit për programe apo aksione të caktuara, sipas pikës (i) të pikës (c) të nenit 58(1) të Rregullores Financiare, por duke mbajtur vetë përgjegjësinë e përgjithshme financiare për zbatimin e buxhetit, sipas nenit 58(2) të Rregullores Financiare;
- c) menaxhim indirekt me subjekte të tjera nga Përfituesit IPA II, sipas pikave (ii), (iii), (v) deri (vii) të pikës (c) të nenit 58(1) të Rregullores Financiare;
- d) menaxhim të përbashkët me Shtetet Anëtare sipas pikës (b) të nenit 58(1) të Rregullores Financiare për programet e bashkëpunimit ndërkufitar ku marrin pjesë Shtete Anëtare të BE-së dhe që zbatohen siç përcakton Rregullorja Zbatuese IPA II.

Neni 8 Marrëveshjet e Financimit

- 1) Komisioni dhe Përfituesi IPA II lidhin Marrëveshje Financimi sipas nenit 6 të Rregullores Zbatuese IPA II, kur kërkohet nga vendimi financues përkatës.
- 2) Marrëveshjet e Financimit përcaktojnë, ndër të tjera, kushtet e menaxhimit të asistencës IPA II, përfshirë metodat e zbatimit, intensitetin e ndihmës, afatet e zbatimit, si edhe rregullat për pranueshmërinë e shpenzimeve.

- 3) Për programet që zbatohen me menaxhim indirekt nga Përfituesi IPA II, Marrëveshjet e Financimit përfshijnë dispozitat e kërkuara nga neni 40 i Rregullave të Zbatimit të Rregullores Financiare, si dhe dispozitat që përcaktojnë kontrollin *ex-ante* për procedurat e shpalljes së fituesve për grante dhe prokurime, nëse ka, të cilat kryhen nga Delegacioni i BE-së apo Komisioni, si edhe ato që përcaktojnë kontrollin dhe mbikëqyrjen, nëse ka, të kryera nga Delegacioni i BE-së apo Komisioni.
- 4) Për programet e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet përfituesve IPA II apo përfituesve IPA II dhe vendeve që përfshin Instrumenti Evropian i Fqinjësisë, mund të nënshkruhet vetëm një Marrëveshje Financimi ndërmjet Komisionit dhe të gjitha vendeve pjesëmarrëse në një program të caktuar.
- 5) Rregullat për zbatimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet një apo më shumë Shteteve Anëtare dhe një apo më shumë Përfituesve IPA II përcaktohen në Marrëveshjen e Financimit që lidhet për programin e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet Përfituesit IPA II, Komisionit dhe, sipas rastit, Shtetit Anëtar ku ngrihet Autoriteti Menaxhues i atij programi bashkëpunimi ndërkufitar.
- 6) Sipas nenit 26 të Rregullores (BE) Nr. 1299/2013, kërkesat e zbatimit të programit që disiplinon menaxhimin financiar si edhe programimin, monitorimin, vlerësimin dhe kontrollin e pjesëmarrjes së vendeve të treta, nëpërmjet një kontributi të burimeve IPA II, në programet e bashkëpunimit transkombëtar dhe ndër-rajonar të krijuara dhe të zbatuara në kuadrin e asaj Rregulloreje ndërmjet Shteteve Anëtare dhe një apo më shumë Përfituesve IPA II, përcaktohen në programin e bashkëpunimit përkatës si dhe, nëse është e nevojshme, në marrëveshjen e financimit ndërmjet Komisionit, qeverive të vendeve të treta në fjalë dhe Shtetit Anëtar ku ngrihet autoriteti menaxhues i programit të bashkëpunimit, duke garantuar qëndrueshmërinë e këtyre kriterëve me rregullat e kohezionit të BE-së.
- 7) Kjo Marrëveshje Kuadër është e zbatueshme për të gjitha Marrëveshjet Sektoriale dhe Marrëveshjet e Financimit të lidhura ndërmjet Palëve për asistencë financiare në kuadrin e IPA II. Marrëveshjet Sektoriale ekzistuese për një fushë apo program të caktuar janë të zbatueshme për të gjitha Marrëveshjet e Financimit të lidhura për atë fushë apo program. Kur nuk ekziston Marrëveshje Financimi, zbatohen rregullat e parashikuara në këtë Marrëveshje.

Neni 9 Marrëveshjet sektoriale

Në Marrëveshjet Sektoriale jepen më shumë hollësi mbi programet e zhvillimit rural në kuadrin e fushës së bujqësisë dhe zhvillimit rural që plotësojnë këtë Marrëveshje, të cilat parashikojnë ndër të tjera masat që udhëheqin zbatimin e asistencës.

SEKSIONI II RREGULLAT E MENAXHIMIT INDIREKT NGA PËRFITUESI IPA II**TITULLI I SISTEMET E MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT****Neni 10 Ngritja e strukturave dhe autoriteteve për menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA II**

(1) Në menaxhim indirekt, Përfituesi IPA II ngre strukturat dhe autoritetet e mëposhtme:

- a) Koordinatori Kombëtar i IPA-s (KKIPA/NIPAC);
- b) Zyrtari Kombëtar i Autorizuar (ZKA/NAO);
- c) strukturat operuese (SO/OS).

Struktura operuese për programet e zhvillimit rural në fushën 'bujqësia dhe zhvillimi rural' përbëhet nga këto autoritete individuale që veprojnë në bashkëpunim të ngushtë:

- i. Autoriteti Menaxhues, organ publik në nivel kombëtar, i ngarkuar me përgatitjen dhe zbatimin e programeve, përfshirë përzgjedhjen e masave dhe publicitetin e tyre, me bashkërendimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e programit në fjalë, që drejtohet nga një zyrtar i lartë me përgjegjësi ekskluzive;
- ii. Agjencia e Zhvillimit Rural IPA (IPARD) me funksione të ngjashme të një agjencie pagesash në Shtetet Anëtare, e ngarkuar me publicitetin, përzgjedhjen e projekteve si edhe autorizimin, kontrollin dhe kontabilizimin e shumave të akorduara dhe pagesat, si edhe me ekzekutimin e pagesave.

(2) ZKA ngre një strukturë menaxhimi të përbërë nga Fondi Kombëtar dhe një zyrë mbështetëse për ZKA-në.

(3) Përfituesi IPA II krijon kushtet për një autoritet auditimi.

(4) Përfituesi IPA II garanton ndarje të mjaftueshme të funksioneve ndërmjet dhe brenda strukturave dhe autoriteteve të parashikuara në paragrafët (1) deri në (3). Detyrat ndahen kur persona të ndryshëm kryejnë detyra të ndryshme që lidhen me të njëjtin transaksion, me qëllim që të garantohet zbatimi i duhur i çdo detyre.

Neni 11 Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave dhe autoriteteve

- (1) Strukturave dhe autoriteteve të përmendura në nenin 10 iu ngarkohen funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Shtojcën A që duhet të respektojnë kuadrin e kontrollit të brendshëm të Shtojcës B të kësaj Marrëveshjeje.
- (2) Përfituesi IPA II menjëherë informon Komisionin për ndonjë ndryshim thelbësor në strukturat dhe autoritetet e përmendura në nenin 10.
- (3) Në Marrëveshjet Sektoriale dhe Marrëveshjet e Financimit mund të përcaktohen funksione apo përgjegjësi për fusha apo programe specifike, në përputhje me përqasjen bazë të zgjedhur për ngarkimin e funksioneve dhe përgjegjësive sipas Shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje.
- (4) Nën menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA II, nëse personave dhe/apo subjekteve specifike iu janë ngarkuar përgjegjësi për një aktivitet në lidhje me menaxhimin, zbatimin, kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin, vlerësimin, raportimin apo auditimin e programeve, Përfituesi IPA II iu mundëson këtyre personave dhe/ose subjekteve ushtrimin e detyrave që shoqërojnë këtë përgjegjësi. Këtu përfshihen veçanërisht rastet kur nuk ka lidhje hierarkike ndërmjet këtyre personave dhe/ose subjekteve dhe organeve pjesëmarrëse në atë aktivitet. Përfituesi IPA II iu garanton këtyre personave dhe/ose subjekteve autoritetin për të miratuar:
 - a) marrëdhënie formale pune ndërmjet tyre dhe organeve në fjalë;
 - b) një sistem të mjaftueshëm për shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre dhe organeve në fjalë, përfshirë kompetencën për të kërkuar informacion dhe të drejtën e aksesit në dokumentacion dhe të personelit në terren, nëse është e nevojshme;
 - c) standardet që duhen përmbushur dhe procedurat që duhen ndjekur.

TITULLI II DISPOZITA SPECIFIKE PËR T'I BESUAR PËRFITUESIT IPA II DETYRA TË ZBATIMIT TË BUXHETIT

Neni 12 Kushtet për t'i besuar Përfituesit IPA II detyrat e zbatimit të buxhetit

- (1) Komisioni ia beson Përfituesit IPA II detyrat e zbatimit të buxhetit, duke lidhur një Marrëveshje Financimi.
- (2) Gjatë menaxhimit të fondeve IPA II, Përfituesi IPA II respekton parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar⁹, transparencës dhe mos-diskriminimit, si dhe garanton vizibilitet

⁹ Parimi i menaxhimit të qëndrueshëm financiar përfshin parimet e ekonomisë, efijencës dhe efektivitetit. Parimi i ekonomisë kërkon që burimet të përdoren në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur, si edhe me çmimin më të mirë. Parimi i efijencës kërkon marrëdhënien më të mirë midis burimeve që shfrytëzohen dhe rezultateve që arrihen. Parimi i efektivitetit kërkon arritjen e objektivave specifike të vendosura, si edhe arritjen e rezultateve të synuara.

të asistencës IPA II. Përfituesi IPA II garanton shkallë mbrojtjeje të interesave financiare të Bashkimit Evropian në masën që e kërkon Rregullorja Financiare, duke pasur mirë parasysh:

- a) natyrën e detyrave që i janë besuar dhe shumat përkatëse;
- b) rreziqet financiare;
- c) nivelin e sigurisë të sistemeve, rregullave dhe procedurave të tyre, bashkë me masat e ndërmarra nga Komisioni, me qëllim mbikëqyrjen dhe mbështetjen e zbatimit të detyrave që iu janë ngarkuar.

(3) Për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian, Përfituesi IPA II ka detyrimet e mëposhtme:

- a) ngre një sistem kontrolli të brendshëm funksional, efikas dhe eficient;
- b) përdor sistem kontabël që jep informacion të saktë, të plotë dhe të besueshëm në kohën dhe mënyrën e duhur, i cili dallon qartë kostot e pranuar nga pagesat e kryera;
- c) garanton që strukturat dhe autoritetet e përmendura në nenin 10(1) dhe (2) të jenë objekt auditimi të jashtëm të pavarur, që respekton standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht dhe që realizohet nga një autoritet auditimi funksionalisht i pavarur nga këto struktura dhe autoritete;
- d) zbaton rregullat dhe procedurat e duhura për të garantuar financim nga asistenca IPA II nëpërmjet granteve, prokurimit dhe instrumenteve financiare.

(4) Përfituesi IPA II ka edhe këto detyrime:

- a) në bazë të nenit 23, garanton publikimin *ex-post* të informacionit për marrësit e asistencës IPA II;
- b) garanton mbrojtje të arsyeshme të të dhënave personale sipas Direktivës 95/46/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit¹⁰ si dhe Rregullores (KE) Nr. 45/2001 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit¹¹.

(5) Nëse kryhen ndryshime thelbësore në sistemet apo rregullat e Përfituesit IPA II ose procedurave që lidhen me menaxhimin e fondeve të BE-së që i është besuar Përfituesit

¹⁰ Direktiva 95/46/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 24 tetor 1995 për mbrojtjen e individëve në lidhje me trajtimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave (GZ L 281, 23 nëntor 1995, faqe 31).

¹¹ Rregullorja (KE) Nr. 45/2001 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 18 dhjetor 2010 për mbrojtjen e individëve në lidhje me trajtimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Komunitetit, si edhe qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave (GZ L 8, 12 janar 2001, faqe 1).

IPA II, ky i fundit informon menjëherë Komisionin pa asnjë vonesë. Komisioni shqyrton marrëveshjet e financimit të lidhura me Përfituesin IPA II, me qëllim që të garantojë përmbushje të vazhdueshme të kërkesave të përcaktuara në paragrafin 3.

Neni 13 Besimi i detyrave të zbatimit të buxhetit

- (1) ZKA, në emër të Përfituesit IPA II, ka detyrimin që t'i dorëzojë Komisionit një kërkesë për të marrë detyrat e zbatimit të buxhetit në kuadrin e një programi apo mase.
- (2) Para dorëzimit të kërkesës së përmendur në paragrafin 1, ZKA garanton që struktura menaxhuese dhe struktura(t)operuese përkatëse të përmbushin kërkesat e pikave (a), (b) dhe (d) të nenit 12(3), si dhe ato të Shtojcës B të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, ZKA mund të bazohet në rezultatet e një vlerësimi *ex-ante* të kryer në kuadrin e akreditimit kombëtar që kërkon Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1085/2006¹² apo një Marrëveshje e mëparshme Financimi.

Nëse ZKA nuk mund të bazohet në ndonjë vlerësim të mëparshëm *ex-ante*, kërkesa mbështetet nga një opinion auditiv për strukturën menaxhuese dhe strukturën(at) operuese, i cili hartohet nga një auditues i jashtëm i pavarur nga strukturat dhe autoritetet e përmendura në nenin 10(1) dhe (2) dhe bazohet në shqyrtimet e kryera sipas standardeve të auditimit të pranuar ndërkombëtarisht.

- (3) Kërkesa shoqërohet me një konfirmim të kryer prej ZKA-së, KKIPA-s dhe titullarit të autoritetit auditues, se ata janë gati të realizojnë funksionet dhe përgjegjësitë që iu janë ngarkuar në Shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje.
- (4) Para se të besojë detyra zbatimi të buxhetit të asistencës IPA II, Komisioni shqyrton kërkesën e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, si edhe strukturat dhe autoritetet e përmendura në nenin 10 dhe, për qëllime të vlerësimit *ex-ante* sipas nenit 61(1) të Rregullores Financiare, siguron prova për t'u bindur se janë përmbushur kërkesat e pikave (a) deri në (d) të nenit 12(3) dhe ato të Shtojcës B të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë shqyrtim, Komisioni mund të kryejë verikime në terren.

Për të besuar detyra zbatimi të buxhetit të asistencës IPA II, Komisioni mund të bazohet në vlerësimin *ex-ante* të kryer në kuadrin e një Marrëveshjeje të mëparshme Financimi me Përfituesin IPA apo një vlerësimi *ex ante* të kryer për dhënien e kompetencave të menaxhimit sipas Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1085/2006. Me kërkesë të Komisionit, Përfituesi IPA II paraqet të dhëna shtesë, nëse këto vlerësime nuk përmbushin të gjitha kërkesat.

¹²

Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1085/2006 e datës 17 korrik 2016 për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paranëtarësimin (IPA) (GZ L 2010, 31 korrik 2006, faqe 82).

Neni 14 Masat nëse struktura menaxhuese dhe strukturat operuese nuk përmbushin dispozitat e pikave (a), (b) dhe (d) të nenit 12(3) dhe ato të Shtojcës B të kësaj Marrëveshjeje

- (1) Pasi Komisioni i beson detyrat e zbatimit të buxhetit, ZKA monitoron respektimin në vazhdim nga struktura menaxhuese dhe struktura(t) operuese, të kërkesave përkatëse të parashikuara në pikat (a), (b) dhe (d) të nenit 12(3) dhe ato të Shtojcës B të kësaj Marrëveshjeje. Nëse nuk respektohen këto kërkesa, ZKA informon Komisionin pa vonesë dhe vë në dijeni KKIPA-n, si dhe merr masat e duhura garantuese për pagesat e kryera dhe kontratat e nënshkruara.
- (2) Përveç kësaj, ZKA merr masat e nevojshme për të garantuar ri-përmbushjen e kërkesave të përmendura në paragrafin 1.

Neni 15 Pezullimi ose anulimi i disa pjesëve të Marrëveshjes së Financimit në lidhje me detyrat e besuara për zbatimin e buxhetit

- (1) Komisioni monitoron respektimin e neneve 12(3) dhe 53(1) dhe mund të marrë në çdo kohë masa korrigjuese, përfshirë pezullimin apo anulimin e pjesëve të Marrëveshjes së Financimit, nëse këto kërkesa nuk respektohen më.
- (2) Nëse Komisioni pezullon apo anulon pjesë të Marrëveshjes së Financimit në lidhje me besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit, zbatohen dispozitat e mëposhtme:
 - a) Komisioni mund të ndërpresë transferimin e fondeve të Përfituesit IPA II;
 - b) angazhimet ligjore që struktura operuese kërkon pas njoftimit për pezullimin apo anulimin, konsiderohen të papranueshme për asistencën IPA II;
 - c) pa cenuar mundësinë e korrigjimeve financiare të mëtejshme, Komisioni mund të bëjë korrigjime financiare sipas nenit 43 për transaksionet që preken prej mosrespektimit të mëparshëm të kërkesave që lidhen me detyrat e besuara për zbatimin e buxhetit.
- (3) Marrëveshja Sektoriale apo e Financimit mund të përcaktojë dispozita të hollësishme për pezullimin apo anulimin e pjesëve që lidhen me detyrat e besuara për zbatimin e buxhetit.

SEKSIONI III RREGULLAT E PROGRAMIMIT

Neni 16 Programimi i asistencës

- (1) Asistenca IPA II jepet mbi bazën e dokumenteve strategjike të hartuara për kohëzgjatjen e Kuadrit Financiar Shumëvjeçar të BE-së nga Komisioni, në bashkëpunim me Përfituesin IPA II. Kjo asistencë zbatohet nëpërmjet programeve dhe masave të përcaktuara në nenet 2 dhe 3 të Rregullave të Përbashkëta Zbatuese. Si rregull, zbatimi kryhet mbi baza njëvjeçare ose shumëvjeçare, mbi bazë vendi ose programi shumëvendësh, si edhe mbi bazën e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar të ngritur në përputhje me dokumentet strategjike dhe të hartuar nga Përfituesi IPA II dhe/ose Komisioni, sipas rastit, dhe të miratuar nga Komisioni.
- (2) Programet kombëtare apo shumëvendëshe vjetore apo shumëvjeçare bazohen në dokumente masash/aksionesh, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje. Dokumentet e masave përgatiten në nivel kombëtar nga autoritetet përkatëse të ngarkuara prej Përfituesit IPA II, përveç rastit të programeve shumëvendëshe që përgatiten nga Komisioni në konsultim me përfituesit IPA. KKIPA garanton që objektivat e vendosura në aksionet apo programet e propozuara nga Përfituesi IPA II të jenë në koherencë me objektivat e dokumenteve strategjike kombëtare dhe marrin parasysh strategjitë makrorajonale dhe ato të baseneve detare. Nëse dokumentet e programimit përgatiten nga Përfituesi IPA II, KKIPA bashkërendon përgatitjen e dokumenteve dhe ia dorëzon Komisionit.
- (3) Në zbatim të nenit 5(6) të Rregullores IPA II, Komisioni nxit bashkërendimin midis grupeve të interesit gjatë përgatitjes së asistencës. Në zbatim të parimit të pronësisë të parashikuar në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, Përfituesi IPA garanton konsultimin e duhur dhe aksesin në informacionin përkatës të grupeve të interesit, përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe autoritetet vendore, për t'iu mundësuar që të luajnë rol domethënës në procesin e programimit, në bashkëpunim me Komisionin kur është e nevojshme.
- (4) Asistenca mund të mbështetë pjesëmarrjen e Përfituesit IPA në programet dhe agjencitë e BE-së. Pjesëmarrja e Përfituesit IPA II në programet e BE-së bëhet në varësi të kriterëve dhe kushteve specifike që parashikohen për secilin program të tillë në një marrëveshje që lidhet ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit IPA II, në përputhje me marrëveshjet që parashikojnë parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes së përfituesve IPA II në programet e BE-së.
- (5) Asistenca IPA II në kuadrin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar në fushën “bujqësia dhe zhvillimi rural” jepet mbi bazën e prioriteteve përkatëse të përcaktuara në dokumentet strategjike kombëtare, nëpërmjet një grupi masash të paracaktuara që specifikohen më hollësisht në Marrëveshjen Sektoriale. Zbatimi ka formën e programeve shumëvjeçare për zhvillimin rural me angazhime financiare të ndara, sipas nenit 189(3) të Rregullores Financiare, hartuar në nivel kombëtar dhe që mbulon të gjithë periudhën e zbatimit të IPA II. Programi përgatitet nga Autoriteti Menaxhues, siç parashikohet në pikën (i) të nenit 10(1)(c) të kësaj Marrëveshjeje dhe i dorëzohet Komisionit pas konsultimit me grupet e interesit.

Asistenca për programet e zhvillimit rural duhet të kontribuojë në arritjen e këtyre objektivave:

- a) rritja e sigurisë ushqimore e Përfituesit IPA II dhe aftësimi i sektorit agro-ushqimor që të përballojë presionet e konkurrencës, si edhe përafrimi gradual i sektorit me standardet e BE-së, veçanërisht ato të higjienës dhe mjedisit, ndërsa ruhet zhvillimi territorial i balancuar i zonave rurale, gjithmonë duke pasur parasysh prioritetet e BE-së për zhvillimin rural duke zhvilluar kapitalin njerëzor dhe fizik.
- b) Kanalizimi i mbështetjes për investime përmes sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit që përmbushin standardet e qeverisjes së mirë të një administrate publike moderne dhe kur strukturat kombëtare përkatëse zbatojnë standarde të barasvlershme me standardet e ngjashme të organizatave në Shtetet Anëtare të BE-së.

Neni 17 Miratimi i programeve dhe ndryshimet

- (1) Pas miratimit të programit, nëse është e nevojshme, programit mund t'i bëhen ndryshime sipas nenit 2 të Rregullores së Përbashkët Zbatuese, me qëllim që aty të pasqyrohet informacion dhe rezultate të reja në lidhje me zbatimin e aksioneve në fjalë, përfshirë rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit, si edhe nevojën për të rregulluar shumat e asistencës në dispozicion. Propozimet për ndryshime që mund të dorëzojë Përfituesi IPA II duhet të jenë të argumentuara siç duhet dhe të kenë të paktën këtë informacion: tekstin e programit të ndryshuar, arsyet për ndryshimin e propozuar, efektet e pritshme të ndryshimit, si edhe tabelat financiare dhe të masave /aksioneve /aktiviteteve të ndryshuara, kur ndryshimet e propozuara janë të natyrës financiare.
- (2) Përfituesi IPA II propozon ndryshime në programe, kurdo që është e nevojshme, për të pasqyruar ndryshimet e ndodhura në legjislacionin e BE-së ose kurdo që e kërkojnë ndryshimet në kushtet për zbatimin e asistencës IPA II.
- (3) Dispozitat e hollësishme për përgatitjen, miratimin dhe ndryshimet në programe, zbatohen siç parashikohet në dokumentet dhe udhëzimet përkatëse të përgatitura nga Komisioni.

SEKSIONI IV RREGULLAT E ZBATIMIT

TITULLI I RREGULLAT E PËRGJITHSHME DHE PARIMET E ZBATIMIT

Neni 18 Rregullat për prokurimin dhe dhënien e granteve

- (1) Asistenca në kuadrin e të gjitha fushave të IPA II menaxhohet sipas rregullave për aksionet e jashtme që parashikohen në Titullin IV të Pjesës Dy të Rregullores Financiare dhe Rregullat e Zbatimit të saj.

- (2) Të gjitha kontratat e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve si edhe marrëveshjet e grantit jepen dhe zbatohen në përputhje me procedurat dhe dokumentet standard të përcaktuar dhe të publikuar prej Komisionit për zbatimin e aksioneve të jashtme që janë në fuqi në momentin e shpalljes së procedurës në fjalë, përveç kur parashikohet ndryshe në Marrëveshjen Sektoriale apo atë të Financimit.
- (3) Rezultatet e procedurave të tenderimit, si edhe të dhënies së granteve dhe çmimeve publikohen sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin 1 dhe siç përcaktohet më hollësisht në nenin 25.
- (4) Në rast menaxhimi indirekt nga Përfituesi IPA II, brenda një muaji pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes përkatëse të Financimit, ZKA i dorëzon Komisionit një plan prokurimesh/parashikime financiare për programin apo aksionin që zbatohet në kuadrin e Marrëveshjes së Financimit. Ky detyrim nuk zbatohet për asistencën IPA II në kuadrin e programeve të zhvillimit rural në fushën 'bujqësia dhe zhvillimi rural'.
- (5) Për sa i përket prokurimit, legjislacioni i brendshëm i Përfituesit IPA II që transponon Direktivën 2014/24/BE konsiderohet i barasvlershëm me rregullat që zbaton Komisioni në zbatim të Rregullores Financiare. Komisioni mund të pranojë aplikimin e këtij legjislacioni të brendshëm për zbatimin e asistencës IPA II, me kusht që të respektohen kushtet e dispozitave përkatëse të Marrëveshjes së Financimit.

Neni 19 Rregullat e shtetësisë dhe origjinës për prokurimin publik, grantet dhe procedurat e tjera të kontraktimit

- (1) Pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, granteve dhe procedurave të tjera për shpalljen e fituesit për masat e financuara në kuadrin e IPA II është e hapur për të gjithë personat që janë shtetas dhe persona juridikë që janë të vendosur efektivisht në vendet e mëposhtme (më poshtë të referuar si "vendet përfituese") dhe për Organizatat Ndërkombëtare¹³.
 - (a) Shtetet Anëtare, Përfituesit IPA II, palët e Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane dhe vendet partnere të përfshira në Instrumentin Evropian të Fqinjësisë, dhe
 - (b) vendet për të cilat aksesi i ndërsjellë në asistencën e jashtme përcaktohet nga Komisioni. Aksesi i ndërsjellë mund të jepet për periudha të kufizuara të paktën njëvjeçare, kurdo që një vend akordon të drejtë pjesëmarrje me të drejta të barabarta për subjektet e BE-së dhe për vendet përfituese në kuadër të IPA II. Komisioni konsultohet me Përfituesin IPA II para se të vendosë për aksesin e ndërsjellë dhe kohëzgjatjen e tij.

¹³

Organizatat Ndërkombëtare janë organizata ndërkombëtare të sektorit publik, të ngritura në kuadrin e marrëveshjeve ndërshtetërore, agjenci të specializuara të ngritura prej organizatave të tilla, si dhe organizata të tjera jofitimprurëse të asimiluara nën organizata ndërkombëtare me vendim të Komisionit.

Persona juridikë mund të jenë organizatat e shoqërisë civile, siç janë organizatat jofitimprurëse joqeveritare, si edhe fondacione politike të pavarura, organizata me bazë komunitare si edhe agjenci jofitimprurëse, institucione, organizata dhe rrjete të tyre të sektorit privat në nivel vendor, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, me kusht që të kenë të drejta dhe detyra ligjore në përputhje me legjislacionin e brendshëm përkatës.

- (2) Nëse aksionet bashkëfinancohen me një partner ose donator tjetër, ose përmes një fondi besimi të ngritur prej Komisionit, mund të përfitojnë edhe vendet që janë të pranueshme sipas rregullave të atij partneri, donatori, Shteti Anëtar apo që janë të përcaktuar në aktin e themelimit të fondit të besimit.

Nëse aksionet zbatohen me menaxhim indirekt përmes një prej organeve të besuara që renditen në pikat (ii) deri (vii) të nenit 58(1)(c) të Rregullores Financiare, mund të përfitojnë edhe vendet që janë të pranueshme sipas rregullave të atij organi.

Nëse aksionet financohen bashkërisht nga IPA II dhe një instrument tjetër për aksionet e jashtme të BE-së, përfshirë Fondin Evropian për Zhvillim, vendet e identifikuara si në IPA II edhe në instrumentin tjetër konsiderohen të pranueshme për qëllime të këtyre aksioneve.

Në rastin e aksioneve me natyrë globale, rajonale apo ndërkufitare të financuara nga IPA II, vendet, territoret dhe rajonet që mbulon aksioni mund të konsiderohen të pranueshme për qëllimet e atij aksioni.

- (3) Të gjitha furnizimet e blera në zbatim të një kontrate prokurimi ose sipas një marrëveshjeje granti të financuar nga IPA II, duhet ta kenë origjinën nga një vend i pranueshëm.

Megjithatë, ato mund ta kenë origjinën nga çfarëdo vend, nëse sasia e furnizimeve që blihet është nën pragun për përdorimin e procedurës konkurruese me negociata. Për qëllime të këtij neni, termi "origjinë" përcaktohet në nenin 23 dhe 24 të Rregullores së Këshillit (KEE) nr. 2913/92 të 12 tetorit 1992 që krijon Kodin Doganor Komunitar dhe legjislacionin shtesë Komunitar që disiplinon origjinën jopreferenciale¹⁴.

- (4) Rregullat e këtij neni nuk zbatohen dhe nuk vendosin kufizime shtetësie për personat fizikë të punësuar ose të kontraktuar ligjërisht nga një kontraktues i pranueshëm ose, sipas rastit, nga një nënkontraktues i pranueshëm.

- (5) Për të promovuar kapacitetet, tregjet dhe blerjet vendore, prioritet i jepet kontraktuesve vendorë dhe rajonalë kur Rregullorja Financiare parashikon dhënien e kontratave mbi

¹⁴

Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 2913/92 e 12 tetorit 1992 që përcakton Kodin Doganor Komunitar dhe legjislacionin shtesë Komunitar që disiplinon origjinën jopreferenciale (GZ L 302, 19 tetor 1992, faqe 1).

bazën e një tenderi të vetëm. Në të gjitha rastet, pjesëmarrja e kontraktuesve vendorë dhe rajonale nxitet sipas dispozitave përkatëse të Rregullores Financiare.

- (6) Pranueshmëria, siç është përcaktuar në këtë nen, mund të kufizohet nga Marrëveshja e Financimit në lidhje me shtetësinë, vendndodhjen gjeografike apo natyrën e aplikantëve, kur këto kufizime kërkohen nga natyra specifike dhe objektivat e aksionit dhe kur ato janë të nevojshme për zbatimin efikas, veçanërisht për pjesëmarrjen në procedurat e tenderimit për aksione bashkëpunimi ndërkufitar.
- (7) Ofertuesit, aplikantët dhe kandidatët nga vendet e papranueshme apo mallrat me origjinë të papranueshme mund të konsiderohen të pranueshëm prej Komisionit në rast se urgjenca apo mungesa e produkteve dhe shërbimeve në tregjet e vendeve përkatëse apo në situata të tjera të justifikuara ku aplikimi i rregullave të pranueshmërisë do ta bënte realizimin e projektit, programit apo aksionit të pamundur ose tejet të vështirë.
- (8) Personat fizikë dhe juridikë që janë fituar nga kontratat respektojnë legjislacionin mjedisor të zbatueshëm, përfshirë marrëveshjet mjedisore shumëvendëshe, si edhe standardet bazë të punës të miratuara ndërkombëtarisht¹⁵.

Neni 20 Pjesëmarrja në programet dhe agjencitë e BE-së

Në rast pjesëmarrjeje në programet dhe agjencitë e BE-së, Përfituesi IPA II duhet të paguajë në buxhetin e programit apo agjencisë. Programi kombëtar ose shumëvendësh mund të parashikojë kontribute për koston e pjesëmarrjes së Përfituesit IPA II në programet dhe agjencitë e BE-së.

Neni 21 Parimet e zbatimit të mbështetjes buxhetore për Përfituesin IPA II

- (1) Komisioni mund të vendosë t'i japë mbështetje buxhetore Përfituesit IPA. Kjo mbështetje zbatohet me menaxhim direkt. Mbështetje plotësuese mund të jepet krahas mbështetjes buxhetore në kuadrin e menaxhimit direkt, menaxhimit indirekt me Përfitues IPA II, ose menaxhimit indirekt me subjekte të ndryshme nga Përfituesi IPA II, sipas rastit.
- (2) Kusht për lëvrimin e mbështetjes buxhetore është arritja e progresit të kënaqshëm në përmbushjen e objektivave të miratuara me Përfituesin IPA II dhe të parashikuara në Marrëveshjen e Financimit.
- (3) Dispozitat e hollësishme mbi kriteret e pranueshmërisë për kuadrin e qëndrueshëm makroekonomik, menaxhimin e qëndrueshëm publik financiar, transparencën dhe mbikëqyrjen e buxhetit, politikave kombëtare/sectoriale dhe reformave, si edhe vlerësimi i riskut dhe përgatitjet, zbatimi dhe ndjekja e mbështetjes financiare janë të parashikuara

15

Standardet bazë të punës të ILO-s, konventat për lirinë e tubimit dhe kontratave kolektive, eliminimi i punës së detyrueshme e me dhunë, eliminimi i diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin, si edhe shfuqizimi i punës së fëmijëve.

në dokumentet përkatëse dhe udhëzimet që Komisioni përgatit me qëllim zbatimin e IPA II përmes mbështetjes buxhetore.

Neni 22 Parimet e zbatimit për binjakëzimin

- (1) Masat mund të zbatohen me binjakëzim kur administrata e Shtetit Anëtarë të përzgjedhur pranon të japë ekspertizën e kërkuar për sektorin publik. Binjakëzimi strukturohet në formën e grantit për të rimbursuar shpenzimet e kryera nga Shteti (et) Anëtar(e) në fjalë, si edhe mund të parashikojë atashimin afatgjatë të një këshilltari para-anëtarësimi i caktuar që të këshillojë me kohë të plotë administratën e Përfituesit IPA II, më poshtë i referuar si "këshilltar binjakëzimi rezident" (KBR/RTA). Përfituesi IPA II i vë në dispozicion KBR-së mjediset e mjaftueshme për zyrë.

Granti i binjakëzimit përcaktohet sipas dispozitave përkatëse të Pjesës Një, Titullit VI për grantet e Rregullores Financiare dhe Rregullave të saj të Zbatimit.

- (2) Komisioni ka hartuar një manual binjakëzimi për të gjitha llojet e binjakëzimit, të cilin e përditëson periodikisht.

TITULLI II TRANSPARENCA DHE VIZIBILITETI

Neni 23 Informimi, publiciteti dhe transparenca

- (1) Përfituesi IPA II angazhohet të rritë transparencën dhe llogaridhënien në dhënien e asistencës, përfshirë edhe bërjen publike të informacionit mbi vëllimin dhe akordimin e asistencës, garanton krahasueshmëri ndërkombëtare të të dhënave si edhe lehtëson aksesin, përcjelljen dhe publikimin e tyre. Çdo aktor që zbaton asistencën IPA II respekton kërkesat për informimin, publicitetin dhe transparencën, si edhe garanton vizibilitetin e duhur të aksioneve të BE-së.

- (2) Në menaxhim indirekt nga Përfituesi IPA II, strukturat operuese publikojnë informacione për marrësit e asistencës IPA II në mënyrën e mëposhtme:

- a) Publikimi bëhet sipas një prezantimi standard në një rubrikë të dedikuar dhe lehtësisht të aksesueshme në faqen e internetit të Përfituesit IPA II. Nëse publikimi i tillë në faqe interneti është i pamundur, informacioni publikohet me çfarëdo mjeti tjetër të përshtatshëm, përfshirë edhe Fletoren Zyrtare të Përfituesit IPA II.
- b) Informacionet publikohen jo më vonë se 30 qershori i vitit që pason vitin financiar kur fondet janë akorduar.
- c) Përfituesi IPA II i komunikon Komisionit adresën e faqes së internetit ku është publikuar informacioni. Nëse informacioni është publikuar me mjete tjera të përshtatshme, Përfituesi IPA i jep Komisionit hollësitë e plota mbi mjetin e përdorur.

Faqja e internetit e Komisionit tregon vendin/rubrikën e dedikuar për publikimin e këtij informacioni.

- d) Strukturat operuese garantojnë informimin e marrësit të asistencës se do të figurojë në listën e publikuar për këtë qëllim. Të dhënat personale që shpallen në këtë listë trajtohen në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) Nr. 45/2001 dhe duke respektuar kërkesat mbi konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave.

Përfituesi IPA II publikon emrin dhe vendndodhjen e marrësit të asistencës, shumën, natyrën e qëllimit të kontratës së dhënë. Vendndodhja e personit juridik është adresa e tij. Vendndodhja e personit fizik është një rajon në nivel NUTS 2¹⁶.

Informacionet e përcaktuara në nënparagrafin e dytë botohen vetëm për çmimet, grantet dhe kontratat që janë dhënë përmes konkurrimeve, procedurave të dhënies së granteve apo prokurimeve publike. Informacioni nuk publikohet në rastin e kontratave me vlerë nën pragun e përcaktuar në nenin 137(2) të Rregullave të Zbatimit të Rregullores Financiare.

Për sa i përket të dhënave që iu referohen personave fizikë, emrat zëvendësohen nga "personi fizik" dy vjet pas mbarimit të vitit financiar në të cilin janë dhënë fondet. Kjo zbatohet edhe për të dhënat personale të personave juridikë, për të cilat titulli zyrtar identifikon një ose më shumë persona fizikë.

Publikimi i emrave të personave fizikë nuk lejohet, nëse ky publikim rrezikon t'iu cenojë të drejtat themelore apo dëmton interesat e tyre tregtare.

Përfituesi IPA II i paraqet Komisionit listën e të dhënave që do të publikohen në lidhje me personat fizikë, si edhe argumentimin për kërkesat e mospublikimit, listë e cila duhet të miratohet paraprakisht nga Komisioni. Kur është e nevojshme, Komisioni cakton vendndodhjen e personit fizik në një rajon të nivelit NUTS 2.

Publikimi i kontratave nuk mund të bëhet, nëse ky publikim rrezikon të cenojë interesat tregtare të kontraktuesve apo përfituesve të granteve. Përfituesi IPA II i paraqet një listë me arsyetime të tilla Komisionit, i cili duhet të japë miratimin paraprak për këtë mospublikim.

- (3) Në rastin e menaxhimit indirekt nga Përfituesi IPA II, organet përkatëse, në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për zbatimin e veprimeve të jashtme, në fuqi në momentin e shpalljes së procedurës në fjalë, përgatitin një njoftim për kontratën e dhënë sapo kjo të jetë nënshkruar, dhe ia dërgojnë Komisionit për publikim, nëse nuk parashikohet ndryshe në Marrëveshjet Sektoriale apo të Financimit. Ky njoftim për kontratën e dhënë mund të publikohet nga Përfituesi IPA II në mediat përkatëse.

¹⁶ NUTS do të thotë Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat dhe niveli NUTS 2 do të thotë klasa e njësive administrative me përmasa mesatare popullesie ndërmjet 800 000 dhe 3 milion banorë.

- (4) Programet dhe dokumentet strategjike bashkë me ndryshimet e tyre janë dokumente publike dhe i vihen në dispozicion publikut të gjerë dhe shoqërisë civile.

Neni 24 Vizibiliteti dhe komunikimi

- (1) Komisioni dhe Përfituesi IPA II miratojnë një plan koherent me aktivitetet për vizibilitetin dhe komunikimin, me qëllim që në mënyrë aktive të përgatitet dhe publikohet informacion mbi programet dhe masat në kuadrin e asistencës IPA II në Republikën e Shqipërisë. Procedurat për zbatimin e aktiviteteve të tilla specifikohen në Marrëveshjet Sektoriale apo të Financimit.
- (2) Në rastin e menaxhimit direkt, zbatimi i aktiviteteve të përmendura në paragrafin (1) është përgjegjësi e Komisionit, me ndihmën e Përfituesit IPA II.
- (3) Në rastin e menaxhimit indirekt nga Përfituesi IPA II dhe për programet e bashkëpunimit ndërkuftar të përcaktuara në pikat (b) dhe (c) të nenit 63(2), zbatimi i aktiviteteve të përmendura në paragrafin (1) më lart është përgjegjësi e strukturës(ave) operuese të Përfituesit(ve) IPA II.
- (4) Aktivitetet e vizibilitetit dhe komunikimit demonstrojnë sesi një aksion i caktuar kontribuon në arritjen e objektivave të programit dhe në procesin e aderimit, si edhe synojnë forcimin e ndërgjegjësimit të përgjithshëm publik dhe mbështetjen e aksioneve të financuara dhe të objektivave të përcaktuara. Aktivitetet e vizibilitetit dhe komunikimit synojnë të theksojnë për audiencat e evidentuara vlerën e shtuar dhe ndikimin e BE-së. Aktivitetet e vizibilitetit gjithashtu nxisin transparencën dhe llogaridhënien në përdorimin e fondeve.
- (5) Përfituesi IPA II raporton tek Komitetit Monitorues IPA dhe komitetet monitoruese sektoriale në lidhje me aktivitetet e vizibilitetit dhe komunikimit.

TITULLI III MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 25 Mbrojtja e të dhënave

- (1) Përfituesi IPA II garanton mbrojtje të arsyeshme të të dhënave personale. Të dhëna personale do të thotë çdo e dhënë e lidhur me një person fizik. Për çdo operacion të kryer me të dhënat personale, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja apo ndryshimi, nxjerrja, konsultimi, përdorimi, zbulimi, fshirja apo shkatërrimi, respektohen

rregullat dhe procedurat e Përfituesit IPA II dhe shtrihet në masën e nevojshme për zbatimin e asistencës së IPA II.

- (2) Në veçanti, Përfituesi IPA merr të gjitha masat e duhura teknike dhe organizative për sigurinë, në raport me të gjitha rreziqet e qenësishme të operacioneve të tilla dhe natyrën e informacionit që lidhet me personin në fjalë, me qëllim:
 - (a) të parandalojë aksesin e paautorizuar të çdo personi në sistemet kompjuterike për të kryer operacione të tilla, dhe, veçanërisht leximin, kopjimin, ndryshimin ose heqjen e paautorizuar të medias ruajtëse; hedhjen e paautorizuar të të dhënave, si dhe çdo zbulim të paautorizuar, tjetërsim apo fshirje të informacionit të ruajtur;
 - (b) të sigurojë që përdoruesit e autorizuar të një sistemi TI që kryen operacione të tilla të kenë akses vetëm në informacionin që u takon sipas të drejtave të tyre të aksesit;
 - (c) të hartojë strukturën organizative në mënyrë që të plotësojë kërkesat e mësipërme.

Neni 26 Konfidencialiteti

- (1) Përfituesi IPA II pranon se dokumentet e tij të zotëruara nga një subjekt i përcaktuar në pikat (ii) deri (iii) të nenit 58 (1)(c) të Rregullores Financiare të cilit Komisioni i ka besuar detyra zbatimi të buxhetit, mund t'i përcillen Komisionit nga ky subjekt vetëm për qëllimin e monitorimit të zbatimit të këtyre detyrave. Komisioni respekton modalitetet e konfidencialitetit që kanë miratuar bashkërisht Përfituesi IPA dhe ky subjekt, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.
- (2) Pa cenuar nenin 50, Përfituesi IPA II dhe Komisioni ruajnë konfidencialitetin e çdo dokumenti, informacioni apo materiali tjetër që lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e asistencës së IPA II që është klasifikuar si konfidencial.
- (3) Para publikimit të informacionit të tillë, Palët marrin pëlqimin me shkrim të njëra-tjetrës.
- (4) Palët zbatojnë dispozitat e konfidencialitetit deri pesë vjet pas përfundimit të periudhës së ekzekutimit.

TITULLI VI OFRIMI I LEHTËSIRAVE DHE TAKSIMI

Neni 27 Ofrimi i lehtësirave për zbatimin e programeve dhe ekzekutimin e kontratave

- (1) Për të garantuar zbatimin efikas të programeve në kuadrin e IPA II, Përfituesi IPA II merr të gjitha masat e nevojshme që:
 - (a) për procedura tenderimi për shërbime, furnizime apo punime, si edhe për kontrata granti apo binjakëzimi, personat fizikë dhe juridikë që kanë të drejtë të marrin pjesë
-

- në procedurat e konkurrimit sipas nenit 19, kanë të drejtë vendosjeje dhe vendbanimi të përkohshëm kur këtë e kërkon rëndësia ose kohëzgjatja e kontratës. Kjo e drejtë fitohet vetëm pasi procedura shpallet dhe ushtrohet nga personeli drejtues dhe teknik, duke përfshirë KBR-të e nevojshme për të kryer studime dhe masa të tjera përgatitore për hartimin e ofertave/aplikimeve/propozimeve. Kjo e drejtë skadon një muaj pas vendimit për shpalljen e fituesit të kontratës;
- (b) ofertuesit dhe aplikantët në mënyrë efektive të dorëzojnë ofertat/ aplikimet / propozimet pa hasur ndonjë pengesë si kërkesa ligjore, administrative ose doganore shtesë që cenojnë trajtimin e barabartë ndërmjet ofertuesve ose aplikantëve, përveç rasteve kur këto kërkesa janë reflektuar në një dokument themelor të programit të miratuar nga Komisioni;
 - (c) personelit që merr pjesë në zbatimin e asistencës IPA II dhe rrethit të ngushtë familjar të tyre t'u akordohen përfitime, privilegje dhe përjashtime jo më pak të favorshme sesa ato që zakonisht iu akordohen stafit ndërkombëtar apo të jashtëm të punësuar në Republikën e Shqipërisë në kuadrin e ndonjë marrëveshjeje tjetër dypalëshe apo shumëvendëshe, apo marrëveshjeje për asistencë dhe bashkëpunim teknik;
 - (d) personeli që merr pjesë në zbatimin e asistencës IPA II dhe rrethi i ngushtë familjar i tyre të lejohen të hyjnë në Republikën e Shqipërisë, të vendosen në Republikën e Shqipërisë, të punojnë aty dhe të dalin nga Shqipëria, siç justifikohet nga natyra e kësaj kontrate;
 - (e) të merren lejet e nevojshme për importimin e mallrave, veçanërisht pajisjet profesionale që nevojiten për ekzekutimin e kontratës në fjalë, në respektim të ligjeve ekzistuese, rregullave dhe akteve normative të Përfituesit IPA II;
 - (f) importet e kryera në kuadrin e IPA II të përjashtohen nga detyrimet doganore, tarifatat e importit dhe tarifa të tjera, përfshirë akcizat;
 - (g) të merren lejet e nevojshme për ri-eksportimin e mallrave më lart, pas përfundimit të ekzekutimit të kontratës në fjalë;
 - (h) të merren autorizimet për importin ose blerjen e valutës së nevojshme për zbatimin e kontratës në fjalë dhe zbatimin e akteve normative për kontrollin e kursit të këmbimit kombëtar në mënyrë jo-diskriminuese për kontraktuesit, pavarësisht shtetësisë apo ku kanë selinë.
 - (i) të merren të gjitha lejet e nevojshme për riatdhesimin e fondeve të marra për kryerjen e aksionit të financiar nga IPA II, në zbatim të akteve normative për kontrollin e kursit të këmbimit kombëtar që është në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

- (j) që transaksionet e nevojshme për realizimin e kontratave të financuara nga IPA II të përjashtohen nga procedurat që kërkojnë kryerjen e pagesës për mallrat dhe/ose shërbimet tek kontraktuesit e tyre jashtë shtetit, përmes bankave apo institucioneve financiare që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.
- (2) Përfituesi IPA II garanton bashkëpunim të plotë të të gjitha autoriteteve përkatëse. Gjithashtu, u garanton akses ndërmarrjeve shtetërore dhe institucioneve të tjera shtetërore që janë të përfshira ose të nevojshme në zbatimin e një programi ose në ekzekutimin e kontratës.
- (3) Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Përfituesi IPA II miraton ose ndryshon legjislacionin dhe/ose aktet normative të nevojshme për t'iu dhënë fuqi ligjore procedurave të parashikuara në këtë ligj, ndërsa i mban këto procedura të thjeshta, të arsyeshme dhe sa më pak kohëshpenzuese.

Neni 28 Rregullat për taksat, tarifat doganore dhe ato fiskale

- (1) Përveç kur parashikohet ndryshe në një Marrëveshje Sektoriale ose Financimi, taksat dhe tarifat doganore dhe tarifat e importit apo tarifa që kanë efekt të barasvlershëm me to, nuk janë të shpenzime të pranueshme për IPA II. Ky rregull vlen edhe për bashkëfinancimin që i jepet Përfituesit IPA II dhe marrësve të ndihmës IPA II.
- (2) Dispozitat e mëposhtme janë të zbatueshme:
 - (a) Të gjitha importet nga kontraktuesit e BE-së lejohen të hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa paguar tarifa doganore, tarifa importi, taksën e vlerës së shtuar (TVSH), ose tarifë tjetër me efekt të barasvlershëm me to. Ky përjashtim zbatohet vetëm për importet ose tarifat për mallrat e furnizuar dhe/ose shërbimet e kryera, si dhe/ose punimet që kryhen nga kontraktues të BE-së në kuadrin e një kontrate të financuar prej BE-së. Republika e Shqipërisë garanton që të gjitha importet t'i dorëzohen në pikën e hyrjes kontraktuesve të BE-së siç e kërkojnë dispozitat e kontratës përkatëse dhe për përdorim të menjëhershëm, siç kërkon zbatimi normal i kontratës, pavarësisht nëse ka vonesa apo mosmarrëveshje për tarifat dhe taksat e lartpërmendura;
 - (b) Kontraktuesit e BE-së përjashtohen nga TVSH për çdo shërbim që japin dhe/ose mallra që furnizojnë dhe/ose punime që kryejnë në kuadrin e kontratës së financuar prej BE-së. Edhe mallrat e furnizuara, shërbimet e ofruara apo punimet e kryera nga një kontraktues për një kontraktues të BE-së përjashtohen nga TVSH në atë masë që shërbejnë për të përmbushur objektivat dhe aktivitetet në kuadrin e kontratës të financuar prej BE-së.
 - (c) Përjashtimi i parashikuar në paragrafin (b) fiton efektet e kryhet parimisht, me përjashtim *ex-ante*. Kur kjo është teknikisht dhe/ose praktikisht e pamundur, përjashtimi kryhet përmes rimbursimit/zbritjes së shumave.

Nëse aplikohet përjashtim *ex-ante*, kontraktuesi i BE-së apo kontraktuesi që furnizon mallrat dhe/ose ofron shërbimet dhe/ose kryen punime për një kontraktues të BE-së, lëshon një faturë ekskluzive TVSH-je për të cilën Përfituesi IPA garanton paraprakisht se ekzistojnë procedura dhe mekanizma efikasë për përjashtimin *ex-ante* nga TVSH.

Nëse zbatohet procedura e rimbursimit, kontraktuesit e BE-së dhe kontraktuesit e kontraktuesve të BE-së përfitojnë rimbursim TVSH direkt nga administrata doganore sapo i dorëzojnë administratës tatimore një kërkesë me shkrim të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë për rimbursimin e TVSH-së.

Kontraktuesit e BE-së dhe kontraktuesit e kontraktuesve të BE-së gëzojnë të drejtën të zbesin shumën e TVSH-së të paguar për mallrat e furnizuara dhe/ose shërbimet e kryera dhe/ose punimet e bëra në kuadrin e asistencës IPA II që përfitojnë përjashtim nga TVSH, siç parashikon kjo Marrëveshje, zbritje kjo që bëhet nga TVSH e grumbulluar prej tyre për transaksione biznesi të zakonshme jashtë kuadrit të IPA II.

Administrata tatimore plotëson çdo kërkesë për përjashtim, rimbursim tatimor dhe zbritje shumash brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike, pa ndonjë kosto shtesë përveç tarifës administrative minimale dhe të arsyeshme.

- (d) Fitimet ose të ardhurat që lindin nga kontratat e financuara prej BE-së taksohen në Republikën e Shqipërisë sipas regjimit tatimor kombëtar/vendor. Sidoqoftë, personat fizikë dhe juridikë, përfshirë stafin e riatdhesuar, KBR-të, rezidentë ose me seli në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian në një vend tjetër përfitues në kuadrin e IPA II dhe të ndryshëm nga Përfituesi IPA II, ekzekutimi i kontratave të financuara prej BE-së dhe kontraktuesit e përfituesve të granteve (pavarësisht shtetësisë apo vendbanimit të tyre përjashtohen nga tatim fitimi dhe tatimi mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë, përfshirë tatimin në burim apo taksat e përkohshme.

Granti që BE-ja i jep përfituesit të grantit nuk përbën fitim apo të ardhur për këtë përfitues. Kur gjenerohen fitime nga një kontratë granti, Komisioni gëzon të drejtën të kompensojë përqindjen e fitimit sipas kushteve të kontratës përkatëse. Pjesa e mbetur e fitimit mund të taksohet sipas regjimit tatimor kombëtar/vendor.

- (e) Shpenzimet e kontraktuesve lirohen nga taksat e konsumit apo ndonjë taksë tjetër apo tarifë me efekt të barasvlershëm për shpenzimet që kryhen në lidhje me mallrat e furnizuara dhe/ose shërbimet e kryera dhe/ose punimet e realizuara prej kontraktuesit të BE-së në kuadrin e kontratës së financiar nga BE-ja.
- (f) Ata që përfitojnë nga aksione dhe/ose kontrata dhe/ose aktivitete që kryhen në kuadër të IPA II përjashtohen nga "taksa e trashëgimisë dhe transferimit" apo çdo taksë apo

tarifë tjetër me efekt të barasvlershëm që rezultojnë nga mallrat dhe/ose të drejtat, dhe/ose objektet e ndërtuara dhe/ose fondet e transferuara atyre në kuadrin e IPA II.

- (g) Sendet personale dhe familjare të importuara për përdorim personal nga personat (dhe rrethi i ngushtë familjar), me përjashtim të atyre të rekrutuar në Shqipëri, që kryejnë detyra të përcaktuara në kontrata shërbimi dhe/ose pune dhe/ose granti dhe/ose binjakëzimi apo marrëveshje, përjashtohen nga tarifatat doganore, tarifatat e importit, taksat dhe tarifatat e tjera që kanë efekt të barasvlershëm me to dhe/ose kritere tejet shtrënguese kolaterali; këto sende personale apo familjare ri-eksportohen ose asgjësohen në vendin përfitues në përfundim të kontratës, në përputhje me aktet normative në fuqi të Republikës së Shqipërisë,
 - (h) Kontratat e BE-së, kontratat e nënshkruara prej kontraktuesve të BE-së, si dhe ortakët e një konsorciumi apo sipërmarrjeje me kapital të përbashkët ose bashkëfinancues dhe shoqëritë e ndërlidhura në grante, nuk paguajnë taksën e vulës apo regjistrimit, si edhe asnjë taksë me efekt të barasvlershëm, në Republikën e Shqipërisë. Ky përjashtim vlen për transaksionet (përfshirë dhënien e të drejtave) dhe dokumentet që lidhen me pagesa që iu bëhen kontraktuesve të BE-së, përfshirë kontratat e lidhura ndërmjet përfituesve të grantit/huasë (përfshirë ortakët e tyre, shoqëritë e ndërlidhura, ose përfituesit e nën-granteve/huave) dhe kontraktuesit e tyre (përfshirë personelin e tyre dhe ekspertët që kontraktujnë) dhe kontratat e lidhura për shpenzime të rastit dhe të përkohshme për përkatësisht kontrata shërbimi dhe kontrata pune.
 - (i) Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi "kontraktues i BE-së" nënkupton çdo person fizik ose juridik që ofron shërbime dhe/ose furnizon mallra dhe/ose ekzekuton punime në kuadrin e një kontrate të BE-së. Termi "kontraktues i BE-së" nënkupton edhe përfituesit e granteve/huave (përfshirë ortakët, shoqëritë e ndërlidhura dhe përfituesit e nën-granteve/huave, si edhe kontraktuesit e binjakëzimit), ortakët e një konsorciumi apo sipërmarrjeje me kapital të përbashkët, kontraktuesit dhe KBR-të në kuadrin e kontratave të binjakëzimit, si edhe kontraktuesit në kuadrin e Instrumentit për Asistencën Teknike dhe Shkëmbimin e Informacionit (TAIEX).
 - (j) Termi "*kontratë e BE-së*" nënkupton çdo kontratë ose kontratë granti, përfshirë kontratat e nën-granteve/huave dhe marrëveshjet e delegimit në kuadrin e menaxhimit indirekt, përmes të cilës një aktivitet financohet në kuadrin e IPA II, përfshirë bashkëfinancimin nga Përfituesi IPA II dhe marrësve të asistencës IPA II dhe që nënshkruhet nga Komisioni Evropian ose Përfituesi IPA II ose një përfitues granti. Termi "kontratë e BE-së" përfshin edhe dispozitat e asistencës në kuadrin e TAIEX-it dhe pjesëmarrjen në programet e BE-së, përfshirë grantet e marra në kuadrin e programeve të BE-së dhe bashkëfinancimin për grante të tilla.
 - (k) Kontraktuesit që zbatojnë një kontratë të financuar prej BE-së përjashtohen edhe nga këto tarifa:
-

- i. taksa e veçantë e komunikimit;
 - ii. taksat për mjetet motorike
 - iii. tarifa të veçanta që aplikohen nga autoritete rajonale apo vendore ose borde të veçanta në kontekstin e ekzekutimit të kontratës jo-proporcional me koston e ekzekutimit ose që kanë efekt të barasvlershëm me këto taksa.
- (3) Kurdo që është e nevojshme, Përfituesi IPA II miraton ose ndryshon aktet nënligjore dhe/ose miraton aktet e nevojshme për t'i dhënë fuqi dispozitive tatimore në këtë Marrëveshje menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi.
- (4) Rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë nen zbatohen për çdo taksë apo tarife tjetër të ngjashme ose me efekt të barasvlershëm, të cilat mund të miratohen pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, që janë ndryshime apo zëvendësime të atyre ekzistuese.
- (5) Në rast konflikti të dispozitat të këtij neni dhe legjislacionit të brendshëm të Përfituesit IPA II, do të kenë përparësi dispozitat e Marrëveshjes. Në rast aderimi në BE, Përfituesi IPA II vazhdon të zbatojë dispozitat e neneve 27 dhe 28, përveç kur janë të papajtueshme me detyrimet e tij në kuadrin e *acquis* përkatës.

SEKSIONI V RREGULLAT PËR MENAXHIMIN FINANCIAR TË ASISTENCËS IPA II

TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 29 Pranueshmëria e shpenzimeve

- (1) Çdo zë shpenzimi i financuar në kuadrin e Rregullores IPA II nuk përfiton financim tjetër në kuadrin e buxhetit të BE-së.
- (2) Para lidhjes së Marrëveshjes së Financimit përkatëse, kontratat dhe ndryshimet e nënshkuara, shpenzimet e kryera nga marrësit dhe pagesat e bëra nga Përfituesi IPA II nuk përfitojnë financim në kuadrin e Rregullores IPA II.
- (3) Shpenzimet e mëposhtme nuk pranohen për financim në kuadrin e Rregullores IPA II:
 - (a) blerja e tokës ose e godinave ekzistuese, përveç kur justifikohet nga natyra e operacionit në vendimin e financimit;
 - (b) shpenzime të tjera që mund të parashikohen në Marrëveshjet Sektoriale apo të Financimit.
- (4) Afati për pranueshmërinë e shpenzimeve përcaktohet në Marrëveshjet e Financimit.

Neni 30 Intensiteti i ndihmës dhe norma e kontributit të BE-së

- (1) Asistenca IPA II mbështet zbatimin e reformave të Përfituesit IPA II, siç parashikohet në nenin 1 të Rregullores IPA II. Programet specifike dhe aksionet e veçanta mund të kërkojnë kontribute financiare si nga Përfituesit IPA II, ashtu edhe nga BE-ja.
- (2) Kur kërkohet bashkë-kontribut financiar i Përfituesit IPA II dhe i BE-së, kontributi i BE-së llogaritet në raport me shpenzimet e pranueshme, siç përcaktohet në Marrëveshjet Sektoriale apo të Financimit.

TITULLI II RREGULLAT QË LIDHEN ME MENAXHIMIN INDIREKT NGA PËRFITUESI IPA II

Neni 31 Pranueshmëria e shpenzimeve në kuadrin e menaxhimit indirekt

Në kuadrin e programeve të zhvillimit rural për fushën "bujqësia dhe zhvillimi rural", janë të zbatueshme këto dispozita specifike:

- (a) Shpenzimet e asistencës teknike për të mbështetur përgatitjen e programeve të zhvillimit rural dhe ngritjen e sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit mund të jenë të pranueshme para datës së nxjerrjes së vendimit të Komisionit për miratimin e programit të zhvillimit rural por jo më parë se 1 janari 2014;
- (b) Projektet e investimeve në kuadrin e programeve të zhvillimit rural mbeten të pranueshme për financimin e BE-së, me kusht që të mos i nënshtrohen ndonjë modifikimi thelbësor brenda pesë vjetësh nga pagesa përfundimtare e strukturës operuese;
- (c) Në rast të kostove për njësi, pagesa të njehershme që nuk i kalojnë 100 000 EURO të kontributit publik dhe financimit me normë fikse, që përcaktohen nga aplikimi i një përqindjeje ndaj një ose disa kategori shpenzimesh të caktuara, BE-ja mbulon vetëm shumat e përcaktuara për secilën masë të programit dhe siç ka përcaktuar Agjencia IPARD përkatëse para shpalljes së ftesës për aplikime.

Neni 32 Gjurma e auditit

ZKA garanton, në çdo kohë, vënien në dispozicion të të gjithë informacionit përkatës që garanton gjurmë auditit mjaftueshëm të hollësishme. Ky informacion përfshin evidenca të dokumentuara për autorizimin e kërkesë-pagesave, për kontabilitetin dhe pagesën e kërkesave të tilla, si edhe trajtimin e paradhënies, garancive dhe borxheve.

Neni 33 Pagesat e kontributit të BE-së

- (1) Pagesat e kontributit të Bashkimit Evropian kryhen brenda kufijve të fondeve në dispozicion.
- (2) Pagesat jepen në formë para-financimi, pagesash të ndërmjetme dhe ekzekutim bilanci përfundimtar. Në rastin e programeve specifike dhe veprimeve të veçanta, vete, pagesat e kontributit të BE-së për financimin e aksioneve në fjalë llogariten duke aplikuar normën e bashkëfinancimit - të përcaktuara në vendimin për financim - në shpenzimet e pranueshme të certifikuara në përputhje me pikën (a) të Klauzolës 2 (3) të Shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje, me kusht që të mos tejkalohet shuma e kontributit të BE-së të përcaktuar në vendimin për financim.
- (3) Më 15 janar dhe 15 korrik të çdo viti, Përfituesi IPA II i dërgon Komisionit një parashikim të kërkesë-pagesave të mundshme për vitin financiar në fjalë dhe për vitin financiar pasardhës, në lidhje me të gjitha fushat dhe programet IPA II. Komisioni mund të kërkojë përditësim të këtij parashikimi, sipas rastit.
- (4) Pagesat e Komisionit për Fondin Kombëtar bëhen brenda 90 ditësh pas përbushjes së kushteve të përcaktuara në nenet 34, 35 ose 37. Komisioni mund ta ndërpresë këtë afat kohor për kërkesë-pagesat për të kërkuar të gjitha dokumentet themelore të nevojshme për të shpjeguar ndonjë element përkatës të pasqyrës së shpenzimeve të certifikuar, përfshirë informacion mbi raportimin e parregullsive në pajtim me nenin 51(2) dhe Shtojcën H të kësaj Marrëveshjeje.
- (5) Shumat e paraqitura në programet e dorëzuara prej Përfituesit IPA II në pasqyrën e shpenzimeve të certifikuar, në kërkesë-pagesat dhe shpenzimet e përmendura në raportet e zbatimit shprehen në Euro. Përfituesi IPA II garanton që, për flukset e thesarit ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit IPA II, norma e regjistruar për konvertimin në Euro të monedhës kombëtare të jetë norma mujore kontabël e Euros e përcaktuar nga Komisioni për muajin në të cilin shpenzimi i paguar regjistrohet në llogarinë e Fondit Kombëtar ose të strukturës operuese përkatëse të përcaktuar në Marrëveshjen e Financimit.
- (6) Pagesat e Komisionit për Fondin Kombëtar bëhen në Euro në llogarinë në Euro, me kusht që të ketë fonde buxhetore, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenet 34, 35 ose 37 si dhe në marrëveshjet sektoriale apo marrëveshjet e financimit. Për çdo program hapet një llogari në Euro, e cila përdoret vetëm për transaksionet që lidhen me atë program.
- (7) Përfituesi IPA II garanton që përfituesit të marrin shumën totale të kontributit publik në kohën e duhur dhe të plotë. Nuk vendoset asnjë tarifë specifike apo pagesë tjetër me efekt të njëjtë që redukton këto shuma për marrësit dhe kontributin publik, ndërsa pasuritë e financuara në këtë mënyrë nuk i nënshtrohen asnjë konfiskimi administrativ apo gjyqësor, sekuestrimi apo zbritjeve të ngjashme.

- (8) Nëse bilanci i llogarisë IPA në Euro i parashikuar në nenin 6 është i pamjaftueshëm për të mbuluar kërkesë-pagesat e dorëzuara nga përfituesit në pritje të marrjes së pagesës nga Komisioni, Përfituesi IPA II përdor fondet kombëtare për të parafinancuar kontributin e BE-së. Në këto raste, fondet kombëtare trajtohen si fonde të BE-së dhe paragrafi 6 zbatohet në momentin kur bëhet pagesa e plotë e kontributit kombëtar, nëse ka, dhe kontributi i BE-së i parafinancuar prej fondeve kombëtare regjistrohet në llogaritë e Fondit Kombëtar.
- (9) Asistenca IPA II mbulon vetëm shpenzimet e kryera dhe të paguara nga Përfituesi II IPA II në përputhje me rregullat e pranueshmërisë të parashikuara në Rregulloren Financiare, Rregullat e saj të Zbatimit, Rregulloren e Përbashkët Zbatuese, Rregulloren Zbatuese IPA II dhe nenet 29, 30 dhe 31, si dhe siç përcaktohet në secilin aksion në kuadër të programeve.
- (10) Shkëmbimi i informacionit në lidhje me transaksionet financiare ndërmjet Komisionit dhe strukturave e autoriteteve të përmendura në nenin 10 bëhen në mënyrë elektronike, kur është e mundur, duke ndjekur procedurat e rëna dakord ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit IPA II.

Neni 34 Parafinancimi

- (1) Kushtet bazë për kërkesë-pagesën e parafinancimit janë si më poshtë:
- (a) ZKA/NAO e ka njoftuar Komisionin për hapjen e llogarisë përkatëse në Euro;
 - (b) Marrëveshja e Financimit është nënshkruar dhe është në fuqi.
- (2) Dispozitat e hollësishme për llogaritjen e pagesave të parafinancimit për programet njëvjeçare dhe shumëvjeçare parashikohen në Marrëveshjet Sektoriale dhe/ose të Financimit.
- (3) Shuma totale e parafinancimit paguhet jo më vonë se data e mbylljes së programit, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Marrëveshjen Sektoriale apo atë të Financimit.

Neni 35 Pagesat e ndërmjetme

- (1) Kushtet bazë për pagesë të ndërmjetme janë si më poshtë:
- (a) ZKA t'i ketë dërguar Komisionit kërkesë-pagesën shoqëruar me pasqyrën e shpenzimeve ku renditen me hollësi shpenzimet e bëra dhe të paguara si edhe informacion për parafinancimin, nëse është e zbatueshme. Kërkesë-pagesa përmban

- informacion përkatës për zbatimin siç parashikohet hollësisht në Marrëveshjen Sektoriale apo atë të Financimit;
- (b) të jenë respektuar tavanet për kontributin e BE-së, siç përcaktohet në vendimin për financim;
 - (c) KKIPA t'i ketë dërguar Komisionit raportin vjetor të zbatimit, sipas nenit 59(1), përfshirë atë më të fundit;
 - (d) Autoriteti Auditues t'i ketë dërguar Komisionit opinionin vjetor të auditit më të fundit, si dhe raportin vjetor të aktivitetit auditues, sipas pikës (b) të Klauzolës 5(3) të Shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje.
 - (e) Marrëveshja përkatëse e Financimit të jetë në fuqi;
 - (f) Komisionit t'i jetë vënë në dispozicion çdo informacion i kërkuar;
- (2) Pa cenuar opinionin vjetor të auditit dhe vendimin për shqyrtimin dhe miratimin e llogarive, nëse konstatohet se nuk janë respektuar rregullat përkatëse apo se fondet nuk janë përdorur siç duhet, pagesat mund të pezullohen ose ndërpriten sipas nenit 60(4) të Rregullores Financiare dhe procedurës së parashikuar në nenet 39 dhe 40.

Neni 36 Procedura e shqyrtimit dhe pranimit të llogarive

- (1) Procedura e shqyrtimit dhe pranimit të llogarive synon të garantojë se shpenzimet e bëra dhe të paguara nga Përfituesi IPA II në kontekstin e menaxhimit indirekt dhe që i ngarkohen buxhetit të BE-së të jenë në përputhje me rregullat e zbatueshme të Bashkimit Evropian dhe se llogaritë janë të plota, të sakta dhe të vërteta.
- (2) Procedura e shqyrtimit dhe pranimit të llogarive përbëhet nga:
- (a) analiza e pasqyrës së shpenzimeve siç dorëzohet nga ZKA;
 - (b) analiza e raportit përfundimtar të zbatimit, sipas nenit 59(4);
 - (c) analiza e opinionit që dërgon Autoriteti Auditues për pasqyrën e shpenzimeve të mbështetur nga një raport aktiviteti auditues, sipas rastit;

- (d) analiza e dokumenteve përkatëse, siç përcaktohet në Marrëveshjen Sektoriale apo atë të Financimit dhe, sipas rastit, ose kontrollet në vend të Komisionit, pa kufizime, në përmbajtjen e këtyre deklaratave dhe raporteve financiare dhe në transaksionet përkatëse, përfshirë kontrollet e kryera me marrësit e asistencës;
 - (e) caktimi nga Komisioni i shumës së shpenzimeve të njohur si e pranuar në buxhetin e BE-së, në vijim të një procedure rakordimi, kur është e nevojshme, dhe pasi njoftohen Përfituesit IPA II;
 - (f) llogaritja e korigjimit financiar që lind nga diferenca midis shpenzimeve të deklaruara dhe shpenzimeve të njohura si pranohen në buxhetin e BE-së;
 - (g) rikuperimin ose shlyerjen nga Komisioni të bilancit që lind nga diferencat ndërmjet shpenzimeve të pranuar në buxhetin e BE-së dhe shumat që i janë paguar Përfituesit IPA II.
- (3) Procedura e shqyrtimit dhe pranimit të llogarive e parashikuar në paragrafin 2 nuk cenon mundësinë që Komisioni të rikuperojë shpenzimet e papranueshme në një kohë të mëvonshme, mbi bazën e auditeve apo inspektimeve të kryera gjatë apo pas zbatimit të programit.

Neni 37 Pagimi i bilancit përfundimtar

- (1) Kushtet bazë për pagimin e bilancit përfundimtar janë si më poshtë:
- (a) ZKA t'i ketë dërguar Komisionit një kërkesë-pagesë përfundimtare, sipas rastit, dhe një pasqyrë shpenzimesh përfundimtare;
 - (b) KKIPA t'i ketë dërguar Komisionit raportin përfundimtar të zbatimit sipas nenit 59(4);
 - (c) Autoriteti Auditues t'i ketë dërguar Komisionit, sipas pikës (iii) të Klauzolës 5(3)(b) të Shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje, opinionin për pasqyrën e shpenzimeve përfundimtare, të mbështetur sipas rastit nga një raport përfundimtar aktiviteti auditues;
 - (d) Marrëveshja Financiare përkatëse të jetë në fuqi;

(e) Komisioni të ketë përfunduar procedurën e shqyrtimit dhe pranimit të llogarive të parashikuara në nenin 36;

(2) Kur nuk ka kërkesë për pagesë përfundimtare, ZKA i paraqet Komisionit një pasqyrë financiare përfundimtare.

Neni 38 Anulimi i fondeve të papërdorura në rastin e programeve shumëvjeçare me buxhet të ndarë

(1) Komisioni anulon automatikisht çdo fond buxhetor të akorduar për një program që, deri më 31 dhjetor të vitit të pestë pas vitit buxhetor kur është akorduar, nuk është përdorur për qëllimin e parafinancimit apo kryerjen e pagesave të ndërmjetme ose për të cilën ZKA nuk ka paraqitur pasqyrë shpenzimesh të certifikuar apo kërkesë-pagesë. Në Marrëveshjen Sektoriale ose në atë të Financimit mund të specifikohet një afat më i hershëm.

(2) Komisioni informon Përfituesin IPA II në kohën e duhur sa herë që ka rrezik anulimi fondesh të akorduara si në paragrafin 1.

Neni 39 Ndërprerja e pagesave

(1) Pavarësisht afateve për pagesat e parashikuara në nenin 33(4), Komisioni mund të ndërpresë pagesat për Përfituesin IPA II plotësisht ose pjesërisht, me qëllim që të kryejë kontrole të mëtejshme kur:

(a) Komisioni vihet në dijeni të informacioni të besueshëm që tregon mangësi të konsiderueshme në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, ose që shpenzimet e certifikuara nga subjekti në fjalë kanë lidhje me një parregullsi të rëndë dhe nuk është korrigjuar;

(b) ndërprerja është e nevojshme për të parandaluar dëmin e konsiderueshëm ndaj interesave financiare të BE-së.

(2) Komisioni mund të ndërpresë vetëm një pjesë të shpenzimeve që figurojnë në kërkesë-pagesën e cenuar nga elementët e përcaktuar në paragrafin 1. Komisioni informon Përfituesin IPA II menjëherë për arsyen e ndërprerjes dhe i kërkon të korrigjojë situatën, nëse nevojitet. Komisioni eliminon ndërprerjen sapo të jenë marrë masat e nevojshme.

Neni 40 Pezullimi i pagesave

- (1) Komisioni mund të pezullojë pagesat për Përfituesin IPA II, veçanërisht kur zbulohen gabime sistemike që vënë në dyshim besueshmërinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të subjektit në fjalë apo ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve përkatëse.
- (2) Përfituesit IPA II i jepet mundësia që të paraqesë komentet brenda një periudhe dymujore para se Komisioni të vendosë për pezullimin sipas paragrafit 1.
- (3) Komisioni e ndërpret pezullimin kur Përfituesi IPA II i ka marrë masat e nevojshme për ndreqjen e gabimeve sistemike.

Nëse Përfituesi IPA II nuk i ka marrë këto masa, Komisioni mund të vendosë të anulojë plotësisht ose pjesërisht kontributin IPA II të programit sipas nenit 43.

Neni 41 Rikuperimi i fondeve

- (1) Çdo situatë e përcaktuar në nenin 51(5) që ndodh kurdo gjatë zbatimit të asistencës IPA II ose që rezulton nga një audit, mund të çojë në rikuperimin e fondeve nga Komisioni prej Përfituesit IPA II.
- (2) ZKA rikuperon kontributin e BE-së që i është paguar Përfituesit IPA II prej atyre që kanë qenë në situatën e përcaktuar në nenin 51(5) apo që kanë përfituar prej saj sipas procedurave kombëtare për rikuperimin e fondeve publike. Edhe nëse ZKA nuk arrin të rikuperojë plotësisht apo pjesërisht këto fonde, Komisioni gëzon të drejtën të rikuperojë këto fonde duke ia marrë Përfituesit IPA II.

Neni 42 Rregullimet financiare nga Përfituesi IPA II

ZKA, i cili fillimisht mban përgjegjësinë për shqyrtimin e parregullsive, kryen rregullimet financiare kur në aksionet apo programet zbulohet një nga situatat e përcaktuara në nenin 51(5), duke anuluar të gjithë ose pjesërisht kontributin e BE-së për ato aksione apo programe. ZKA merr parasysh natyrën dhe shkallën e parregullsive, si dhe humbjen financiare që i është shkaktuar kontributit të BE-së.

Neni 43 Korrigjimet financiare nga Komisioni

- (1) Për të garantuar përdorim të fondeve IPA II në përputhje me rregullat e zbatueshme, Komisioni ndjek procedurën e shqyrtimit dhe pranimit të llogarive të specifikuar në nenin

36 si edhe mekanizmat e korrigjimit financiar sipas nenit 17 të Rregullores Zbatuese IPA II, si edhe siç parashikohet hollësisht në Marrëveshjet Sektoriale ose Marrëveshjet Financiare.

(2) Nevoja për korrigjim financiar lind nga situatat e mëposhtme:

(a) identifikimi i ndonjë shtate të parashikuar në nenin 51(5);

(b) identifikimi i ndonjë dobësie apo mangësie në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të Përfituesit IPA II;

(c) ndjekje e situatës nga Komisioni në vijim të raporteve apo opinioneve të Autoritetit Auditues.

(3) Nëse Komisioni konstaton se shpenzimet në kuadrin e programit që mbulon IPA II janë bërë dhe paguar në shkelje të rregullave të zbatueshme, vendos se cilat shuma të përjashtohen nga financimi i BE-së.

(4) Komisioni bën llogaritjen dhe kryerjen e korrigjimeve të tilla, si edhe rikuperimet përkatëse, duke zbatuar kriteret dhe procedurat që përcaktohen në paragrafët 5 deri 7 të këtij neni, si edhe në nenet 36 dhe 44.

(5) Korrigjimet financiare kryhen mundësisht me kompensim, në situatat e përcaktuara në paragrafin 2.

(6) Komisioni kryen korrigjimet financiare pasi identifikohen shumatat e paguara padrejtësisht dhe implikimet financiare për buxhetin. Nëse është e pamundur që këto shumatat të identifikohen me saktësi me qëllim që të kryhen korrigjime individuale, Komisioni mund të aplikojë korrigjime me normë fikse ose korrigjime bazuar në ekstrapolim të konstatimeve.

(7) Kur vendos për shumën e korrigjimit, Komisioni merr parasysh natyrën dhe shkallën e situatës së përcaktuar në nenin 51(5) dhe/ose shtrirjen dhe implikimet financiare të dobësive apo mangësive të konstatuara në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të programit në fjalë.

Neni 44 Procedura për korrigjimet financiare dhe pranimin e llogarive

- (1) Para marrjes së një vendimi për një korigjim financiar, përfshirë ato që bëhen në bazë të procedurës për shqyrtimin dhe pranimin e llogarive, Komisioni informon ZKA-në për përfundimet e parakohshme dhe i kërkon që brenda dy muajsh të japë komentet e veta.

Nëse Komisioni propozon një korigjim financiar mbi bazë ekstrapolimi të konstatimeve apo një norme fikse sipas nenit 43(6), Përfituesit IPA II i jepet mundësia të ofrojë informacion që i mundëson Komisionit të vlerësojë situatën sipas nenit 51(5), nëpërmjet një shqyrtimi të dokumentacionit përkatës. Me pëlqimin e Komisionit, Përfituesi IPA II mund të kufizojë objektin e këtij shqyrtimi në një sasi apo model dokumentacioni përkatës. Përveç se në rastet e justifikuara siç duhet, ky shqyrtim nuk zgjat më shumë se dy muaj nga periudha dymujore e përcaktuar në nënparagrafin e parë. Rregulla më të hollësishme mund të parashikohen në Marrëveshjen Sektoriale ose në Marrëveshjen e Financimit.

- (2) Komisioni merr vendimin pasi merr parasysh ndonjë të dhënë që ia paraqet Përfituesi IPA II.

Neni 45 Ripërdorimi i kontributit të BE-së

- (1) Fondet e anuluar prej kontributit të BE-së në vijim të korigjimeve financiare sipas nenit 43, derdhen në buxhetin e BE-së.
- (2) Kontributi i anuluar ose i rikuperuar nga përfituesi IPA II sipas nenit 42 nuk mund të ripërdoret për aktivitetin apo aktivitetet që kanë qenë objekt rikuperimi apo rregullimi, as nëse rikuperimi apo rregullimi ka ardhur pas një parregullsie sistematike, për aktivitete në vazhdim brenda të gjithë apo një pjese të programit apo aksionit në të cilin është konstatuar parregullsia sistematike.

Neni 46 Shlyerja

- (1) Përfituesi IPA II kryen çfarëdo shlyerje në buxhetin e përgjithshëm të BE-së para datës së përcaktuar në urdhrin e rikuperimit të hartuar sipas nenit 79 të Rregullores Financiare. Afati është dita e fundit e muajit të dytë pas nxjerrjes së këtij urdhri.
- (2) Vonesat në shlyerje shkaktojnë kamatëvonesë që fillon nga dita kur skadon afati, deri në datën kur kryhet pagesa. Norma e kamatës është 1,5 pikë përqindje mbi normën e zbatuar nga Banka Qendrore Evropiane në operacionet kryesore ri-financuese në ditën e parë të punës të muajit kur bie data në fjalë.

TITULLI III MBYLLJA E PROGRAMIT**Neni 47 Mbyllja e programit me menaxhim indirekt nga Përfituesi IPA II**

- (1) Komisioni njofton me shkrim Përfituesin IPA II për mbylljen e programit.
- (2) Komisioni nuk e mbyll programin dhe nuk ia paguan bilancin përfundimtar Përfituesit IPA II pa kryer paraprakisht shqyrtimin dhe pranimin e llogarive siç e parashikon neni 36.
- (3) Mbyllja e programit nuk i cenon të drejtën Komisionit për të ndërmarrë korrigjime financiare në një fazë të mëvonshme.
- (4) Rregulla më të hollësishme për mbylljen e programeve mund të parashikohen në Marrëveshjen Sektoriale ose në atë të Financimit.

Neni 48 Mbyllja e programit me menaxhim direkt dhe indirekt me subjekte të ndryshme nga Përfituesi IPA II

- (1) Programi mbyllet pasi të mbyllen të gjitha kontratat dhe grantet e financuara nga ky program.
- (2) Komisioni njofton me shkrim Përfituesin IPA II për mbylljen e programit.
- (3) Mbyllja e programit nuk i cenon të drejtën Komisionit për të ndërmarrë korrigjime financiare në një fazë të mëvonshme.
- (4) Rregulla më të hollësishme për mbylljen e programeve mund të parashikohen në Marrëveshjen Sektoriale ose në atë të Financimit.

Neni 49 Ruajtja e dokumenteve

Përfituesi IPA II ruan për gjashtë vjet, nga afati përfundimtar për zbatimin operacional të marrëveshjes së financimit, të gjitha dokumentet që lidhen me procedurat e prokurimit dhe shpalljes së fituesit të grantit, kontratat, shtesat, korrespondencat përkatëse dhe të gjitha dokumentet përkatëse që lidhen me pagesat dhe rikuperimet.

Periudha kohore e përcaktuar në pikën (1) të këtij neni ndërpritet në rast procedimi ligjor ose me kërkesë të justifikuar siç duhet nga Komisioni.

TITULLI IV

MBIKËQYRJA, KONTROLLI, AUDITI DHE MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARE

Neni 50 Mbikëqyrja, kontrolli dhe auditi nga Komisioni dhe Gjykata Evropiane e Auditëve

- (1) Të gjitha Marrëveshjet e Financimit si edhe programet, aksionet dhe kontratat në zbatim të tyre janë objekt mbikëqyrjeje, kontrolli dhe auditi nga Komisioni, përfshi Zyrën Evropiane Anti-Mashtrim (OLAF) dhe auditet e Gjykatës Evropiane të Auditëve.

Nën menaxhim indirekt nga Përfituesi IPA II, kjo përfshin edhe të drejtën e Komisionit dhe Delegacionit të BE-së në Republikën e Shqipërisë që të marrë masa të përshtatshme, si për shembull:

- (a) verifikim *ex-ante* i tenderimit dhe kontraktimit të kryer nga strukturat operuese përkatëse;
- (b) kontrolle *ex-post* të tenderimit, kontraktimit, ekzekutimit të kontratës, përfshirë menaxhimin financiar të tyre, si edhe aktivitetet e programit të kryera nga strukturat operuese përkatëse;
- (c) mbikëqyrje në lidhje me funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit.

Agjentët e autorizuar dhe përfaqësuesit e Komisionit dhe të OLAF-it kanë të drejtë të kryejnë çfarëdo verifikimi teknik dhe financiar që Komisioni apo OLAF-i e çmon të nevojshme për mbikëqyrjen apo rishikimin e zbatimit të programit, aksionit apo kontratës, përfshirë vizita në terren dhe në ambientet ku po zbatohen aktivitetet e financuara prej IPA II. Komisioni njofton paraprakisht autoritetet kombëtare për këto misione.

- (2) Përfituesi IPA II ngre një strukturë (shërbim bashkërendimi Anti-mashtrim)¹⁷ për të lehtësuar bashkëpunimin efikas dhe shkëmbimin e informacionit me OLAF-in, përfshirë informacionin me natyrë operacionale.

Nën menaxhimin indirekt, këtij shërbimi i ngarkohet bashkërendimi i aktiviteteve dhe detyrimeve operacionale dhe administrative, si edhe të propozojë ndryshime në legjislacionin e brendshëm sipas rastit, me qëllim që të mbrohen interesat financiare të BE-së. Ndër të tjera, struktura ka për detyrë të orientohet drejt hartimit/zbatimit të strategjive kombëtare në mbrojtje të interesave financiare të BE-së, duke identifikuar dobësitë e mundshme në sistemet kombëtare për menaxhimin e fondeve të BE-së, përfshirë lëvrimin e asistencës IPA II, të garantojë kapacitete e mjaftueshme njerëzore për këto detyra, përfshirë trajnimin e stafit për parandalimin e mashtrimit, të mbështetë bashkëpunimin ndërmjet administratës kombëtare, autoriteteve të prokurorisë dhe OLAF-

¹⁷

Kjo strukturë nuk bën pjesë në strukturat e përcaktuara në nenin 10 dhe ngritja e saj nuk është parakusht për ngarkimin e detyrave për ekzekutimin e buxhetit.

it, të shkëmbejë informacion mbi parregullsitë dhe mashtrimet e dyshuara me autoritetet kombëtare dhe OLAF-in, si edhe të garantojë përmbushjen e detyrimeve në kuadrin e Rregullores (KE, Euratom) nr. 883/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit¹⁸, Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 2988/1995¹⁹ si dhe Rregulloren e Këshillit 2185/1996²⁰.

- (3) Përfituesi IPA II vë në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar, përfshirë të dhëna kompjuterike, si edhe merr të gjitha masat e duhura për të lehtësuar punën e personave të udhëzuar për të realizuar audite dhe inspektime.
- (4) Përfituesi IPA II mban të dhëna dhe kontabilitet të mjaftueshëm që evidentojnë shërbimet, furnizimet, punimet dhe grantet e financuara në kuadrin e Marrëveshjes së Financimit përkatëse, në përputhje me standardet kontabël të pranura ndërkombëtarisht. Përfituesi IPA II garanton edhe që agjentët apo përfaqësuesit e Komisionit, përfshirë ata të OLAF-it, të kenë të drejtën të inspektojnë të gjitha dokumentet dhe llogaritë përkatëse që i përkasin zërave të financuar në kuadrin e Marrëveshjes së Financimit përkatëse dhe ndihmon Gjykatën Evropiane të Auditëve për realizimin e auditeve me objekt përdorimin e asistencës IPA II.
- (5) Për të garantuar mbrojtjen efikase të interesave financiare të BE-së, Komisioni dhe OLAF-i mund të kryejnë kontrolle në terren dhe dokumentare, si edhe inspektime sipas Rregullores nr. (EU, Euratom) 883/2013 dhe Rregullores (KE, Euratom) nr. 2185/199. Këto kontrolle dhe inspektime përgatiten dhe kryhen në bashkëpunim të ngushtë me Përfituesin IPA II, që njoftohet në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, me qëllim që të ofrojë të gjithë ndihmën e kërkuar. Përfituesi IPA II identifikon një shërbim që të asistojë, me kërkesën e OLAF-it, në kryerjen e hulumtimeve sipas Rregullores nr. (EU, Euratom) 883/2013 dhe Rregullores (KE, Euratom) nr. 2185/1996. Nëse Përfituesi IPA II dëshiron, kontrollin në terren dhe inspektimet mund të kryhen bashkërisht. Nëse pjesëmarrësit në aktivitetet e financuara nga IPA II kundërshtojnë kontrollin në terren apo inspektimin, Përfituesi IPA II që vepron në përputhje me rregullat kombëtare, u siguron inspektorëve të Komisionit/OLAF-it ndihmën e nevojshme që ata të kryejnë detyrën e tyre në kryerjen e kontrollit në terren dhe inspektimit. Komisioni/OLAF-i i raporton sa më shpejt Përfituesit IPA II për ndonjë të dhënë apo dyshim në lidhje me një mashtrim apo parregullsi për të cilat është vënë në dijeni gjatë kryerjes së kontrollit në terren apo inspektimit. Në çdo rast, Komisioni/OLAF-i ka detyrimin të informojë autoritetin e sipërcituar mbi rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve.

¹⁸ Rregullorja (BE, Euratom) nr. 883/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 shtator 2013 në lidhje me hetimet që kryen Zyra Evropiane Anti-Mashtrim dhe që shfuqizon Rregulloren (KE) nr. 1073/1999 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, si edhe Rregulloren e Këshillit (Euratom) nr. 1074/1999, (GZ L 248, 18 shtator 2013, faqe 1).

¹⁹ Rregullorja e Këshillit (Euratom, KE) nr. 2988/1995 e 18 dhjetorit 1995 për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Evropiane (GZ L 312, 23 dhjetor 1995, faqe 1).

²⁰ Rregullorja e Këshillit (Euratom, KE) nr. 2185/96 e 11 nëntorit 1996 në lidhje me kontrollin në terren dhe inspektimet që kryen Komisioni në mbrojtje të interesave financiare të Komuniteteve Evropiane kundër mashtrimit dhe parregullsisive të tjera (GZ L 292, 15 nëntor 1996, faqe 2).

- (6) Kontrollat dhe auditet e përshkruara më lart janë të detyrueshme për të gjithë marrësit dhe nënkontraktuesit që kanë përfituar fonde të asistencës IPA II, si dhe përfshijnë të gjitha informacionet përkatëse që ndodhen në dokumentet e Fondit Kombëtar të Përfituesit IPA II në lidhje me kontributin kombëtar, nëse ka,
- (7) Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe të Gjykatës Evropiane të Auditëve, Komisioni gëzon të drejtën të kontrollojë llogaritë dhe operacionet e Fondit Kombëtar dhe, sipas rastit, të strukturave operuese, nga vetë ai ose nëpërmjet një audituesi të jashtëm të ngarkuar prej Komisionit.

Neni 51 Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

- (1) Në përputhje me nenin 60(3) të Rregullores Financiare, Përfituesi IPA II të cilit i janë besuar detyrat e ekzekutimit të buxhetit të asistencës IPA II, parandalon, zbulon dhe korrigjon parregullsitë dhe mashtrimet gjatë kryerjes së këtyre detyrave. Për këtë qëllim, Përfituesi IPA II kryen kontrole *ex-ante* dhe *ex-post*, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, përfshirë kontrollat në terren mbi baza modelesh transaksionesh përfaqësuese dhe/ose me bazë risku, që të garantohet se aksionet e financuara prej buxhetit janë kryer me efektivitet dhe zbatuar me korrektësi. Përfituesi IPA II rikuperon fondet e paguara padrejtësisht dhe ngrë padi gjyqësore kur është e nevojshme.
 - (2) Përfituesi IPA II siguron hetim dhe trajtim efikas të rasteve të dyshuara për mashtrim, konflikt interesi apo parregullsi dhe garanton funksionimin e një mekanizmi kontrolli dhe raportimi, siç parashikohet në nenin 16 të Rregullores Zbatuese IPA II. Përfituesi IPA II raporton pa vonesë tek Komisioni për mashtrimet e dyshuara dhe parregullsitë e tjera që kanë qenë objekt shqyrtimi administrativ apo gjyqësor të shkallës së parë, si dhe e mban të informuar Komisionin për ecurinë e procedimeve administrative dhe ligjore. Përveç dispozitave të Shtojcës H të kësaj Marrëveshjeje, klauzola më të hollësishme mund të parashikohen në Marrëveshjen Sektoriale apo atë të Financimit.
 - (3) Gjithashtu, Përfituesi IPA II merr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar apo zbuluar çdo praktikë korrupsioni aktiv apo pasiv në cilëndo fazë të procedurës së tenderimit apo të shpalljes së fituesit të grantit, ose gjatë zbatimit të kontratave korresponduese.
 - (4) Përfituesi IPA II, përfshirë personelin përgjegjës për zbatimin e detyrave të aktiviteteve të financuara nga IPA II, merr masat e duhura paraprake për të shmangur ndonjë rrezik konflikti interesi dhe informon menjëherë Komisionin për ndonjë konflikt të tillë interesi ose situatë që mund të çojë në konflikt të tillë.
 - (5) Për qëllime të këtij neni, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
-

- (a) *Gabim* do të thotë gabime të paqëllimshme administrative dhe teknike nga Përfituesi IPA II ose marrësi i asistencës IPA II;
- (b) *Parregullsi* do të thotë çfarëdo shkelje të një dispozite të rregullave të zbatueshme dhe kontratave që rezulton nga një veprim apo mosveprim i një operatori ekonomik që ka ose do të kishte efektin e cenimit të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian, duke ngarkuar një zë pajustificuar shpenzimesh në buxhetin e përgjithshëm.
- (c) *Operator ekonomik* do të thotë çfarëdo personi fizik apo juridik ose subjekt tjetër që merr pjesë në zbatimin e asistencës IPA II;
- (d) *Parregullsi sistemike* do të thotë çfarëdo parregullsie me natyrë përsëritëse, me probabilitet të lartë të ndodhë në lloje të ngjashme operacionesh, që rezulton nga mangësi serioze në funksionimin efikas të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, përfshirë mosvendosjen e procedurave të përshtatshme sipas rregullave të zbatueshme;
- (e) *Mashtrim* do të thotë çfarëdo veprimi apo mosveprimi i paqëllimshëm që lidhet me: përdorimin ose paraqitjen e dokumenteve apo pasqyrave të rreme, të pasakta apo të paplota, që ka për efekt përvetësimin apo mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i BE-së apo buxhetet e menaxhuara nga apo për llogari të Bashkimit Evropian, moszbulimin e informacionit në shkelje të një detyrimi specifik me të njëjtin efekt apo keqpërdorimi i këtyre fondeve për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë dhënë fillimisht;
- (f) *Mashtrim i dyshuar* do të thotë një parregullsi që çon në nisjen e një procedimi administrativ apo gjyqësor në nivel kombëtar, me qëllim që të përcaktohet nëse ka pasur paramendim, veçanërisht në lidhje me mashtrimin, siç parashikohet më lart;
- (g) *Korrupsion aktiv* do të thotë veprimi i qëllimshëm i kujtudo që premtion ose jep një favor të çfarëdo lloji, drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi, nëpunësi apo vetes ose një pale të tretë për të, që të veprojë apo të mos veprojë në zbatim të detyrës së vet apo në ushtrim të funksioneve të veta, duke shkelur funksionet zyrtare në mënyrë të tillë që dëmton ose ka gjasa të dëmtojë interesat financiare të BE-së;
- (h) *Korrupsion pasiv* do të thotë veprim i qëllimshëm i një nëpunësi civil, i cili, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, kërkon ose merr favore të çfarëdo lloji për vete apo për një palë të tretë, ose pranon premtimin për një favor të tillë, që të veprojë apo të mos veprojë në zbatim të detyrës së vet apo në ushtrim të funksioneve të veta, duke shkelur funksionet zyrtare në mënyrë të tillë që dëmton ose ka gjasa të dëmtojë interesat financiare të BE-së;
- (i) *Konflikt interesi* do të thotë kur cenohet ushtrimi i paanshëm dhe objektiv i funksioneve të një aktori financiar apo personi tjetër për arsye që përfshijnë familjen, jetën

emocionale, politike apo përkatësinë kombëtare, interesat ekonomike apo interesa të tjera të përbashkëta me një përfitues fondesh;

- (j) Konstatim administrativ apo gjyqësor parësor do të thotë një vlerësim paraprak me shkrim nga një autoritet kompetent, qoftë administrativ apo gjyqësor, që mbi bazën e fakteve specifike arrin në përfundimin se është kryer një parregullsi, pa cenuar mundësinë që ky përfundim mund të rishikohet ose revokohet si rezultat i fakteve të procedurës administrative apo gjyqësore.

Përkufizimet më lart në këtë nen nuk konsiderohen sikur shtojnë vepra penale të reja në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë bashkë me ndryshimet e tij.

SEKSIONI VI MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI

TITULLI I MONITORIMI

Neni 52 Komiteti Monitorues IPA

- (1) Brenda gjashtë muajve pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së parë të Financimit, Komisioni dhe Përfituesi IPA II ngrenë një Komiteti Monitorimi IPA. Ky Komitet përmbush përgjegjësitë e Komitetit të Monitorimit IPA, siç parashikon Rregullorja nr. 1085/2006.
 - (2) Komiteti Monitorues IPA shqyrton efikasitetin, cilësinë, koherencën, bashkërendimin dhe përputhshmërinë e zbatimit të të gjitha aksioneve drejt përmbushjes së objektivave të parashikuar në Marrëveshjet e Financimit dhe në dokumentet strategjike të vendit. Për këtë qëllim, ky Komitet bazohet sipas rastit në informacionin e marrë prej komiteteve sektoriale të monitorimit.
 - (3) Komiteti monitorues IPA mund t'i paraqesë propozime Komisionit, KKIPA-s dhe ZKA-së për të garantuar koherencë dhe bashkërendim më të mirë të asistencës IPA II, siç parashikohet në dokumentet strategjike të vendit, dhe, sipas rastit, në dokumentet strategjike shumëvendëshe apo në Rregulloren IPA II, si dhe për të forcuar eficientë, efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të kësaj asistence. Gjithashtu, Komiteti Monitorues IPA mund t'iu rekomandojë masa korrigjuese Komiteteve Monitoruese Sektoriale, me qëllim që të garantohet përmbushja e objektivave të IPA II dhe të forcohet efikasiteti dhe efektshmëria e asistencës IPA II. Për këtë qëllim, sipas rastit, merr parasysh përfundimet dhe rekomandimet e nxjerra nga monitorimet dhe vlerësimet e kryera si nga Komisioni, ashtu edhe nga Përfituesi IPA II.
 - (4) Komiteti Monitorues IPA miraton rregulloren e vet të brendshme bashkërisht me KKIPA-n, ZKA-në dhe Komisionin.
-

- (5) Komiteti Monitorues IPA përbëhet nga përfaqësues të Komisionit, KKIPA-s dhe organeve të autoriteteve kombëtare përkatëse të Përfituesit IPA II dhe, sipas rastit, organizatave ndërkombëtare, përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare dhe grupe interesi si shoqëria civile dhe organizatat e sektorit privat. Përfaqësuesit e grupeve të interesit zgjidhen sipas rregullave dhe kritereve të përcaktuara në rregulloren e brendshme të Komitetit Monitorues IPA dhe bashkërisht me Komisionin. Mbledhjet e Komitetit Monitorues IPA bashkëkryesohen nga një përfaqësues i Komisionit dhe një përfaqësues i KKIPA-s.
- (6) Komiteti Monitorues IPA mbledhet të paktën një herë në vit. Takime të posaçme mund të zhvillohen me nismën e Komisionit apo të Përfituesit IPA II, veçanërisht mbi bazë tematike.
- (7) Në rastin e menaxhimit direkt, kur Komitetet Monitoruese Sektoriale ende nuk janë ngritur sipas nenit 53, Komiteti Monitorues IPA kryen të gjitha funksionet e renditura në paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 53 Komiteti Monitorues Sektorial

- (1) Në kuadrin e menaxhimit indirekt nga Përfituesi IPA II, ai në konsultim me Komisionin ngre Komitete Monitoruese Sektoriale për çdo fushë apo program, përfshirë në nivel sektori sipas rastit, jo më vonë se gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e të parës Marrëveshje Financimi në lidhje me fushën apo programin përkatës, pas konsultimeve me Komisionin. Kur është e nevojshme, mund të ngrihen Komitete Monitoruese Sektoriale të posaçme që funksionon me metoda zbatimi të tjera.
- (2) Secili Komitet Monitorues Sektorial shqyrton efikasitetin, efektshmërinë, cilësinë, koherencën, bashkërendimin dhe përputhshmërinë e zbatimit të aksioneve në fushën apo programin përkatës, si edhe qëndrueshmërinë e tyre me strategjinë kombëtare dhe përkatëse, kur është e nevojshme. Ai e mat progresin në përmbushjen e objektivave të masave dhe *produkteve*, rezultateve dhe ndikimeve të pritshme të tyre, duke përdorur tregues që nisen nga skenarë bazë, si edhe progresin e bërë në ekzekutimin financiar.
- (3) Bazuar në raportet që marrin prej strukturave operuese, Komitetet Sektoriale Monitoruese kryejnë veçanërisht këto detyra:
 - (a) shqyrtojnë progresin e bërë në arritjen e objektivave dhe *produkteve* dhe rezultateve të planifikuara, si dhe në vlerësimin e ndikimit dhe qëndrueshmërisë së aksioneve dhe programeve në vazhdim, ndërsa garantohet koherenca me dialogun politik të vazhdueshëm, strategjitë kombëtare dhe rajonale sektoriale përkatëse dhe aktivitetet shumëvendëshe dhe/ose rajonale në vend;
 - (b) shqyrtojnë raportet vjetore të zbatimit, përfshirë ekzekutimin financiar të aksioneve;

- (d) shqyrtojnë konstatimet dhe përfundimet përkatëse, si edhe propozimet për masa korigjuese që lindin prej kontrolleve në terren, monitorimit dhe vlerësimit, nëse ka;
 - (e) diskutojnë mbi aspektet përkatëse të funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit;
 - (f) diskutojnë mbi çështjet problematike dhe aksionet;
 - (g) nëse nevojitet, marrin në konsideratë ose bëjnë propozime për ndryshime në programe, si edhe masa të tjera korigjuese për të garantuar përmbushjen e objektivave të masave dhe për të forcuar efikasitetin, efektshmërinë, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e asistencës IPA II;
 - (h) shqyrtojnë masat për informimin, reklamat, vizibilitetin dhe komunikimin e marra, në përputhje me nenet 23 dhe 24;
- (4) Konkluzionet operacionale, përfshirë rekomandimet nëse ka, hartohen në fund të mbledhjeve të komiteteve monitoruese sektoriale. Këto përfundime janë objekt ndjekjeje të mjaftueshme dhe shqyrtimi në mbledhjet pasardhëse të komitetit, si dhe përbëjnë bazën e raportimit pranë komitetit monitorues IPA për progresin e bërë sipas nenit 52(2).
- (5) Secili komitet monitorues sektorial miraton vetë rregulloren e brendshme, e cila hartohet në konsultim me strukturën operuese, KKIPA-n dhe Komisionin.
- (6) Komiteti monitorues sektorial përbëhet nga përfaqësues të organeve dhe autoriteteve kombëtare përkatëse, grupet e tjera të interesit siç janë partnerët ekonomikë, socialë dhe mjedisorë, si edhe organizatat ndërkombëtare, sipas rastit, përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare dhe shoqërinë civile. Komisioni merr pjesë në mbledhjen e komitetit. Përfaqësuesit e grupeve të interesit përzgjidhen mbi bazën e rregullave dhe kritereve të përcaktuara në rregulloren e brendshme. Mbledhjet e komitetit monitorues IPA kryesohen nga një përfaqësues i lartë i Përfituesit IPA II. Në varësi të fushës apo programit, mbledhjet e komitetit mund të bashkëkryesohen me Komisionin.
- (7) Komitetet monitoruese sektoriale mblidhen të paktën dy herë në vit. Mund të zhvillohen edhe mbledhje të posaçme
- (8) Gjatë zbatimit të programeve dhe aksioneve në zbatim të Rregullores nr. 1085/2006 dhe Rregullores IPA II, komitetet monitoruese sektoriale të ngritura sipas nenit 19 të Rregullores Zbatuese IPA II marrin parasysh punën e kryer nga komitetet monitoruese sektoriale të ngritura në zbatim të Rregullores nr. 1085/2006, veçanërisht në lidhje me programet dhe aksionet që përmban komponenti, fusha apo sektoriali përkatës IPA.

Neni 54 Aktivitete monitoruese të tjera

- (1) Përfituesi IPA II aplikon procedura shqyrtimi transparente, jo-diskriminuese dhe të efektshme në lidhje me zbatimin aktual të detyrave të besuara, si dhe angazhohet për të kryer monitorim të planifikuar *ex-post* periodik, sistematik dhe të duhur, me qëllim që të vlerësojë efikasitetin, efektshmërinë, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e asistencës IPA II.
- (2) Platforma të tjera monitorimi mund të ngrihen sipas rastit. Aktivitetet dhe rezultatet e tyre i raportohen komitetit monitorues IPA.

TITULLI II VLERËSIMI

Neni 55 Parimet e përgjithshme për vlerësimin e asistencës IPA II

- (1) Asistenca IPA II është objekt i vlerësimeve sipas nenit 30(4) të Rregullores Financiare, me qëllim përmirësimin e relevancës, koherencës, cilësisë, efikasitetit, efektshmërisë, vlerës së shtuar të BE-së, qëndrueshmërisë dhe sinergjisë me dialogun politik përkatës.
- (2) Objektivat e vlerësimit janë si më poshtë:
 - (a) vlerësimi i kushteve për zbatimin e asistencës, performancës së saj, si aktuale ashtu edhe në vazhdim, si edhe qëndrueshmëria e asistencës me objektivat e politikave të përcaktuara për arritjen e ndikimeve dhe objektivave afatgjata;
 - (b) vlerësimi i relevancës së treguesve të rezultateve dhe ndikimit të rënë dakord, për përmbushjen e ndikimeve dhe objektivave globalë afatgjatë;
 - (c) vlerësimi i procesit të programimit dhe i sistemit të monitorit si edhe, sipas rastit, i modaliteteve të zbatimit;
 - (d) arritja e llogaridhënies për asistencën ndaj institucioneve të BE-së dhe publikut, në lidhje me efikasitetin (*vlera e parasë*) dhe përdorimin e fondeve;
 - (e) nxjerrja e mësimave të dobishme që synojnë përmirësimin e cilësisë dhe hartimin e politikave dhe ndërhyrjeve të ardhshme.

Për këto qëllime, vlerësimet kryhen në kohën e duhur dhe konstatimet e nxjerra merren parasysh gjatë ciklit pasues të programimit dhe zbatimit, si edhe në vendimin për akordimin e burimeve financiare.

- (3) Vlerësimet mund të kryhen në nivel politikash, strategjik, tematik, sektorial, programi dhe operacional, si edhe në nivel vendi dhe rajonal.
- (4) Mund të kryhen vlerësime *ex ante*. Këto vlerësime synojnë të optimizojnë alokimin e burimeve buxhetore në kuadrin e programeve, si edhe të përmirësojnë cilësinë e programit. Ato identifikojnë dhe llogarisin pabarazitë, boshllëqet dhe potencialin për

zhvillim, synimet që do të arrihen, rezultatet e pritshme, objektiva të kuantifikuar, koherencën - nëse nevojitet - të strategjisë së propozuar dhe cilësinë e procedurave për zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe menaxhimin financiar.

- (5) *Vlerësimet e ndërmjetme* kryhen, kur është e nevojshme, në përputhje me nenin 18 të Rregullave të Zbatimit të Rregullores Financiare. Vlerësimi i ndërmjetëm vlerëson performancën e asistencës, rezultatet e arritura dhe mësimet e nxjerra për sa i përket burimeve njerëzore dhe financiare të akorduara, me qëllim që të verifikohet se janë në përputhje me objektivat e vendosura. Gjithashtu, Komisioni mund të kryejë vlerësime të dokumenteve strategjike në nivel vendi ose rajonal.
- (6) Vlerësimet *ex post* vlerësojnë relevancën, vlerën e shtuar të BE-së, efikasitetin, efektshmërinë, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e asistencës IPA II në drejtim të arritjes së objektivave të vendosura.
- (7) Vlerësimet marrin parasysh objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe legjislacionin përkatës të BE-së. Ndikimet afatgjata dhe qëndrueshmëria e efekteve të asistencës IPA II vlerësohen në përputhje me rregullat dhe procedurat e zbatueshme në atë kohë.
- (8) Rezultatet e vlerësimeve merren parasysh nga komiteti monitorues IPA dhe komitetet monitoruese sektoriale.
- (9) Komisioni harton metodat e vlerësimit, përfshirë standardet e cilësisë, objektivat dhe treguesit e matshëm. Përfituesi IPA II ndjek këto metoda për kryerjen e vlerësimeve.

Neni 56 Vlerësimet nga Komisioni

Kur Komisioni ndërmerr vlerësime sipas nenit 12 dhe 17 të Rregullave të Përbashkëta Zbatuese, Përfituesi IPA mbështet Komisionin duke ofruar të gjitha të dhënat dhe informacionin e nevojshëm, sipas angazhimeve ndërkombëtare për efektshmërinë e ndihmës, për të mundësuar monitorimin dhe vlerësimin e aksioneve në fjalë, përfshirë treguesit për të matur progresin në nivel vendi, siç parashikohet në dokumentet strategjike të vendit.

Neni 57 Vlerësimet nga Përfituesi IPA II në kuadrin e menaxhimit indirekt

- (1) Përfituesi IPA II të cilit i janë besuar detyra zbatimi të buxhetit të asistencës IPA II, mban përgjegjësi për kryerjen e vlerësimeve të programeve që menaxhon sipas nenit 55.
 - (2) Përfituesi IPA II, në konsultim me Komisionin, harton një plan vlerësimi ku paraqet aktivitetet vlerësuese që synon të realizojë në faza të ndryshme të zbatimit.
-

TITULLI III RAPORTIMI**Neni 58 Kërkesat bazë për raportimin pranë Komisionit**

Deri më 15 shkurt të vitit financiar pasardhës, KKIPA i dorëzon Komisionit një raport vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II. Raporti ndjek modelin e bashkëlidhur Marrëveshjes së Financimit dhe tregon kryesisht:

- (a) përfshirjen e Përfituesit IPA në programim, monitorim, vlerësim, komunikim dhe aktivitetet e vizibilitetit;
- (b) problemet e hasura në përmbushjen e kushteve dhe garantimin e qëndrueshmërisë, masat përkatëse të marra/planifikuara, problemet kryesore horizontale të hasura dhe masat zbutëse të marra, problemet e hasura gjatë zbatimit të aktiviteteve;
- (c) informacion mbi treguesit e përcaktuar në dokumentet strategjike të vendit dhe në dokumentet e programimit të specifikuara në Seksionin III të Marrëveshjes Kuadër.

Kërkesa më specifike për raportimin mund të parashikohen në Marrëveshjen Sektoriale ose në atë të Financimit.

Neni 59 Kërkesat e raportimit pranë Komisionit në kuadrin e menaxhimit indirekt nga Përfituesi IPA II sipas nenit 60(5) të Rregullores Financiare

(1) Përveç kërkesave të përcaktuara në nenin 58, KKIPA i dorëzon Komisionit një raport vjetor mbi zbatimin e detyrave të besuara për ekzekutimin e buxhetit, deri më 15 shkurt të vitit financiar pasardhës. Raporti bazohet në informacionin që kanë dërguar Strukturat Operuese, përpilohet sipas modelit bashkëlidhur Marrëveshjes së Financimit dhe përmban domozdoshmërisht:

- (a) një përmbledhje të arritjeve kryesore;
- (b) një përmbledhje të problemeve kryesore të hasura gjatë kryerjes së detyrave të ekzekutimit të buxhetit, si edhe gjatë masave vijuese;
- (c) informacion cilësor dhe sasior për progresin e bërë në zbatimin e objektivave, rezultateve, treguesve të përcaktuar në dokumentet strategjike të vendit, si dhe në dokumentet e programimit të specifikuara në Seksionin III;
- (d) rekomandime për masa korrigjuese/të mëtejshme.

(2) Deri më 15 shkurt të vitit financiar pasardhës, ZKA i dorëzon Komisionit si edhe një

kopje KKIPA-s, sa më poshtë:

(a) pasqyra apo raporte financiare vjetore me bazë akruale, siç specifikohet në Marrëveshjen e Financimit, të përpiluara sipas formatit të pasqyrave apo raporteve financiare vjetore bashkëlidhur Marrëveshjes së Financimit, ku përcaktohen qartë kostot e pranuar dhe pagesat e bëra;

(b) një deklaratë vjetore menaxhimi e përpiluar sipas udhëzimeve të Shtojcës C të kësaj Marrëveshjeje që mbulon:

- i) përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin financiar të fondeve të BE-së në Republikën e Shqipërisë, si dhe për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve përkatëse;
- ii) përgjegjësinë për funksionimin efikas të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm në kuadër të IPA II;

Nëse nuk ekzistojnë konfirmimet e kërkuara sipas Shtojcës C të kësaj Marrëveshjeje, ZKA informon Komisionin për arsyet dhe pasojat e mundshme bashkë me masat e marra ose të planifikuara për të korrigjuar situatën, si edhe për të mbrojtur interesat Bashkimit Evropian; dhe

(c) një përmbledhje të raporteve për auditet dhe kontrollet e kryera nga struktura e menaxhimit, që ofron një bazë të qëndrueshme për deklaratën e menaxhimit. Kjo përmbledhje përfshin një analizë për natyrën dhe shkallën e gabimeve dhe dobësive të identifikuara në sistem, masat korrigjuese të marra apo të planifikuara, si edhe për punën ndjekëse në vijim të raporteve që ka nxjerrë Autoriteti Auditues.

(3) Deri më 15 mars të vitit financiar pasardhës, Autoriteti Auditues i dorëzon Komisionin dhe Republikës së Shqipërisë dhe me kopje KKIPA-n dhe NAO-n, një Opinion Auditiv i shoqëruar me raportin vjetor të aktiviteteve audituese, siç përshkruhet në pikën (ii) të Klauzolës (5)(3)(b) të Shtojcës A dhe në Shtojcat D dhe E të kësaj Marrëveshjeje.

(4) Në fund të zbatimit të secilit program dhe deri në afatin e vendosur në Marrëveshjen e Financimit, KKIPA, bazuar në raportet e strukturave operuese të përcaktuara në nenin 60(1), dorëzon një raport përfundimtar për të gjithë periudhën e zbatimit ku mund të përfshijë raportin vjetor të fundit.

(5) KKIPA dorëzon një raport përfundimtar për zbatimin e asistencës IPA II për të gjithë periudhën e zbatimit të programeve të miratuara nga 1 janari 2014 deri më 31 dhjetor 2020.

(6) Përfituesi IPA II raporton rregullisht për të dhënat në lidhje me zbatimin financiar, duke përdorur transmetimin elektronik të të dhënave. Në Marrëveshjet e Financimit përcaktohet dispozita e hollësishme për shpeshësinë, formatin dhe tipin e të dhënave që do të transmetohen.

Neni 60 Raportet nga strukturat operuese në kuadrin e menaxhimit indirekt nga Përfituesi IPA II

- (1) Strukturat Operuese i vënë në dispozicion KKIPA-s dhe ZKA-së të gjithë informacionin e nevojshëm për qëllimet e raporteve të përcaktuara në nenet 58 dhe 59.
- (2) Struktura Operuese, në varësi të aksionit apo programit që ka nën përgjegjësi, mund të duhet të hartojë një raport vjetor gjithëpërfshirës për vitin e plotë financiar, të cilin KKIPA ia dorëzon Komisionit, pasi shqyrtohet prej Komitetit Monitorues Sektorial përkatës. Çdo kërkesë raportimi shtesë ndaj atyre të përcaktuara në paragrafin 1 parashikohet në Marrëveshjen Sektoriale ose në atë të Financimit.

Neni 61 Gjuha

Të gjitha raportet, vlerësimet dhe dokumentet e tjera që lidhen me përgatitjen dhe zbatimin e programeve IPA që i dorëzohen Komisionit, hartohen në gjuhën angleze.

SEKSIONI VII DISPOZITAT PËR PROGRAMET ME AKSIONE SHUMËVJEÇARE ME ANGAZHIME FINANCIARE TË NDARA**Neni 62 Parimet e zbatimit për programet me aksione shumëvjeçare me angazhime financiare të ndara të zbatuara me menaxhim indirekt nga Përfituesi IPA II**

- (1) Asistenca IPA II mund të zbatohet me menaxhim indirekt nëpërmjet programeve me aksione shumëvjeçare me angazhime financiare të ndara, sipas nenit 189(3) të Rregullores Financiare dhe nenit 6(3) të Rregullave të Përbashkëta Zbatuese. Programet e tilla përgatiten prej Komisionit mbi bazën e programeve operacionale sektoriale ose dokumenteve strategjike me aksione, sipas rastit, që hartohen nga strukturat operuese përkatëse. Programet operacionale sektoriale ose dokumentet strategjike me aksione përcaktohen në konsultim të ngushtë me Komisionin dhe grupet e interesit.

Programet operacionale sektoriale përmbajnë të gjithë informacionin e kërkuar sipas udhëzimeve të Komisionit, përfshirë ndër të tjera:

- (a) një vlerësim të nevojave dhe objektivave afatmesme;
- (b) një përmbledhje të konsultimeve me grupet e interesit;
- (c) një përshkrim të aksioneve strategjike që janë përzgjedhur;
- (d) një tabelë financiare ku specifikohet për çdo vit, për çdo aksion dhe, në mënyrë indikative për çdo aktivitet, shuma totale e kontributit të BE-së;

- (e) modalitetet e propozuara për vlerësimin dhe monitorimin;
 - (f) një listë indikative të projekteve madhore, nëse ka;
 - (g) sipas rastit, një përshkrim të strukturave dhe autoriteteve kombëtare për menaxhimin dhe kontrollin e programit operacional, sipas nenit 10 dhe Shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje;
- (2) Si pjesë e programeve me aksione shumëvjeçare me angazhime financiare të ndara siç përcakton paragrafi 1, asistenca mund të financojë edhe projekte madhore. Për qëllime të këtij neni, "projekt madhor" do të thotë një projekt që përfshin një sërë punimesh, aktiviteteve apo shërbimesh që synon në vetvete të përmbushë një detyrë të përcaktuar dhe të pandashme të një natyrë plotësisht ekonomike apo teknike, i cili ka synime të identifikuarra qartë dhe kosto totale që tejkalojnë 10 milion EURO.
- (3) Projektet madhore i dorëzohen Komisionit për miratim nga Përfituesi IPA II. Vendimi që miraton projektin përcakton objektin fizik dhe shpenzimet e pranueshme. Ai pasohet nga një marrëveshje dypalëshe me Përfituesin IPA II ku përcaktohen këta elementë.
- (4) Kur i dorëzon një projekt madhor Komisionit, Përfituesi IPA II jep të gjithë informacionin e kërkuar sipas udhëzimeve të Komisionit, përfshirë ndër të tjera:
- (a) informacion mbi subjektin përgjegjës për zbatimin;
 - (b) informacion mbi natyrën e investimit;
 - (c) kalendarin e zbatimit;
 - (d) vlerësimin e përgjithshëm të bilancit socio-ekonomik të operacionit;
 - (e) analizën e ndikimit mjedisor;
 - (f) planin e financimit.
- (5) Për qëllime të këtij neni, "aktivitet" do të thotë një komponent i një aksioni që mund të identifikohet lehtë nga kostoja e tij dhe kontributi i BE-së, si edhe nga lloji i financimit (p.sh. prokurimi, granti, etj.) i përzgjedhur nga strukturat operuese të programeve në fjalë, ose nën përgjegjësinë e tyre, që kontribuon në arritjen e objektivave të një aksioni. Në kontekstin e instrumenteve financiare, një aktivitet konsiston nga kontributet financiare të programit për instrumentet financiare, si edhe mbështetja financiare pasuese që jepet nga këto instrumente financiare.
- (6) Në rastin e projekteve madhore siç përcaktohen në paragrafin 3, shpenzimet janë të pranueshme vetëm pas Vendimit të Komisionit që miraton projektin madhor.
- (7) Në kuadrin e programeve shumëvjeçare me angazhime financiare të ndara, Komisioni gëzon të drejtën të kërkojë dorëzimin paraprak të propozimeve edhe për aktivitetet që nuk bien nën përkufizimin e projekteve madhore. Në lidhje me këto aktivitete, shpenzimet janë të pranueshme vetëm pasi Komisioni i komunikon zyrtarisht Përfituesit

IPA II se aktiviteti është miratuar.

- (8) Për sa i përket aktiviteteve që financohen në kuadrin e asistencës IPA II në programet me aksione shumëvjeçare me angazhime financiare të ndara siç përcaktohen në paragrafin 1 që gjenerojnë të ardhura neto pas përfundimit të tyre, shpenzimet e pranueshme zvogëlohen paraprakisht duke pasur parasysh potencialin e aktivitetit për të gjeneruar të ardhura neto gjatë një periudhe specifike që përfshin si zbatimin e aktivitetit, ashtu edhe periudhën pa përfundimit të tij.

Për qëllime të këtij paragrafi, "të ardhura neto" do të thotë flukse hyrëse paraje që paguhen drejtpërdrejt nga përdoruesit për mallra apo shërbime që jepen nga aktiviteti, si për shembull tarifat e paguara nga përdoruesit e infrastrukturës, shitja apo qiradhënia e tokës apo godinave, ose pagesat për shërbime minus kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes të pajisjeve jetëshkurtra që përballohen gjatë periudhës korresponduese. Kursimet e kostos operacionale të gjeneruara nga aktiviteti trajtohen si të ardhura neto, përveç kur zbriten nga një reduktim i barabartë në operim. Kur jo të gjitha kostot e investimeve direkte dhe të nevojshme për aktivitetin janë të pranueshme për financim në kuadrin e asistencës IP II, të ardhurat neto akordohen *proporcionalisht* për pjesët e pranueshme dhe të papranueshme të kostove të investimit. Dispozitat e hollësishme për llogaritjen e të ardhurave neto parashikohen në Marrëveshjen e Financimit përkatëse.

- (9) Ky nen nuk zbatohet për programet shumëvjeçare për zhvillimin rural me angazhime financiare të ndara.

SEKSIONI VIII DISPOZITAT PËR PROGRAMET E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR

TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 63 Format e bashkëpunimit ndërkufitar

- (1) Asistenca në kuadrin e këtij Seksioni synon të promovojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të nxitë integrimin në BE dhe të promovojë zhvillimin socio-ekonomik nëpërmjet nismave të përbashkëta vendore dhe rajonale.
- (2) Bashkëpunimi ndërkufitar jep asistencë për:
- (a) Bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet një ose më shumë Shteteve Anëtare dhe një ose më shumë Përfituesve IPA II;
 - (b) Bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet dy ose më shumë Përfituesve IPA II;
 - (c) Bashkëpunimin ndërkufitar ku vendet përfituese të Instrumentit Evropian të

Fqinjësisë marrin pjesë në programe të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II.

- (3) Ky Seksion zbatohet për bashkëpunimin ndërkufitar të përcaktuar në pikat (b) dhe (c) të paragrafit 2. Rregullat e zbatueshme për bashkëpunimin ndërkufitar të caktuara në pikën (a) të paragrafit 2 specifikohen në marrëveshjet e financimit që do të lidhen në zbatim të nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 64 Përkufizime shitesë për bashkëpunimin ndërkufitar

Për qëllimet e këtij Seksioni vlejné këto përkufizime:

- (a) "operacion" do të thotë një projekt, kontratë, aksion ose grup projektsh të përzgjedhura nga Autoriteti Kontraktues i programit në fjalë, ose nën përgjegjësinë e tij, që kontribuon në arritjen e objektivave të një prioriteti tematik apo prioriteteve tematike të cilave u përket;
- (b) "përfitues" do të thotë një organ publik ose privat përgjegjës për nisjen ose nisjen dhe zbatimin e operacioneve;
- (c) "shpenzime publike" do të thotë çdo kontribut publik për financimin e operacioneve që burojnë nga buxheti i autoriteteve publike kombëtare, rajonale ose vendore, buxheti i BE-së që lidhet me asistencën IPA II, buxheti i shoqatave të autoriteteve publike apo organeve të të drejtës publike me mision shërbimi publik,

Neni 65 Intensiteti i ndihmës dhe norma e asistencës IPA II

- (1) Vendimi i Komisionit që miraton një program bashkëpunimi ndërkufitar cakton normën e bashkëfinancimit dhe shumën maksimale të asistencës IPA II, bazuar në:
 - (a) totalin e shpenzimeve të pranueshme, përfshirë shpenzimet publike dhe private;
 - (b) shpenzimet publike të pranueshme.
- (2) Norma e bashkëfinancimit e BE-së në nivelin e çdo prioriteti tematik është të paktën 20% dhe jo më shumë se 85% e shpenzimeve të pranueshme. Norma e bashkëfinancimit për asistencën teknike të përcaktuar në nenin 72 është 100%.

TITULLI II RREGULLAT PËR PROGRAMIMIN

Neni 66 Prioritetet tematike dhe përqendrimi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA

- (1) Për çdo program bashkëpunimi ndërkufitar, vendet pjesëmarrëse përzgjedhin maksimumi katër prioritetet tematike, siç renditen në Shtojcën J të kësaj Marrëveshjeje
-

- (2) Programet e bashkëpunimit ndërkufitar kanë një buxhet specifik për operacionet e asistencës teknike, siç përcaktohet në nenin 72.

Neni 67 Shtrirja gjeografike

Vendet pjesëmarrëse dhe Komisioni bashkërisht miratojnë një listë rajonesh përfituese që t'i përfshijnë në programin e bashkëpunimit ndërkufitar.

Neni 68 Përgatitja, vlerësimi, miratimi dhe ndryshimet në programet e bashkëpunimit ndërkufitar

- (1) Programet e bashkëpunimit ndërkufitar hartohen sipas programit model të dhënë prej Komisionit dhe përgatiten bashkërisht nga vendet pjesëmarrëse.
- (2) Për çdo prioritet tematik të përzgjedhur, vendet pjesëmarrëse bien dakord për objektivat specifike, rezultatet e pritshme, synimet, treguesit dhe llojet e aktiviteteve që do të mbështeten, si edhe identifikojnë grupet e synuara dhe përfituesit përfundimtarë.
- (3) Programi i bashkëpunimit ndërkufitar i dorëzohet Komisionit për miratim me rrugë elektronike nga Përfituesi IPA II, ku është i vendosur Autoriteti Kontraktues.
- (4) Komisioni vlerëson qëndrueshmërinë e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar me Rregulloren Zbatuese IPA II dhe kontributin e tyre efikas në përzgjedhjen e prioriteteve tematike të përcaktuara në Shtojcën J të kësaj Marrëveshjeje, si edhe objektivat e vendosura në dokumentet strategjike.
- (5) Komisioni jep komentet e veta brenda tre muajve nga data e dorëzimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar. Vendet pjesëmarrëse i japin Komisionit të gjithë informacionin shtesë të nevojshëm dhe, sipas rastit, rishikojnë programin e bashkëpunimit ndërkufitar të propozuar.
- (6) Gjatë miratimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar pas dorëzimit të tij zyrtarisht, Komisioni sigurohet që të gjitha komentet e veta janë pasqyruar në shkallë të mjaftueshme.
- (7) Programet e bashkëpunimit ndërkufitar mund të ndryshohen me nismën e vendeve pjesëmarrëse, ose të Komisionit me pëlqimin e vendeve pjesëmarrëse.
- (8) Kërkesat për ndryshime në programet e bashkëpunimit ndërkufitar të dorëzuara nga vendet pjesëmarrëse analizohen siç duhet dhe përcaktojnë veçanërisht ndikimin e pritshëm të ndryshimeve në programin e bashkëpunimit ndërkufitar për arritjen e objektivave. Këto kërkesa shoqërohen me programin e rishikuar. Paragrafët (3) deri (6) zbatohen për ndryshimet në programet e bashkëpunimit ndërkufitar.

Ndryshimet mund të kërkohen në një ose më shumë prej rasteve të mëposhtme:

- (a) në vijim të shqyrtimit afatmesëm të dokumenteve strategjike që çojnë në ndryshime në strategjitë që ndikojnë ndjeshëm në programet e bashkëpunimit ndërkufitar, përfshirë ndryshimet në vendndodhjen e Autoritetit Kontraktues apo planit financiar;
- (b) në vijim të ndryshimeve socio-ekonomike në zonën e programit;
- (c) për të pasqyruar ndryshimet në prioritetet rajonale, kombëtare ose të BE-së;
- (d) në vijim të rezultateve të vlerësimeve të përcaktuara në nenin 55.

Neni 69 Marrëveshjet dypalëshe ndërmjet vendeve pjesëmarrëse për menaxhimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar të zbatuara me menaxhim indirekt

Në kuadrin e menaxhimit indirekt, vendet pjesëmarrëse lidhin një marrëveshje dypalëshe për të gjithë kohëzgjatjen e programit të bashkëpunimit ndërkufitar, ku parashikohen përgjegjësitë përkatëse për zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar. Marrëveshjet dypalëshe përmbajnë ndër të tjera:

- (a) përshkrimin e strukturave kryesore zbatuese dhe roleve e përgjegjësive të tyre;
 - (b) përshkrimin e modaliteteve menaxhuese, financiare, kontrollit dhe auditit për programin e bashkëpunimit ndërkufitar;
 - (c) modalitetet për procedurat kryesore të zbatimit, përfshirë procesin për përzgjedhjen e operacioneve dhe modaliteteve për programin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe monitorimin në nivel operacionesh;
 - (d) modalitetet për të garantuar ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve të bëra prej përfituesve, si edhe për të garantuar kryerjen e verifikimeve të përcaktuara në Klauzolën 4(3)(b)(x) të Shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje;
 - (e) masa korrigjuese në rastin e vështirësive në zbatim;
 - (f) modalitetet për të garantuar menaxhimin e qëndrueshëm financiar të fondeve të akorduara për programin e bashkëpunimit ndërkufitar, përfshirë rikuperimin e shumave të paguara padrejtësisht.
 - (g) modalitet për përjashtimin nga taksat që parashikon neni 28.
-

TITULLI III OPERACIONET**Neni 70 Përzgjedhja e operacioneve**

- (1) Operacionet e përzgjedhura në kuadrin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar sjellin ndikime ndërkufitare dhe përfitime të qarta.
- (2) Operacionet në kuadrin e bashkëpunimit ndërkufitar përzgjidhen nga Autoriteti Kontraktues përmes ftesave për propozime që mbulojnë të gjithë zonën përfituese;
- (3) Vendet pjesëmarrëse mund të identifikojnë operacione jashtë ftesës për propozime. Në këtë rast, operacionet përmenden specifikisht në programin e bashkëpunimit ndërkufitar të përcaktuar në nenin 68.
- (4) Operacionet e përzgjedhura për bashkëpunimin ndërkufitar përfshijnë përfitues të paktën nga dy vende pjesëmarrëse. Përfituesit bashkëpunojnë në zhvillimin dhe zbatimin e operacioneve. Gjithashtu, ato bashkëpunojnë ose në plotësimin me staf, ose në financimin e operacioneve, ose me të dyja.
- (5) Një operacion mund të kryhet në vetëm një vend përfitues, me kusht që të përcaktohen ndikimet dhe përfitimet ndërkufitare.

Neni 71 Përfituesit

- (1) Për programet e bashkëpunimit ndërkufitar të përcaktuar në pikën (b) të nenit 63(2), përfituesit duhet të jenë të vendosur në një nga vendet pjesëmarrëse IPA II të programit. Për programet e bashkëpunimit ndërkufitar të përcaktuara në pikën (c) të nenit 63(2), përfituesit duhet të jenë të vendosur në një Përfitues IPA II, ose në një vend që bën pjesë në Instrumentin Evropian të Fqinjësisë dhe pjesëmarrës në program.
- (2) Një nga përfituesit e një operacioni në një program bashkëpunimi ndërkufitar caktohet nga përfituesit e grantit si përfitues kryesor.
- (3) Përfituesi kryesor merr përgjegjësinë për të garantuar zbatimin financiar të të gjithë operacionit, monitoron që operacioni të zbatohet sipas kushteve të parashikuara në kontratë dhe përcakton modalitetet me përfituesit e tjerë për të garantuar menaxhimin e qëndrueshëm financiar të fondeve të akorduara për operacionin, përfshirë modalitetet për rikuperimin e shumave të paguara padrejtësisht.

Neni 72 Asistenca teknike

- (1) Secili program bashkëpunimi ndërkufitar ka një buxhet specifik të akorduar për operacionet e asistencës teknike.

- (2) Shuma e asistencës IPA II që akordohet për asistencën teknike është jo më shumë se 10% e shumës totale të akorduar për programin e bashkëpunimit ndërkufitar.
- (3) Operacionet e asistencës teknike përfshijnë ndër të tjera:
- (a) përgatitjen, menaxhimin, monitorimin, vlerësimin, informimin, komunikimin, formimin e rrjeteve, zgjidhjen e ankesave, aktivitetet e kontrollit dhe auditit që lidhen me zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;
 - (b) aktivitete për forcimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;
 - (c) masa për zvogëlimin e barrës administrative për përfituesit, përfshirë sistemin e shkëmbimit të të dhënave elektronike, si edhe aksionet për të forcuar kapacitetet dhe për të shkëmbyer praktikat më të mira ndërmjet autoriteteve në vendet përfituese IPA në lidhje me administrimin dhe përdorimin e asistencës IPA II. Këto aksione mund të prekin periudha programimi të mëparshme dhe të mëvonshme.
- (4) Me derogim nga neni 31, shpenzimet ose asistencë teknike në mbështetje të përgatitjeve për një program bashkëpunimi ndërkufitar dhe ngritja e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit mund të jenë të pranueshme për financim para datës së nxjerrjes së Vendimit të Komisionit për miratimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar, por jo më herët se data 1 janar 2014.

TITULLI IV ZBATIMI

Neni 73 Modalitetet e zbatimit

- (1) Programet e bashkëpunimit ndërkufitar zbatohen me menaxhim direkt ose indirekt.
- (2) Programet e bashkëpunimit ndërkufitar menaxhohen nga një Autoritet Kontraktues siç përcakton Vendimi i Komisionit që miraton programin e bashkëpunimit ndërkufitar përkatës.

TITULLI V STRUKTURAT DHE AUTORITETET E PROGRAMIT DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE

Neni 74 Strukturat dhe autoritetet për menaxhimin e BNK-së

- (1) Strukturat e mëposhtme të parashikuara në nenin 10 përfshihen në menaxhimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar në Përfituesit IPA II:
- (a) KKIPA-t e vendeve pjesëmarrëse në programet e bashkëpunimit ndërkufitar dhe, sipas rastit, koordinatorët e bashkëpunimit territorial;

- (b) ZKA dhe struktura menaxhuese e Përfituesit IPA II pjesëmarrës ku ka vendndodhjen Autoriteti Kontraktues kur programi ndërkufitar zbatohet me menaxhim indirekt;
 - (c) strukturat operuese në të gjitha vendet pjesëmarrëse që do të bashkëpunojnë ngushtë në programimin dhe zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar përkatës. Në rastin e menaxhimit indirekt, struktura operuese përfshin një Autoritet Kontraktues.
 - (d) Autoriteti Auditues, kur programi ndërkufitar zbatohet me menaxhim indirekt.
- (2) Vendet pjesëmarrëse ngrenë Komitetin e Përbashkët Monitorues (më poshtë i referuar si "KPM") që përmbush edhe rolin e komitetit monitorues sektorial të parashikuar në nenin 53.
- (3) Sekretariati i Përbashkët Teknik (më poshtë i referuar si "SPT") ngrihet për të ndihmuar Komisionin, strukturat operuese dhe KPM-në.

Neni 75 KKIPA

KKIPA-t e vendeve pjesëmarrëse mbajnë përgjegjësi të përbashkët për të garantuar qëndrueshmërinë e objektivave të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar të propozuar me objektivat e dokumenteve strategjike të IPA II.

Neni 76 Strukturat operuese

- (1) Strukturat operuese ngrihen brenda administratës së secilit vend pjesëmarrës që të zbatojë dhe të menaxhojë programet e bashkëpunimit ndërkufitar. E njëjta strukturë operuese mund të përdoret për më shumë se një program bashkëpunimi ndërkufitar.
- (2) Në menaxhimin indirekt, struktura operuese e vendit të cilit i janë besuar detyra ekzekutimi të buxhetit për një program ndërkufitar, përfshin edhe një Autoritet Kontraktues.
- (3) Strukturat operuese të vendeve pjesëmarrëse bashkëpunojnë ngushtë në detyrat me interes të ndërsjellë. Ato kryejnë bashkërisht këto funksione dhe marrin përsipër këto përgjegjësi si më poshtë:
- (a) përgatisin programet e bashkëpunimit ndërkufitar sipas nenit 68, ose rishikime të tyre;
 - (b) përgatisin marrëveshje dypalëshe sipas nenit 69 në rastin e menaxhimit indirekt dhe garantojnë zbatimin e tij;
 - (c) bashkëpunojnë për të garantuar përmbushjen e detyrave të përcaktuara në paragrafët 4 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje;

- (d) marrin pjesë në mbledhjet e KPM-së dhe në mbledhje të tjera dypalëshe;
 - (e) emërojnë përfaqësuesin(t) e tyre në KPM;
 - (f) ngrenë Sekretariatit e Përbashkët Teknik (SPT) dhe garantojnë plotësimin e tij me stafin e duhur;
 - (g) përgatisin dhe zbatojnë vendimet strategjike të KPM-së;
 - (h) mbështetin punën e KPM-së dhe i japin informacionin e kërkuar për të kryer detyrat e veta, veçanërisht të dhëna mbi progresin e programit operacional në arritjen e objektivave specifike dhe synimeve për çdo prioritet tematik, siç janë përcaktuar në programin e bashkëpunimit ndërkufitar;
 - (i) ngrenë një sistem për mbledhjen e informacionit të besueshëm rreth zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar;
 - (j) hartojnë raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit, siç përcakton neni 80;
 - (k) përgatisin dhe zbatojnë një plan koherent për komunikimin dhe vizibilitetin;
 - (l) hartojnë një plan pune vjetor për SPT-në, që miratohet nga KPM-ja.
- (4) Nëse programi i bashkëpunimit ndërkufitar zbatohet me menaxhim indirekt, struktura operuese e Përfituesit IPA II ku ka vendndodhjen Autoriteti Kontraktues, përveç detyrave të përcaktuara në Klauzolën 4 të Shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje, ka edhe këto detyra:
- (a) emëron anëtarët e komisionit të vlerësimit dhe garanton që komisioni i vlerësimit të ketë edhe një anëtar me të drejtë vote nga vendi ku nuk e ka vendndodhjen Autoriteti Kontraktues; ndërsa Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtën të emërojë kryetarin dhe sekretarin e komisionit;
 - (b) kryen ndjekjen operacionale dhe menaxhimin e operacionale në bashkëpunim të ngushtë me vendin tjetër pjesëmarrës.
- (5) Nëse struktura operuese e Përfituesit IPA II ku ka vendndodhjen Autoriteti Kontraktues nuk mund të kryejë verifikimet e parashikuara në Klauzolën 4(3)(b)(x) të Shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje në të gjithë zonën e programit, vendet pjesëmarrëse bien dakord sesi të kryejnë këto funksione të verifikimit të menaxhimit. Modalitetet për kryerjen e verifikimeve të tilla parashikohen në marrëveshjen dypalëshe të parashikuar në nenin 69.
-

Neni 77 Autoriteti Auditues

- (1) Autoriteti Auditues për programin e bashkëpunimit ndërkufitar është nga vendi ku ka vendndodhjen Autoriteti Kontraktues.
- (2) Funkzionet e Autoritetit Auditues janë të parashikuara në Klauzolën 5 të Shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje.
- (3) Kur Autoriteti Auditues i parashikuar në paragrafin 1 nuk ka autorizimin për të kryer drejtpërdrejt funksionet në të gjithë territorin që mbulon programi i bashkëpunimit ndërkufitar, ndihmohet nga një grup audituesish që përbëhet nga një përfaqësues prej secilit vend pjesëmarrës në programin e bashkëpunimit ndërkufitar. Grupi i auditëve kryesohet nga Autoriteti Auditues i Përfituesit IPA II ku ka vendndodhjen Autoriteti Kontraktues i programit të bashkëpunimit ndërkufitar. Modalitetet specifike për kryerjen e verifikimeve të tilla parashikohen në marrëveshjen dypalëshe të parashikuar në nenin 69.

Neni 78 Komiteti i Përbashkët Monitorues (KPM)

- (1) Vendet pjesëmarrëse ngrenë një KPM jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e të parës Marrëveshjeje Financimi.
- (2) Secili vend pjesëmarrës emëron përfaqësuesin e vet në KPM.
- (3) KPM-ja përbëhet nga përfaqësues të Komisionit KKIPA-ve apo koordinatorëve të bashkëpunimit territorial, sipas rastit, dhe përfaqësues të vendeve pjesëmarrëse (autoritete kombëtare, rajonale dhe vendore), përfshirë strukturat operuese BNK dhe, sipas rastit, grupe interesi të tjera si organizatat e shoqërisë civile. Komisioni merr pjesë në punimet e KPM-së me rol këshillimor.
- (4) KPM-në e kryeson vendi pjesëmarrës në të cilin nuk ka vendndodhjen Autoriteti Kontraktues.
- (5) KPM-ja mblidhet të paktën dy herë në vit. Takime të posaçme mund të zhvillohen me nismën e vendeve pjesëmarrëse apo të Komisionit.
- (6) KPM-ja miraton vetë rregulloren e brendshme në konsultim me strukturat operuese dhe Komisionin.
- (7) Vendet pjesëmarrëse kanë të drejta vote të barabarta, pavarësisht numrit të përfaqësuesve që ka emëruar.
- (8) Detyrat e KPM-së janë si më poshtë:

- (a) është përgjegjës për identifikimin e prioriteteve specifike, objektivave specifike përfutuesit e synuar dhe fokusin specifik të secilës ftesë për propozime që miratohen nga Komisionit;
 - (b) shqyrton dhe jep opinion këshillimor për listën e operacioneve të përzgjedhura përmes ftesave për propozime para vendimit për shpalljen e fituesit të grantit. Autoriteti Kontraktues miraton vendimin përfundimtar për shpalljen e fituesve të granteve;
 - (c) shqyrton progresin e bërë në lidhje me arritjen e objektivave specifike, rezultatet e pritshme dhe synimet për çdo prioritetet tematik siç përcaktohet në programin e bashkëpunimit ndërkufitar, mbi bazën e informacionit që i japin strukturat operuese të vendeve pjesëmarrëse. Progresi monitorohet kundrejt treguesve të përcaktuar në programin e bashkëpunimit ndërkufitar;
 - (d) shqyrton konstatimet dhe përfundimet përkatëse, si edhe propozimet për masa ndjekëse korrigjuese që lindin nga kontrollet në terren, monitorimi dhe vlerësimet, nëse ka;
 - (e) miraton propozimet për ndryshime në programin e bashkëpunimit ndërkufitar. Kur është e nevojshme, mund të bëjë propozime për ndryshime në programin e bashkëpunimit ndërkufitar siç parashikon neni 68, për të garantuar arritjen e objektivave të programimit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe për të forcuar efikasitetin, efektshmërinë, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e asistencës IPA II. KPM-ja mund të japë edhe rekomandime sesi të përmirësohet zbatimi i programit të bashkëpunimit ndërkufitar;
 - (f) shqyrton dhe miraton planin e komunikimit dhe vizibilitetit për programin e bashkëpunimit ndërkufitar;
 - (g) shqyrton dhe miraton planin e vlerësimit, siç përcaktohet në nenin 57(2);
 - (h) shqyrton dhe miraton raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit, siç përcaktohen në nenin 80;
 - (i) shqyrton dhe miraton planin vjetor të punës së Sekretariatit të Përbashkët Teknik.
- (9) KPM-ja raporton tek Komiteti Monitorues IPA i vendit ku ka vendndodhjen Autoriteti Kontraktues.

Neni 79 Sekretariati i Përbashkët Teknik (SPT)

- (1) Për çdo program bashkëpunimi ndërkufitar ngrihet një SPT për të ndihmuar Komisionin, strukturat operuese dhe KPM-në. SPT-ja do ta ketë vendndodhjen në vendin ku ndodhet

edhe Autoriteti Kontraktues. SPT-ja mund të ketë një zyrë antenë në vendin tjetër pjesëmarrës.

- (2) Funksionimi i SPT-së financohet nga buxheti i asistencës teknike.
- (3) Stafi i SPT-së përbëhet nga shtetas të të dy vendeve pjesëmarrëse në programin e bashkëpunimit ndërkufitar.
- (4) SPT-ja menaxhohet nga struktura operuese kur ka vendndodhjen Autoriteti Kontraktues;
- (5) Strukturat operuese përgatitin çdo vit një plan pune për SPT-në që i dërgohet KPM-së për shqyrtim dhe miratim.
- (6) Detyrat e SPT-së janë si më poshtë:
 - (a) organizon mbledhjet e KPM-së, përfshirë mbajtjen, hartimin dhe shpërndarjen e procesverbalit të mbledhjeve;
 - (b) ndihmon aplikantët potencialë në gjetjen e partnerëve dhe zhvillimin e projekteve, duke organizuar ditë informuese dhe tryeza të rumbullakëta; krijimi dhe mbajtja e një rrjeti me grupe interesi;
 - (c) këshillon përfituesit e grantit mbi zbatimin e projekteve;
 - (d) mbështet punën e komisioneve të vlerësimit;
 - (e) përgatit, kryen dhe raporton për vizitat monitoruese në operacionet e bashkëpunimit ndërkufitar
 - (f) ngre një sistem për mbledhjen e informacionit të besueshëm në lidhje me zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;
 - (g) kontribuon në hartimin e raporteve vjetore dhe përfundimtare të zbatimit të programit ndërkufitar;
 - (h) planifikon dhe zbaton fushata informimi dhe aktivitete të tjera për sensibilizimin publik mbi programin e bashkëpunimit ndërkufitar, përfshirë publikimin e materialeve publicitare rreth programit ndërkufitar dhe mirëmbajtjen e faqes së internetit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar.

TITULLI VI RAPORTIMI

Neni 80 Raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit

(1) Në zbatim të nenit 60, strukturat operuese hartojnë një raport vjetor dhe përfundimtar zbatimi për secilin program bashkëpunimi ndërkufitar për qëllime të kërkesave raportuese që parashikohen në nenet 58 dhe 59. Raporti përfundimtar mund të përfshijë raportin vjetor të fundit. Raporti ndjek modelin bashkëlidhur Marrëveshjes së Financimit dhe përmban ndër të tjera:

(a) Progresin e bërë në zbatimin e programit ndërkufitar dhe në veçanti arritjen e objektivave specifike për prioritetet tematike, përfshirë elementët sasiorë dhe cilësorë që tregojnë progresin në raport me objektivat;

(b) Informacion mbi hapat e marra për të garantuar cilësinë dhe efektshmërinë e zbatimit, veçanërisht:

i. masat e monitorimit dhe vlerësimit, përfshirë modalitetet për mbledhjen e të dhënave;

ii. përmbledhje të problemeve kryesore të hasura gjatë zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe të masave korrigjuese që janë marrë;

iii. rekomandime për masa korrigjuese;

(c) masat e marra për të garantuar vizibilitetin dhe publicitetin e programit ndërkufitar;

(d) informacion të hollësishëm për ekzekutimin financiar të programit ndërkufitar.

Informacioni i përcaktuar në pikën (d) jepet nga Autoriteti Kontraktues i programit dhe përfshihet në raporte vetëm kur zbatimi është me menaxhim indirekt.

(2) Pas shqyrtimit dhe miratimit nga KPM-ja, raportet i dërgohen KKIPA-s dhe ZKA-së - sipas rastit – të Përfituesit IPA II ku ka vendndodhjen Autoriteti Kontraktues, që i dorëzohet KKIPA-s të vendit tjetër pjesëmarrës dhe Komisionit në kuadrin e kërkesave të raportimit të përcaktuara në nenet 58 dhe 59.

SEKSIONI IX DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 81 Komunikimi

Shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit IPA II në lidhje me programet, dokumentet e aksioneve dhe ndryshimet e tyre, si edhe dokumentacionit që lidhet me zbatimin e aksioneve, bëhet sa të jetë i mundur me mjete elektronike. Modalitetet që disiplinojnë shkëmbimin e të dhënave miratohen bashkërisht ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit IPA II dhe parashikohen në Marrëveshjen Sektoriale apo atë të Financimit.

Neni 82 Konsultimi

- (1) Çdo çështje në lidhje me ekzekutimin apo interpretimin e kësaj Marrëveshjeje është objekt konsultimi ndërmjet Palëve të kësaj Marrëveshjeje që çon, kur është e nevojshme, në ndryshime të kësaj Marrëveshjeje.
- (2) Komisioni mund të pezullojë financimin e aktiviteteve në kuadrin e IPA II, kur nuk arrihet përmbushja e një detyrimi të përcaktuar në këtë Marrëveshje për të cilin nuk janë marrë masat korrigjuese në kohën e duhur.
- (3) Përfituesi IPA II mund të heqë dorë nga zbatimi i plotë apo i pjesshëm i asistencës së IPA II. Për këtë qëllim, Përfituesi IPA II njofton të paktën 6 muaj paraprakisht Komisionin. Palët e kësaj Marrëveshjeje përcaktojnë hollësitë e kësaj dorëheqjeje me anë të shkëmbimit të letrave, ose me anë të miratimit të ndryshimeve në Marrëveshjen e Financimit, sipas rastit.

Neni 83 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, arbitrazhi

- (1) Mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Kuadër zgjidhen miqësisht me konsultime, siç përcakton neni 82. Palët komunikojnë me shkrim qëndrimet dhe zgjidhjet e mundshme të tyre. Njëra palë i përgjigjet brenda 30 ditësh kërkesës së dërguar nga Pala tjetër për zgjidhje miqësore në nivel të brendshëm. Kur skadon kjo periudhë, ose nëse përpjekjet për arritjen e një zgjidhjeje miqësore nuk japin rezultat brenda 60 ditësh që nga kërkesa e parë, secila Palë mund të njoftojë tjetrën se e konsideron procedurën e zgjidhjes miqësore të dështuar.
- (2) Nëse nuk arrihet zgjidhja miqësore, secila Palë mund ta paraqesë çështjen për arbitrazh pranë Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, sipas Rregullave të vitit 2012 për Gjykatën e Përhershme të Arbitrazheve në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
- (3) Në procedimet e arbitrazhit përdoret gjuha angleze. Autoriteti përgjegjës është Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit pas një kërkesë me shkrim të dorëzuar nga cilado Palë. Vendimi i arbitrazhit është detyrues për të gjitha palët dhe nuk apelohehet.

Neni 84 Mosmarrëveshjet me palët e treta

- (1) Pa cenuar juridiksionin e gjykatës të përcaktuar në një kontratë të financuar nga IPA II, si gjykata përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura ndërmjet palëve të kësaj kontrate, Bashkimi Evropian gëzon në territorin e Shqipërisë imunitet nga paditë, përfshirë arbitrazhin, përveç parashikimeve në nenin 83 të kësaj Marrëveshjeje, nga procedimet ligjore për sa i përket çfarëdo mosmarrëveshjeje ndërmjet Komisionit Evropian dhe/ose Përfituesit IPA II dhe një pale të tretë, ose ndërmjet palëve të treta, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me dhënien e asistencës IPA II për Përfituesin IPA II në

kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur Bashkimi Evropian heq dorë shprehimisht nga ky imunitet.

- (2) Përfituesi IPA II e evokon në këtë imunitet në çdo procedim gjyqësor apo administrativ para një gjykate apo instance administrative në Shqipëri, si dhe mban një pozicion që merr parasysh plotësisht interesat e Bashkimit Evropian. Kur është e nevojshme, Përfituesi IPA II dhe Komisioni angazhohen në konsultime paraprake në lidhje me qëllimin që do të mbahen.

Neni 85 Njoftimet

- (1) Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje bëhet me shkrim dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim nënshkruhet dhe dorëzohet si dokument origjinal ose si dokument origjinal i skanuar.

- (2) Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Komisionin

European Commission
DG Enlargement /C
Rue de la Loi 15
B-1049 Brussels, Belgium
Faks: +32 229 68727
E-mail: elarg-c@ec.europa.eu

Për Përfituesin IPA II

Znj. Klajda Gjasha
Ministre e Integritimit Evropian
Koordinator Kombëtar IPA
Bul. Dëshmorët e Kombit
Tirana, Albania
Faks +355 4256267
E-mail: info@integrimi.gov.al

Neni 86 Shtojcat

Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje janë pjesë e pandashme e kësaj Marrëveshjeje Kuadër.

Neni 87 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur njëra Palë informon tjetrën me shkrim për miratimin e saj në përputhje me legjislacionin e brendshëm ekzistues ose procedurën e saj.

Neni 88 Zbatueshmëria e Marrëveshjes Kuadër për IPA-n

Marrëveshja Kuadër e lidhur ndërmjet Komisionit dhe Republikës së Shqipërisë ka fuqi për asistencën e miratuar në kuadrin e instrumenteve të mëparshme të para-anëtarësimit, derisa kjo asistencë të plotësohet sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjet Kuadër përkatëse.

Neni 89 Ndryshimet

Çdo ndryshim i rënë dakord nga Palët bëhet me shkrim dhe është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje. Çdo ndryshim i tillë hyn në fuqi sipas procedurës të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 87.

Neni 90 Afati i Marrëveshjes

- (1) Kjo Marrëveshje ka afat të papërcaktuar dhe mbetet në fuqi derisa njëra Palë e zgjidh duke njoftuar me shkrim Palën tjetër. Marrëveshja pushon efektet 3 muaj nga data e njoftimit me shkrim.
- (2) Në përfundim të kësaj Marrëveshjeje, çfarëdo asistencë që është në ekzekutim e sipër ndërpritet, përveç rastit të të drejtave të fituara në kuadrin e kontratave specifike të financuara nga IPA.

Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje në gjuhën angleze.

E nënshkruar për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, në Tiranë, në datën

nga

Znj. Klajda Gjoshja
Ministre e Integritimit Evropian dhe
Koordinator Kombëtar IPA

E nënshkruar për dhe në emër të Komisionit, në Bruksel, në datën

nga.....

Z. Jean-Eric Paquet
Drejtor

SHTOJCA A

Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave, autoriteteve dhe organeve sipas nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje Kuadër

Shënim paraprak:

Kjo listë përcakton funksionet kryesore dhe përgjegjësitë e përbashkëta të strukturave, autoriteteve dhe organeve përkatëse. Lista nuk duhet të konsiderohet e plotë por plotëson pjesën thelbësore të kësaj Marrëveshjeje.

Klauzola 1 Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA)

KKIPA caktohet nga Përfituesi IPA II. KKIPA duhet të jetë zyrtar i lartë i qeverisë ose i administratës shtetërore të Përfituesit IPA II, me autoritetin e duhur. Përveç funksioneve dhe përgjegjësiave që parashikohen në nenet 6(2), 16(2), 59 dhe 75 të kësaj Marrëveshjeje, kur detyrat e zbatimit të buxhetit i janë besuar Përfituesit IPA II, ka edhe këto detyra:

- (a) merr masa për të garantuar që objektivat e vendosura në aksione apo programe për të cilat janë besuar detyra të zbatimit të buxhetit, të adresohen siç duhet gjatë zbatimit të asistencës IPA II.
- (b) në zbatim të nenit 57 të kësaj Marrëveshjeje, koordinon hartimin e një plani vlerësimi në konsultim me Komisionin, ku paraqiten aktivitetet vlerësuese që do të kryhen në

faza të ndryshme të zbatimit, siç parashikojnë dispozitat e nenit 55 të kësaj Marrëveshjeje

Klauzola 2 Zyrtari Përgjegjës Akreditues (ZPA):

(1) ZKA caktohet nga Përfituesi IPA II. Ai duhet të jetë përfaqësues i lartë i qeverisë ose i administratës shtetërore të Përfituesit IPA II, me autoritetin e duhur.

(2) ZKA mban përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin financiar të asistencës IPA II në Shqipëri, si edhe garanton ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve. ZKA është përgjegjës, në veçanti, për:

(a) menaxhimin financiar të fondeve IPA II, si dhe operacioneve financiare;

(b) funksionimin efikas të sistemeve të kontrollit të brendshëm për zbatimin e asistencës IPA II në pajtim me Aneksin B të kësaj Marrëveshjeje.

Gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve, ZKA mund të kryejë verifikime në terren.

(3) Për qëllimet e paragrafit 2(a), ZKA, i mbështetur nga Fondi Kombëtar, përmbush në veçanti detyrat e mëposhtme:

(a) harton dhe i paraqet Komisionit pasqyrat e shpenzimeve duke detajuar:

I. shpenzimet e kryera dhe të paguara;

II. dhe kur është e nevojshme, përfshin informacionin për para-financimin në kërkesë-pagesat, vërteton se këto dalin nga sistemet e besueshme të kontabilitetit sipas parimit akreal (rrjedhës) të përcaktuar në përputhje me pikën (b), se janë të sakta dhe bazohen në dokumente mbështetëse të verifikueshme dhe kanë qenë objekt i verifikimit nga strukturat operuese dhe strukturat e menaxhimit. Në përfundim të një programi, ZKA harton pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve;

(b) garanton kontabilitetin e bazuar në parimin akreal (rrjedhës), i cili regjistron dhe ruan në formë të kompjuterizuar të dhënat kontabël për çdo veprim/ aktivitet/ operacion dhe mbështet të gjitha të dhënat e nevojshme për hartimin e kërkesë-pagesave dhe raporteve ose pasqyrave financiare vjetore. Ky sistem siguron informacion të saktë, të plotë dhe të besueshëm në kohën e duhur dhe përfshin gjithashtu të dhënat e shumave të

rikuperueshme, shumat e rikuperuara dhe shumat e tërhequra pas anulimit të të gjithë ose një pjese të asistencës IPA II për një program apo veprim;

- (c) siguron transferimin e fondeve tek strukturat operuese ose marrësit;
 - (d) verifikon, kur është e nevojshme, ekzistencën dhe saktësinë e elementeve bashkë-financues dhe garanton burime të mjaftueshme në Fondin Kombëtar për t'u përballur me mungesat e mundshme për shkak të transferimit të vonuar të fondeve nga Komisioni, ose lëshimit të urdhrave të rikuperimit prej tij;
 - (e) kryen rregullimet financiare që kërkohen në lidhje me parregullsitë e konstatuara, në bazë të nenit 51, në përputhje me nenin 17 të Rregullores Zbatuese IPA dhe nenit 42 të kësaj Marrëveshjeje, dhe rikuperon kontributin e Bashkimit Evropian të paguar marrësit në pajtim me procedurat kombëtare të rikuperimit, në rast të situatave të referuara në nenin 51(5) dhe, siç parashikohet në nenin 41 të kësaj Marrëveshjeje;
 - (f) gjatë hartimit dhe dorëzimit të raporteve apo pasqyrave financiare si edhe kërkesë-pagesave sipas pikës (a) të paragrafit (3), mban parasysh rezultatet e auditeve të kryera nga ose nën përgjegjësinë e Autoritetit Auditues;
 - (g) është pikë kontakti për fluksin e informacionit financiar ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit IPA II dhe për çdo çështje në lidhje me dispozitat financiare të kësaj Marrëveshjeje.
- (4) Për qëllime të paragrafit 2(b), ZKA, i mbështetur dhe zyra mbështetëse e ZKA-së kryen në veçanti detyrat e mëposhtme:
- (a) jep nivel sigurie për rregullsinë dhe ligjshmërinë e transaksioneve në fjalë;
 - (b) vendos masa efikase dhe proporcionale anti-mashtrimi, duke marrë parasysh risqet e identifikuar, si dhe garanton raportim sipas nenit 51(2), duke e mbajtur shërbimin e koordinimit anti-mashtrim të përcaktuar në nenin 50(2) të informuar në lidhje me këtë raportim;
 - (c) është përgjegjës për monitorimin e përmbushjes në vijimësi nga struktura menaxhuese dhe strukturat operuese të kërkesave të përcaktuara në pikat (a), (b) dhe (d) të nenit 12(3) dhe Shtojcën B të kësaj Marrëveshjeje, dhe në rast të mosplotësimit të këtyre kërkesave garanton informimin pa vonesë të Komisionit dhe merr masa mbrojtëse të përshtatshme në lidhje me pagesat e bëra ose kontratat e nënshkruara;

- (d) siguron ekzistencën dhe funksionimin efikas të sistemeve të kontrollit të brendshëm për zbatimin e asistencës IPA II;
 - (e) siguron raportimin mbi sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, kontrollon programimin dhe kapacitetet e stafit në strukturat e përfshira për programimin dhe zbatimin e veprimeve;
 - (f) garanton funksionimin e një sistemi të përshtatshëm raportimi dhe informimi;
 - (g) ndjek konstatimet e raporteve të auditit të kryera nga Autoriteti Auditues, në përputhje me Klauzolën 5(2) të Shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje. Gjatë kryerjes së kësaj detyre, ZKA:
 - i. vendos nëse nevojiten përmirësime në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, regjistron vendimet në këtë drejtim dhe garanton zbatimin në kohë të këtyre përmirësimeve;
 - ii. kryen rregullimet e kërkesë-pagesave që i janë dorëzuar Komisionit, nëse është e nevojshme;
 - (h) gjatë përgatitjes së deklaratës së menaxhimit siç parashikon pika (b) e nenit 59(2), mban parasysh rezultatet e auditeve të kryera nga ose nën përgjegjësinë e Autoritetit Auditues;
 - (i) njofton menjëherë Komisionin për ndonjë ndryshim thelbësor në lidhje me sistemet e menaxhimit dhe kontrollit për shqyrtimin dhe miratimin paraprakisht të zbatimit të tyre;
 - (j) bashkërendon, kur është e nevojshme, përgatitjen e planeve të veprimit të konsoliduara që trajtojnë dobësi të vazhdueshme të zbuluara në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit
- (5) ZKA harton dhe i paraqet Komisionit deri më 15 shkurt të vitit financiar pasardhës, dokumentet e parashikuara në nenin 59(2) të kësaj Marrëveshjeje Kuadër.

Klauzola 3 Struktura menaxhuese

- (1) Struktura menaxhuese përbëhet nga Fondi Kombëtar (FK) dhe Zyra Mbështetëse e ZKA-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e Fondit Kombëtar dhe të zyrës mbështetëse përcaktohen

qartë.

- (2) Fondi Kombëtar (FK) i jep llogari ZKA-së dhe është një organ në nivel ministror në vendin e Përfituesit IPA II me kompetenca qendrore buxhetore dhe vepron si subjekt qendror i thesarit. Ai mbështet ZKA-në në përmbushjen e detyrave të tij/ saj, në veçanti ato të administrimit të llogarive të IPA II dhe operacionet financiare të përcaktuara në Klauzolën 2 (3) të kësaj Shtojce dhe, është i ngarkuar të merret me detyrat e menaxhimit financiar të asistencës IPA II, nën përgjegjësinë e ZKA-së.
- (3) Fondi Kombëtar veçanërisht është përgjegjës për këto detyra:
 - (a) mban dhe organizon llogaritë bankare qendrore të IPA-s;
 - (b) kërkon fonde dhe merr të gjitha pagesa nga buxheti i BE-së;
 - (c) autorizon transferimin e fondeve nga Komisioni tek strukturat operuese ose marrësit;
 - (d) kthen fondet në buxhetin e BE-së pas lëshimit të urdhrave të rikuperimit nga Komisioni;
 - (e) mbështet ZKA-në në përgatitjen e raportimit financiar për Komisionin;
 - (f) mban sistem kontabël kompjuterik aktual që jep informacion të saktë, të plotë dhe të besueshëm në kohën e duhur.
- (4) kur është e përshtatshme, shkëmbimi i informacionit me Komisionin, në lidhje me transaksionet financiare, bëhet në mënyrë elektronike, duke përdorur procedurat e rëna dakord ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit IPA II.
- (5) Zyra Mbështetëse e ZKA-së mban përgjegjësi të plotë për ZKA-në dhe e ndihmon atë (ZKA) për përmbushjen e detyrave të përmendura në Klauzolën 2(4) dhe (5) të kësaj Shtojce.

Klauzola 4 Struktura(t) operuese

- (1) Struktura(t) operuese krijohen brenda administratës së përfituesit të IPA II që të përgatisin, zbatojnë dhe menaxhojnë asistencën IPA II.
 - (2) Struktura operuese është përgjegjëse për zbatimin, informimin dhe vizibilitetin, sipas neneve 23 dhe 24 të kësaj Marrëveshjeje, monitorimin dhe raportimin e programeve, si dhe vlerësimin e tij sa herë që është e përshtatshme, në përputhje me parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar. Ajo është përgjegjëse për garantimin e ligjshmërisë dhe rregullsinë e shpenzimeve të bëra për zbatimin e programeve nën përgjegjësinë e saj.
-

(3) Struktura operuese kryen funksionet e mëposhtme dhe merr përsipër përgjegjësitë e mëposhtme:

(a) Për sa i përket menaxhimit të programit, detyrat e saj janë:

- i. monitoron zbatimin e programit, propozon amendamente, sipas nevojës, dhe siguron informacionin për komitetin monitorues sektorial mbi ecurinë e programit në arritjen e objektivave të tij, veçanërisht në bazë të standardeve dhe treguesve që lidhen me (objektivat), si dhe të dhënat financiare;
- ii. jep të gjithë informacionin e nevojshëm për qëllimet e raporteve të hartuara nga KKIPA dhe ZKA dhe të paraqitura Komisionit, siç parashikohet në nenin 59 të kësaj Marrëveshjeje. Mund të jetë e nevojshme të hartojë një raport të hollësishëm vjetor që mbulon vitin e plotë financiar, i cili duhet paraqitur nga KKIPA tek Komisioni, pas shqyrtimit nga komiteti monitorues sektorial përkatës;
- iii. shkëmben brenda strukturës operative çdo informacion që lidhet me kryerjen e detyrave të përcaktuara për zbatimin e veprimeve;
- iv. është përgjegjëse për hartimin e planit të vlerësimit dhe kryerjen, sipas nevojës, vlerësime *ex-ante*, të ndërmjetme dhe *ex-post* të programeve që menaxhon, në zbatim të dispozitave të nenit 55 të kësaj Marrëveshjeje.

(b) Në lidhje me përzgjedhjen dhe kontrollin e aksioneve dhe menaxhimit financiar, struktura operuese në përputhje me nenet përkatëse të kësaj Marrëveshjeje:

- i. garanton që veprimet janë zgjedhur për financim dhe janë miratuar në përputhje me procedurat dhe kriteret e zbatueshme për fushën e politikës ose programit;
- ii. organizon procedurat për prokurimin dhe dhënien e granteve dhe kontraktimit;
- iii. krijon procedura për të garantuar mbajtjen e të gjitha dokumenteve në lidhje me prokurimin, dhënien e granteve, kontraktimin, menaxhimin financiar, kontrolleve dhe auditeve të nevojshme që kërkohen për të siguruar gjurmë të mjaftueshme auditimi;

iv. kryen pagesat për, dhe rikuperimin nga, marrësit e asistencës IPA II;

- v. garanton që të gjitha organet brenda strukturës operative të përfshira në zbatimin e veprimeve të mbajnë ose sistem të veçantë kontabiliteti, ose kodifikim të përshtatshëm kontabiliteti për të gjitha transaksionet në lidhje me një veprim;
- vi. garanton që ZKA merr të gjitha informacionet e nevojshme mbi procedurat dhe verifikimet e menaxhimit të kryera në lidhje me shpenzimet;
- vii. krijon bazën e sistemit të kontabilitetit akrual, e cila regjistron dhe ruan, në formë të kompjuterizuar, të dhënat e kontabilitetit për çdo veprim/ aktivitet dhe mbështet të gjitha të dhënat e nevojshme për hartimin e kërkesë-pagesës dhe raportit ose pasqyrës vjetore financiare, duke bërë zotimet dhe pagesat dhe monitorimin e zbatimit të veprimit;
- viii. krijon sistemin për raportimin në kohë të parregullsive dhe për masat efektive dhe proporcionale të anti-mashtimit, duke marrë parasysh risqet e identifikuar;
- ix. krijon sistemin për njohjen e të gjitha shumave që duhet të paguhet dhe për regjistrimin e tyre në librin e debitorëve, duke përfshirë parregullsitë, para pranimit të tyre;
- x. verifikon që shpenzimet e kryera, të paguara dhe të deklaruara tek ZKA përputhen me legjislacionin e zbatueshëm të brendshëm dhe të BE-së, programin, kushtet për mbështetjen e veprimit dhe kushtet e kontratës, që mallrat ose shërbimet janë dorëzuar, dhe se pagesat e kërkuara nga marrësit janë të sakta.

Këto verifikime të menaxhimit mbulojnë aspektet administrative, financiare, teknike dhe fizike të secilit veprim dhe përfshijnë:

- verifikimin e plotë administrativ të dokumenteve mbështetëse në lidhje me çdo angazhim dhe pagesë;
 - verifikimet fizike në vend, shpeshësia dhe shtrirja e të cilëve merr parasysh, ndër të tjera, llojin e aksionit, shumën e shpenzimeve publike të përfshira dhe nivelin e riskut të identifikuar;
-

- xi. garanton auditin e brendshëm të organeve brenda strukturës operuese;
 - xii. garanton respektimin e kërkesave për informimin, publicitetin, transparencën, vizibilitetin dhe komunikimin, siç parashikojnë nenet 23 dhe 24 të Marrëveshjes Kuadër;
- (c) Organet brenda strukturës operuese regjistrojnë me shkrim modalitetet e punës ndërmjet tyre. Kryetarët e këtyre organeve caktohen qartë dhe mbajnë përgjegjësi për detyrat që iu ngarkohen. Përfituesi IPA II iu mundëson ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre. Ata mbajnë përgjegjësi ndaj kryetarit të strukturës operuese, sipas rastit.

Klauzola 5 Autoriteti Auditues

- (1) Përfituesi IPA II merr masat e nevojshme për të garantuar një autoritet auditues të jashtëm, i cili është i pavarur nga KKIPA, ZKA, struktura menaxhuese dhe strukturat operuese për të siguruar autonominë e nevojshme financiare dhe, në përputhje me standardet e auditit të pranuar ndërkombëtarisht. Autoriteti Auditues emërohet nga Përfituesi IPA II. Ai/Ajo duhet të zotërojë kompetencë, njohuri dhe përvojë të mjaftueshme në fushën e auditimit për të kryer detyrat e kërkuara.
- (2) Autoriteti Auditues kryen kontrole mbi sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, për veprimet, transaksionet dhe llogaritë vjetore në përputhje me standardet e auditit të pranuar ndërkombëtarisht dhe me strategjinë e funksionimit të auditit. Komisioni mund të miratojë udhëzime dhe përcaktime më të hollësishme për këto standarde.
- (3) Autoriteti Auditues, nën përgjegjësinë e kryetarit, kryen veçanërisht funksionet e mëposhtme dhe merr përsipër përgjegjësitë e mëposhtme:
- (a) Përgatit strategjinë trevjeçare të auditit, sipas modelit në Shtojcën G të kësaj Marrëveshjeje, e cila përditësohet çdo vit. Strategjia e auditit përcakton metodologjinë e auditit, metodat e procedurave për auditet e aktiviteteve dhe transaksioneve, si edhe planifikimin e auditeve. Auditet synojnë të verifikojnë:
 - i. plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e raporteve ose pasqyrave financiare vjetore dhe llogaritë vjetore të tyre;
 - ii. funksionimin efikas të sistemeve të menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes;
 - iii. ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve në fjalë.

Autoriteti Auditues paraqet strategjinë e auditit për tre vitet e ardhshme deri në fund të muajit nëntor të çdo viti tek Komisioni dhe një kopje tek ZKA. Kur përdoret një sistem i përbashkët i menaxhimit dhe kontrollit për më shumë se një program, mund të përgatitet një strategji auditit e vetme për programet apo veprimet në fjalë.

(b) harton dhe paraqet tek Komisioni, KKIPA dhe ZKA raportet dhe opinionet si më poshtë:

- i. deri më 15 mars të çdo viti, paraqet **një opinion vjetor auditit** në përputhje me nenin 60 (5) të Rregullores Financiare dhe sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën E të kësaj Marrëveshjeje, për raportet ose pasqyrat financiare vjetore dhe llogaritë vjetore të saj për vitin e kaluar financiar, që mbulojnë plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, funksionimin e sistemit të menaxhimit, kontrollit dhe të mbikëqyrjes, si edhe ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve në fjalë;
- ii. deri më 15 mars të çdo viti, së bashku me opinionin vjetor të auditit, paraqet një **raport vjetor të aktiviteteve audituese** sipas modelit në Shtojcën D të kësaj Marrëveshjeje ku përcakton konstatimet nga auditet e kryera në përputhje me strategjinë e auditit gjatë periudhës në fjalë dhe mbështetjen e opinionit vjetor të auditit. Raporti vjetor i aktiviteteve audituese përcakton, ndër të tjera, çdo mangësi të konstatuar në sistemet e menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes, si edhe çdo masë korrigjuese të ndërmarrë apo të planifikuar nga ZKA, Fondi Kombëtar dhe/ ose strukturat operuese në fjalë;
- iii. paraqet një **opinion auditit për deklaratën përfundimtare të shpenzimeve** që i dorëzohet Komisionit nga ZKA për mbylljen e çfarëdo programi ose të ndonjë pjese të tij. Ky opinion adreson vlefshmërinë e aplikimit për pagesën e fundit (përfundimtare) dhe saktësinë e informacionit financiar, dhe kur është e nevojshme, mbështetet nga raporti përfundimtar i aktiviteteve audituese. Ai bëhet sipas modelit të dhënë në Aneksin F të kësaj Marrëveshjeje. Autoriteti Auditues e dërgon opinionin brenda tre muajve pas dorëzimit të pasqyrës përkatëse përfundimtare të shpenzimeve nga ZKA.

(c) Marrëveshja Sektoriale ose Marrëveshja Financiare mund të parashikojë kërkesa më specifike për strategjinë e auditit dhe/ose raportet apo opinionet e parashikuara në shkronjën b).

*SHTOJCA B

KUADRI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Lista standarde e fushave dhe kërkesave përkatëse sipas pikës (a) të nenit 12(3)

1. Mjedisi i kontrollit

(a) Etika dhe politikat e integritetit:

- demonstroi përkushtim ndaj integritetit dhe vlerave etike,
- garanton kulturën për organizatën, të kërkuar nga drejtuesit e lartë dhe e kuptueshme në të gjithë organizatën,
- garanton procedurat për identifikimin dhe shmangien e konfliktit të interesave.

(b) Mbikëqyrja e detyrave që u delegohen vartësve:

- garanton që procedurat e mbikëqyrjes dhe strukturat janë krijuar, përfshirë edhe raportimin nga aktorët vartës,
- garanton që llogaridhënia mbështetet nga mbikëqyrja proaktive dhe e vazhdueshme.

(c) Krijimi i strukturave, linjave të raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë:

- garanton që strukturat janë përcaktuar dhe krijuar në të gjitha nivelet në mënyrë që të mundësohet arritja e objektivave të caktuara, se detyrat dhe funksionet për subjektet janë përkatësisht të ndara,
- garanton që të gjitha subjektet dhe individët kanë bazën e duhur ligjore dhe aftësi të plota për të kryer detyrat dhe funksionet e tyre të caktuara,
- garanton se linjat e raportimit janë përcaktuar, si brenda ashtu dhe ndërmjet subjekteve, për të garantuar fluksin e nevojshëm të informacionit për menaxhimin e aktiviteteve të secilit subjekt dhe për të mundësuar llogaridhënien në të gjitha nivelet e organizatës,
- garanton që autoriteti dhe niveli i përgjegjësisë është përkufizuar dhe caktuar në bazë të aftësive të demonstruara dhe detyrave të përcaktuara:

i. Administrata e lartë - ka autoritetin për vendimet e rëndësishme, rishikon detyrat

e administratës, harton direktiva, udhëzime dhe kontrollin për të mundësuar menaxhimin, dhe stafin për të kuptuar dhe kryer detyrat e kontrollit të brendshëm;

- ii. Menaxhimi – udhëzon dhe lehtëson ekzekutimin e direktivave dhe udhëzimeve të administratës së lartë në nivelin e subjektit përkatës;
- iii. Personeli – nënkupton standardet e sjelljes së subjektit, risqet e vlerësuara të objektivave dhe aktivitetet që lidhen me kontrollin në nivelin e tyre përkatës, të fluksit të informacionit dhe komunikimit të pritshëm, dhe monitorimin e aktiviteve të rëndësishme për arritjen e objektivave të tyre;
- iv. Ofruesit e shërbimit të jashtëm – i përmbahet përcaktimit të menaxhimit të fushës së autoritetit dhe përgjegjësisë për të gjithë ata punonjës që nuk janë të angazhuar në organizatë.

(d) Planifikimi, rekrutimi, mbajtja, trajnimi dhe vlerësimi i stafit:

- garanton se numrat dhe cilësia e stafit funksionojnë në të gjitha nivelet për të arritur objektivat,
- garanton se çdo anëtar i stafit është përgjegjës për sa i përket përgjegjësisë të tyre në lidhje me realizimin e objektivave të përcaktuara,
- garanton se deklaratat e misionit, përshkrimet e punës etj. përditësohen dhe janë të njohura për të gjithë stafin,
- garanton që stafi në “pozicionet e ndjeshme” është i identifikuar dhe se zbatohen kontrollet e duhura (përfshirë, kur është e përshtatshme, politikat e rotacionit) për “pozicionet sensitive”

(e) Llogaridhënia për detyrat e ngarkuara dhe përgjegjësitë:

- vendos masat për performancën, stimujt, dhe shpërblimet e tjera të përshtatshme në të gjitha nivelet, duke konsideruar arritjen e objektivave,
- garanton vlerësimin e rregullt të performancës së stafit në të gjitha nivelet duke ushtruar ndjekjen e duhur, për shembull në aspektin e shpërblimit ose veprimet disiplinore,
- garanton që presioni në organizatë përdoret pozitivisht për të garantuar arritjen e objektivave, ndërsa shmangen presionet negative, për shembull në aspektin e objektivave jo-realiste të objektivave të performancës ose objektivave konfliktuale.

2. Menaxhimi i riskut

(a) Vendosja e objektivave

- garanton vendosjen e objektivave në të gjitha nivelet, me qartësi të mjaftueshme për të mundësuar identifikim dhe vlerësim të risqeve ndaj këtyre objektivave;
- garanton që *objektivat operacionalë* të kenë fokus të qartë për të mundësuar akordimin e burimeve të nevojshme për arritjen e rezultateve të dëshiruara;
- garanton që *objektivat e raportimit të jashtëm dhe të brendshëm* të përfshijnë aspekte të besueshmërisë, kohës dhe transparencës së raporteve;
- garanton që *objektivat e përputhshmërisë* të reflektojnë se të gjitha aktivitetet kryhen sipas rregullave dhe akteve normative në fuqi.

(b) Identifikimi, vlerësimi dhe reagimi ndaj riskut

- garanton identifikimin tërësor të risqeve në të gjitha nivelet dhe se identifikimi i risqeve të përfshijë të gjithë faktorët kryesorë të brendshëm dhe të jashtëm për organizatën;
- garanton kryerjen e vlerësimit të riskut në mënyrë të mjaftueshme, pas identifikimit të riskut, përfshirë llogaritjen e probabilitetit dhe ndikimit të risqeve të identifikuara;
- garanton që administrata të përcaktojë dhe zbatojë reagimin e mjaftueshëm ndaj risqeve të identifikuara dhe të vlerësuara, me qëllim që të zbutet ndikimi negativ ndaj arritjes së objektivave;

(c) Risku i mashtrimit

- garanton peshimin e potencialit për mashtrim dhe parregullsi, gjatë vlerësimit të risqeve ndaj arritjes së objektivave;
- garanton që parregullsitë e zbuluara më poshtë në organizatë të raportohen dhe të ndiqen siç duhet, përfshirë mbrojtjen e “bilbilfryësve”.

(d) Identifikimi dhe vlerësimi i ndryshimeve që prekin sistemin e kontrolleve të brendshme

- garanton që administrata të identifikojë dhe të vlerësojë ndryshimet e mëdha, si të brendshme edhe të jashtme, që mund të cenojnë efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe që kanë ndikim në arritjen e objektivave të organizatës.

3. Aktivitetet e kontrollit

(a) Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit

- garanton që në të gjitha nivelet e organizatës të identifikohen dhe zhvillohen aktivitetet e kontrollit që kontribuojnë në zbutjen e risqeve ndaj arritjes së objektivave;
- garanton që çdo drejtues është përgjegjës për të gjitha aspektet e transaksioneve në rastet e alokimeve apo pagesave në lidhje me palët e treta;
- garanton që aktivitetet e kontrollit, *ndër të tjera*, të përfshijnë:
 - (i) Para se të autorizohet një transaksion, aspektet e këtij transaksioni duhet të verifikohen nga të paktën një anëtar i stafit përveç atij(atyre) që e ka(në) filluar transaksionin. Për të njëjtin skedar, i njëjti person nuk mund të bëjë edhe fillimin edhe verifikimin (parimi i katër syve-parimi i rishikimit dhe aprovimit).
 - (ii) Rregullat për çdo lloj prokurimi dhe ftesë granti që garantojnë kuadrin e duhur ligjor për të gjitha proceset e angazhimit financiar e teknik;
 - (iii) Procedurat, përfshirë listat e verifikimit, për çdo hap të prokurimit dhe ftesave për grant (p.sh. specifikimet teknike, komisionet e vlerësimit, raportimi i pritshmërive etj), duke garantuar që çdo anëtar i stafit t'i ketë të qarta përgjegjësitë në këto fusha;
 - (iv) Rregullat dhe procedurat e publicitetit që garantojnë përmbushjen e kërkesave normative;
 - (v) Procedurat e pagesës, përfshirë procedurat për konfirmimin e dorëzimit dhe/ose kushtet e pranueshmërisë, procedurat për kontrollet në terren nëse është e nevojshme, duke u siguruar që pagesat të kryhen vetëm për kërkesë-pagesat e justifikuara/të argumentuara që përmbushin të gjitha kërkesat kontraktuale;
 - (vi) Procedurat për monitorimin e dorëzimit të bashkëfinancimit që garantojnë përmbushjen e të gjitha kërkesave ligjore;
 - (vii) Procedurat buxhetore për të garantuar disponimin e fondeve në të gjitha rastet, duke garantuar përmbushjen nga organizata të angazhimeve të saj kontraktuale;

- (viii) Procedurat për vazhdimësinë e operacioneve, duke garantuar që risqet e konsiderueshme ndaj vazhdimësisë (p.sh. humbja e të dhënave, mungesa e individëve etj) të identifikohen dhe miratohen plane kontigjence;
- (ix) Procedurat e kontabilitetit që garantojnë kontabilitet të plotë, të saktë dhe transparent, të cilat respektojnë parimet kontabël të pranura ndërkombëtarisht;
- (x) Procedurat e rakordimit që garantojnë kurdo se bilancet kontabël janë rakorduar me informacion nga palë të treta;
- (xi) Raportimi i përjashtimeve, *ndër të tjera*, përjashtimet ndaj procedurave normale të miratuara në nivelin e duhur, përjashtimet e pamiratuara dhe dështimet e kontrollit kurdo që identifikohen, duke garantuar që devijimet nga praktikat normale të regjistrohen, shënohen dhe shqyrtohen nga nivelet e duhura;
- (xii) Procedurat e arkivimit që garantojnë se dokumentet mund të jenë të disponueshme për rishikim gjatë periudhave të kërkuara që duhen mbajtur;
- (xiii) Ndarja e detyrave, duke garantuar që detyrat e ndryshme në ciklin e të njëjtit operacion i ngarkohen personave të ndryshëm, në mënyrë që të mundësohet kontrolli i kryqëzuar automatik.

(b) Aktivitetet e kontrollit të sigurisë

- garantojnë procedura sigurie (IT dhe të tjera) të mjaftueshme, që asetet dhe të dhënat të jenë të sigurta ndaj ndërhyrjeve të paautorizuara apo dëmtimeve fizike;
- garantojnë ekzistencën e të drejtave të aksesit sipas të gjitha niveleve, si akses fizik ashtu edhe akses elektronik.

(c) Politikat dhe procedurat në lidhje me aktivitetet e kontrollit

- garantojnë ekzistencën e procedurave dhe politikave të shkruara që përcaktojnë se çfarë pritet nga të gjitha nivelet dhe që specifikojnë aksionet hollësisht;
- garantojnë se ekziston përgjegjësi dhe llogaridhënie e qartë për kryerjen e aktiviteteve të kontrollit;
- garantojnë se politikat dhe procedurat përmbajnë edhe kohën se kur duhet të kryhet aktiviteti i kontrollit, si edhe çdo aktivitet korrigjues;

- garantojnë se gjatë kryerjes së një aktiviteti kontrolli janë hulumtuar siç duhet çështjet e evidentuara për ndjekje dhe se janë marrë masat korrigjuese përkatëse;
- garantojnë që aktiviteti i kontrollit të kryhet nga personel i aftë, me fokus të vazhdueshëm tek risqet që duhen zbutur prej aktivitetit;
- garantojnë se drejtuesit dhe administrata e lartë, sipas rastit, të rivlerësojë periodikisht politikat dhe procedurat, si edhe aktivitetet e kontrollit, për të garantuar në vazhdimësi rëndësinë dhe efektivitetin e tyre.

4. Informimi dhe komunikimi

(a) Informacioni në mbështetje të funksionimit të kontrolleve të brendshme:

- garanton që ekzistojnë proceset në të gjitha nivelet për të identifikuar informacionin e nevojshëm që pritet të mbështetë funksionimin e komponentëve të tjerë të kontrollit të brendshëm dhe arritjen e objektivave të organizatës;
- garanton që informacioni të merret nga të gjitha burimet përkatëse, përfshirë burimet e brendshme dhe të jashtme;
- garanton që informacioni të merret nga të gjitha burimet përkatëse dhe përpunohet për të përfutur informacion domethënës dhe të saktë për të përmbushur kërkesat e përcaktuara për informacionin;
- garanton që informacioni i përgatitur të jetë në kohë, aktual, i saktë, i vlefshëm, i plotë, i mjaftueshëm, i aksesueshëm, i mbrojtur, i verifikueshëm dhe i ruajtur, me qëllim që të përdoret në vlerësimin e kontrolleve të brendshme dhe arritjen e objektivave.

(b) Komunikimi i brendshëm

- garanton se proceset funksionojnë për të komunikuar informacionin e kërkuar që i mundëson të gjithë stafit, përfshirë edhe drejtuesit, të kuptojnë dhe të kryejnë detyrat e kontrollit të brendshëm;
- garanton se ekziston komunikimi ndërmjet administratës së lartë dhe niveleve të tjera të organizatës, në mënyrë që administrata e lartë të ketë informacionin e nevojshëm për të përmbushur rolin e saj në funksion të objektivave të organizatës;
- garanton se funksionojnë kanale komunikimi të veçanta, si për shembull linjat falas për “bilbilfryrësit”, të cilat shërbejnë si mekanizma sigurie për të mundësuar komunikimin anonim ose konfidencial kur kanalet normale janë jofunksionale ose joefikase;

- garanton se metoda e përzgjedhur e komunikimit ka parasysh kohën, marrësin dhe natyrën e informacionit.

(c) Komunikimi i jashtëm

- garanton që ekzistojnë proceset për t'i komunikuar informacionin e kërkuar palëve të jashtme në formatin dhe kohën e duhur, përfshirë Komisionin Evropian, Gjykatën Evropiane të Auditëve etj.
- garanton kanale komunikimi nga jashtë brenda, të cilat mundësojnë marrjen e mendimit të palëve të jashtme, me qëllim që t'i jepet informacioni përkatës të gjitha niveleve të organizatës, përfshirë administratën e lartë;
- garanton që informacioni relevant nga palët e jashtme, përfshirë Komisionin Evropian, Gjykatën Evropiane të Auditëve etj. të arrijë nivelet relevante të organizatës, përfshirë administratën e lartë;
- garanton se ekzistojnë kanale komunikimi të veçanta, p.sh. në rastin e denoncimeve apo padive nga "bilbilfryrësit", si edhe komunikimin anonim ose konfidencial deri tek niveli i administratës së lartë;
- garanton se metoda e përzgjedhur e komunikimit ka parasysh kohën, marrësin dhe natyrën e informacionit, si edhe pritshmëritë dhe kërkesat normative dhe rregullatore.

5. Monitorimi i kuadrit të kontrollit të brendshëm²¹

(a) Monitorimi i vazhdueshëm dhe specifik

- garanton se monitorimi i vazhdueshëm dhe specifik është zhvilluar dhe kryer, për të verifikuar se komponentët e kontrollit të brendshëm janë të pranishëm dhe funksionalë në të gjitha nivelet;
- garanton që administratës së lartë t'i vihen në dispozicion rezultatet e funksionimit të sistemeve të tyre në nivelet e varësisë;
- garanton që monitorimi i vazhdueshëm të kryhet nga administrata përgjegjëse në nivelin e çdo strukture të organizatës;

²¹

Aktiviteti monitorues vlerëson nëse kontrollet në secilin nga pesë komponentët e kontrollit të brendshëm janë të pranishëm dhe funksionalë siç duhet, ndërsa aktivitetit i kontrollit i përgjigjet risqeve specifike. Në një organizatë, mbikëqyrja nga eprori direkt mund të konsiderohet si aktivitet kontrolli, ndërsa shqyrtimi nga funksioni i kontrollit të cilësisë mund të konsiderohet aktivitet monitorimi.

- garanton që monitorimi specifik periodik të kryhet nga funksioni i auditit të brendshëm për t'i mundësuar administratës së lartë shqyrtim të pavarur të sistemeve të varësisë;

(b) Vlerësimi, regjistrimi dhe komunikimi i mangësive të kontrollit të brendshëm

- garanton që administrata përgjegjëse dhe administrata e lartë, sipas rastit, të vlerësojnë rezultatet e monitorimit të vazhdueshëm dhe specifik;
- garanton që mangësitë t'i komunikohen palëve përgjegjëse për marrjen e masave korrigjuese dhe administratës së lartë, sipas rastit;
- garanton që administrata dhe administrata e lartë, sipas rastit, të gjurmojnë nëse mangësitë janë korrigjuar në masë të mjaftueshme dhe brenda afateve të caktuara.

SHTOJCA C

Model Deklarate e Menaxhimit²²

Unë, i nënshkruari (*emri, mbiemri, titulli zyrtar ose funksioni*), Zyrtar Kombëtar Autorizues i Republikës së Shqipërisë, për programin (*emri i programit dhe CCI*), bazuar në zbatimin e (*emri i programit*) gjatë vitit (*viti*), bazuar në gjykimin tim dhe të gjithë informacionit që më është vënë në dispozicion, përfshirë rezultatet e mbikëqyrjes sime të drejtpërdrejtë dhe punën e auditit të brendshëm; si edhe nga auditet dhe kontrollet në lidhje me shpenzimet e që figurojnë në kërkesë-pagesat e dorëzuara Komisionit gjatë vitit (*viti*), dhe duke marrë parasysh detyrimet e mia në kuadrin e Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014 dhe veçanërisht nenin 9 të saj,

deklaroj se:

- informacioni në raportet apo pasqyrat financiare është paraqitur si duhet, i plotë dhe i saktë, në përputhje me nenin 23(1)(b) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014;
- shpenzimet e përfshira në pasqyrat apo raportet financiare vjetore janë përdorur për qëllimet e synuara, në përputhje me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014 dhe parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar²³;

²² Në zbatim të nenit 9(4) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

²³ Parimi i menaxhimit të qëndrueshëm financiar përfshin parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe efektshmërisë. Parimi i ekonomisë kërkon që burimet e përdorura të vihen në dispozicion në kohën e duhur, me sasi dhe cilësinë e duhur, dhe me çmimin më të mirë. Parimi i efikasitetit ka të bëjë me marrëdhënien më të mirë ndërmjet burimeve të angazhuara dhe rezultateve të arritura. Parimi i efektshmërisë lidhet me arritjen e objektivave specifike të përcaktuar për arritjen e rezultateve të synuara (neni 30 I Rregullores (BE AURATOM) nr. 966/2012).

- sistemi i menaxhimit dhe kontrollit²⁴ i ngritur për programin jep garancitë e nevojshme në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve përkatëse;
- Unë kam mbikëqyrur operacionet dhe sistemin e kontrollit të brendshëm²⁵ në lidhje me zbatimin e asistencës IPA II dhe Marrëveshjen përkatëse të Financimit.

Unë konfirmoj se parregullsitë e evidentuara në auditin e fundit apo raportet e kontrollit për vitin financiar sipas Klauzolës 5(2) të Shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje Kuadër janë trajtuar siç duhet në zbatim të Klauzolës 2(4)(g) të Marrëveshjes Kuadër. Në rastet kur ka qenë e nevojshme, janë ndjekur në mënyrë të mjaftueshme mangësitë në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të raportuara në këto raporte ose ato janë në ndjekje për sa i përket masave korrigjuese pasuese:..... (nëse është e nevojshme, përcaktoni cilat masa korrigjuese janë në ndjekje, në datën e nënshkrimit të deklaratës).

Unë gjithashtu konfirmoj se shpenzimet që janë objekt vlerësimi në proces për ligjshmërinë dhe rregullsinë e tyre janë përjashtuar nga pasqyra e shpenzimeve dhe pasqyrat financiare deri në daljen e përfundimit të vlerësimit, për përfshirjen e tyre të mundshme në kërkesë-pagesën e vitit pasardhës.

Për më tepër, unë konfirmoj se masat efikase dhe proporcionale anti-mashttrim janë të miratuara dhe mbajnë parasysh risqet e identifikuar, si edhe jam i vetëdijshëm se bërja publike e materialeve që kanë të bëjnë me zbatimin e programit mund të dëmtojë reputacionin apo interesat financiare të BE-së.

(Vendi dhe data e lëshimit)

Nënshkrimi

(Emri dhe titulli apo funksioni zyrtar i Kryetarit të Autoritetit Auditues përgjegjës)

SHTOJCA D

Model Raporti Vjetor të Aktivitetit Auditues²⁶

²⁴ Strukturat dhe autoritetet e parashikuara në nenin 7(1) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014 të ngritura prej Përfituesit IPA II dhe struktura menaxhuese e parashikuar në nenin 7(2) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014 të ngritura prej ZKA-së.

²⁵ Struktura operuese dhe struktura menaxhuese.

²⁶ Në zbatim të nenit 12(3) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

Drejtuar:

- Komisionit Evropian, Drejtorisë së Përgjithshme
- Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë
- kopje Koordinatorit Kombëtar IPA (KKIPA) të Republikës së Shqipërisë dhe
- kopje Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA) të Republikës së Shqipërisë

1. HYRJJE

1.1. Hollësitë e Autoritetit Auditues përgjegjës dhe organet e tjera që janë përfshirë në përgatitjen e raportit.

1.2. Periudha referuese (d.m.th. viti) dhe objekti i auditeve (përfshirë shpenzimet e deklaruara Komisionit për vitin në fjalë).

1.3. Identifikimi i sektorit/fushës(ave) që mbulon raportin dhe i strukturës operuese dhe strukturës menaxhuese.

1.4. Përshkrimi i hapave të marra për përgatitjen e raportit dhe hartimin e opinionit të auditit.

2. NDRYSHIMET THELBËSORE NË SISTEMET E MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT

2.1 Hollësitë e ndryshimeve thelbësore në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, dhe konfirmimin e përputhshmërisë së tyre me nenin 7 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014 bazuar në punën audituese të kryer nga Autoriteti Auditues në kuadrin e nenit 12 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

2.2 Qartësimi i datave nga të cilat zbatohen këto ndryshime, data e njoftimit të ndryshimeve pranë Autoritetit Auditues, si edhe ndikimin e këtyre ndryshimeve tek puna audituese.

3. NDRYSHIMET NË STRATEGJINË E AUDITIT

3.1 Hollësitë e ndonjë ndryshimi ndaj Strategjisë së Auditit ose që janë propozuar, si dhe i arsyeve për to. Në veçanti, përcaktoni ndryshimet në metodën e kampionimit të përdorur për auditimin e operacioneve (shihni paragrafin 5 më poshtë).

3.2 Autoriteti Auditues bën dallimin ndërmjet ndryshimeve të bëra ose të propozuara në një fazë të vonë, të cilat nuk ndikojnë në punën e bërë gjatë periudhës referuese si dhe ndryshimet e bëra gjatë periudhës referuese që ndikojnë në punën audituese dhe rezultatet.

Përfshihen vetëm ndryshimet e krahasuara me versionin e mëparshëm të Strategjisë Audituese.

4. AUDITET E SISTEMEVE

4.1 Hollësitë e organeve që kanë kryer audite sistemesh, përfshirë vetë Autoritetin Auditues.

4.2 Tabelë përmbledhëse të auditeve të kryera, duke sqaruar autoritetet/organet e audituara, vlerësimin e kërkesave kyçe për çdo autoritet/organ, çështjet e mbuluara²⁷ dhe një krahasim me planifikimin auditues. Përmbledhja përfshin programin (emrin dhe CCI), autoritetin/organ që ka kryer auditin e sistemeve, datën e auditit, objektin e auditit, përfshirë kufizimet në objekt, si edhe autoritetet/organet e audituar. Edhe auditet tematike horizontale raportohen në këtë seksion.

Periudha audituese	1. Programi (CCI dhe titulli)	2. Organi Auditues ²⁸	3. Organ(et)e audituara	4. Data e auditit ²⁹	5. Objekti i auditit ³⁰	6. Konstatimet dhe përfundimet kryesore	7. Problemet me natyrë sistemike dhe masat e marra	8. Ndikimi financiar i parashikuar (nëse ka)	9. Ndjekja (mbyllur ose jo)

4.3 Përshkrim i bazës për përzgjedhjen e auditeve në kontekstin e Strategjisë së Auditit. Përcaktohet Strategjia e Auditit e zbatuar, veçanërisht metodologjia e vlerësimit të riskut dhe rezultatet që çuan në përpilimin e planit specifik auditues të sistemeve. Në rast se është bërë një përditësim i vlerësimit të riskut, kjo përshkruhet në pikën 3 lart që trajton ndryshimet e Strategjisë së Auditit.

4.4 Nëse nevojitet, ky seksion mund të përmbajë më shumë hollësi përveç atyre që paraqiten në tabelën më lart:

4.4.1 Përshkrim i konstatimeve kryesore dhe konkluzionet e nxjerra nga puna audituese për sistemet e menaxhimit dhe kontrollit si edhe funksionimi i tyre, përfshirë mjaftueshmërinë e kontrolleve të menaxhimit, procedurat e certifikimit dhe gjurmën e auditit, ndarjen e mjaftueshme të funksioneve dhe pajtimin me politikat dhe kërkesat e BE-së dhe;

²⁷ Çështjet duhet të korrespondojnë me ato që figurojnë në Strategjinë e Auditit (por jo ekskluzivisht), si p.sh. cilësia e verifikimeve të menaxhimit, përfshirë në lidhje me respektimin e rregullave të prokurimit publik, rregullave të ndihmës shtetërore, kërkesat mjedisore, mundësitë e barabarta, zbatimin e instrumenteve inxhinierike financiare, efikasitetin e sistemeve TI, raportimin e kthimeve dhe rikuperimeve, zbatimin e vlerësimit të riskut nga mashtrimi; besueshmërinë e të dhënave që lidhen me indikatorët dhe standardet dhe ecuria e programit në arritjen e objektivave.

²⁸ Organet që kanë kryer auditet e sistemeve, përfshirë vetë Autoritetin Auditues.

²⁹ Data e punës audituese në terren.

³⁰ Autoritetet e audituara, auditit tematik horizontal, kufizimet e objektit...

4.4.2 Hollësi nëse ndonjë problem i identifikuar konsiderohet se ka karakter sistemik, dhe të masave të marra, përfshirë kuantifikimin e shpenzimeve të parregullta dhe ndonjë korrigjim financiar përkatës.

4.5 Përshkrimi (sipas rastit) i mangësive specifike që lidhen me menaxhimin e instrumenteve financiarë, të zbuluara gjatë auditave të sistemeve dhe ndjekjen e rasteve nga autoritetet kombëtare për të korrigjuar këto të meta.

4.6 Niveli i sigurisë së përfutur nga auditet e sistemeve (i ulët /mesatar/i lartë) dhe argumentimi.

5. AUDITET E MODELEVE/KAMPIONEVE TË TRANSAKSIONEVE

5.1 Autoritetet/organet që kanë kryer auditet e modeleve/ kampioneve, përfshirë Autoritetin Auditues.

5.2 Përshkrim i metodologjisë së kampionimit të aplikimit dhe informacion nëse metodologjia është në përputhje me Strategjinë e Auditit.

5.3 Sqarim i parametrave të përdorur për kampionimin statistikor, nivelin e materialitetit, nivelin e besimit, normën e pritshme të gabimit, llogaritjet e modelit/kampionit të kërkuar dhe të intervalit, njësive të modelit/kampionit, numrit të njësive të modelit/kampionit në popullatë, numrin e njësive të audituara të modelit/kampionit.

5.4 Rakordimi i shpenzimeve që i janë deklaruar Komisionit në vitin financiar me shpenzimet e kampionuara. Rakordimi i zërave përfshin zërat negativë ku janë kryer korrigjime financiare gjatë vitit financiar, si edhe diferenca ndërmjet shumave të deklaruara në Euro dhe shumat në monedhë vendase, sipas rastit.

5.5 Kur ka zëra negativë, konfirmim se ato janë trajtuar si popullatë më vete.

5.6 Në rast përdorimi të kampionit jo-statistikor, tregoni arsyet për përdorimin e metodës në pajtim me nenin 12(2) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014, përqindjen e aksioneve /operacioneve /shpenzimeve që mbulojnë auditet, hapat e marrë për të garantuar rastësinë e kampionit (dhe karakterin përfaqësues të tij) dhe për të garantuar përmasën e mjaftueshme të kampionit që i mundëson Autoritetit Auditues të hartojë një opinion auditit të vlefshëm. Gjithashtu, llogaritjet një normë gabimi e parashikuar në rastin e kampionimit jo-statistikor.

5.7 Tabelat përmbledhëse (shihni më poshtë) të ndara sipas programit tregojnë shpenzimet e pranueshme që i janë deklaruar Komisionit gjatë vitit, shumën e shpenzimeve të audituara, përqindjen e shpenzimeve të audituara në lidhje me totalin e shpenzimeve të pranueshme që i janë deklaruar Komisionit për vitin e fundit, numrin total të njësive të modelit/kampionit në popullatë, si dhe numrin e njësive të modelit/kampion aktualisht të audituara për kampionin e rastësishëm.

Informacioni në lidhje me modelin/kampionin statistikor të rastësishëm dallohet nga kampionët e tjerë përkatës, nëse ka (p.sh. modelet/kampionët komplementarë me bazë risku).

5.8 Analiza e rezultateve dhe auditeve kryesore (kampionët e përzgjedhur dhe të audituar, bashkë me shumën përkatëse dhe llojet³¹ e gabimeve për çdo operacion), si edhe natyrën³² e gabimeve të konstatuara, shkaqet kryesore dhe masat korrigjuese të propozuara, përfshirë zbutjen e këtyre gabimeve në të ardhmen.

5.9 Hollësitë e normës më të mundshme të gabimit (norma totale e gabimit³³) dhe, në rastin e metodës së kampionimit statistikor, pragun e sipërm të normës së gabimit si rezultat i auditeve të operacioneve, shumën e shpenzimeve të parregullta të zbuluara dhe normën e gabimit që rezulton nga kampioni i rastësishëm i audituar.

5.10 Krahasoni normën totale të gabimit me nivelin e materialitetit të vendosur, me qëllim që të konfirmohet nëse popullata është e keqdeklaruar materialisht apo jo. Nëse po, analizoni domethënien e normën totale të gabimit për opinionin e auditit, si edhe raportoni masat korrigjuese të rekomanduara.

5.11 Korrigjimet që lidhen vitin aktual të zbatuara nga struktura operuese/ struktura menaxhuese para dorëzimit të pasqyrës përfundimtare të shpenzimeve dhe pasqyrave financiare tek Komisioni, dhe që rezultojnë nga auditet e operacioneve³⁴, përfshirë normën fikse ose korrigjimet e ekstrapoluara.

5.12 Norma totale e mbetur e gabimit³⁵ pas zbatimit të korrigjimeve të lartpërmendura dhe pesha që ka tek opinionin e auditit.

5.13 Informacion mbi rezultatet e auditit të modelit/kampionit të komplementaritetit (p.sh. me bazë risku), nëse ka.

5.14 Informacion për ndjekjen e parregullsive, përfshirë rishikimin e normave të mbetura të gabimit të raportuara më parë, si rezultat i të gjitha ndërhyrjeve korrigjuese të mëvonshme.

5.15 Hollësi nëse ndonjë problem i identifikuar është gjykuar se ka natyrë sistemike dhe masat e marra, përfshirë kuantifikimin e shpenzimeve të parregullta dhe ndonjë korrigjim financiar përkatës.

³¹ Rastësor, sistemik, anomal.

³² Për shembull: pranueshmëria, prokurimi publik, ndihma shtetërore

³³ Siç përshkruan neni 28(14) i Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 480/2014.

³⁴ Kjo prek si korrigjimet për njësitë model të audituara, si edhe korrigjimet e zbatuara si rezultat i normës totale të gabimit

³⁵ Gabimet totale minus korrigjimet e përcaktuara në paragrafin 5.11, pjesëtuar me popullsinë totale.

5.16 Përshkrimi (sipas rastit) i mangësive specifike apo parregullsive që lidhen me instrumentet financiare. Sipas rastit, tregohet norma e gabimit e modelit/kampionit në lidhje me instrumentet financiare të audituara.

5.17 Analizat e rezultateve kryesore të auditeve të zërave negativë, përfshirë përfundimet nëse zërat negativë të audituar korrespondojnë me vendimet e vendit apo Komisionit, si dhe rakordimin e tyre me shumat që figurojnë në llogaritë e shumave të kthyer dhe të rikuperuara gjatë vitit, si edhe shumat që do të rikuperohen në fund të vitit.

5.18 Përfundimet e nxjerra nga rezultatet e auditeve në lidhje me efikasitetin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit.

6. AUDITET E RAPORTEVE FINANCIARE VJETORE OSE TË PASQYRAVE / LLOGARIVE VJETORE

6.1 Të dhëna për autoritetet / organet që kanë kryer auditet e raporteve financiare ose pasqyrat/ llogaritë vjetore.

6.2 Përshkrimi i metodës së auditit të përdorur për verifikimin e elementëve të raporteve financiare vjetore apo të pasqyrave/ llogarive vjetore të parashikuara në nenin 12(2) dhe nenin 23(1)(b) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr.447/2014.

6.3 Përshkrimi i përfundimeve të nxjerra prej rezultateve të auditeve në lidhje me plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e pasqyrës së shpenzimeve dhe pasqyrave financiare, përfshirë përshkrimin e korigjimeve financiare të bëra dhe të reflektuara në pasqyrën e shpenzimeve dhe pasqyrat financiare si ndjekje e rezultateve të auditit të bërë për transaksionet/ operacionet.

6.4 Të dhëna nëse ndonjë problem i identifikuar gjykohet se ka natyrë sistemike, si edhe masat e ndërmarra.

7. NDJEKJA E AKTIVITETIT AUDITUES TË VITEVE TË MËPARSHME

7.1 Informacion mbi ndjekjen e rekomandimeve të prapambetura të auditit dhe ndjekja e rezultateve të auditeve të sistemit, si edhe të auditeve të transaksioneve/ operacioneve (përfshirë auditet e bëra në lidhje me modelin plotësues) nga vitet e mëparshme.

7.2 Ngjarjet pasuese që prekin opinionin e mëparshëm dhe raportin vjetor të aktivitetit auditues të mëparshëm të përgatitur sipas nenit 12(3) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

8. INFORMACION SHITESË

8.1 Informacion mbi mashtrimin e raportuar dhe dyshimet për mashtrim, bashkë me masat e marra.

8.2 Ngjarjet pasuese pas dorëzimit të deklaratës së shpenzimeve dhe pasqyrave financiare, si edhe para se t'i përcillet Komisionit raporti vjetor i aktivitetit auditues sipas nenit 12(3) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014, që merren parasysh gjatë përcaktimit të nivelit të sigurisë dhe opinionit nga Autoriteti Auditues.

8.3 Në këtë seksion raportohet edhe ndonjë informacion shtesë që Autoriteti Auditues e çmon të përshtatshëm dhe të rëndësishëm për t'ia komunikuar Komisionit, veçanërisht për të justifikuar opinionin e auditit,

9. NIVELI I PËRGJITHSHËM I SIGURISË

9.1 Shpjegimi sesi niveli i përgjithshëm i nivelit të sigurisë mbi funksionimin e duhur të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit përftohet nga kombinimi i rezultateve të auditeve të sistemit dhe auditet e operacioneve.

9.2 Kur norma totale e gabimit në lidhje me shpenzimet e deklaruara në kërkesë-pagesa në një vit është mbi nivelin e materialitetit, analizoni domethënien e saj dhe vlerësoni nëse kjo tregon se ekzistojnë mangësi serioze në funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit gjatë atij viti. Kur është e nevojshme, mbani parasysh edhe rezultatet e auditeve të tjera kombëtare apo të BE-së të kryera në lidhje me atë vit.

9.3 Vlerësim i masave korrigjuese të nevojshme për sistemin, si edhe për perspektivën financiare.

9.4 Vlerësim i rregullimeve pasuese përkatëse që janë bërë, si edhe i masave korrigjuese të marra, si p.sh. korrigjimet financiare të përfshira në pasqyrën e shpenzimeve dhe pasqyrat financiare, dhe vlerësoni normën e mbetur të gabimit si edhe nevojën për ndonjë masë korrigjuese shtesë që është e nevojshme për sistemin edhe perspektivën financiare.

10. TABELA PËR SHPENZIMET E DEKLARUARA DHE AUDITETET E MODELEVE

			A	B	C	D	E	F	G	H=F-G
Fondi	Referenca (CCI)	Programi	Shpenzimet deklaruar Komisionit për atë vit ³⁶	Shpenzimet në vitin financiar të audituar si model i rastësishëm	Numri total i njësive në popullatë	Numri i njësive model për modelin e rastësishëm	Shuma dhe përqindja (norma e gabimit) e shpenzimeve të parregullta në kampionin e rastësishëm ³⁷	Totali i normës së gabimit të parashikuar	Korrigjime të bëra si rezultat i normës totale të gabimit	Norma totale e mbetur e gabimit
				Shuma ³⁹ % ⁴⁰			Shuma %	%		

SHTOJCA E

Model Opinioni Auditit Vjetor⁴¹

Drejtuar:

- Komisionit Evropian, Drejtorisë së Përgjithshme
- Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë
- kopje Koordinatorit Kombëtar IPA (KKIPA) të Republikës së Shqipërisë dhe
- kopje Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA) të Republikës së Shqipërisë

HYRJE

Unë, i nënshkruari Kryetar i Autoritetit Auditues të Republikës së Shqipërisë, i pavarur në kuptimin e nenit 12(1) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014, kam kryer procedurat e auditimit për funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit, mbi bazën e një modeli të shpenzimeve të deklaruar dhe të llogarive të përpiluara nga dhe nën përgjegjësinë e

³⁶ Kjo kolonë korrespondon me “shumën totale të shpenzimeve të pranueshme të përfshira në sistemet kontabël të strukturës menaxhuese dhe që figurojnë në kërkesë-pagesat që i janë dorëzuar Komisionit. Këto shpenzimeve duhet të korrespondojnë me shpenzimet bruto të përfshira në kërkesë-pagesat të deklaruarë atë vit, para se të bëhet ndonjë korrigjim si rezultat i punës së Autoritetit Auditues për vitin në fjalë.

³⁷ Nëse kampioni i rastësishëm mbulon më shumë se një Fond ose program, informacioni për shumën dhe përqindjen (normën e gabimit) të shpenzimeve të parregullta jepet [për të gjithë kampionin dhe jo në nivel programi/fondi.

³⁸ Shpenzimet nga kampioni plotësues dhe shpenzimet për kampionim e rastësishëm nuk janë në vitin referues (shuma).

³⁹ Shuma e shpenzimeve të audituara.

⁴⁰ Përqindja e shpenzimeve të audituara në lidhje me shpenzimet që i janë deklaruar Komisionit për vitin referues.

⁴¹ Në zbatim të nenit 12(3) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA) sipas neneve 7(2) dhe 11 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014, në lidhje me programin.....[emri i programit dhe numri CCI] (më poshtë i referuar si "programi"), me qëllim lëshimin e një opinionit auditiv sipas nenit 12(3) dhe 23(2) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014. Ky opinion auditiv është në pajtim me standardet e mëposhtme.....[citeti standardet audituese ndërkombëtare të zbatuara].

Unë kam vlerësuar edhe përputhshmërinë e deklaratës së menaxhimit të përpiluar nga Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA) në kuadrin e nenit 9(4) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014 me këtë punë audituese.

OBJEKTI I AUDITIMIT

Auditi i programit është kryer në përputhje me Strategjinë e Auditimit dhe ka marrë parasysh standardet e auditimit të miratuara ndërkombëtarisht, referuar vitit (*viti*) dhe të raportuara në raportin vjetor të aktivitetit auditues sipas nenit 12(3) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

Ose

Nuk ka pasur kufizime në objektin e auditimit.

Ose

Objekti i auditimit u kufizua nga faktorët e mëposhtëm:

- (a).....
- (b).....
- (c) etj.

[Përcaktoni kufizimet në objektin e auditit, për shembull, mungesën e ndonjë dokumentacioni mbështetës, çështjet nën procedim gjyqësor dhe llogaritni nënseksionin "Opinion i Kualifikuar" më poshtë shumën e shpenzimeve dhe kontributin e BE-së të prekur dhe ndikimin e kufizimeve në objektin e auditit opinionin e auditit.]

OPINIONI

BESUESHMËRIA E RAPORTEVE FINANCIARE VJETORE OSE TË PASQYRAVE / LLOGARIVE VJETORE

Ose

(Opinion i pakualifikuar)

Bazuar në procedurat e auditimit të lartpërmendura dhe në lidhje me programin, kam siguri të arsyeshme se:

- pasqyra e shpenzimeve dhe pasqyrat financiare japin një panoramë të vërtetë dhe të drejtë.

Në opinionin tim, puna audituese e kryer nuk vë në dyshim pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit.

Ose

(Opinion i kualifikuar)

Bazuar në procedurat e auditimit të lartpërmendura dhe në lidhje me programin, kam siguri të arsyeshme se:

- pasqyra e shpenzimeve dhe pasqyrat financiare japin një panoramë të vërtetë dhe të drejtë,

me përjashtim të aspekteve të mëposhtme:⁴²

Si rezultat, çmoj se ndikimi i kualifikimeve është [i kufizuar] / [i konsiderueshëm].

Ky ndikim arrin vlerën[shuma në EURO dhe %] të shpenzimeve totale të deklaruara. Kontributi Komunitar i prekur është.... [shuma në EURO].

Në opinionin tim, puna audituese e kryer nuk vë në dyshim pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit, ose

Në opinionin tim, puna audituese e kryer vë në dyshim pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit për këto aspekte:

Ose

(Opinion negativ)

Bazuar në procedurat e auditimit të lartpërmendura dhe në lidhje me programin, kam siguri të arsyeshme se:

- shpenzimet për të cilat i është kërkuar rimbursim Komisionit nuk janë të ligjshme dhe të rregullta
- sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të ngritur nuk funksionojnë siç duhet.

Ky opinion negativ bazohet.....⁴³

⁴² Në rast se preken sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, tregoni organin ose organet dhe aspektet e sistemeve të tyre që nuk ishin në pajtim me kërkesat dhe/ose nuk funksionin me efikasitet.

⁴³ Në rast se preken sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, tregoni për çdo organ dhe për çdo aspekt arsyet për opinionin negativ.

në opinionin tim, puna audituese e kryer vë në dyshim pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit për këto aspekte:

[Autoriteti Auditues mund të trajtojë edhe çështje që nuk prekin opinionin e tij, siç parashikojnë standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht. Mospërgjegjësia e opinionit mund të parashikohet në raste të jashtëzakonshme⁴⁴].

LIGJSHMËRIA DHE RREGULLSIA E SHPENZIMEVE DHE FUNKSIONIMI I SISTEMEVE TË MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT

Ose

(Opinion i pakualifikuar)

Bazuar në procedurat e auditimit të lartpërmendura dhe në lidhje me programin, kam siguri të arsyeshme se:

- shpenzimet për të cilat i është kërkuar rimbursim Komisionit janë të ligjshme dhe të rregullta;
- sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të ngritura funksionojnë siç duhet.

Në opinionin tim, puna audituese e kryer nuk vë në dyshim pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit.

Ose

(Opinion i kualifikuar)

Bazuar në procedurat e auditimit të lartpërmendura dhe në lidhje me programin, kam siguri të arsyeshme se:

- pasqyra e shpenzimeve dhe pasqyrat financiare japin një panoramë të vërtetë dhe të drejtë.

me përjashtim të aspekteve më lart (specifikoni aspektet):
⁴⁵

Si rezultat, çmtoj se ndikimi i kualifikimeve është [i kufizuar] / [i konsiderueshëm].

Ky ndikim arrin vlerën[shuma në EURO dhe %] të shpenzimeve totale të deklaruara. Kontributi Komunitar i prekur është.... [shuma në EURO].

Në opinionin tim, puna audituese e kryer nuk vë në dyshim pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit, **ose**

⁴⁴ Këto raste të jashtëzakonshme lidhen me faktorë të jashtëm të paparashikueshëm që janë jashtë fuqisë së Autoritetit Auditues.

⁴⁵ Në rast se preken sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, përcaktoni organin ose organet dhe aspektet e sistemeve të tyre që nuk ishin në pajtim me kërkesat dhe/ose nuk funksiononin me efikasitet.

Në opinionin tim, puna audituese e kryer vë në dyshim pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit për këto aspekte:

Ose

(Opinion negativ)

Bazuar në procedurat e auditimit të lartpërmendura dhe në lidhje me programin, kam siguri të arsyeshme se:

- shpenzimet për të cilat i është kërkuar rimbursim Komisionit nuk janë të ligjshme dhe të rregullta
- sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të ngritur nuk funksionojnë siç duhet.

Ky opinion negativ bazohet në.....⁴⁶

Në opinionin tim, puna audituese e kryer vë në dyshim pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit për këto aspekte:

[Autoriteti Auditues mund të trajtojë edhe çështje që nuk prekin opinionin e tij, siç parashikojnë standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht. Mospërgjegjësia e opinionit mund të parashikohet në raste të jashtëzakonshme⁴⁷].

Nënshkrimi

(Emri dhe titulli apo funksioni zyrtar i Kryetarit të Autoritetit Auditues përgjegjës.

SHTOJCA F

Model Opinioni Auditit për pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve⁴⁸

Drejtuar:

- Komisionit Evropian, Drejtorisë së Përgjithshme
- Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë
- kopje Koordinatorit Kombëtar IPA (KKIPA) të Republikës së Shqipërisë, dhe
- kopje Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA) të Republikës së Shqipërisë

⁴⁶ Në rast se preken sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, tregoni për çdo organ dhe për çdo aspekt arsyet për opinionin negativ.

⁴⁷ Këto raste të jashtëzakonshme lidhen me faktorë të jashtëm të paparashikueshëm që janë jashtë fushës së Autoritetit Auditues.

⁴⁸ Në zbatim të nenit 12(4) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

HYRJE

Unë, i nënshkruari Kryetar i Autoritetit Auditues të Republikës së Shqipërisë, funksionalisht i pavarur në kuptimin e nenit 12(1) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014, kam kryer auditin e pasqyrës përfundimtare të shpenzimeve për programin (tregoni programin – titulli, komponenti, periudha, numri (CCI)), të hartuar nën përgjegjësinë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA) sipas nenit 9(4) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014, me qëllim lëshimin e një opinionit auditiv sipas nenit 12(4) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014. Ky opinion auditiv është në pajtim me standardet e mëposhtme.... [citoni standardet audituese ndërkombëtare të zbatuara].

Unë besoj se puna audituese e kryer ofron një bazë të pranueshme për opinionin tim.

OBJEKTI I AUDITIMIT

Auditi u krye në përputhje me nenin 17(1) të Marrëveshjes Kuadër.

Ose

Nuk ka pasur kufizime në objektin e auditimit.

Ose

Objekti i auditimit u kufizua nga faktorët e mëposhtëm:

- a)
- b)
- c) etj.

[Përcaktoni kufizimet në objektin e auditit, për shembull, mungesën e ndonjë dokumentacioni mbështetës, çështjet nën procedim gjyqësor dhe llogaritni nën seksionin Opinion i Kualifikuar më poshtë shumat e shpenzimeve dhe kontributin e BE-së të prekur dhe ndikimin e kufizimeve në objektin e auditit në opinionin e auditit.]

OPINIONI

Ose

(Opinion i pakualifikuar)

Bazuar në auditin e lartpërmendur dhe në lidhje me programin, kam siguri të arsyeshme se:

- shumat e paraqitura në pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve dhe në kërkesë-pagesën përfundimtare, ku përfshihet deklarata, janë të vlefshme dhe të pranueshme;
- informacioni financiar i paraqitur është i saktë; dhe
- shpenzimet e paraqitura në pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve janë të ligjshme dhe të rregullta.

Ose

(Opinion i kualifikuar)

Bazuar në auditin e lartpërmendur dhe në lidhje me programin, kam siguri të arsyeshme se:

- shumat e paraqitura në pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve dhe në kërkesë-pagesën përfundimtare, ku përfshihet deklarata, janë të vlefshme dhe të pranueshme;
- informacioni financiar i paraqitur është i saktë; dhe
- shpenzimet e paraqitura në pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve janë të ligjshme dhe të rregullta,

me përjashtim të aspekteve të mëposhtme:⁴⁹

Si rezultat, çmtoj se ndikimi i kualifikimeve është [i kufizuar] / [i konsiderueshëm].

Ky ndikim arrin vlerën[shuma në EURO dhe %] të shpenzimeve totale të deklaruar. Kontributi Komunitar i prekur është.... [shuma në EURO].

Ose

(Opinion negativ)

Bazuar në auditin e lartpërmendur dhe në lidhje me programin, kam siguri të arsyeshme se:

- shumat e paraqitura në pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve dhe në kërkesë-pagesën përfundimtare, ku përfshihet deklarata, nuk janë të vlefshme dhe/ose të pranueshme;
- informacioni financiar i paraqitur nuk është i saktë; dhe/ose
- shpenzimet e paraqitura në deklaratën përfundimtare të shpenzimeve nuk janë të ligjshme dhe të rregullta.

Ky opinion negativ bazohet në.....⁵⁰

[Autoriteti Auditues mund të trajtojë edhe çështje që nuk prekin opinionin e tij, siç parashikojnë standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht. Mospërgjegjësia e opinionit mund të parashikohet në raste të jashtëzakonshme⁵¹].

(Vendi dhe data e lëshimit)

Nënshkrimi

⁴⁹ Në rast se preken sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, përcaktoni organin ose organet dhe aspektet e sistemeve të tyre që nuk ishin në pajtim me kërkesat dhe/ose nuk funksiononin me efikasitet.

⁵⁰ Në rast se preken sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, përcaktoni për çdo organ dhe për çdo aspekt arsyet për opinionin e kundërt.

⁵¹ Këto raste të jashtëzakonshme duhet të lidhen me faktorë të jashtëm të paparashikueshëm që janë jashtë fuqisë së Autoritetit Auditues.

(Emri dhe titulli apo funksioni zyrtar i Kryetarit të Autoritetit Auditues përgjegjës)

SHTOJCA G

Modeli i Strategjisë së Auditimit⁵²

1. PARATHËNIE

1.1 Identifikimi i programeve (emri dhe *CCI*) që mbulon strategjia e auditit.

1.2 Identifikimi i autoritetit auditues përgjegjës për hartimin, monitorimin dhe përditësimin e strategjisë së auditit dhe të ndonjë organi tjetër që ka kontribuar.

1.3 Shpjegimi i procedurës së ndjekur për hartimin, monitorimin dhe përditësimin e strategjisë së auditit.

1.4 Specifikimi i objektivave të përgjithshëm të strategjisë së auditit dhe hapat e marrë për të garantuar harmonizimin e objektivave me të gjitha organet e auditit.

1.5 Shpjegimi i të gjitha funksioneve dhe përgjegjësi të autoritetit auditues, me referencë misionin, statutin e auditit ose legjislacionin e brendshëm, sipas rastit.

1.6 Konfirmimi i autoritetit auditues për pavarësinë e tij, sipas nenit 12(1) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014 dhe për autonominë e tij të nevojshme financiare sipas Klauzolës 5(1) të Shtojcës A të Marrëveshjes Kuadër.

2. BAZA LIGJORE DHE OBJEKTI

2.1 Evidentim i kuadrit rregullator kombëtar, nëse ka, që rregullon autoritetin auditues dhe funksionet e tij.

2.2 Konfirmim se strategjia mbulon vitin tjetër dhe dy vitet financiare pasardhëse.

3. VLERËSIMI I RISKUT

3.1 Shpjegimi i metodës së ndjekur për vlerësimin e riskut të përgjithshëm, përfshirë edhe sqarimin e faktorëve të riskut të marrë në konsideratë, përfshirë ato për fushat specifike të përshkruara në kuadrin e paragrafit 4.2.3 më poshtë [bashkë me proceset e synuara dhe vlerësimin e ndryshimeve procedurale dhe organizative, ndër të tjera], sistemin e pikëzimit të përdorur për vlerësimin e riskut, masën se sa janë marrë parasysh rezultatet e auditeve të

⁵² Në zbatim të nenit 12(2) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

mëparshme të organeve dhe sistemet që mbulojnë strukturën operuese dhe strukturën menaxhuese.

3.2 Identifikoni kontrollet duke përcaktuar organizimin, zbatimin dhe funksionimin në tre nivele:

- niveli i parë i kontrolleve të ushtruara nga strukturat administrative IPA;
- niveli i dytë i kontrolleve të ushtruara nga njëra anë, nëpërmjet sistemit të kontrollit të brendshëm, si edhe funksionit të auditimit të brendshëm, nga ana tjetër;
- monitorimi i nivelit të lartë, i ushtruar përmes funksionit garantues të ZKA-së.

3.3. Procedurat për përditësimin e vlerësimit të riskut.

4. METODOLOGJIA

4.1 Përshkrim i shkurtër i metodologjisë së auditimit.

Përshkrim i shkurtër i hapave kryesorë të aktivitetit auditues si p.sh.: planifikimi dhe organizimi i objektivave të auditit⁵³ që duhen përmbushur, kryerjen e auditit dhe mbledhjen e evidencave, vlerësimin e evidencave dhe formulimin e konkluzioneve, raportimin⁵⁴, proceset ndjekëse/vijuese⁵⁵ dhe modalitetet e kontrollit të cilësisë për punën e autoritetit auditues.

Referencë për procedurat apo manualët ekzistuese të auditit, ku këto hapa mund të përshkruhen më hollësisht.

Referencë për standardet e auditit të pranuar ndërkombëtarisht që synon të përdorë autoriteti auditues.

Referencë për procedurat e miratuara për hartimin e raportit vjetor të aktivitetit auditues dhe të opinionit të auditit që i dorëzohet Komisionit sipas nenit 12(3) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

4.2 Për auditet e sistemeve:

4.2.1 Përcaktimin e organeve që do të auditohen dhe elementët kyç të kontrollit.

4.2.2 Sqarim për ndonjë audit sistemi në lidhje me elementët kyç të kontrollit që synojnë fusha

⁵³ Përfshirë referencën për pragjet të materialitetit dhe faktorët e tjerë sasiorë dhe cilësorë që merren parasysh kur vlerësohet materialiteti i konstatimeve të auditit për llojet kryesore të auditeve të përshkruara në seksionet 4.2, 4.3 dhe 4.4. të kësaj strategjie.

⁵⁴ Referencë për fazat e ndryshme të raportimit (si p.sh. projekt-raportet e auditit, procedurat e rakordimit me audituesin dhe raportet përfundimtare të auditit), afatet për raportimin si edhe proceset ndjekëse.

⁵⁵ Përfshirë referencën për procedurat e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve dhe masat korrigjuese që rezultojnë nga raportet e auditit.

tematike specifike, për shembull:

- cilësia e verifikimit të menaxhimit, përfshirë në lidhje me respektimin e rregullave të prokurimit publik, kërkesat mjedisore apo mundësitë e barabarta;
- cilësia e verifikimeve për përzgjedhjen dhe menaxhimin e projekteve në lidhje me zbatimin e instrumenteve të inxhinierisë financiare;
- Funksionimi dhe siguria e sistemeve TI, si edhe lidhjen e tyre me sistemin(et) TI të Komisionit;
- besueshmëria e të dhënave në lidhje me treguesit, standardet e arritura dhe ecurinë e programeve në arritjen e objektivave të përcaktuara nga struktura operuese.
- raportimi i kthimeve dhe rikuperimeve;
- zbatimi i masave efikase dhe proporcionale anti-mashtrim që kërkon vlerësimi i riskut të mashtrimit.

4.3 Për auditin e transaksioneve/operacioneve:

4.3.1 Specifikimin e metodologjisë së kampionimit që përdoret në pajtim me nenin 12(2) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014, përfshirë procedurat për rishikimin e saj, nëse është e nevojshme.

4.3.2 Kur është e nevojshme, edhe një përshkrim të mënyrës së kampionimit jostatistikor që i mundëson autoritetit auditues të hartojë një opinion auditivi të vlefshëm, siç parashikon neni 12(2) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

4.3.3 Përshkrimi i procedurës për rekomandimin e hapave të duhur që duhen marrë nga autoritetet përkatëse kur zbulohen gabime (ose referencë për procedurat apo manualët e auditimit, kur kjo çështje paraqitet).

4.3.4 Përshkrimi i procedurës së miratuar për klasifikimin dhe trajtimin e gabimeve të zbuluara (ose referencë për procedurat apo manualët e auditimit, kur kjo çështje paraqitet).

4.3.5 Aspekte specifike në lidhje me instrumentet financiare të auditeve, sipas rastit.

4.3.6 Aspekte specifike në lidhje me alternativat e auditeve të kostove të thjeshtuara, sipas nenit 31(c) të Rregullores Zbatuese, sipas rastit.

4.4. Për auditet e raporteve financiare vjetore ose pasqyrat/llogaritë vjetore:

Sqarim të metodës audituese për auditin e raporteve financiare vjetore ose pasqyrave/llogarive vjetore, procedurën për rekomandimin e hapave të duhura që duhen marrë nga autoritetet

përkatëse kur zbulohen gabime.

Metoda audituese duhet të mbajë parasysh rezultatet e auditeve të sistemeve dhe auditet e transaksioneve/operacioneve të kryera në strukturën menaxhuese dhe strukturën operuese, si edhe verifikimet e menaxhimit të parashikuara në Klauzolën 4(3)(b)(x) të Shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje.

4.5 Procedurat për t'i mundësuar autoritetit auditues që të vendosë nëse aktiviteti auditues vë në dyshim pohimet e bëra për mungesën e rezervave në deklaratën e menaxhimit, sipas nenit 9(4) të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) nr. 447/2014.

5. AKTIVITETI AUDITUES I PLANIFIKUAR

5.1 Sqarim dhe justifikim të prioriteteve dhe objektivave specifike në lidhje me vitin tjetër dhe dy vitet pasardhëse, bashkë me shpjegimin e lidhjes së rezultateve të vlerësimit të riskut me aktivitetin auditues të planifikuar.

5.2 Aktivitetet monitoruese të planifikuara dhe ndjekja e konstatimeve të auditit pararendës.

5.3 Kalendar indikativ të detyrave audituese në lidhje me vitin tjetër dhe dy vitet e tjera pasardhëse për auditet e sistemeve dhe auditetet tematike, si më poshtë:

Autoritetet / organet apo fushat tematike që auditohen	CCI	Emri i Programit	Rezultati i vlerësimit të riskut	Objektivat dhe objekti i Auditit 20xx	Objektivat dhe objekti i Auditit 20xx	Objektivat dhe objekti i Auditit 20xx

6. BURIMET E PLANIFIKUARA

6.1 Jepni organigramën e autoritetit auditues.

6.2 Sqaroni burimet e planifikuara që do të akordohen në lidhje me vitin tjetër dhe dy vitet pasardhëse.

6.3 Sqaroni kualifikimet dhe përvojën e kërkuar të stafit që kryen auditet, si edhe kriteret e trajnimit, sipas rastit.

SHTOJCA H

Raportimi për mashtrimin e dyshuar dhe parregullsi të tjera në lidhje me Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II)

Klauzola 1 Përkufizime

Për qëllime të raportimit të mashtrimit të dyshuar dhe parregullsive të tjera, zbatohen përkufizimet e përcaktuara në nenin 51 të kësaj Marrëveshjeje për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.

Klauzola 2 Raportimi fillestar

(1) Përfituesi IPA II, pa asnjë vonesë, raporton tek Komisioni për çdo mashtrim të dyshuar dhe parregullsi të tjera që kanë qenë objekt i konstatimit administrativ apo gjyqësor paraprak, si dhe e mban Komisionin të informuar mbi ecurinë e procedimeve administrative dhe ligjore.

Në atë raport, Përfituesi IPA jep në të gjitha rastet hollësi që lidhen me:

- a) Instrumentin IPA II dhe fushën përkatëse, emërtimin dhe numrin e programit dhe të aksionit apo operacionit në fjalë;
- b) identitetin dhe rolin e personave fizikë dhe juridikë të përfshirë apo të ndonjë subjekti tjetër pjesëmarrës, përveç rasteve kur informacioni nuk lidhet me këtë për qëllime të luftës ndaj parregullsive, duke marrë parasysh edhe natyrën e parregullsisë në fjalë;
- c) identifikimin e rajonit apo fushës ku është kryer operacioni, duke përdorur informacionin e përshtatshëm, si për shembull nivelin NUTS⁵⁶;
- d) dispozitën(at) që janë shkelur;

⁵⁶ Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat

- e) datën dhe burimin e informatës së parë që çoi në dyshimin se është kryer një parregullsi;
 - f) praktikat e ndjekura në kryerjen e parregullsisë;
 - g) sipas rastit, nëse praktika lë shkak për të dyshuar për mashtrim;
 - h) mënyrën si është zbuluar parregullsia;
 - i) sipas rastit, Përfituesin IPA dhe Shtetet Anëtare dhe/ose vendet e treta të përfshira;
 - j) periudhën apo momentin kur është kryer parregullsia;
 - k) datën kur është bërë konstatimi administrativ apo gjyqësor paraprak i parregullsisë;
 - l) shuma totale të shpenzimeve të pranueshme të specifikuara nga kontributi i BE-së, kontributi kombëtar dhe kontributi privat;
 - m) shpenzimet e prekura nga parregullsia e specifikuar nga kontributi i BE-së dhe kontributi kombëtar;
 - n) shuma që do të ishte paguar padrejtësisht po të mos ishte identifikuar parregullsia sipas kontributit të BE-së dhe kontributit kombëtar;
 - o) natyra e shpenzimeve të parregullta;
 - p) pezullimi i pagesave, sipas rastit, si dhe mundësia e rikuperimit;
- (2) Kur informacioni i përcaktuar në paragrafin 1 dhe veçanërisht informacioni në lidhje me praktikat e ndjekura në kryerjen e parregullsisë dhe mënyra si është zbuluar, nuk është i disponueshëm ose duhet të përpunohet, Përfituesi IPA aq sa mundet ia vë në dispozicion pa vonesë Komisionit informacionin e munguar ose të saktë.
- (3) Kur legjislacioni i brendshëm ka dispozita për konfidencialitetin e hetimeve, komunikimi i informacionit është objekt autorizimi nga gjykata përkatëse.

Klauzola 3 Rastet urgjente

Secili Përfitues IPA II raporton menjëherë tek Komisioni dhe, kur është e nevojshme, edhe tek Shtetet Anëtare apo Përfituesit IPA II të interesuar, për parregullsi të zbuluara apo të supozuara, kur ekziston frika se ato mund të shkaktojnë pasoja jashtë territorit të tij.

Klauzola 4 Raportimi për ndjekjen e çështjeve

- (1) Bashkë me informacionin e parashikuar në Klauzolën 2, Përfituesi IPA i jep Komisionit pa asnjë vonesë hollësi për fillimin, përfundimin apo braktisjen e ndonjë procedure për

vendosjen e penaliteteve administrative apo penale në lidhje me parregullsitë e raportuara si edhe rezultatin e procedurave të tilla.

Në lidhje me parregullsitë për të cilat janë vendosur penalitetet, Përfituesi IPA sqaron edhe sa më poshtë:

- (a) nëse penalitetet janë të natyrës administrative apo penale;
 - (b) nëse penalitetet rezultojnë nga shkelja e legjislacionit të BE-së apo të legjislacionit të brendshëm;
 - (c) dispozitat ku bazohen penalitetet;
 - (d) arsyet për braktisjen e procedurave të rikuperimit, nëse ka;
 - (e) nëse është konstatuar mashtrim
- (2) Me kërkesë me shkrim të Komisionit, Përfituesi IPA II jep informacion shtesë në lidhje me një parregullsi specifike të një grupi parregullsish.

Klauzola 5 Transmetimi elektronik

Informacioni i parashikuar në Klauzolën 2, 3 dhe 4(1) dërgohet në anglisht me mjete elektronike, duke përdorur modulën e dhënë prej Komisionit për këtë qëllim, nëpërmjet një lidhjeje interneti të sigurt.

Klauzola 6 Përdorimi i informacionit

Komisioni mund të përdorë çdo informacion me natyrë të përgjithshme ose pune që i është komunikuar nga Përfituesi IPA sipas këtyre dispozitave për të kryer analizat e riskut dhe, mbi bazën e këtij informacioni të marrë, mund të përgatitë raporte dhe të krijojë sisteme paralajmërimi paraprak që shërbejnë për të identifikuar risqet më me efikasitet.

Klauzola 7 Përdorimi i Euros

Për raportimin e parregullsive përdoren monedha Euro. Përfituesi IPA II konverton në Euro shumat e shpenzimeve të kryera në monedhën vendase. Këto shuma konvertohen në Euro me kursin e këmbimit valutor të Komisionit në muajin kur shpenzimi është kontabilizuar në llogaritë e Strukturës Operuese të programit apo aksionit në fjalë. Komisioni e publikon kursin e këmbimit çdo muaj elektronikisht.

Kur shumat lidhen me shpenzime të kontabilizuara në llogaritë e autoritetit kombëtar gjatë një periudhë më shumë se një-mujore, mund të përdoret kursi i këmbimit për muajin kur shpenzimi është regjistruar herën e fundit. Nëse shpenzimet nuk janë regjistruar në kontabilitetin e autoritetit kombëtar, përdoret kursi i këmbimit valutor më i fundit publikuar elektronikisht prej Komisionit.

Klauzola 8 Mbrojtja e të dhënave personale

- (1) Përfituesit IPA II dhe Komisioni marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar zbulimin e paautorizuar apo aksesin në informacionin e përcaktuar në Klauzolat 2, 3 dhe 4(1).
- (2) Informacioni i përcaktuar në Klauzolat 2, 3 dhe 4(1) nuk mund t'u dërgohet personave të tjerë përveç atyre të Përfituesit IPA II apo brenda institucioneve të BE-së, detyrat e të cilëve kërkojnë që ata të kenë akses në këtë informacion, përveç rasteve kur Përfituesi IPA II që ofron këtë informacion shprehet dakord.
- (3) Të dhënat personale që gjenden në informacionin e përcaktuar në Klauzolat 2, 3 dhe 4(1) trajtohen vetëm për qëllime të specifikuar në ato dispozita.

SHTOJCA I

Prioritetet tematike për asistencë

Asistenca, sipas rastit, mund të financojë prioritetet tematike si më poshtë:

- (a) respektimin e parimit të administratës publike të aftë dhe qeverisjes ekonomike, Ndërhyrjet në këtë fushë synojnë: forcimin e administratës publike, përfshirë profesionalizimin dhe depolitizimin e shërbimit civil, mishërimin e parimeve të meritokracisë dhe garantimin e procedurave administrative të mjaftueshme; forcimi i kapaciteteve për të garantuar stabilitet makroekonomik dhe për të mbështetur progresin drejt një ekonomie tregu funksionale dhe sa më konkurruese; mbështetje për pjesëmarrjen në mekanizmat shumëpalësh të mbikëqyrjes fiskale të BE-së dhe për bashkëpunimin me institucionet financiare ndërkombëtare mbi bazat e politikës ekonomike, si edhe forcimi i menaxhimit financiar publik.
- (b) ngritjen dhe promovimin që në fazë të hershme të funksionimit të duhur të institucioneve të nevojshme që garantojnë shtetin e të drejtës. Ndërhyrjet në këtë fushë synojnë ngritjen e sistemeve gjyqësore të pavarura, llogaridhënëse dhe efikase, përfshirë rekrutimin transparent dhe të bazuar në meritë, sistemet e vlerësimit dhe ngritjes në detyrë, si edhe procedura disiplinore efikase në rast shkeljeje; ngritjen e sistemeve të qëndrueshme për të mbrojtur kufijtë, për të menaxhuar flukset e migrimit si edhe për t'iu dhënë azil personave në nevojë; zhvillimin e mjeteve efikase për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve – përfshirë romët dhe personat lesbikë, homoseksualë, biseksualë, transjinorë dhe ndër-gjinorë – si edhe liritë themelore, përfshirë lirinë e medias.
- (c) forcimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave të partnerëve socialë, përfshi shoqatat profesionale, në vendet përfituese të renditura në Shtojcën I të

Rregullores IPA II si dhe nxitjen e formimit të rrjeteve në të gjitha nivelet ndërmjet organizatave me seli në BE dhe përfituesve të renditur në Shtojcën I të Rregullores IPA II, duke mundësuar dialogun efikas me aktorët publikë dhe privatë.

- (d) investimet në arsim, aftësi dhe të nxëniet për tërë jetën. Ndërhryjet në këtë fushë synojnë promovimin e aksesit të barabartë në fëmijëri të hershme dhe arsim parësor dhe dytësor cilësor; uljen e nivelit të braktisjes së shkollës në moshë të hershme; përshtatjen e sistemeve të arsimit dhe formimit profesional (AFP) me kërkesat e tregut të punës; përmirësimin e cilësisë dhe rëndësisë së arsimit të lartë; rritjen e aksesit në të nxëniet për tërë jetën dhe mbështetjen e investimeve në arsim dhe infrastrukturën e formimit profesional, veçanërisht me qëllim reduktimin e pabarazive territoriale dhe nxitjen e arsimit pa segregacion.
 - (e) rritjen e punësimit dhe mbështetjen e lëvizshmërisë së punës, Ndërhryjet në këtë fushë synojnë integrimin e qëndrueshëm të të rinjve të papërfshirë në punësim, shkollim apo trajnim (NEET) në tregun e punës, përfshirë nëpërmjet masave që stimulojnë investimet në krijimin e vendeve cilësore të punës; mbështetjen e integritetit të të papunëve; dhe inkurajimin e pjesëmarrjes më të madhe në tregun e punës të të gjithë grupeve të nën-përfaqësuara. Fushat e tjera të ndërhryjes janë mbështetja për barazinë gjinore, përshtatja e punonjësve dhe sipërmarrjeve ndaj ndryshimit, krijimi i dialogut social të qëndrueshëm, si edhe modernizimi dhe forcimi i institucionet të tregut të punës.
 - (f) promovimin e përfshirjes sociale dhe luftën ndaj varfërisë. Ndërhryjet në këtë fushë synojnë integrimin e komuniteteve të marzhinalizuar si romët; luftimin e diskriminimit mbi baza gjinie, race apo origjine etnike, besimi fetar apo bindjeje, paaftësie, moshe apo orientimi seksual; dhe rritjen e aksesit në shërbime mjaft cilësore dhe të qëndrueshme që janë të përballueshme për qytetarët, si shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe shërbimet sociale me interes të përgjithshëm, përfshirë masat për modernizimin e sistemeve të mbrojtjes sociale.
 - (g) promovimin e transportit të qëndrueshëm dhe eliminimin e bllokimit të trafikut në infrastrukturën e rrjeteve kyçe të transportit, sidomos duke investuar në projekte me vlerë të shtuar evropiane të lartë. Investimet e identifikuar duhet të prioritizohen mbi bazën e kontributit që japin për lëvizshmërinë, qëndrueshmërinë, uljen e shkarkimeve të gazeve serë, si dhe mbi bazën e rëndësisë ndaj lidhjeve me Shtetet Anëtare dhe rëndësisë me Hapësirën e Përbashkët të Transportit Evropian.
 - (h) përmirësimin e mjedisit të sektorit privat dhe konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve, përfshirë specializimin racional, si nxitës kyç të rritjes, krijimin e vendeve të punës dhe kohezionit. Prioritetet do t'i jepet projekteve që përmirësojnë klimën e biznesit.
 - (i) forcimin e kërkimit shkencor, zhvillimit teknologjik dhe novacionit, sidomos nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës kërkimore, mjedisit favorizues dhe promovimit të formimit të rrjeteve dhe bashkëpunimit.
 - (j) kontribuimin në sigurinë e furnizimeve me artikuj ushqimorë dhe ruajtjen e diversitetit dhe rentabilitetit në sistemet bujqësore në komunitetet rurale dinamike dhe rrethinat.
-

- (k) forcimin e sektorit agro-ushqimor që të përballojë presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut, si edhe të përafrohet gradualisht me rregullat dhe standardet e BE-së, duke ndjekur objektivat ekonomikë, socialë dhe mjedisorë nëpërmjet zhvillimit territorial të balancuar në zonat rurale.
- (l) mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, duke kontribuar në reduktimin e shkarkimeve të gazeve serë, rritjen e përballimit të ndryshimeve klimatike dhe nxitjen e informimit dhe qeverisjes aktive në raport me klimën. Financimet IPA II do të promovojmë politikat që mbështetin kalimin drejt një ekonomike të qëndrueshme, me burime efikase, të sigurta dhe me karbon të ulët.
- (m) promovimin e masave pajtuese, paqeruajtëse dhe besimforcuese.

SHTOJCA J

Prioritetet tematike për asistencë për bashkëpunimin territorial

Asistenca për bashkëpunimin ndërkufitar, sipas rastit, mund të financojë prioritetet tematike si më poshtë:

- a) nxitja e punësimit, lëvizshmëria e fuqisë punëtore dhe përfshirja sociale e kulturore përmes kufijve, duke zbatuar ndër të tjera këto masa: integrimi ndërkufitar i tregjeve të punës, përfshirë lëvizshmërinë ndërkufitare; nismat e përbashkëta vendore për punësimin; shërbimet e informimit dhe këshillimit, si edhe trajnimet e përbashkëta; barazia gjinore; mundësitë e barabarta; integrimi i komuniteteve të emigrantëve dhe grupeve vulnerabil, investimet në shërbimet publike të punësimit; mbështetja e investimeve në shëndetin publik dhe shërbimet sociale;
- b) mbrojtja e mjedisit dhe nxitja e përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i riskut duke zbatuar, ndër të tjera, këto masa: aksione të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit; nxitjen e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, efikasitetin e burimeve, burimet e rinovueshme të energjisë, si dhe kalimin drejt një ekonomie të sigurt dhe të qëndrueshme me karbon të ulët; nxitja e investimeve për të trajtuar rreziqet specifike, duke siguruar përballimin e fatkeqësive natyrore dhe zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të fatkeqësive natyrore dhe gatishmërinë ndaj emergjencave;
- c) nxitja e transportit të qëndrueshëm dhe përmirësimi i infrastrukturave publike, duke zbatuar ndër të tjera këto masa: reduktimi i izolimit duke përmirësuar aksesin në shërbimet dhe rrjetet e transportit, informacionit dhe komunikimit, si edhe investimi në ujërat ndërkufitare, si edhe objektet dhe sistemet e trajtimit të mbetjeve dhe energjetike;
- d) nxitja e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore;

- e) investimi në aftësitë e rinisë dhe arsim, duke zbatuar ndër të tjera këto masa: zhvillimi dhe zbatimi i infrastrukturës dhe skemave të përbashkëta për arsimim, formim profesional dhe trajnim, duke mbështetur aktivitetet e përbashkëta të rinisë;
- f) promovimi i qeverisjes vendore dhe rajonale dhe forcimi i kapaciteteve planifikuese dhe administrative të autoriteteve vendore dhe rajonale;
- g) forcimi i konkurrueshmërisë, mjedisit të biznesit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, tregtisë dhe investime, duke realizuar ndër të tjera, promovimin dhe mbështetjen e sipërmarrjes, sidomos të NVM-ve, si dhe zhvillimi i tregjeve ndërkufitare vendore dhe ndërkombëtarizimit;
- h) forcimi i kërkimit shkencor, zhvillimit teknologjik, novacionit si dhe të teknologjive të informimit dhe komunikimit, duke zbatuar ndër të tjera promovimin e ndarjes/bashkimit të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve logjistike në dobi të zhvillimit të kërkimit dhe teknologjisë.

MARRËVESHJE SEKTORIALE

NDËRMJET

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TË PËRFAQËSUAR NGA

Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë

Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie

1.3.

*Republic of Albania, Ministry of Justice, Official
Translations Service*

1.4.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

KOMISIONIT EVROPIAN

QË PËRCAKTON

**DISPOZITAT E MENAXHIMIT DHE ZBATIMIT TË ASISTENCËS FINANCIARE
TË BE-së PËR REPUBLIKEN E SHQIPËRISË NË KUADËR TË INSTRUMENTIT
PËR ASISTENCËN E PARA-ANËTARËSIMIT
NË FUSHËN "BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL" (IPARD)**

Pasqyra e Lëndës

SEKSIONI I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	7
Neni 1	Objekti	7
Neni 2	Respektimi i marrëveshjeve.....	7
Neni 3	Vendimet Financuese dhe Marrëveshjet e Financimit.....	7
Neni 4	Përputhshmëria me masa dhe instrumente të tjera	8
SEKSIONI II	RREGULLAT E MENAXHIMIT INDIREKT NGA SHQIPËRIA.....	8
TITULLI 1:	NGRITJA E SISTEMEVE TË MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT	8
Neni 5	Parimet zbatuese	8
Neni 6	Funksionet dhe përgjegjësitë e përbashkëta të strukturave dhe autoriteteve.....	8
Neni 7	Funksionet dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues.....	8
Neni 8	Funksionet dhe përgjegjësitë e Autoritetet Menaxhues.....	9
Neni 9	Funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë IPARD	10
TITULLI 2:	SISTEMET E KONTROLLIT.....	11
Neni 10	Dispozita të përgjithshme për aplikimet për mbështetje kërkesë-pagesat dhe deklaratat e tjera	11
Neni 11	Verifikimet administrative.....	12
Neni 12	Verifikimet në vend	13
Neni 13	Përmbajtja e verifikimeve në vend	14
Neni 14	Verifikimet ex-post.....	14
Neni 15	Raporti i kontrollit	15
Neni 16	Matjet e zonës	16
Neni 17	Verifikimi administrativ i matjeve të zonës	16
Neni 18	Elementët e verifikimeve në vend të matjeve të zonës.....	16
Neni 19	Matja e zonës	16
Neni 20	Verifikimi i kushteve të pranueshmërisë dhe alokimeve për matjet e zonës.....	17
Neni 21	Raporti i kontrollit për matjet e zonës	17
Neni 22	Reduktimet dhe përjashtimet sipas përmasave të zonës.....	18
TITULLI 3:	DISPOZITA SPECIFIKE PËR T’I DHËNË SHQIPËRISË DETYRA TË ZBATIMIT TË BUXHETIT	19
Neni 23	Kërkesat kryesore	19
Neni 24	Përgatitjet për dërgimin e kërkesës për të marrë detyra të zbatimit të buxhetit	20
Neni 25	Kërkesa dhe shtojcat mbështetëse	21
SEKSIONI III	RREGULLAT E PROGRAMIMIT.....	21
Neni 26	Programi IPARD II.....	21
Neni 27	Masat e Programit IPARD II.....	22
SEKSIONI IV	RREGULLAT E ZBATIMIT.....	22
TITULLI 1	RREGULLAT E PËRGJITHSHME DHE PARIMET E ZBATIMIT.....	22
Neni 28	Rregullat për prokurimin	22
TITULLI 2	TRANSPARENCA DHE VIZIBILITETI	23
Neni 29	Informimi, publiciteti dhe transparenca.....	23
Neni 30	Vizibiliteti dhe komunikimi.....	24
SEKSIONI V	RREGULLAT E MENAXHIMIT FINANCIAR TË ASISTENCËS IPA II...25	25

TITULLI 1	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	25
Neni 31	Rregulla të përgjithshme për asistencën financiare	25
Neni 32	Intensiteti i ndihmës dhe norma e kontributit të BE-së	25
TITULLI 2:	PRANUESHMËRIA	26
Neni 33	Pranueshmëria e shpenzimeve	26
TITULLI 3:	FINANCIMI DHE PAGESAT	28
Neni 34	Anulimi i fondeve të papërdorura	28
Neni 35	Plani i financimit për programin IPARD II	29
Neni 36	Pagimi i kontributit të BE-së	29
NENI 37	KËRKESË-PAGESAT NGA SHQIPËRIA	31
Neni 38	Parafinancimi	32
Neni 39	Llogaritja e shumës që duhet të paguhet	33
Neni 40	Pagimi i bilancit përfundimtar	33
Neni 41	Pagesat që iu bëhen përfituesve	34
Neni 42	Kursi i këmbimit dhe interesat	36
TITULLI 4	MBYLLJA E PROGRAMIT	38
Neni 43	Mbyllja e programit IPARD II	38
Neni 44	Ruajtja e dokumenteve	38
TITULLI 5:	KORRIGJIMET FINANCIARE SI DHE SHQYRTIMI E PRANIMI I	
LLOGARIVE.....		39
Neni 45	Përmbajtja e llogarive vjetore	39
Neni 46	Përcjellja e informacionit të nevojshëm për shqyrtimin dhe pranimin e llogarive... ..	39
Neni 47	Forma dhe përmbajtja e informacionit kontabël.....	40
Neni 48	Procedura e shqyrtimit dhe miratimit të llogarive	41
Neni 49	Verifikimi i konformitetit	42
Neni 50	Rikuperimi i fondeve	43
SEKSIONI VI	MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI.....	45
TITULLI I:	MONITORIMI I PROGRAMIT	45
Neni 51	Monitorimi i Programit dhe treguesit e programit.....	45
Neni 52	Komiteti Monitorues i IPARD-it	45
Neni 53	Indikatorët.....	47
TITULLI 2	VLERËSIMI.....	47
Neni 54	Parimet për zbatimin e programit IPARD II	47
Neni 55	Vlerësimi ex ante i programit IPARD II	48
Neni 56	Plani i vlerësimit për programin IPARD	48
Neni 57	Vlerësimi i ndërmjetëm	49
Neni 58	Vlerësimi ex-post.....	49
TITULLI 3	RAPORTIMI	50
Neni 59	Raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit	50
SEKSIONI VII	DISPOZITA SPECIFIKE PËR PROGRAMET E VEPRIMIT	52
SHUMËVJEÇARE ME FONDE TË PËRBASHKËTA.....		52
Neni 60	Zbatueshmëria e marrëveshjeve sektoriale për IPA-n	53
Neni 61	Adresa për komunikimet	53
Neni 62	Mosrespektimi dhe zgjidhja e marrëveshjes.....	54
Neni 63	Hyrja në fuqi	55

Neni 64	Nënshkrimi	55
SHTOJCA 1 - FUNKSIONET KRYESORE TË SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM		56
SHTOJCA 2 - KUADRI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM		61
SHTOJCA 3 - DOKUMENTET E KËRKUARA PËR APLIKIMIN E BESUESHMËRISË PËR DETYRAT E ZBATIMIT TË BUXHETIT		69
SHTOJCA 4 - RREGULLAT PËR PROGRAMIMIN		139
SHTOJCA 5 - FORMULARI D 1 – PASQYRA E SHPENZIMEVE DHE BURIMIT TË TË ARDHURAVE.....		153
SHTOJCA 6 - FORMULARI D 2 - PASQYRA VJETORE E LLOGARIVE PËR.....		155
VITIN FINANCIAR (.....)		155
SHTOJCA 7 - PARASHIKIMET E PAGESAVE		159
SHTOJCA 8 - INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI PËR MBËSHTETJEN E ASISTENCËS IPA II		160
SHTOJCA 9 - LISTA E PAGESAVE TË KRYERA PËR VITIN FINANCIAR 20XX- PËR PROGRAMIN IPARD II Shqipëria.....		167

Komisioni Evropian, më poshtë i referuar si **“Komisioni”** që vepron për dhe në emër të Bashkimit Evropian

nga njëra anë,

dhe

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë që vepron për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë, më poshtë i referuar si **“Shqipëria”**,

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht referuar si **“Palët”**.

Duke marrë parasysh se:

- (1) Më 11 mars 2014, Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratuan Rregulloren (BE) Nr. 231/2014 për krijimin e instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit¹ (më poshtë e referuar si “Rregullorja IPA II”). Ky instrument përbën bazën ligjore për dhënien e asistencës financiare përfituesve të renditur në Shtojcën I të Rregullores IPA II (më poshtë referuar si “Përfituesit IPA II”), për t'i ndihmuar në miratimin dhe zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike që kërkohen nga këto përfitues për të qenë në përputhje me vlerat e BE-së dhe për të përafuar gradualisht rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së, me synimin për t'u bërë anëtarë të BE-së;
- (2) Më 2 maj 2014, Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratuan Rregulloren (BE) Nr. 447/2014² që përcakton procedura dhe rregulla të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të BE-së për financimin e masave të jashtme (më poshtë e referuar si Rregullorja e Përbashkët Zbatuese”);

1.1.1. ¹ Rregullorja (BE) Nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014 për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II) (GZ L 77, 15 mars 2014, faqe 11).

1.1.2. ² Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 447/2014 e datës 2 maj 2014 për rregullat specifike për Rregulloren zbatuese (BE) nr. 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që përcakton një Instrument për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II) (GZ L 132, 3.5.2014, fq. 32)

(3) Në përputhje me Nenin 5 të Rregullores Zbatuese IPA II, marrëveshjet kuadër mund të parashikohen nga marrëveshje sektoriale që përcaktojnë dispozita specifike për menaxhimin dhe zbatimin e asistencës IPA II në fushat ose programet e politikave specifike.

(4) Shqipëria është e pranueshme për asistencë sipas Rregullores IPA II.

Në datën 09.04.2015 u nënshkrua (u lidh) një³ marrëveshje kuadër ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit për masat për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë sipas IPA II (më poshtë e referuar si “MK”)

(5) u lidh një marrëveshje kuadër ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit për masat për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë sipas IPA II (më poshtë e referuar si “MK”)

(6) Programet e zhvillimit rural duhet të zbatohen nga Shqipëria mbi bazën e menaxhimit të tërthortë në përputhje me Nenin 58 (1) (c) të Rregullores (BE, EURATOM) nr. 966/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit⁴ dhe duhet të përcaktojnë masat që do të financohen me asistencën e IPA II. Llojet e përzgjedhura të masave duhet të jenë të një natyre të ngjashme me ato të parashikuara sipas Rregullores (BE) nr. 1305/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit⁵.

(7) Në disa pjesë të Marrëveshjes Kuadër niveli i hollësisë së rregullave për zbatimin e programeve të zhvillimit rural nuk është i mjaftueshëm. Si rezultat, është e nevojshme të përcaktohen hollësisë të mëtejshme për zbatimin dhe menaxhimin e asistencës në fushën e politikës së zhvillimit rural të IPA II në një marrëveshje sektoriale në përputhje me Nenin 9 të Marrëveshjes Kuadër.

(8) Ndërsa një marrëveshje sektoriale duhet të plotësojë Marrëveshjen Kuadër, struktura e kësaj Marrëveshjeje ndjek strukturën e Marrëveshjes Kuadër,

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

³ Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, ligji nr. 37/2015, datë 9.4.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II)”

1.1.3. ⁴ Rregullorja (BE, EURATOM nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 25 tetorit 2012 për rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 1605/2002 (GZ L 298, 26. 10. 2012, fq. 1)

1.1.4. ⁵ Rregullorja (BE) nr. 1305/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 17 dhjetorit 2013 për mbështetjen për zhvillimin rural nga Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural (FBEZHR) dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1698/2005 (GZL 347, 20. 12. 2013, fq. 487)

SEKSIONI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Kjo Marrëveshje përcakton dispozita specifike për menaxhimin dhe zbatimin e asistencës në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural të Shqipërisë, sipas nenit 9 të Marrëveshjes së Financimit Kuadër (MK).

Kjo Marrëveshje plotëson MK-në të lidhur me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë sipas nenit 5, pikat 1 dhe 2, të Rregullores Zbatuese IPA II për zbatimin e IPA II. Në rast përplasjeje ndërmjet kësaj Marrëveshjeje dhe MK-së, precedencë kanë dispozitat e MK-së.

Neni 2 Respektimi i marrëveshjeve

(1) Shqipëria zotohet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e duhur të të gjitha aktiviteteve të asistencës si edhe për të lehtësuar zbatimin e programit IPARD II, në përputhje me MK-në dhe këtë marrëveshje (më poshtë të referuara si "marrëveshjet"). Shqipëria zotohet edhe që të respektojë programin IPARD II dhe Marrëveshjen e Financimit përcaktuar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Në rast konflikti mes marrëveshjes dhe programit IPARD II, kanë përparësi dispozitat e marrëveshjeve.

Neni 3 Vendimet Financuese dhe Marrëveshjet e Financimit

Në vijim të hyrjes në fuqi të MK-së dhe kësaj Marrëveshjeje, si edhe pas miratimit nga Komisioni të një vendimi financues që miraton programin IPARD II, palët lidhin një Marrëveshje Financimi sipas nenit 6, pika 3 të Rregullores Zbatuese IPA.

Marrëveshja e Financimit bën ndarjen e alokimeve ligjore shumëvjeçare dhe periudhën e vlefshmërisë së këtyre alokimeve, që ndahen në lote njëvjeçare përgjatë disa vitesh.

Marrëveshja e Financimit rishikohet çdo vit për të pasqyruar shumat e disponueshme në buxhetin e BE-së dhe, sipas rastit, për të pasqyruar ndryshimet që i bëhen kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4 Përputhshmëria me masa dhe instrumente të tjera

- (1) Përveç nenit 5(1)(b) të MK-së, Komisioni dhe Shqipëria garantojnë përputhshmërinë dhe koordinimin e asistencës brenda dhe ndërmjet programit IPARD II, masave në fushat e tjera në kuadrin e Rregullores IPA II dhe asistencës së Bankës Europiane të Investimeve dhe instrumenteve financiarë ndërkombëtarë të tjerë, në nivelet e planifikimit, programimit dhe zbatimit.
- (2) Çdo mbivendosje e masave që financohen prej asistencës IPA duhet të shmanget.

SEKSIONI II RREGULLAT E MENAXHIMIT INDIREKT NGA SHQIPËRIA

TITULLI 1: NGRITJA E SISTEMEVE TË MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT

Neni 5 Parimet zbatuese

Shqipëria e zbaton programin IPARD II me menaxhim indirekt.

Neni 6 Funkcionet dhe përgjegjësitë e përbashkëta të strukturave dhe autoriteteve

Strukturat dhe autoritetet e përcaktuara në nenin 10, pika 1), germa (c) dhe në nenin 10, pika 2 të MK-së ngrihen me një akt formal dhe ushtrojnë të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7 Funkcionet dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues

- (1) Zyrtari Kombëtar Autorizues (më poshtë e referuar si "ZKA") është përgjegjës për ngritjen e strukturës menaxhuese sipas nenit 10, pika 2 të MK-së;
- (2) Përveç Klauzolës 2 të Shtojcës A të MK-së, ZKA-ja vepron si interlokutor i vetëm me Komisionin për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me IPARD-in në lidhje me:
 - (a) shpërndarjen e udhëzimeve dhe teksteve të BE-së që lidhen me sistemet e menaxhimit dhe kontrollit si edhe me organe të tjera përgjegjëse për zbatimin e tyre, si edhe për aplikimin e tyre të harmonizuar;

(b) kërkesën për marrjen e detyrave të zbatimit të buxhetit, sipas nenit 13, pika 1 të MK-së;

(c) informacionin e plotë kontabël për qëllime statistikore dhe kontrolli, që i dorëzohet Komisionit.

- (3) ZKA-ja vlerëson ndonjë ndryshim të propozuar për zbatimin apo modalitetet e pagesave të strukturës operuese dhe strukturës menaxhuese. ZKA-ja informon Komisionin, me një kopje për të vënë në dijeni Autoritetin Auditues, për ndonjë ndryshim thelbësor, përfshi vlerësimin e ZKA-së, shpjegimet, justifikimet dhe dokumentet mbështetëse të përshtatshme për shqyrtimin dhe miratimin paraprak të zbatimit të tyre.

Neni 8 Funksionet dhe përgjegjësitë e Autoritetet Menaxhues

- (1) Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e programit IPARD II, në përputhje me Shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje.
- (2) Autoriteti Menaxhues kryen funksionet duke siguruar zbatim efektiv të programit IPARD II.

Në përputhje me nenin 10, pika 1, germa c) të MK-së, është përgjegjës për:

- (a) përgatitjen e programit IPARD II dhe ndryshimeve të mundshme të tij, përfshi ato që kërkohen prej Komisionit;
- (b) kontrollin dhe verifikimin e masave që do të përcaktohen në programit IPARD II në bashkëpunim me Agjencinë IPARD;
- (c) përzgjedhjen e masave nën secilën thirrje për aplikime në kuadrin e programit IPARD II si edhe kohën e zbatimit, kushtet e pranimit dhe alokimin financiar për çdo masë, nën çdo thirrje. Vendimet merren bashkërisht me Agjencinë IPARD;
- (d) miratimin e bazës ligjore kombëtare të përshtatshme për zbatimin e IPARD II si edhe rishikimin e saj sipas nevojës;
- (e) mbështetjen e Komitetit Monitorues IPARD, sipas nenit 52 të kësaj Marrëveshjeje, kryesisht duke ofruar dokumentet e nevojshme për monitorimin e cilësisë dhe zbatimit të programit IPARD II.

- (3) Autoriteti Menaxhues, sipas Klauzolës 4(3)(a)(i) të Shtojcës A të MK-së, ngre një sistem raportimi dhe informimi për të mbledhur informacion financiar dhe statistikor mbi progresin e programit IPARD, bazuar edhe në informacionin që pret të marrë nga Agjencia IPARD; këto të dhëna ia përcjell Komitetit Monitorues IPARD II, sipas modaliteteve të rëna dakord ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit, duke përdorur – ku është e mundur – sisteme kompjuterike që mundësojnë shkëmbim të dhënash me Komisionit dhe të lidhur me sistemin e raportimit dhe informimit të ngritur prej ZKA-së sipas Klauzolës 2(4)(f) të Shtojcës A të MK-së. Sistemi i raportimit dhe informimit duhet të kontribuojë edhe për raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit të parashikuara në nenin 59 të kësaj Marrëveshjeje.
- (4) Autoriteti Menaxhues i propozon Komisionit ndryshime në programin IPARD II, duke vënë në dijeni edhe Koordinatorin Kombëtar IPA (më poshtë e referuar si “KKIPA”), pas konsultimit me Agjencinë IPARD dhe pasi ka marrë pëlqimin e Komitetit Monitorues IPARD II. Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për informimin e autoriteteve përkatëse mbi nevojën e bërjes së ndryshime administrative të nevojshme, kur këto ndryshime kërkohen pas një vendimi të Komisionit që ndryshon programin IPARD II.
- (5) Çdo vit, Autoriteti Menaxhues harton një plan veprimi për operacionet e synuara të realizohen me Asistencën Teknike, që i dorëzohet Komitetit Monitorues IPARD II për miratim.
- (6) Siç parashikon Klauzola 4(3)(a)(iv) e Shtojcës A të MK-së, Autoriteti Menaxhues harton një plan veprimi sipas nenit 56 të kësaj Marrëveshjeje. Plani i dorëzohet Komitetit Monitorues sipas nenit 52 të kësaj Marrëveshjeje, jo më vonë se një vit pas miratimit të programit IPARD II prej Komisionit. Autoriteti Menaxhues raporton te Komiteti Monitorues IPARD II dhe te Komisioni mbi progresin e bërë me zbatimin e këtij plani.
- (7) Autoriteti Menaxhues harton një plan koherent me aktivitetet për vizibilitetin dhe komunikimin, sipas nenit 24 të MK-së, si dhe konsultohet me informon Komisionin, pasi është këshilluar me Komitetin Monitorues IPARD II. Plani, mbi të gjitha, tregon nismat e marra dhe që do të merren për informimin e publikut të gjerë për rolin e luajtur prej BE-së dhe programimit IPARD II dhe për rezultatet e tij.
- (8) Nëse Autoriteti Menaxhues delegon një pjesë të detyrave te një organ tjetër, ai mban përgjegjësinë e plotë për menaxhimin dhe zbatimin e atyre detyrave, në përputhje me parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar.

Neni 9 Funkcionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë IPARD

- (1) Agjencisë IPARD i ngarkohen funksionet dhe përgjegjësitë sipas Shtojcës 1. Sipas nenit 10(1) të MK-së, ajo ka edhe këto përgjegjësi:

- (a) i jep konfirmim Autoritetit Menaxhues mbi kontrollin dhe verifikimin e masave të programit IPARD II;
 - (b) organizon thirrjet për aplikime dhe publikon kushtet e pranueshmërisë, pasi merr pëlqimin e Autoritetit Menaxhues mbi çështjet e ngritura në zbatim të nenit 8(2)(c) të kësaj Marrëveshjeje;
 - (c) përzgjedh projektet për zbatim;
 - (d) përcakton me shkrim detyrimet kontraktuale ndërmjet Agjencisë IPARD dhe përfituesve, përfshi informacion mbi sanksionet e mundshme në rast mospërmbushjeje të detyrave dhe, sipas rastit, lëshon miratimin për nisjen e punës. Agjencia IPARD mund të vazhdojë të kontrakttojë apo të marrë përsipër zotime në zbatim të kësaj Marrëveshjeje për një masë specifike deri në datën kur Shqipëria fillon të kontrakttojë apo të marrë përsipër zotime për këtë masë në kuadrin e ndonjë programi pasues të IPARD II;
 - (e) merr masa ndjekëse për të garantuar progresin e projekteve në zbatim;
 - (f) raporton mbi progresin e masave në zbatim, kundrejt disa indikatorëve;
 - (g) garanton që përfituesi të sensibilizohet për kontributin e BE-së në projekt;
 - (h) garanton raportimin e parregullsive në nivel kombëtar;
 - (i) garanton që ZKA-ja, struktura menaxhuese dhe Autoriteti Menaxhues të marrin të gjithë informacionin që u nevojitet për kryerjen e detyrave të tyre;
 - (j) garanton respektim të detyrimeve në lidhje me publicitetin, sipas nenit 23 të MK-së.
- (2) Për investime në projekte infrastrukturore të tipit që pritet të gjenerojnë të ardhura neto të konsiderueshme, Agjencia IPARD vlerëson nëse ky projekt është i këtij tipi, para se të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me një përfitues potencial. Nëse konstatohet se është i tillë, Agjencia IPARD sigurohet që ndihma publike nga të gjitha burimet nuk tejkalon 50% të kostos totale të lidhur me projektin dhe të konsideruar të pranueshme për bashkëfinancim të BE-së.
- (3) Agjencia IPARD siguron që për çdo projekt të programit IPARD II, akumulimi i ndihmës publike të dhënë nga të gjitha burimet të mos tejkalojë tavanet maksimale për shpenzimet publike të përcaktuara në nenin 32.

TITULLI 2: SISTEMET E KONTROLLIT

Neni 10 Dispozita të përgjithshme për aplikimet për mbështetje kërkesë-pagesat dhe deklaratat e tjera

- (1) Shqipëria miraton procedurat e përshtatshme për dorëzimin e aplikimeve për mbështetje, të kërkesë-pagesave dhe të deklaratave të tjera që lidhen me masat e zhvillimit rural.
- (2) Rezultatet e verifikimeve administrative dhe në vend vlerësohen për të përcaktuar nëse ekziston risku për operacione të tjera të ngjashme, përfitues apo organe tjera që të mos respektojnë kriteret e përshtatshmërisë dhe detyrimet e tjera të imponuara nga Marrëveshjet dhe programi IPARD II, si edhe nëse aplikohet niveli i duhur i kontrollit dhe nëse janë të nevojshme masa korigjuese dhe parandaluese.
- (3) Kur është rasti, verifikimet administrative dhe në vend për pranueshmërinë do të marrin në konsideratë rastet e dyshuara të mosrespektimit të raportuara nga shërbimet, organet apo organizata të tjera.

Neni 11 Verifikimet administrative

- (1) Verifikimet administrative kryhen për çdo aplikim për mbështetje, kërkesë-pagesë apo deklarata të tjera që kërkohet të dorëzohen nga përfituesi, dhe përfshijnë të gjithë elementët që mund të kontrollohen dhe duhet të kontrollohen me anë të verifikimeve administrative. Kjo procedurë përfshin regjistrimin e punës së kontrollit të ndërmarrë, rezultatet e verifikimit dhe masat e marra në rast mospërputhjes.
- (2) Verifikimet administrative të aplikimeve për mbështetje duhet të sigurojnë që operacioni përputhet me detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjeje, përfshi ato të standardeve dhe kërkesave të tjera të detyrueshme. Verifikimet përfshijnë veçanërisht:
 - (a) pranueshmërinë e operacionit për të cilin kërkohet mbështetje;
 - (b) kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në programin IPARD II, zotimet dhe detyrimet e tjera të operacionit për të cilin kërkohet mbështetje;
 - (c) pajtueshmërinë me kriteret e përzgjedhjes;
 - (d) pranueshmërinë e kostove të operacionit;
 - (e) pajtueshmërinë e operacionit për të cilin kërkohet mbështetje me rregullat e zbatueshme të brendshme dhe të BE-së, në veçanti, dhe, aty ku është e nevojshme, me rregullat e prokurimit publik, ndihmës publike dhe standardeve të tjera të detyrueshme të imponuara nga legjislacioni i brendshëm apo Marrëveshjet e nënshkruara (përfshi programin IPARD);

- (f) arsyetimin e kostove të propozuara, që vlerësohen me anë të një sistemi vlerësimi të përshtatshëm, të tilla si kostot referuese, kostot standarde për njësi, krahasimi i ofertave të ndryshme apo nga një komision vlerësimi;
- (g) besueshmërinë e përfituesit, bazuar në informacione prej palëve të treta si vendime gjykatash, ndjekje penale të filluara nga prokuroria, apo procedura falimentimi të filluara.
- (3) Verifikimet administrative të kërkesë-pagesave përfshijnë:
- (a) dhënien e produkteve apo shërbimeve të bashkëfinancuara. Parafinancimi kontraktual i Autoritetit Kontraktues mund të cilësohet shpenzim i pranueshëm deri në masën 10% të vlerës së kontratës;
- (b) vërtetësinë e shpenzimeve të pretenduara;
- (c) operacionin e përfunduar dhe përmbushjen e kushteve, krahasuar me operacionin për të cilin është dorëzuar aplikimi dhe është dhënë mbështetja;
- (d) arsyetimin e kostove të pretenduara, që vlerësohen me anë të një sistemi vlerësimi të përshtatshëm, si edhe pagesat e bëra.
- (4) Verifikimet administrative përfshijnë procedura për shmangien e financimit të dyfishtë me të tjera skema financimi të BE-së apo skema kombëtare. Në rast se ka financim nga burime të tjera, këto verifikime sigurojnë që mbështetja totale e marrë të mos kapërcejnë tavanet maksimale të lejueshme për ndihmën.
- (5) Verifikimet administrative përfshijnë edhe dokumentet e përcaktuara në nenin 36(7).
- (6) Indicet për parregullsi ndiqen me një procedurë administrative të përshtatshme.

Neni 12 Verifikimet në vend

- (1) Për të gjitha aplikimet kryhen verifikime në vend, për mbështetjen dhe kërkesë-pagesat që duhet të dorëzohen nga përfituesi, që mbulojnë të gjithë elementet që mund të kontrollohen në momentin e vizitës. Por, në raste të jashtëzakonshme, të regjistruara dhe të shpjeguara siç duhet, Shqipëria mund të vendosë se verifikimi në vend nuk është i nevojshëm.
- (2) Përfituesi mund të njoftohet paraprakisht për verifikimin në vend, me kusht që të mos vihet në rrezik qëllimi i kontrollit. Nëse njoftimi paraprak bëhet më shumë se 48 orë para verifikimit në

vend, informacioni duhet të jetë i kufizuar aq sa duhet, në varësi të natyrës së masës dhe operacionit që po bashkëfinancohet.

- (3) Kur është e mundur, verifikimet në vend që parashikohen në këtë Marrëveshje kryhen në të një kohë si çdo kontroll që parashikohet në legjislacionin e BE-së apo në atë të brendshëm. Kontrolli në vend zgjat rreptësisht vetëm aq sa është i nevojshëm.
- (4) Inspektorët që kryejnë kontrollin në vend nuk duhet të jenë përfshirë në verifikime administrative të të njëjtit operacion.
- (5) Marrëveshja e Financimit e lidhur ndërmjet Komisionit dhe Shqipërisë, si edhe çdo ndryshim i saj, mund të parashikojë që verifikimi në vend për një masë e caktuar të bëhet me bazë kampionimi. Në këtë rast, Marrëveshja e Financimit përcakton madhësinë minimale të kampionit, kriteret për përzgjedhjen e kampionit dhe si rritet madhësia e kampionit nëse verifikimi zbulon numër të lartë parregullsisht.

Neni 13 Përmbajtja e verifikimeve në vend

- (1) Verifikimi në vend verifikon që operacioni është përgatitur dhe është zbatuar në përputhje me rregullat e zbatueshme, si dhe mbulon të gjitha kriteret e pranueshmërisë, alokimet dhe detyrimet që lidhen me kushtet për dhënien e mbështetjes, që janë të mundura të kontrollohen në momentin e vizitës. Verifikimi siguron edhe që operacioni është i pranueshëm për financim.
- (2) Verifikimi në vend verifikon saktësinë e të dhënave të deklaruara nga përfituesi përkundër dokumenteve mbështetëse. Kjo përfshin verifikimin që aplikimet dhe kërkesë-pagesat e dorëzuara prej përfituesit janë të mbështetura me kontabilitet apo dokumente të tjera, duke përfshirë, kur është e nevojshme, një kontroll mbi saktësinë e të dhënave në kërkesë-pagesë, në bazë të të dhënave apo dokumenteve tregtare që disponohen nga palë të treta.
- (3) Verifikimi në vend verifikon nëse dobia apo dobia e synuar i operacionit është në përputhje me dobinë e përshkruar në aplikimin për mbështetje, si dhe për të cilën është dhënë mbështetja. Verifikimi në vend përfshin një vizitë në vendin ku po zbatohet operacioni ose, nëse operacioni është jokonkret, te promovuesi i operacionit.

Neni 14 Verifikimet *ex-post*

- (1) Verifikimi *ex post* kryhet për operacionet e investimit për të verifikuar respektimin e alokimeve të përcaktuara në nenin 33, pika 6 të Programit IPARD II.

- (2) Kontrollorët e verifikimit *ex post* nuk duhet të kenë qenë të përfshirë në verifikimin *ex ante* të të njëjtit operacion të investimit, me përjashtim të rastit kur kontrollorët kanë kryer të paktën një verifikim në vend në periudhën mes këtyre dy verifikimeve.
- (3) Verifikimi *ex post* kryhet brenda pesë viteve nga data kur përfituesi merr pagesën e fundit. Gjatë periudhës pesëvjeçare, të gjitha investimet kontrollohen të paktën një herë.
- (4) Verifikimi *ex post* që kryhet përgjatë periudhës pesëvjeçare, bazohet në analizën e riskut dhe implikimeve financiare të operacioneve, grupeve të operacioneve apo masave të ndryshme.
- (5) Kur zgjidhet kampioni i operacioneve të miratuara që do të kontrollohet në zbatim të paragrafëve (3) dhe (4) merr parasysh në veçanti:
 - (a) nevojën për të kontrolluar numrin e përshtatshëm të operacioneve sipas tipeve dhe përmasave;
 - (b) çdo faktor risku që është identifikuar nga verifikimi kombëtar apo i BE-së;
 - (c) nevojën për të ruajtur balancën ndërmjet masave.

Neni 15 Raporti i kontrollit

- (1) Për çdo verifikim në vend nën këtë Titull përgatitet një raport kontrolli që bën të mundur shqyrtimin e hollësive të verifikimit të kryer. Raporti përcakton në veçanti:
 - a) masat dhe aplikimet apo kërkesë-pagesat që janë kontrolluar;
 - b) personat e pranishëm;
 - c) nëse i është dërguar njoftim paraprak përfituesit dhe kur;
 - d) rezultatet e verifikimit dhe, kur është e nevojshme, ndonjë vërejtje;
 - e) matje të tjera kontrolli që do të kryhen.
- (2) Në rastin e verifikimit në vend, përfituesit i jepet mundësia të firmosë raportin gjatë kontrollit që të vërtetohet prania e tij gjatë kontrollit, si edhe të shkruajë vërejtje. Kur nuk konstatohet ndonjë mospërputhje, përfituesit i jepet një kopje e raportit të kontrollit.
- (3) paragrafi (1) dhe nënparagrafi i dytë i paragrafit 2 aplikohen *mutatis mutandis* për verifikimet *ex post* nën këtë titull.

Neni 16 Matjet e zonës

- (1) Për qëllime të këtij Titulli, “matjet e zonës” nënkuptojnë ato matje që mbështeten mbi bazën e madhësisë së zonës së deklaruar.
- (2) Pa cenuar nenin 11, pika 1 dhe nenin 12, verifikimi i matjeve të zonës respekton rregullat e përcaktuara në nenet 17-22.

Neni 17 Verifikimi administrativ i matjeve të zonës

- (1) Verifikimi administrativ synon gjetjen e mospërputhjeve. Verifikimi mbulon të gjithë elementët që mund dhe duhet të kontrollohen nga verifikimi administrativ, me qëllim që të konstatohet se:
 - (a) kriteret e pranueshmërisë, alokimet dhe detyrimet e tjera janë përmbushur;
 - (b) nuk ka financim të dyfishtë përmes skemave të tjera të BE-së;
 - (c) aplikimi për mbështetje apo kërkesë-pagesa është e plotë dhe e dorëzuar brenda afatit dhe, kur është e mundur, dokumentet mbështetëse janë dorëzuar dhe vërtetojnë pranueshmërinë;
 - (d) ka përputhje me alokimet afatgjata, kur është e nevojshme.
- (2) Kur është e nevojshme, verifikimi administrativ përfshin verifikim të kryqëzuar ndërmjet parcelave bujqësore siç janë deklaruar në aplikim dhe/ose në kërkesë-pagesë dhe informacion që përmban një sistem identifikimi i parcelave bujqësore për parcelat referuese, me qëllim që të verifikohet pranueshmëria e tyre;
- (3) Kur nga verifikimi i kryqëzuar konstatohen të dhëna për mospërputhje, kryhet ndonjë procedurë administrative të përshtatshme dhe, kur është e nevojshme, një verifikim në vend.

Neni 18 Elementët e verifikimeve në vend të matjeve të zonës

- (1) Verifikimi në vend kryhet për të gjitha parcelat bujqësore për të cilën është kërkuar mbështetje.
- (2) Verifikimi në vend kryen matjen e zonës dhe verifikon kriteret e pranueshmërisë, alokimet dhe detyrimet e tjera të përfituesit në kuadrin e masave.

Neni 19 Matja e zonës

- (1) Verifikimi në vend mat parcelat bujqësore për të cilat është dorëzuar një aplikim për mbështetje dhe/ose kërkesë-pagesë.
- (2) Marrëveshja e Financimit e lidhur ndërmjet Komisionit dhe Shqipëria, si edhe çdo ndryshim i saj, mund të parashikojë që matja e zonës në kuadrin e verifikimit në vend të bëhet me bazë kampionimi të rastësishëm të parcelave. Në këtë rast, Marrëveshja e Financimit përcakton madhësinë minimale të kampionit. Kur ky verifikim kampioni zbulon ndonjë mospërputhje, maten të gjitha parcelat bujqësore ose pranohen rezultatet e kampionit të matur.
- (3) Zonat me parcela bujqësore maten me mjete që garantojnë cilësi të paktën të njëjtë me atë të Sistemit Global të Navigimit Satelitor (GNSS) apo të ortoimazherisë.
- (4) Për matjet e kryera me GNSS dhe/ose ortoimazheri, përcaktohet një marzh tolerance njëshifror. Për këtë qëllim, mjetet matëse që përdoren, duhet të jenë të kalibruara për vlerat poshtë maksimales. Sidoqoftë, toleranca është deri 1.25m.

Toleranca maksimale për çdo parcelë bujqësore nuk duhet të tejkalojë 1.0 ha në terma absolutë.

- (5) Matja mund të përfshijë tërë parcelën bujqësor ku përmbush plotësisht kriteret e pranueshmërisë. Në raste të tjera, matja kryhet për pjesën e parcelës që është e pranueshme për financim.

Neni 20 Verifikimi i kushteve të pranueshmërisë dhe alokimeve për matjet e zonës

- (1) Verifikimi kryhet me çdo mjet që mundëson kontrollin e alokimeve të ndryshme dhe detyrimeve të përfituesit.
- (2) Kur vetëm një metodë kontrolli është e pamjaftueshme për qëllimin e paragrafit (1), sistemi i kontrollit parashikon disa mjete kontrolli të cilat, së bashku, mundësojnë arritjen e qëllimit të paragrafit (1).

Neni 21 Raporti i kontrollit për matjet e zonës

- (1) Për çdo verifikim në vend të matjeve të zonë, përgatitet një raport kontrolli që bën të mundur shqyrtimin e hollësive të verifikimit të kryer dhe nxjerrjen e përfundimeve në lidhje me respektimin e kriterëve të pranueshmërisë, alokimet dhe detyrimet e tjera. Raporti përcakton në veçanti:
 - (a) masat dhe aplikimet apo kërkesë-pagesat që janë kontrolluar;
 - (b) personat e pranishëm;

- (c) parcelat bujqësore që janë kontrolluar, parcelat bujqësore që janë matur përfshi, sipas rastit, rezultatin e matjeve për parcelë bujqësore të matur dhe metodën matëse të përdorur;
 - (d) kur është e nevojshme, rezultatet e matjeve të tokës jobujqësore për të cilën është kërkuar mbështetje në kuadrin e masave të zhvillimit rural, si edhe metodën matëse të përdorur;
 - (e) nëse është dhënë njoftimi i kontrollit për përfituesin dhe nëse po, periudhën e njoftimit paraprak;
 - (f) të dhëna të ndonjë mase specifike kontrolli që duhet të kryhet në kontekstin e masave individuale;
 - (g) matje të tjera kontrolli që do të kryhen.
 - (h) të dhëna të ndonjë mospërputhjeje të konstatuar që kërkon ndjekje gjatë vitet pasardhëse;
- (2) Përfituesit i jepet mundësia të firmosë raportin gjatë kontrollit që të vërtetohet prania e tij gjatë kontrollit, si edhe të shkruajë vërejtje. Kur nuk konstatohet ndonjë mospërputhje, përfituesit i jepet një kopje e raportit të kontrollit.

Neni 22 Reduktimet dhe përjashtimet sipas përmasave të zonës

- (1) Nëse nga matjet rezulton që zona është më e madhe sesa është deklaruar në kërkesë-pagesë, për llogaritjen e mbështetjes merret zona e deklaruar.

Nëse zona e deklaruar në kërkesë-pagesë tejkalon zonën e përcaktuar, mbështetja llogaritet mbi bazën e zonës së përcaktuar.

Megjithatë, nëse diferenca mes totalit të zonës së përcaktuar dhe totalit të zonës së deklaruar në kërkesë-pagesë për një masë është jo më shumë se 0.1 hektarë, zona e përcaktuar konsiderohet e barabartë me zonën e deklaruar.

Nënparagrafi i tretë nuk zbatohet nuk aplikohet kur diferenca është mbi 20% e totalit të zonës së deklaruar për pagesa.

Nëse është vendosur kufi apo tavan për zonën përfituese të mbështetjes, numri i hektarëve të deklaruar në kërkesë-pagesë reduktohet në atë kufi apo tavan.

- (2) Në rastin e parashikuar në nënparagrafin e dytë të paragrafit (1), mbështetja llogaritet mbi bazën e zonës së përcaktuar të reduktuar me dyfishin e diferencës së konstatuar, nëse kjo diferencë tejkalon ose 3%, ose tejkalon dy hektarë, por jo më shumë sesa 20% të zonës së përcaktuar.

Nuk jepet mbështetje nëse diferenca tejkalon 20% të zonës së përcaktuar.

TITULLI 3: DISPOZITA SPECIFIKE PËR T'I DHËNË SHQIPËRISË DETYRA TË ZBATIMIT TË BUXHETIT

Neni 23 Kërkesat kryesore

- (1) Në momentin e dërgimit të kërkesës për t'i dhënë përfituesit detyra të zbatimit të buxhetit, strukturat dhe autoritetet e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit - siç përcaktohet në nenet 10 dhe 11 të Marrëveshjes Kuadër - duhet të kenë organizim administrativ të mirëpërcaktuar dhe sistem verifikimi të brendshëm me një rregullore të brendshme të plotë, përgjegjësi institucionale dhe personale të qarta, që përmbushin kriteret e parashikuara në Shtojcën B të Marrëveshjes Kuadër dhe në Shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me fushat e mëposhtme:

- (a) mjedisi i kontrollit;
- (b) menaxhimi i riskut
- (c) aktivitetet e kontrollit
- (d) informimi dhe komunikimi;
- (e) monitorimi i kuadrit të kontrollit të brendshëm.

Për Autoritetin Menaxhues, nuk aplikohen kriteret e parashikuara në Shtojcën 2 të Marrëveshjes së Financimit dhe në Shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me menaxhimin e riskut, aktivitetet e kontrollit dhe monitorimin e kuadrit të kontrollit të brendshëm.

Roli i Autoriteti Menaxhues në kuadrin e masës "Asistencë Teknike", nëse është i zbatueshëm, përshkruhet në Programin IPARD II.

- (2) Shqipëria mund të përcaktojë kriteret më të hollësishme që kanë parasysh madhësinë, përgjegjësitë dhe veçoritë e tjera specifike të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit.

- (3) Kërkesa për marrjen e detyrave të zbatimit të buxhetit dhe shtojcat mbështetëse i dorëzohet Komisionit pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër dhe kësaj Marrëveshjeje dhe pasi Komisioni miraton vendimin financues që miraton Programin IPARD II.

Neni 24 Përgatitjet për dërgimin e kërkesës për të marrë detyra të zbatimit të buxhetit

(1) Para dërgimit të kërkesës për të marrë detyra të zbatimit të buxhetit, ZKA-ja bindet që Agjencia IPARD dhe modalitetet administrative, kontabël, të pagesave dhe të kontrollit të brendshëm ofrojnë garancitë e mëposhtme:

- (a) pranueshmëria e aplikimeve dhe përputhshmëria me Marrëveshjet verifikohen para se të nënshkruhen kontratat me kërkuarit dhe para se të regjistrohen fondet e alokuara;
- (b) pranueshmëria e kërkesë-pagesave dhe përputhshmëria e tyre me Marrëveshjet verifikohen para se të jepet autorizimi për kryerjen e pagesës;
- (c) fondet e alokuara dhe pagesat e kryera regjistrohen saktë dhe plotësisht në kontabilitet;
- (d) kryhen verifikohet e parashikuara në Marrëveshje;
- (e) dokumentet e kërkuara dorëzohen brenda afatit dhe në formën e parashikuar nga Marrëveshjet apo nga procedurat e miratuara;
- (f) dokumentet mund të gjenden dhe mbahen në mënyrë të tillë që garanton plotësinë, vlefshmërinë dhe lexueshmërinë e tyre me kalimin e kohës, përfshi edhe dokumentet elektronike sipas kuptimit të Marrëveshjeve.

(2) Nëse ZKA-ja nuk është i bindur se struktura menaxhuese dhe struktura operuese respektojnë kriteret e përcaktuara në Shtojcat A dhe B të MK-së si dhe të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje, i drejton instruksione organit përkatës ku specifikon kushtet që duhen përmbushur para se të dërgojnë te Komisioni kërkesën për të marrë detyra zbatimi.

(3) Agjencia IPARD mban dokumentet që justifikojnë pagesat e kryera dhe dokumente në lidhje me kryerjen e verifikimeve të parashikuara administrative dhe fizike. Në rastet kur dokumentet përkatëse mbahen nga zyra vendore apo organe të deleguara, këto zyra apo organe i dërgojnë rregullisht raporte Agjencisë IPARD mbi numrin e verifikimeve të kryera, përmbajtjen e tyre dhe masat e marrë nën dritën e rezultateve.

(4) ZKA-ja garanton që sistemet kontabël të Fondit Kombëtar dhe të Agjencisë IPARD përmbushin parimet kontabël të pranura ndërkombëtarisht.

(5) ZKA-ja bindet që modalitetet administrative dhe të kontrollit të brendshëm të Autoritetet Menaxhues ofrojnë garancitë e mëposhtme:

- (a) dokumentet e kërkuara dorëzohen brenda afatit dhe në formën e parashikuar nga Marrëveshjet apo nga procedurat e miratuara;

(b) dokumentet mund të gjenden dhe mbahen në mënyrë të tillë që garanton plotësinë, vlefshmërinë dhe lexueshmërinë e tyre me kalimin e kohës, përfshi edhe dokumentet elektronike sipas kuptimit të Marrëveshjeve.

(6) Shqyrtimet e nevojshme për qëllimet e nënparagrafit (1) dhe (5) kryhen sipas metodave kryesisht të barasvlershme me standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht.

(7) Kërkesa për marrjen e detyrave të zbatimit të buxhetit i dorëzohet Komisionit, në pajtim me nenin 25. Kërkesa përmban rezultatet e shqyrtimeve të nevojshme për qëllimet e paragrafit (1) dhe (5) të këtij neni.

(8) ZKA-ja garanton që çfarëdo ndryshimi thelbësor në modalitetet e punës të përcaktuara në nenin 7, pika 3, para se të zbatohen, t'i dorëzohet Komisionit, me një kopje për Autoritetin Auditues, për shqyrtim dhe miratim.

Ndryshim thelbësor cilësohet çfarëdo ndryshimi që iu bëhet sistemeve kombëtare përkatëse pas marrjes së detyrave të zbatimit të buxhetit, ndryshime këto që mund të prekin qenësisht strukturat zbatuese dhe sistemet e paraqitura fillimisht si pjesë e kërkesës.

(9) ZKA-ja mban strukturën menaxhuese dhe strukturën operuese nën mbikëqyrje të vazhdueshme, në përputhje me nenin 14, pika 1 të MK-së.

(10) Shqipëria ngre një sistem që garanton njoftimin e menjëhershëm të ZKA, nëse ka informacione që sugjerojnë se struktura menaxhuese apo struktura operuese nuk respektojnë kriteret.

Neni 25 Kërkesa dhe shtojcat mbështetëse

ZKA-ja ia dërgon kërkesën Komisionit për të marrë detyrat e zbatimit të buxhetit sipas nenit 13 të MK-së, bashkë me dokumentet e përcaktuara në Shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje. Një kopje e kësaj kërkesë dhe e dokumenteve mbështetëse i dërgohet Autoritetit Auditues.

SEKSIONI III RREGULLAT E PROGRAMIMIT

Neni 26 Programi IPARD II

Sipas nenit 16, pika 5 të MK-së, masat e zhvillimit rural që i përkasin fushës së bujqësisë dhe zhvillimit rural janë subjekt i një programi që hartohet në nivel kombëtar dhe që përfshin të gjithë periudhën e zbatimit të asistencës IPA II. Programi përgatitet nga autoritetet përkatëse të autorizuar nga Shqipëria dhe i dorëzohet Komisionit pas konsultimit me palët e interesuara. Programet e zhvillimit rural zbatohen nga Shqipëria mbi bazën e menaxhimit indirekt, sipas nenit 58, pika 1, germa c) e Rregullores (BE, EURATOM) nr. 966/2012 dhe përcaktojnë masat që do të financohen prej asistencës IPA II. Tipet e përzgjedhura të masave duhet të kenë natyrë të ngjashme me ato të parashikuara në Rregulloren (BE) nr. 1305/2013.

Neni 27 Masat e Programit IPARD II

(1) Në përputhje me objektivat e përcaktuar në nenin 16, pika 5 të MK-së, programi IPARD II mund të mbështetë masat e mëposhtme për adresimin e prioriteteve tematike të parashtruara në germat (j), (k) dhe (l) të Shtojcës I të MK-së:

- (1) investime në aktive fizike të njësive ekonomike bujqësore;
- (2) mbështetje për ngritjen e grupeve të prodhuesve;
- (3) investime në aktive fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit;
- (4) masa agro-mjedisore-klimatike dhe të bujqësisë organike;
- (5) zbatimi i strategjive të zhvillimit vendor – përfaqësja LEADER;
- (6) investime në infrastrukturën publike rurale;
- (7) diversifikim të fermës dhe zhvillim biznesi;
- (8) përmirësim të trajnimit;
- (9) asistencë teknike;
- (10) shërbime këshillimore;
- (11) pyllëzim dhe mbrojtje të pyjeve.

Informacion i mëtejshëm për masat jepet në Shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD përcaktojnë vlerësimin *ex ante* që duhet bërë verifikueshmërinë dhe kontrollueshmërinë e masave që do të përfshihen në programin IPARD II. Gjithashtu, Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD marrin përsipër vlerësimin e verifikueshmërisë dhe kontrollueshmërisë së masave gjatë zbatimit të programit IPARD II. Vlerësimi *ex ante* dhe vlerësimi gjatë periudhës së zbatimit merr parasysh, sipas rastit, rezultatet e verifikimeve gjatë periudhës së programimit aktuale dhe të mëparshme. Kur nga vlerësimet rezulton se nuk janë përmbushur kërkesat e verifikueshmërisë dhe kontrollueshmërisë, masat në fjalë rregullohen si është e nevojshme.

SEKSIONI IV RREGULLAT E ZBATIMIT

TITULLI 1 RREGULLAT E PËRGJITHSHME DHE PARIMET E ZBATIMIT

Neni 28 Rregullat për prokurimin

(1) Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, autoriteti kontraktues i përcaktuar në nenin 190, pika 2 të Rregullores (BE, Euroatom) nr. 966/2012 është një organ kombëtar i sektorit publik, që është përfituesi i asistencës në kuadrin e programit IPARD II.

Megjithatë, prokurimi publik mund të bëhet për llogari të përfituesit nga një organ kombëtar i sektorit publik që i akordohet posaçërisht kjo detyrë.

(2) Për prokurimet në kuadrin e programeve IPARD II sipas nenit 18, pika 5 të MK-së, e drejta e brendshme konsiderohet e barasvlershme me rregullat e zbatuara prej Komisionit në zbatim të Rregullores (BE, EUROATOM) nr. 966/2012 nëse saktësia e transpozimit konfirmohet nga shërbimi përkatës i Komisionit.

TITULLI 2 TRANSPARENCA DHE VIZIBILITETI

Neni 29 Informimi, publiciteti dhe transparencia

(1) Shqipëria jep informacion dhe bën publicitet të programit IPARD II dhe të kontributit të BE-së, sipas Shtojcës 8. Grupi i synuar për t'u informuar është publiku i gjerë. Informacioni nënvizon rolin e BE-së dhe garanton transparencë të asistencës së BE-së.

(2) Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për:

(a) hartimin e një plani me aktivitetet për vizibilitetin dhe komunikimin, sipas nenit 30;

(b) ngritjen e një faqeje interneti apo portali interneti që jep informacion dhe akses në programin IPARD II të Shqipërisë, përfshi informacion për afatet e zbatimit të programimit dhe çdo proces konsultimi publik për këtë qëllim;

(c) informimin e përfituesve potencialë për mundësitë e financimit që ofron programi IPARD II.

(3) Me qëllim që të garantohet transparencia për mbështetjen e IPARD, Agjencia IPARD është përgjegjëse për publikimin e listës së operacioneve dhe përfituesve të asistencës IPA II, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 23, pika 2 të MK-së.

Publikimi bëhet në format Excel, që mundëson ndarjen, kërkimin, nxjerrjen, krahasimin dhe publikimin e lehtë në internet të të dhënave, për shembull në format CSV apo XML. Lista e operacioneve duhet të

gjendet në faqen e internetit apo në portalin e internetit. Informacioni minimal që duhet të përmbajë lista e operacioneve është përcaktuar në Shtojcën 8 të kësaj Marrëveshjeje.

(4) Lista e operacioneve dhe përfituesve përditësohet të paktën çdo gjashtë muaj.

(5) Agjencia IPARD informon përfituesit e asistencës IPARD II për kontributin e BE-së.

(6) Sipas nenit 23, pika 3 të MK-së, vetëm njoftimet për tendera për kontrata publike që janë subjekt i procedurës “ftesë për tender i hapur ndërkombëtar” përgatiten dhe i dërgohen Komisionit për publikim.

Neni 30 Vizibiliteti dhe komunikimi

(1) Aktivitetet për informim dhe publicitet nga Shqipëria për asistencën e dhënë në kuadrin e programit IPARD, sipas nenit 24 të MK-së, zbatohen mbi bazën e një plani me masa vizibilitetit dhe komunikimi që miratohet bashkërisht nga Autoriteti Menaxhues dhe Komisioni. Plani me masa vizibiliteti dhe komunikimi miratohet nga komiteti monitorues i IPARD II, jo më vonë se një vit nga miratimi i programit IPARD II nga Komisioni, dhe përcakton:

- (a) qëllimet dhe grupet e synuara;
- (b) përmbajtjen dhe strategjinë e masave të komunikimit dhe informimit, duke përcaktuar masat që do të ndërmerren;
- (c) buxhetin indikativ të planit;
- (d) departamentet administrative apo organet përgjegjëse për zbatimin e tij;
- (e) kriteret për vlerësimin e ndikimit që kanë masat e informimit dhe publicitetit, në lidhje me transparencën, ndërgjegjësimin rreth programeve IPARD II dhe rolin që luan BE-ja.

Ky plan që mbulon tërë periudhën e programit IPARD II zbatohet mbi bazën e një liste vjetore masash.

(2) Shuma e akorduar për informimin dhe publicitetin mund të jetë pjesë e masave të asistencës teknike të programit IPARD II.

(3) Në mbledhjet e komitetit monitorues të IPARD II, kryetari raportin mbi ecurinë e zbatimit të aktiviteteve të zbatimit dhe informimit, si dhe u paraqet anëtarëve të komitetit shembuj të këtyre aktiviteteve.

(4) Nëse zbatimi i këtij neni kërkon aktivitete specifike zbatimi dhe publiciteti në nivel projekti, këto aktivitete janë përgjegjësi e përfituesve të asistencës IPA II dhe financohet nga shuma e akorduar për projektin përkatës.

SEKSIONI V RREGULLAT E MENAXHIMIT FINANCIAR TË ASISTENCËS IPA II

TITULLI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 31 Rregulla të përgjithshme për asistencën financiare

(1) Shqipëria bashkëfinancon të gjitha aktivitetet që marrin asistencë prej programit IPARD II. Nëse ekzekutimi i aktiviteteve varet nga kontributi financiar prej burimeve vetjake të Shqipërisë apo nga burime të tjera financimi, financimi nga BE-ja bëhet i disponueshëm në momentin kur ky kontribut financiar i Shqipërisë dhe/ose nga burime të financimit bëhet i disponueshëm. Megjithatë, nëse përfituesit i përkasin sektorit publik, kontributi i BE-së mund të jepet më vonë sesa ai i organeve publike të tjera. Në asnjë rast, kontributi i BE-së nuk jepet para kontributit të organeve publike të Shqipërisë.

(2) Kontributi i BE-së bashkëfinancon shpenzimet publike që i janë paguar përfituesit.

(3) Financimi i BE-së është objekt i përmbushjes nga Shqipëria të detyrimeve të përcaktuara në Marrëveshje dhe në Marrëveshjen e Financimit, sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

(4) Llogaria në euro e hapur nga Fondi Kombëtar për llogari të Shqipërisë, sipas nenit 33, pika 6 të MK-së, bashkë me interesat e gjeneruara nga kjo llogari, nuk i nënshtrohet taksave apo tarifave të tjera

(5) Shqipëria i përcjell Komisionit një kampion të firmave të gjithë aktorëve të përfshirë në kërkesë-pagesë që do të paguhet prej BE-së, siç përcaktohet në nenin 37 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 32 Intensiteti i ndihmës dhe norma e kontributit të BE-së

- (1) Për qëllime të programit IPARD II, kontributi i BE-së i parashikuar në nenin 30, pika 2 të MK-së, llogaritet në raport me shpenzimet e pranueshme.
- (2) Intensiteti i ndihmës dhe norma e kontributit të BE-së llogaritet në përputhje me normat dhe tavanet e përcaktuara në Shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje.
- (3) Për llogaritjen e pjesës së shpenzimeve publike si përqindje e kostot totale të pranueshme të investimit, merret parasysh ndihma kombëtare për të lehtësuar aksesin në huamarrje.

TITULLI 2: PRANUESHMËRIA

Neni 33 Pranueshmëria e shpenzimeve

(1) Çdo kontratë apo shtesë e nënshkruar ose shpenzime të bëra nga përfituesit dhe pagesat e kryera nga Shqipëria Para nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit, nuk janë të pranueshme për financim prej programit IPARD II.

Nënparagrafi i parë nuk zbatohet për masat në kuadër të Asistencës Teknike dhe shpenzimet që lidhen me aktivitete të përcaktuara në paragrafin (5), pika c), në rastet kur shpenzimet janë bërë prej përfituesve para 1 janarit 2014.

(2) Shqipëria i përcjell Komisionit listën e shpenzimeve të pranueshme për çdo masë. Komisioni njofton Shqipërinë që pranon listën, ose i përcjell komentet e veta.

(3) Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme për programin IPARD II:

- a) taksat, përfshi taksat mbi vlerën e shtuar;
- b) detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo detyrim tjetër;
- c) blerjet, dhëniet me qira ose me kredi të truallit dhe godinave ekzistuese, pavarësisht nëse qiradhënia rezulton në transferim të pronësisë te përfituesit të qerasë, përveç se kur parashikohet prej dispozitave të programit IPARD II;
- d) gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;
- e) kostot operacionale;
- f) makineri dhe pajisje të përdorura;
- g) detyrime bankare, kostot për vënie garancie dhe detyrime të ngjashme;
- h) kostot për shkëmbime, detyrime dhe humbje të llogarisë në euro për IPARD, si edhe shpenzime të tjera tërësisht financiare;
- i) kontribute në natyrë;
- j) blerja e të drejtave të prodhimit bujqësor, kafshëve, bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre;

- k) çfarëdo kosto mirëmbajtjeje, zhvlerësimi dhe kosto qiramarrjeje, përveç se kur justifikohet siç duhet nga natyra e masës në programin IPARD II;
- l) kosto dhe pagesa të bëra nga administrata publike në menaxhimin dhe zbatimin e asistencës, përfshi ato të strukturës menaxhuese dhe strukturës operuese dhe, në veçanti, shpenzimet administrative, qiratë dhe pagat e personelit të punësuar për aktivitetet e menaxhimit, zbatimin, monitorimit dhe kontrollit, përveç se kur justifikohet siç duhet nga natyra e masës në programin IPARD II.

(4) Përveç se kur Komisioni shprehet dhe vendos qartësisht ndryshe, edhe shpenzimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme:

- a) shpenzimet për projekte që, para përfundimit, u kanë ngarkuar tarifa përdoruesve apo disa përfituesve, përveç rasteve kur tarifat e arkëtuara janë zbritur nga kostot e pretenduara;
- b) kostot promovionale, përveç atyre për interesin kolektiv;
- c) shpenzimet e bëra nga një përfitues, kapitali i të cilit zotërohet mbi 25% nga një apo disa organe publike, përveç se kur Komisioni e ka miratuar në një rast specifik mbi bazën e një kërkesë të argumentuar plotësisht nga Shqipëria. Komisioni e merr vendimin brenda tre muajsh nga marrja e kërkesës. Ky përjashtim nuk aplikohet për shpenzimet në infrastrukturë, përqasjen LEADER apo kapitelin njerëzor.

(5) Pa cenuar paragrafët (2) dhe (3), në rastin e investimeve:

- a) ndërtimi ose përmirësimi i pasurive të paluajtshme është i pranueshëm, deri në vlerën e tregut të aktivitetit, siç përcaktohet në nenin 11, pika 2, germa f) dhe në nenin 11, pika 3 dhe germa d);
- b) blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja, përfshi softuerët kompjuterikë, është e pranueshme, deri në vlerën e tregut të aktivitetit, siç përcaktohet në nenin 11, pika 2, germa f) dhe në nenin 11, pika 3, germa d);
- c) kostot e përgjithshme që lidhen me shpenzimet e përcaktuara në pikat a) dhe b) siç janë tarifat e arkitektëve, inxhinierëve dhe konsulencave të tjera dhe studimeve të fizibilitetit janë të pranueshme deri në tavanin prej 12% të kostove të përcaktuara në pikat a) dhe b) nën këto kushte;
 - i) shuma e pranueshme e kostove të përgjithshme nuk duhet të tejkalojë kostot e arsyeshme të përcaktuara, siç përcaktohet në nenin 11, pika 2, germa f) dhe në nenin 11, pika 3, germa d);
 - ii) për projektet me shpenzime të pranueshme të investimeve të përcaktuara në pikat a) dhe b) prej mbi 3 milion EURO, kostot e përgatitjes së planit të biznesit nuk duhet të tejkalojnë 3% të shpenzimeve të pranueshme të këtyre investimeve;
 - iii) për projektet me shpenzime të pranueshme të investimeve të përcaktuara në pikat a) dhe b) prej të paktën 1 milion EURO por jo më shumë se 3 milion EURO, kostot e përgatitjes së planit të biznesit nuk duhet të tejkalojnë 4% të shpenzimeve të pranueshme të këtyre investimeve;

- iv) për projektet me shpenzime të pranueshme të investimeve të përcaktuara në pikat a) dhe b) prej më pak se 1 milion EURO, kostot e përgatitjes së planit të biznesit nuk duhet të tejkalojnë 5% të shpenzimeve të pranueshme të këtyre investimeve.

Dispozitat e hollësishme në lidhje me shumën maksimale të pranueshme që parashikohet në këtë paragraf, përcaktohen në programin IPARD II mbi bazën e një vlerësimi të nivelit të kostove për masa të ngjashme në Shqipëri.

(6) Për qëllime të nenit 31, germa b) të MK-së, modifikime thelbësore të një projekti janë ato që rezultojnë në:

- a) ndërprerjen apo zhvendosjen e një aktiviteti prodhues jashtë zonës gjeografike të mbuluar prej programit IPARD II;
- b) ndryshim të pronësisë që i jep avantazh të padrejtë një firme apo organi publik;
- c) ndryshim thelbësor që prek natyrën, objektivat apo kushtet e zbatimit, që çojnë në cenimin e objektivave fillestarë.

Nëse një modifikim i tillë zbulohet nga Shqipëria, ky i fundit informon menjëherë Komisionin dhe fillon rikuperimin e kontributit IPARD II sipas nenit 50, pika 1 të kësaj Marrëveshjeje.

(7) ZKA-ja mban përgjegjësinë e përgjithshme dhe detyrimin për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve përkatëse, si dhe aplikon rregullimet financiar sipas nenit 42 të MK-së. Në rast se Komisioni vendos se shpenzimet e deklaruara nuk janë plotësisht në përputhje me Marrëveshjet dhe veçanërisht me parimet e përcaktuara në këtë nen, vlerëson shumat që duhen përjashtuar nga financimi i BE-së sipas nenit 49 të kësaj Marrëveshjeje.

TITULLI 3: FINANCIMI DHE PAGESAT

Neni 34 Anulimi i fondeve të papërdorura

(1) Komisioni automatikisht anulon çdo pjesë të fondit buxhetor të akorduar për programin IPARD II që, deri më 31 dhjetor të vitit të tretë pas vitit buxhetor kur është akorduar, më poshtë e referuar si “n+3”, nuk është përdorur për qëllimin e parafinancimit sipas nenit 38 të Marrëveshjes apo për bërjen e pagesave të ndërmjetme sipas nenit 37 të kësaj Marrëveshjeje, ose për të cilën ZKA-ja - të cilit i janë dhënë detyra të zbatimit të buxhetit - nuk ka paraqitur kërkesë-pagesë që përfshin një deklaratë shpenzimesh të certifikuar sipas nenit 35, pika 1 të MK-së dhe nenit 37, pika 1 të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Në rastet e justifikuara siç duhet, me pëlqimin e Komisionit, kjo periudhë prej tre vitesh e përcaktuar në paragrafin (1) mund të zgjerohet deri në pesë vite në Marrëveshjen e Financimit që parashikohet në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

(3) Jo më vonë se fundi i muajit mars të vitit aktual financiar, Komisioni informon Shqipërinë për çdo risk anulimi fondesh nisur nga informacioni i marrë prej Shqipërisë, sipas nenit 33, pika 3 të MK-së dhe mbi bazën e nevojës për marrjen e vendimeve për korrigjimin e kësaj situatë.

(4) Bazuar në kërkesë-pagesat që Shqipëria dorëzon sipas nenit 37, pika 4, germat b) dhe c), Komisioni sërish informon Shqipërinë në kohën e duhur për çdo risk anulimi automatik fondesh.

(5) Pas marrjes së kërkesë-pagesës së përcaktuar në nenin 37, pika 4, germat d), në janarin e vitit pas vitit n+3, Komisioni informon Shqipërinë për shumën që preket nga rregulli i anulimit automatik, mbi bazën e informacioni që ka në dispozicion Komisioni.

(6) Deri në fund të marsit të vitit pas vitit n+3, Komisioni i përcjell një letër Shqipërisë ku i kërkon të konfirmojë shumën që preket nga rregulli i anulimit automatik, ose të dërgojë brenda dy muajsh komente në lidhje me letrën bashkë me planin e financimit të rishikuar.

Neni 35 Plani i financimit për programin IPARD II

(1) Plani i financimit i programit IPARD II përcakton, në veçanti, shumën maksimale të kontributit të BE-së, ndarjen e tij për çdo vit, normat e bashkëfinancimit të zbatueshme për çdo masë dhe, për qëllime të monitorimit të Programimit, ndarjen sipas masave.

(2) Agjencia IPARD fillon kontraktimin dhe kryerjen e pagesave vetëm pasi programi IPARD II të miratohet nga Komisioni dhe pasi të hyjë në fuqi Marrëveshja e Financimit e përcaktuar në nenin 3, bashkë me dhënien e detyrave të zbatimit të buxhetit.

Neni 36 Pagimi i kontributit të BE-së

(1) Objekt i bashkëfinancimit nga BE-ja është vetëm asistenca e dhënë nga programi IPARD II sipas marrëveshjes dhe e paguar nga Agjencia IPARD.

(2) Në zbatim të dispozitave të çdo mase të programit dhe për opsionet me thjeshtim të kostove sipas pikave b), c) dhe d) dhe siç përcakton Agjencia IPARD para thirrjes për aplikime, pagesat që bën Komisioni nga kontributi i BE-së mbulojnë:

- a) kostot e pranueshme të paguara prej përfituesve;
- b) kostot e njësisë standard;
- c) shuma të plota që nuk tejkalojnë 100 000 EURO, për përfitues, për vit, të kontributit publik;
- d) financim me normë fikse, e përcaktuar nga aplikimi i një përqindjeje ndaj një apo disa kategori kostosh.

(3) Nëse ndihma jepet në bazë të opsioneve të kostove të thjeshtuara sipas paragrafëve (2) pikat b), c) dhe d) ose kostove shtesë dhe mosrealizim të të ardhurave, Shqipëria garanton që llogaritjet përkatëse janë të mjaftueshme dhe të sakta dhe të bëra paraprakisht mbi bazë të drejtë, të barabartë dhe të verifikueshme. Për këtë qëllim, duhet konfirmimi për mjaftueshmërinë dhe saktësinë e llogaritjeve nga një organ funksionalisht i pavarur nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e programit IPARD II dhe që zotëron ekspertizën e duhur. Për qëllime informimi, dokumentet përkatëse i vihen në dispozicion Komisionit para zbatimit të opsioneve të kostove të thjeshtuara.

(4) Pagesat e kontributit të BE-së nga Komisioni bëhen brenda kufijve të fondeve në dispozicion, sipas Marrëveshjes së Financimit të përmendur në nenin 3. Çdo pagesë autorizohet për kërkesë-pagesat më të vjetra që janë bërë për programin IPARD II.

(5) Totali i parafinancimit dhe i pagesave të ndërmjetme nuk duhet të tejkalojë 95% të kontributit të BE-së, siç parashikohet në tabelën e financimit të programit IPARD II.

(6) Nëse arrihet tavan i përcaktuar në paragrafin (5), ZKA-ja vazhdon t'i përcjellë Komisionit kërkesë-pagesat bashkë me deklaratën e shpenzimeve të certifikuar sipas nenit 37, si edhe informacion mbi shumat e mbuluara.

(7) Shpenzimet e paguara nga përfituesit duhet të mbështeten me faturat përkatëse, ose dokumente kontabël që vërtetojnë pagesën. Nëse asistenca nuk është funksion i shpenzimeve, mund të pranohen

dokumente të tjera të përshtatshme që specifikohen në programin IPARD II. Në çdo rast, shpenzimet duhet të certifikohen prej ZKA-së.

NENI 37 KËRKESË-PAGESAT NGA SHQIPËRIA

(1) Kërkesë-pagesat për programin IPARD II bëhen nga ZKA-ja. Këto kërkesa duhet të kenë deklaratat e shpenzimeve të certifikuara, siç përcakton Klauzola 2, pika 3 e Shtojcës A të MK-së dhe mbulojnë, për çdo masë të programit IPARD II, shumën e pranueshme të shpenzimeve publike për të cilën Agjencia IPARD ka paguar kontributin përkatës të BE-së gjatë periudhës referuese.

(2) Kërkesë-pagesat hartohen sipas modelit në Shtojcën 5. Ato duhet të jenë të firmosura dhe të certifikuara, dhe ZKA-ja ia përcjell Komisionit për llogari të Shqipërisë, duke i dërguar kopje edhe Autoritetit Auditues.

(3) Në mbyllje të programit, ZKA-ja përgatit një deklaratë përfundimtare të shpenzimeve.

(4) Sapo përmbushen kushtet e nenit 35, pika 2, Shqipëria i dorëzon Komisionit kërkesë-pagesat e veta brenda afateve të mëposhtme:

- a) deri maksimumi më 30 prill, në rastin e shpenzimeve në periudhën 1 janar – 31 mars;
- b) deri maksimumi më 31 korrik, në rastin e shpenzimeve në periudhën 1 prill – 30 qershor;
- c) deri maksimumi më 31 tetor, në rastin e shpenzimeve në periudhën 1 korrik – 30 shtator;
- d) deri maksimumi më 31 janar, në rastin e shpenzimeve në periudhën 1 tetor – 31 dhjetor.

Shqipëria mund të modifikojë të dhënat e deklaruara në kërkesë-pagesa në deklaratën vjetore të shpenzimeve që dorëzohet deri më 15 shkurt të vitit financiar pas vitit në të cilin është bërë shpenzimi. Në raste të justifikuara siç duhet, Komisioni mund të lejojë Shqipërinë që, në deklaratën përfundimtare të shpenzimeve, të deklarojë shpenzime nga vite financiare të mëparshme, sipas paragrafit (3). Shpenzime nga vite financiare të mëparshme duhet të shoqërohen me një opinion dhe raportin e Autoritetit Auditues dhe përfshirja e tyre në deklaratën përfundimtare nuk cenon pranimin e vendimeve për llogaritë, në zbatim të neneve 48 dhe 49.

Kërkesat dërgohen edhe për rastet kur nuk kërkohet rimbursim.

(5) Shqipëria duhet të japë informacion shtesë kur ka mosmarrëveshje, apo diferenca në interpretim apo në lidhje me kërkesë-pagesat për një periudhë referuese, që rezultojnë veçanërisht nga mospërcjellja e informacionit të kërkuar në Marrëveshjet dhe këto kërkojnë kontrolle shtesë. Ky informacion jepet në zbatim të nenit 33 të MK-së dhe nenet 38 dhe 40 të Marrëveshjes.

Afati për pagesën i përcaktuar në paragrafin (6) mundet, në raste të tilla, të ndërpritet për të gjithë apo një pjesë të shumës që kërkohet rimbursim, dhe kjo ndërprerje përfshin periudhën nga data kur është dërguar kërkesë për informacion deri në marrjen e informacionit të kërkuar.

Nëse nuk gjendet një zgjidhje gjatë këtij afati, Komisioni mund të ndërpresë apo të pezullojë pagesat në zbatim të neneve 39 dhe 40 të MK-së.

(6) Pagesat e ndërmjetme bëhen prej Komisionit brenda 90 ditësh nga regjistrimi i kërkesë-pagesës për të cilën janë përmbushur kërkesat e parashikuara në nenin 35 të MK-së, pa cenuar vendimet e përcaktuara në nenet 48 dhe 49 të kësaj Marrëveshjeje, me kusht që:

- a) shpenzimet e deklaruara të jenë të pranueshme për financim nga BE-ja, sipas nenit 33 të kësaj Marrëveshjeje;
- b) kontrollet në nenin 41 të kësaj Marrëveshjeje nuk kanë konstatuar ndonjë problem;
- c) nuk është vendosur ndërprerje apo pezullim i pagesave në lidhje me masa që janë objekt i aplikimit në fjalë;
- d) ka fonde në dispozicion.

Neni 38 Parafinancimi

(1) Pagesat e parafinancimit të përcaktuara në nenin 34 të MK-së mund të arrijnë në 30% të kontributit të BE-së për tre vitet më të fundit të programit IPARD II, siç parashikon Marrëveshja e Financimit. Parafinancimi mund të paguhet në dy apo më shumë këste, me kusht që të ketë fonde buxhetore në dispozicion.

(2) Komisioni bën një pagesë fillestare parafinancimi, si kështu i parë, që është të paktën sa 50% e shumës së përcaktuar në paragrafin (1).

Këste shtesë mund të paguhet mbi bazën e kërkesës së Shqipërisë, në zbatim të kërkesave që parashikojnë paragrafët (1) dhe(4).

(3) Nëse pagesat e parafinancimit të parashikuara në paragrafin (1) mund të rriten, nëse nuk janë të mjaftueshme për të garantuar pagimin në kohë të kërkesë-pagesave të përfituesve. Kjo rritje bëhet deri në shumën e nevojshme për këtë qëllim. Ajo bazohet në shumën e shpenzimeve të vërtetuara që kanë bërë përfituesit, por që nuk janë shlyer akoma për shkak të mbarimit të fondeve të BE-së në llogarinë IPARD në euro. Sidoqoftë, shuma kumulative e pagesave për parafinancimit nuk duhet të tejkalojë 30% të kontributit të BE-së për tre vitet më të fundit të përcaktuara prej Marrëveshjes së Financimit.

(4) Shuma totale e paguar si parafinancim i rimbursohet Komisionit, nëse nuk dorëzohet asnjë kërkesë-pagesë për programin IPARD II brenda 15 muajsh nga data kur Komisioni ka bërë të parën pagesë të parafinancimit. Kontributi i BE-së për programin IPARD II nuk cenohet nga rimbursimi i tillë.

Neni 39 Llogaritja e shumës që duhet të paguhet

(1) Kontributi i BE-së që paguhet në lidhje me shpenzimet publike të pranueshme të deklaruara për secilën masë dhe për çdo periudhë referuese llogaritet në bazë të planit të financimit në fuqi në ditën e parë të asaj periudhe.

(2) Shumat e kontributit të BE-së që rikuperohen prej përfituesve në kuadrin e programit IPARD II gjatë secilës periudhë referuese dhe borxhet që nuk janë mbledhur brenda dy vitesh nga regjistrimi i tyre në librin kontabël, siç parashikon neni 47, pika 6 e kësaj Marrëveshjeje dhe Klauzola 4(3)(b)(ix) e Shtojcës A të MK-së, zbriten nga shuma që duhet të paguajë Komisioni në kërkesë-pagesën për atë periudhë, në zbatim të nenit 50 të kësaj Marrëveshjeje.

(3) Pa cenuar tavanin 95% siç parashikohet në nenin 36, pika 5, kur totali i shpenzimeve tejkalon totalin e programuar për një masë të caktuar, paguhet maksimumi i shumës që është programuar për atë masë në planin e financimit në fuqi. Shpenzimet e përjashtuara si rezultat i kësaj, mund të merren parasysh në një kërkesë-pagesë pasuese, me kusht që Shqipëria të dorëzojë pranë Komisionit një plan financimi të modifikuar dhe ky i fundit ta ketë pranuar.

Neni 40 Pagimi i bilancit përfundimtar

(1) Për pagimin e bilancit përfundimtar të përcaktuar në nenin 37 të MK-së, zbatohet afati i përcaktuar në nenin 34, pika 2 të kësaj Marrëveshjeje, siç parashikon Marrëveshja e Financimit.

(2) Pagimi i bilancit përfundimtar nuk cenon miratimin e vendimeve pasuese në zbatim të nenit 49.

(3) Pagimi nuk cenon as ndjekjen e dispozitave të nenit 41, pika 4, nenit 44 dhe nenit 50.

(4) Pas dërgimit të kërkesë-pagesës së fundit Komisionit, Shqipëria nuk mund të bëjë më transaksione financiare me llogarinë IPARD në euro. Shqipëria garanton respektimin e kërkesave të përcaktuara në nenin 37, pika 1 të MK-së, deri në përmbushjen e kërkesave të parashtruara në nenin 44 të Marrëveshjes. Për sa i përket nenit 50 të kësaj Marrëveshjeje, i jepet informacion Komisionit kurdo që shumat e rikuperuara regjistrohen në llogaritë kombëtare.

(5) Shqipëria ngre një sistem i mundëson ndjekjen e zbatimit të kërkesave të paragrafit (4). Shqipëria identifikon organin përgjegjës dhe informon Komisionin për modalitetet praktike në lidhje me transferimin e përgjegjësve këtij organi.

Neni 41 Pagesat që iu bëhen përfituesve

(1) Shqipëria garanton që pagesat iu bëhen përfituesve:

- a) në monedhën kombëtare dhe përmes llogarisë IPARD në euro. Si rregull, urdhër-pagesat apo çdo dokument tjetër që vërteton se përfituesi(t) apo të autorizuarit e tij/e tyre lëshohen brenda tre ditëve pune të kësaj debie;
- b) bazuar në deklaratat e shpenzimeve që përfituesi ka bërë dhe të evidentuara me fatura origjinale. Nëse asistenca nuk është funksion i shpenzimeve, mund të pranohen dokumente të tjera të përshtatshme që specifikohen në programin IPARD II.

(2) Shpenzimet janë të pranueshme kur përmbushin kërkesat e nenit 33, pika 1.

(3) Pagesat bëhen me transfertë bankare te llogaria në emër të përfituesit. Pagesat për përfituesit nuk mund të konfiskohen, bllokohen ose rregullohen në asnjë mënyrë në vend të detyrimit të borxhit të një marrësit. **Agjencia IPARD mund që/ edhe të vendos pezullimin e pagesave, per çdo shumë të mbuluar nga përfituesi që lidhen me asistencën financiare në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit.**

(4) Nëse Agjencia IPARD merr fatura origjinale dhe dokumente të tjera të përcaktuara në paragrafin (1), pika b) por nuk i mban ato, Agjencia IPARD sigurohet që të mbajë kopjet dhe që origjinalet do të vihen në dispozicion për qëllime auditi dhe inspektimi.

(5) ZKA-ja dhe Agjencia IPARD garantojnë që totali i shpenzimeve publike të të gjitha organeve publike të Shqipërisë për çdo masë dhe projekt të jenë të identifikueshme në llogaritë kontabël të Agjencisë IPARD.

(6) Agjencia IPARD ruan të dhënat për secilën pagesë ku duhet të ketë informacion të paktën mbi:

- a) shumën në monedhën kombëtare;
- b) shumën e barasvlershme në euro.

(7) Raporti i kontributit të BE-së dhe kontributit kombëtar ndaj shpenzimeve publike, si edhe i totalit të shpenzimeve publike ndaj totalit të shpenzimeve të pranueshme, llogaritet në monedhën kombëtare.

(8) ZKA-ja dhe Agjencia IPARD garantojnë se çdo shumë që është paguar më tepër sesa duhet dhe që është përfshirë në deklaratat e shpenzimeve të certifikuara sipas nenit 37, të transferohen brenda dhjetë ditë pune në llogarinë IPARD në Euro dhe të zbriten nga kërkesë-pagesa e radhës që i dorëzohet Komisionit.

(9) ZKA-ja dhe Agjencia IPARD garantojnë trajtimin në kohë të kërkesë-pagesave që marrin prej përfituesve. Në rastet kur intervali ndërmjet marrjes së kërkesë-pagesës dhe nxjerrjes së urdhër-pagesës tejkalon 6 muaj, bashkëfinancimi i BE-së mund të reduktohet sipas këtyre rregullave:

- a) nëse shpenzimet e kryera pas afatit janë jo më shumë se 4% të shpenzimeve të kryera para afatit, nuk bëhen reduktimi, pavarësisht se sa muaj është vonesa;
- b) kur shpenzimet e kryera pas afatit janë më shumë se 4% të shpenzimeve të kryera para afatit, të gjitha shpenzimet e mëtejshme të kryera me vonesë deri në:

- i) një muaj, reduktohen me 10%;
- ii) dy muaj, reduktohen me 25%;
- iii) tre muaj, reduktohen me 45%;
- iv) katër muaj, reduktohen me 70%;

v) pesë muaj ose më shumë, reduktohen me 100%.

Për qëllime të këtij paragrafi, marrja e kërkesë-pagesës konsiderohet data kur kërkesë-pagesa e bërë prej përfituesit merret nga shërbimet përkatëse të Shqipërisë, pavarësisht nëse kërkesë-pagesave, në momentin e marrjes, ka të gjithë dokumentet mbështetëse të nevojshme për bërjen e pagesave. Agjencia IPARD miraton procedurat që garantojnë se dokumentet e munguara të merren prej përfituesve në kohë për pagesën që bëhet në zbatim të nënparagrafit të parë.

Komisioni mund të aplikojë shkallë kohore të ndryshme dhe/ose reduktime më të ulëta apo zero, nëse për masa të caktuara konstatohen kushte menaxhimi të jashtëzakonshme, apo nëse Shqipëria jep justifikime të mirë-bazuara. Vonesat e përfituesve në dorëzimin e dokumenteve që mungojnë në kërkesë-pagesë nuk konsiderohet justifikim i mirë-bazuar. Shqipëria parashikon dispozitat e përshtatshme në kontratat e nënshkruara me përfituesit, ku të përcaktohen afatet e përshtatshme për dorëzimin e dokumenteve që mungojnë.

Para marrjes së vendimit, Komisioni informon Shqipërinë, duke i mundësuar që të japë argumentet e veta brenda 10 ditësh pune. Komisioni informon Shqipërinë për vendimin përfundimtar që ka marrë, ku shpreh arsyetimin mbi të cilin është bazuar vendimi.

Për çdo shpenzim të kryer pas afateve, Shqipëria i dorëzon Komisionit një justifikim të hollësishëm të vonesës, evidenca të shkruara për të mbështetur këtë justifikim, si edhe një demonstrim të marrëdhënies së drejtpërdrejtë ndërmjet justifikimit dhe shpenzimit përkatës të kryer pas afatit.

(10) Gjatë marrjes së vendimit për anulimin e plotë apo të pjesshëm të kontributit të BE-së, ZKA-ja dhe Agjencia IPARD mbajnë parasysh natyrën e parregullsisë, sa e rëndë është ajo si edhe humbjen financiare që i është shkaktuar kontributit të BE-së.

Neni 42 Kursi i këmbimit dhe interesat

(1) Shqipëria garanton që kursi i këmbimit ndërmjet euros dhe monedhës kombëtare të regjistruar në kontabilitet është kursi kontabël mujor i euros i përcaktuar prej Komisionit për Shqipërinë në muajin gjatë të cilit shpenzimi është regjistruar në kontabilitetin e strukturës operuese. Megjithatë, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme:

- a) për pagesat e Agjencisë IPARD, data e treguar në kontabilitet është data kur urdhër-pagesa i është lëshuar përfituesit;
- b) për pagesat më tepër sesa duhet nga Agjencia IPARD siç parashikon neni 41, pika 8, norma e muajit që i paraprin muajit gjatë të cilit është vënë re fillimisht se është paguar më shumë;
- c) për borxhe ende të parikuperuara, si edhe borxhe që nuk janë shlyer brenda dy viteve nga regjistrimi i librit kontabël të debitorëve sipas nenit 50, norma e muajit që i paraprin muajit gjatë të cilit është vënë re borxhi fillimisht;
- d) për shumat e fiksuara nga auditi i llogarive dhe/ose vendimet për audit konformiteti, norma e muajit që i paraprin muajit në të cilën është marrë Vendimi;
- e) për borxhet dhe interesin e rikuperuar sipas nenit 50, norma e muajit që i paraprin muajit gjatë të cilit është rikuperuar borxhi;
- f) për shuma të parregullta të rikuperuara sipas nenit 51 të MK-së, norma e muajit që i paraprin muajit në të cilën është rikuperuar shuma;
- g) për interesat e fituara në llogaritë e Fondit Kombëtar dhe të Agjencisë IPARD, norma e muajit kur është interesi është kredituar në llogaritë, që duhet të jetë të paktën mujore.
- h) për kufijtë e shkruara në Euro në programin IPARD II për çdo masë, kursi i këmbimit për konvertimin midis Euros dhe monedhës kombëtare do të jetë norma mujore e kontabilitetit të Euros të përcaktuar nga Komisioni për Shqipërinë për muajin paraprak muaji të cilit është bërë thirrja për aplikim.

Pikat (a) deri (h) janë të zbatueshme edhe për rastet e parashikuara në nenin 33, pika 8 të MK-së.

(2) Nëse norma për një muaj nuk publikohet, përdoret norma për muajin më të fundit për të cilin është publikuar.

(3) Nëse nuk respektohen afatet që përcaktojnë Vendimet e marra sipas neneve 48 dhe 49, çdo shumë e prapambetur gjeneron interes me normën e barabartë me atë të Euriborit për depozitat tremujore të publikuara nga Banka Qendrore Europiane plus 1.5 pikë përqindje. Si normë merret mesatarja mujore e muajit në të cilën janë marrë këto Vendime.

(4) Çfarëdo interesi i gjeneruar nga llogaria IPARD në Euro i përket Shqipërisë. Interesat e gjeneruara nga financimi i programit IPARD II prej BE-së i bashkëngjiten ekskluzivisht programit IPARD II dhe konsiderohen burim për Shqipërinë në formën e kontributit publik kombëtar dhe i deklarohen Komisionit në momentin e mbylljes së programit IPARD II. Në momentin e mbylljes së Programit, çdo interes që nuk është harxhuar në formën e kontributit publik kombëtar i kthehet Komisionit.

TITULLI 4 MBYLLJA E PROGRAMIT

Neni 43 Mbyllja e programit IPARD II

(1) Përveç kërkesave minimale për pagimin e bilancit përfundimtar të parashikuara në nenin 37, pika 1 të MK-së, programi IPARD II konsiderohet i mbyllur për qëllimet e nenit 48 të MK-së, sapo përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

- a) bazuar në pranimin e llogarive të vitit të fundit në fjalë dhe të totalit të viteve të zbatimit të IPARD II, pagimi i bilancit përfundimtar ose lëshimi i një urdhri rikuperimi prej Komisionit;
- b) Komisioni anulon fondet;
- c) mbyllet libri kontabël i debitorëve përcaktuar në Klauzolën 4(3)(b)(ix) të Shtojcës A të MK-së dhe nenin 47, pika 6 dhe nenit 50, pika 6 të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Mbyllja e programit IPARD II nuk prek detyrimet e Shqipërisë të përcaktuara në nenin 41, pika 9 dhe në nenin 50, dhe as detyrimin për të ruajtur dokumentet, sipas nenit 44, dhe nuk cenon një vendim pasues sipas nenit 49.

Neni 44 Ruajtja e dokumenteve

(1) Agjencia IPARD dhe Fondi Kombëtar garantojnë se nëse nuk i ruajnë vetë dokumentet e përcaktuara në nenin 49 të MK-së, ato të mbahen në dispozicion të Komisionit për periudhën e referuar në atë nen. Në rastin e situatave të parashikuara në nenin 43 të MK-së, dokumentet mbështetëse që parashikon neni 49 i MK-së mbahen në dispozicion të Komisionit për të paktën shtatë vite pas vitit kur shumat janë rikuperuar plotësisht prej përfituesve dhe janë kredituar në programin IPARD II, apo në të cilin pasojat financiare të mosrikuperimit shprehen në nenin 50 të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Në rastin e procedurës së verifikimit të konformitetit që parashikon neni 49 i Marrëveshjes, dokumentet mbështetëse të përcaktuara në paragrafin 1 mbahen në dispozicion të Komisionit për të paktën një vit pas mbylljes së procedurës, ose, nëse vendimi i konformitetit është objekt procedimi gjyqësor, për të paktën një vit nga mbyllja e këtij procedimi.

TITULLI 5: KORRIGJIMET FINANCIARE SI DHE SHQYRTIMI E PRANIMI I LLOGARIVE

Neni 45 Përmbajtja e llogarive vjetore

Llogaritë vjetore, që përbëhen nga raportet financiare vjetore dhe deklarata të përcaktuara në nenin 59, pika 2, germa a) e MK-së, përfshijnë:

- a) të ardhurat dhe shpenzimet e programit IPARD II, ku jepen shpenzimet dhe të ardhurat e BE-së, kombëtare dhe totale të përmbledhura sipas masës, të paraqitura me bazë vjetore dhe të dorëzuara përmes Formularit D 2, sipas Shtojcës 6 të kësaj Marrëveshjeje;
- b) tabelat e diferencave të programit IPARD II sipas masave, ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave të deklaruar në llogaritë vjetore, si dhe ato të deklaruar për të njëjtën periudhë në dokumentet që parashikon neni 37 i Marrëveshjes, shoqëruar me një shpjegim për çdo diferencë;
- c) tabela e shumave që do të rikuperohen në fund të vitit financiar (libri kontabël i debitorëve);
- d) listën e të gjitha pagesave të bëra në vitin financiar, sipas Shtojcës 9 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 46 Përcjellja e informacionit të nevojshëm për shqyrtimin dhe pranimin e llogarive

(1) Për qëllimin e shqyrtimit dhe pranimit të llogarive sipas nenit 36 të MK-së, ZKA-ja i dërgon Komisionit:

- a) raportet financiare vjetore dhe deklaratat e përcaktuara në nenin 45 të kësaj Marrëveshjeje, bashkë me ndonjë raport të autoriteteve që veprojnë nën delegim prej strukturave, autoriteteve dhe organeve përkatëse sipas nenit 19, pika 1 dhe 2 të MK-së;
- b) deklaratën e menaxhimit nga ZKA-ja sipas nenit 59, pika 2, germa b) e MK-së, përfshi një përmbledhje të raporteve sipas nenit 59, pika 2, germa c) e MK-së.

(2) Dokumentet e përmendura në pikat a) dhe b) duhet të kenë firmë dhe datë dhe të jenë të certifikuar, si edhe t'i përcillen Komisionit nga ZKA-ja në emër të Shqipërisë, sipas nenit 59, pika 2 të MK-së, duke i dërguar kopje Autoritetit Auditues. Dokumentet dërgohen në një pako të vetme bashkë me një kopje elektronike, në përputhje me formatin dhe sipas kushteve të përcaktuara prej Komisionit.

(3) Opinionet dhe raportet e Autoritetit Auditues duhet të kenë firmë dhe datë dhe t'i përcillen Komisionit sipas nenit 59, pika 3 të MK-së, duke i dërguar kopje Autoritetit Auditues. Dokumentet dërgohen në një pako të vetme bashkë me një kopje elektronike, në përputhje me formatin dhe sipas kushteve të përcaktuara prej Komisionit.

(4) Me kërkesë të Komisionit apo me nismë të ZKA-së, informacioni shtesë për shqyrtimin dhe pranimin e llogarive i përcillet Komisionit brenda afatit të përcaktuar prej Komisionit, duke pasur parasysh volumin e punës që kërkon mundësimi i atij informacioni. Në mungesë të informacionit, Komisioni mund të shqyrtojë dhe të pranojë llogaritë mbi bazën e informacionit që ka në dispozicion.

Neni 47 Forma dhe përmbajtja e informacionit kontabël

(1) Forma dhe përmbajtja e informacionit kontabël referuar në nenin 46, pika 1, germa a) përcaktohet mbi bazën e parimeve kontabël të pranuar ndërkombëtarisht dhe garantojnë që totali i shpenzimeve publike të të gjitha organeve publike të Shqipërisë për çdo masë dhe projekt në kuadrin e Programit IPA II të jenë të identifikueshme në librat dhe të dhënat e Fondit Kombëtar dhe të Agjencisë IPARD me anë të një kodi kontabël atë mjaftueshëm.

(2) Shqipëria duhet të japë informacion shtesë kur ka mosmarrëveshje, apo diferenca në interpretim apo përputhshmëri në lidhje me dokumentet dhe informacionin kontabël të referuar në paragrafin (1) për një periudhë referuese, që rezultojnë veçanërisht nga mospërcjellja e informacionit të kërkuar në këtë Marrëveshje, dhe këto kërkojnë kontrolle shtesë.

(3) Nëse pagesat që duhen bërë në kuadrin e programit IPARD II pengohen nga pretendime financiare ndaj përfituesit, ato konsiderohen të kryera në tërësinë e tyre:

- a) në datën e pagimit të shumës që ende i takon përfituesit, nëse pretendimi është më pak sesa shpenzimi i paguar;
- b) në datën e pagimit të shpenzimit, nëse ky i fundit është më pak ose i barabartë me pretendimin.

(4) Komisioni e përdor informacionin kontabël vetëm për këto dy qëllime:

- a) kryerjen e funksioneve të veta në kuadrin e shqyrtimit dhe pranimin të llogarive apo verifikimit të konformitetit;
- b) monitorimin e zhvillimeve dhe dhënien e parashikimeve në sektorin e bujqësisë;

Të drejtë aksesi në këtë informacion kanë Gjykata Europiane e Auditëve dhe Zyra Europiane Anti-Mashtrim (OLAF).

(5) Urdhër-pagesat të paekzekutuara dhe pagesat që i janë debituar llogarisë dhe pastaj janë rikredituar zbriten, sipas Formularit D2 të Shtojcës 6, nga shpenzimet në lidhje me muajin kur Agjencia IPARD ka raportuar mosekzekutimin apo anulimin.

(6) Shqipëria ngre një sistem, për programin IPARD II, për njohjen e të gjitha shumave dhe për regjistrimin në librin kontabël të debitorëve të të gjitha borxheve të tilla, duke përfshirë parregullsitë para marrjes së tyre. Pa cenuar nenin 41, pika 5 apo ndonjë dispozitë kombëtare në lidhje me rikuperimin e borxheve, çfarëdo kontributi financiar që i ngarkohet BE-së në lidhje me këto shuma, duke përfshirë parregullsi, fshihen në fund të vitit të dytë pas regjistrimit të tij në librin kontabël të debitorëve dhe pasi zbritet nga kërkesë-pagesa e radhës, sipas nenit 39, pika 2. Agjencia IPARD dhe Fondi Kombëtar garantojnë që shumat e rikuperuara të kreditohen në llogarinë IPARD në Euro brenda tre ditëve pune nga data e rikuperimit.

Neni 48 Procedura e shqyrtimit dhe miratimit të llogarive

(1) Vendimi për pranimin e llogarive konfirmon se raportet financiare vjetore dhe deklaratat e referuara në nenin 45, geramat a) dhe c) të përfshira në llogaritë vjetore janë të plota, të sakta dhe të vërteta. Vendimi nuk cenon miratimin e ndonjë vendimi pasues për verifikimin e konformitetit, sipas nenit 49. Vendimi për pranimin e llogarive mbulon edhe bilancin e llogarisë IPARD në euro.

(2) Komisioni i komunikon Shqipërisë rezultatet e analizës që i ka bërë informacionit që i është vënë në dispozicion, bashkë me ndonjë ndryshim që propozon, jo më vonë se 15 korriku pas fundit të vitit financiar.

(3) Shuma e cila, si rezultat i vendimit për pranimin e llogarive, që mund të rikuperohet apo paguhet nga Shqipëria, përcaktohet duke zbritur pagesat e ndërmjetme të vitit financiar në fjalë nga shpenzimet e njohura për të njëjtin vit, sipas paragrafit (1). Kjo shumë zbritet prej Komisionit ose i shtohet pagesës së ndërmjetme pasuese apo pagesës përfundimtare.

(4) Nëse shuma e zbritshme në bazë të një vendimi për miratim llogarish tejkalon nivelin e pagesave të mundshme pasuese, ZKA-ja garanton që shuma e pambuluar prej bilancit t'i kreditohet Komisionit në Euro brenda dy muajsh nga njoftimi i atij vendimi. Megjithatë, Komisioni mundet të vendosë, rast pas rasti, që çdo shumë që i takon t'i kreditohet ta zbresë nga pagesat që duhet t'i bëjë Shqipërisë në kuadrin e ndonjë instrumenti të BE-së.

(5) Ky nen zbatohet *mutatis mutandis* për pagesat e parafinancimit sipas kuptimit të nenit 38.

(6) Neni 84 i MK-së nuk zbatohet për verifikimin financiar.

Neni 49 Verifikimi i konformitetit

(1) Nëse Komisioni konstaton se shpenzimet në kuadrin e programit IPARD II janë bërë në shkelje të rregullave të zbatueshme, vendos se cilat shuma të përjashtohen nga financimi i BE-së.

(2) Komisioni vlerëson shumat që do të përjashtohen duke gjykuar se sa e rëndë është shkelja e moskonformitetit të regjistruar. Komisioni mban parasysh natyrën e shkeljes, sa e rëndë është ajo dhe dëmin financiar që i është shkaktuar BE-së.

(3) Nëse, si rezultat i një hetimi, Komisioni gjykon se shpenzimi nuk është kryer në përputhje me rregullat e zbatueshme, ia komunikon gjetjet e veta ZKA-së dhe i përcakton masat korrigjuese të nevojshme për të garantuar respektimin e tyre në të ardhmen.

Komunikimi do t'i referohet këtij neni. ZKA-ja kthen përgjigje brenda dy muajve nga marrja e komunikimit, duke i dërguar kopje Autoritetit Auditues, dhe Komisioni mund të modifikojë qëndrimin e vet si rrjedhojë e kësaj. Në raste të justifikuara siç duhet, Komisioni mund të pranojë të zgjatë periudhën e kthimit të përgjigjes.

Pas skadimit të afatit për kthimin e përgjigjes, Komisioni mund të kërkojë informacion shtesë dhe, kur është e nevojshme, të thërrasë takim dypalësh.

(4) Brenda dy muajve nga data e marrjes së kërkesës për informacion shtesë apo minutat e takimit dypalësh të referuar në nënparagrafin e tretë të paragrafit (3), ZKA-ja përcjell çdo informacion të kërkuar gjatë takimit apo ndonjë informacion tjetër që e konsideron të dobishëm për shqyrtimin në vazhdim.

Në raste të justifikuara siç duhet dhe me kërkesë të argumentuar prej ZKA-së, Komisioni mund të autorizojë zgjatjen e periudhës së përcaktuar në nënparagrafin e parë. Kërkesa i drejtohet Komisionit, me kopje për Autoritetin Auditues, para skadimit të asaj periudhe.

Pas skadimit të periudhës së referuar në nënparagrafin e parë, Komisioni ia përcjell formalisht konkluzionet ZKA-së, me një kopje për Autoritetin Auditues, mbi bazën e informacionit të marrë në kuadrin e procedurës së verifikimit të konformitetit. Aty Komisioni vlerëson shpenzimet që parashikon të përjashtojë nga financimi i BE-së. Nëse Komisioni propozon korrigjim financiar, ZKA-së i jepet mundësia të japë një vlerësim të ndikimit financiar aktual të parregullsisë. Vlerësimi i përcillet Komisionit brenda dy muajve nga data e marrjes së propozimit të Komisionit për korrigjim financiar. Në raste të justifikuara siç duhet, Komisioni mund të bjerë dakord për të zgatur periudhën e kthimit të përgjigjes.

(5) ZKA-ja informon Komisionin, me një kopje për Autoritetin Auditues, për masat korrigjuese që ka ndërmarrë për të garantuar respektimin e rregullave të zbatueshme dhe datën efektive të zbatimit të tyre.

(6) Komisioni mund ta ndërpresë procedurën në çdo moment, pa pasoja financiare për Shqipërinë, nëse pret që efekti financiar i mundshëm nga mosrespektimi i konstatuar nga hulumtimi i referuar në paragrafin (1) nuk tejkalon 10 000 EURO dhe 2% të shpenzimeve përkatëse apo të shumave që do të rikuperohen.

(7) Komisioni bën zbritjen nga financimi i BE-së prej pagesës së ndërmjetme të radhës apo prej pagesës përfundimtare. Megjithatë, Komisioni mund të vendosë një datë tjetër për zbritjet, me kërkesë të Shqipërisë apo kur e kërkon materialiteti i zbritjes.

(8) Në zbatim të nenit 45, pika 1 të MK-së, zbritjet e bëra prej Komisionit nuk i akordohen sërish programit IPARD II.

(9) Neni 84 i MK-së nuk zbatohet për verifikimin e konformitetit.

Neni 50 Rikuperimi i fondeve

(1) Rregullimet financiare dhe ripërdorimi i kontributit të BE-së ndërmerren nga ZKA-ja dhe i nënshtrohen kushteve të mëposhtme:

- a) kur zbulohen parregullsi, ZKA-ja e shtrin hulumtimin në të gjitha operacionet që mund të jenë prekur nga këto parregullsi;
- b) ZKA-ja njofton Komisionin për rregullimet përkatëse, me një kopje për Autoritetin Auditues;
- c) Shumat e kontributit të BE-së që anulohen dhe shumat e rikuperuara i akordohen sërish programit IPARD II sipas nenit 45, pika 2 e MK-së.

(2) Nëse llogaritë vjetore janë dërguar, siç parashikohet në nenin 46, ZKA-ja i përcjell Komisionit, me kopje për Autoritetin Auditues, një raport përmbledhës mbi procedurat e rikuperimit të ndërmarra në përgjigje të parregullsisë. Raporti duhet të japë ndarjen e shumave ende të parikuperuara, sipas procedimit administrativ dhe/ose gjyqësor, si dhe sipas vitit kur parregullsia është konstatuar në rrugë administrative apo gjyqësore. Çdo interes i rikuperuar nga Shqipëria që i takon programit IPARD II në lidhje me borxhet e rikuperuara, regjistrohet në llogaritë e Shqipërisë.

(3) Nëse Agjencia IPARD nuk arrin të rikuperojë kontributin e BE-së prej përfituesve brenda dy viteve nga regjistrimi në librin kontabël të debitorëve, ZKA-ja e rimbursion te buxheti i BE-së. Kur është e mundur, Komisioni zbret shumën e rikuperuar nga pagesa e ndërmjetme e radhës apo pagesa përfundimtare që i bën Përfituesit IPA II. Shqipëria garanton që çdo shumë e rikuperuar të kreditohet në llogarinë IPARD në euro brenda tre ditë pune nga data e rikuperimit.

(4) Shqipëria garanton që çdo shumë që do të rikuperohet prej përfituesve sipas nenit 51 të MK-së përcaktohet duke mbajtur parasysh natyrën e parregullsisë, sa e rëndë është ajo si edhe humbjen financiare që i është shkaktuar kontributit të BE-së, që pastaj regjistrohen në kohë në librin kontabël të debitorëve. Nëse Komisioni konstaton se regjistrimi me vonesë i borxheve ka rezultuar në fshirje të një sasive më të vogël të borxheve sipas paragrafit (3), përcakton korrigjimin financiar që duhet të aplikohet në bazë të nenit 49 të kësaj Marrëveshjeje.

(5) Kur ka qenë e mundur të ndikojnë në rikuperimin e përmendur në paragrafin (1), kur totali i kombinuar i deklaratave të shpenzimeve tejkalon kufirin prej 95%, siç parashikohet në nenin 36 (5) të kësaj Marrëveshjeje apo pas pagesës përfundimtare nga Bashkimi për programin IPARD II është bërë, ZKA duhet të kthejë shumat rikthehet në buxhetin e Bashkimit, në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 46 të MK-së.

(5) ZKA-ja rimbursion shumat e rikuperuara në buxhetin e BE-së, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 46 të MK-së, nëse ka qenë e mundur të kryhet rikuperimi i referuar në paragrafin 1 kur totali i deklaratave dhe shpenzimeve ka tejkaluar tavanin prej 95%, siç parashikon neni 36, pika 5 e kësaj Marrëveshjeje, ose pasi BE-ja ka kryer pagesën përfundimtare për programin IPARD II.

(6) Çdo kontribut i BE-së për programin IPARD II që nuk është rikuperuar deri në datën e mbylljen përfundimtare siç parashikon neni 48, pika 1 e MF-së dhe neni 43 i kësaj Marrëveshjeje, fshihet nga libri kontabël i debitorëve dhe shuma përkatëse rimburohet në buxhetin e BE-së. Kjo pagesë nuk cenon miratimin e ndonjë vendi më pas në zbatim të nenit 49 të kësaj Marrëveshjeje.

SEKSIONI VI MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI

TITULLI I: MONITORIMI I PROGRAMIT

Neni 51 Monitorimi i Programit dhe treguesit e programit

(1) Autoriteti Menaxhues dhe Komiteti Monitorues për programin IPARD II (më poshtë i referuar si "Komiteti Monitorues IPARD II") monitoron efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit të programit IPARD II. Ato i raportojnë Komisionit mbi ecurinë e masave.

(2) Programi monitorohet mbi bazën e indikatorëve të paraqitur në programin IPARD II.

Neni 52 Komiteti Monitorues i IPARD-it

(1) Komiteti Monitorues IPARD II që ngrihet pas miratimit të programit, kryesohet nga një përfaqësues i lartë i Shqipërisë, me të drejtë vote.

(2) Komisioni, struktura operuese, ZKA dhe KKIPA marrin pjesë në punimet e Komitetit Monitorues IPARD II pa të drejtë vote.

(3) Për qëllime të nenit 53, pika 2 të MK-së, Komiteti Monitorues IPARD II shqyrton rezultatet e programit IPARD II, në veçanti arritjen e objektivave të përcaktuar për masat e ndryshme dhe ecurinë në shfrytëzimin e alokimeve financiare për këto masa. Në këtë drejtim, Autoriteti Menaxhues garanton që i gjithë informacioni të lidhur me ecurinë e masave t'i vihet në dispozicion Komitetit Monitorues dhe KKIPA-s.

(4) Komiteti Monitorues IPARD II shqyrton periodikisht progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuar në programin IPARD II. Për këtë qëllim, do t'i jepet në veçanti:

- a) informacion për çdo sektor apo fushë ku janë hasur vështirësi;
- b) informacion mbi rezultatet e verifikimeve të realizuara;

(5) Neni 53, pika 3, germa f) i MK-së interpretohet për Komitetin Monitorues IPARD II në një mënyrën që ky Komitet duhet të shqyrtojë dhe të miratojë, kur është e përshtatshme, çdo propozim të hartuar nga Autoriteti Menaxhues për ndonjë ndryshim në programin IPARD, që i dorëzohet Komisioni me një kopje për KKIPA-n dhe AAK-në.

(6) Pa cenuar nenin 8, pika 4, Komiteti Monitorues IPARD II mundet që, pas konsultimit me Autoritetin Menaxhues dhe Agjencinë IPARD, t'i propozojë Autoritetit Menaxhues dorëzimin pranë Komisionit, me një kopje për KKIPA-n dhe ZKA-në, ndryshimet ose shqyrtimet e programit IPARD II, me qëllim që të garantohet arritja e objektivave të Programit dhe të përmirësohet efikasiteti i asistencës së dhënë.

(7) Komiteti Monitorues IPARD II shqyrton dhe miraton raportet vjetore e përfundimtare të zbatimit, para se t'i dërgohen KKIPA-s për dorëzim pranë Komisionit, me një kopje për ZKA-në dhe Autoritetin Auditues.

(8) Komiteti Monitorues IPARD II shqyrton vlerësimet e programit IPARD II referuar në nenin 57.

(9) Komiteti Monitorues IPARD II shqyrton dhe miraton planin me aktivitetet e vizibilitetit dhe komunikimit të përcaktuara në nenin 30, si dhe çdo përditësim të mëvonshëm të planit.

(10) Për aktivitetet e asistencës teknike në kuadrin e programit IPARD II, merret mendimi i Komitetit Monitorues IPARD II. Ai shqyrton dhe miraton çdo vit një plan veprimi vjetor indikativ për zbatimin e aktiviteve të asistencës teknike, bashkë me shumat indikative për qëllime informimi.

(11) Çdo vizitë dhe seminar i bashkëfinancuar nga BE-ja nën masën "Asistencën Teknike" të programit IPARD II kërkon dorëzimin e një raporti me shkrim të Komitetit Monitorues IPARD II.

(12) Komiteti Monitorues IPARD II vepron siç duhet, nëse nga programi IPARD II i kërkohet të japë mendim për ndonjë çështje.

(13) Të gjitha dokumentet përfundimtare të mbledhjeve të Komitetit Monitorues IPARD II bëhen publike.

Neni 53 Indikatorët

(1) Progresi, efienca dhe efektiviteti i programit IPARD II, në lidhje me objektivat, matet me indikatorë që bazohen te situata bazë dhe progresi i arritur në ekzekutimin financiar.

(2) Programi IPARD II specifikon një numër të kufizuar indikatorësh shtesë specifike për këtë program.

TITULLI 2 VLERËSIMI

Neni 54 Parimet për zbatimin e programit IPARD II

(1) Për qëllime të nenit 55 të MK-së, vlerësimet synojnë të përmirësojnë cilësinë, efektivitetin dhe përputhshmërinë e asistencës nga fondet e BE-së, si edhe strategjinë dhe zbatimin e programit IPARD II.

(2) Programi IPARD II i nënshtrohet kontrolleve *ex-ante* dhe *ex-post* dhe, kur Komisioni e gjykon të përshtatshme, i nënshtrohet edhe vlerësimeve të ndërmjetme që kryhen nga vlerësues të pavarur nën përgjegjësinë e Shqipërisë.

(3) Vlerësimet vlerësojnë zbatimin e programit IPARD II drejt arritjes së objektivave të përcaktuar në nenin 16, pika 5 të MK-së.

(4) Vlerësimet shqyrtojnë shkallën e shfrytëzimit të burimeve, efektivitetin dhe efikasitetin e programimit, ndikimin e tij socio-ekonomik dhe ndikimin e tij mbi objektivat dhe prioritetet e përcaktuara. Vlerësimet shtrihen mbi qëllimet e programit IPARD II dhe synojnë të nxjerrin mësim në lidhje me politikën e zhvillimit rural. Ato identifikojnë faktorët që kontribuuan në suksesin apo dështimin e zbatimit të programit IPARD II, si edhe në qëndrueshmërinë e masave dhe identifikimin e praktikave më të mira.

(5) Raportet e vlerësimit shpjegojnë metodologjinë e përdorur, si edhe përmbajnë një vlerësim të cilësisë së të dhënave dhe gjetjet.

(6) Cilësia dhe implikimet e vlerësimeve vlerësohen nga Autoriteti Menaxhues, Komiteti Monitorues IPARD II dhe Komisioni.

(7) Rezultatet e vlerësimeve *ex-ante* dhe të ndërmjetme merren parasysh në ciklin e programimit dhe zbatimit.

Neni 55 **Vlerësimi *ex ante* i programit IPARD II**

(1) Vlerësimi *ex-ante* bën pjesë e hartimit të programit IPARD II dhe synon të optimizojë shpërndarjen e burimeve buxhetore dhe të përmirësojë cilësinë e programimit. Vlerësimi identifikon dhe vlerëson nevojat afatmesme dhe afatgjata, qëllimet që duhet të arrihen, rezultatet e pritshme, objektivat sasiorë, vlerën e shtuar të BE-së, masën në të cilën janë marrë parasysh objektivat sipas nenit 16, pika 5 të MK-së, mësimet e nxjerra dhe cilësia e procedurave të zbatimit, monitorimit të programit, vlerësimit dhe menaxhimit financiar.

(2) Shqipëria garanton përfshirjen e vlerësuesit *ex-ante* në procesin e përgatitjes së programit IPARD II, në përgatitjen e analizës SËOT, në hartimin e logjikës ndërhyrëse të programit dhe në caktimin e objektivave të programit.

(3) Vlerësimi *ex-ante* kryhet nën përgjegjësinë e Shqipërisë.

Neni 56 **Plani i vlerësimit për programin IPARD**

(1) Autoriteti Menaxhues, në konsultim me KKIPA-n, harton një plan vlerësimi për programin IPARD II, sipas nenit 57 të MK-së Plani i vlerësimit i dorëzohet Komisionit Monitorues jo më vonë se një vit pas miratimit të programit IPARD II nga ana e Komisionit.

(2) Autoriteti Menaxhues dhe Komiteti Monitorues IPARD II e përdorin planin e vlerësimit që:

- a) të shqyrtojnë ecurinë e programit IPARD II në lidhje me qëllimet e tij, përkundrejt rezultateve dhe, sipas rastit, indikatorëve të ndikimit;
- b) të përmirësojnë cilësinë e programit IPARD II dhe zbatimin e tij;

- c) të shqyrtojnë propozimet për ndryshime thelbësore në programin IPARD II;
- d) të përgatiten për vlerësimin e ndërmjetëm dhe *ex-post*.

(3) Autoriteti Menaxhues raporton çdo vit pranë Komitetit Monitorues IPARD II, me një kopje për Autoritetin Auditues, mbi rezultatet e arritura në kuadrin e planit të veprimit. Një përmbledhje e aktiviteteve bashkëngjitet në planin vjetor të referuar në nenin 59.

Neni 57 **Vlerësimi i ndërmjetëm**

(1) Nëse Komisioni e konsideron si të përshtatshme, një vlerësim i ndërmjetëm kryhet në vitin e tretë pas vitit të miratimit të dhënies për herë të parë të detyrave për zbatimin e buxhetit për programin IPARD II.

(2) Vlerësimi i ndërmjetëm propozon masa për të përmirësuar cilësinë e programit IPARD II dhe zbatimin e tij, kur është e përshtatshme. Në veçanti, Shqipëria garanton që vlerësimi i ndërmjetëm të shqyrtojë rezultatet e para të programit IPARD II, përputhshmërinë e tyre me vlerësimin *ex-ante*, rëndësinë e synimeve dhe objektiveve dhe masën në të cilën ato janë arritur. Gjithashtu, vlerëson cilësinë e monitorimit dhe zbatimit të Programit, si dhe përvojën e fituar në ngritjen e sistemit për zbatimin e programit IPARD II.

(3) Vlerësimi i ndërmjetëm i dorëzohet Komitetit Monitorues IPARD II dhe Komisionit deri më 31 dhjetor të vitit të referuar në paragrafin (1).

(4) Përveç vlerësimit të referuar në nenin 54, pika 7, Komiteti Monitorues IPARD II, Autoriteti Menaxhues dhe Komisioni marrin parasysh implikimet e vlerësimit, me qëllim rishikimin e programit IPARD II.

(5) Në raportin e vlerësimit, Autoriteti Menaxhues informon Komisionin për ndjekjen e rekomandimeve. Nëse Shqipëria nuk e dorëzon raportin e vlerësimit të ndërmjetëm deri në datën e referuar në paragrafin 3, zbatohet nenit 37, pika 5.

Neni 58 **Vlerësimi *ex-post***

(1) Shqipëria përgatit për programin IPARD II një vlerësim *ex-post* jo më vonë se fundi i vitit të parë pas periudhës së zbatimit të programit. Ky raport përgatitet dhe i dorëzohet Komisionit jo më vonë se fundi i atij viti.

(2) Mbi bazën e rezultateve të vlerësimit të vënë në dispozicion dhe çështjeve të vlerësimit që lidhen me programin IPARD II, vlerësimi *ex-post* mbulon shfrytëzimin e burimeve dhe efektivitetin e efikasitetin e programit IPARD II, ndikimin e tij dhe përputhshmërinë me vlerësimin *ex-ante*. Ai mbulon faktorët që kontribuuan në suksesin apo dështimin e zbatimit, arritjet e programit IPARD II dhe rezultatet, duke përfshirë qëndrueshmërinë e tyre. Gjithashtu, nxjerrë konkluzione të lidhura me programin IPARD II dhe procesin e zgjerimit.

(3) Nëse Shqipëria nuk e dorëzon raportin e vlerësimit *ex-post* deri në datën e referuar në paragrafin (1), zbatohet neni 37, pika (5).

TITULLI 3 RAPORTIMI

Neni 59 Raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit

(1) Deri më 30 qershor të çdo viti pas një viti të plotë kalendarik të zbatimit të programit IPARD II, Autoriteti Menaxhues, pas konsultimit me Agjencinë IPARD, harton raporte vjetore mbi zbatimin e programit IPARD II gjatë vitit kalendarik pararendës, sipas nenit 60, pika 2 të MK-së. Raporti i parë i dorëzuar mbulon vitet kalendarike nga 2014 e këtej.

(2) Autoriteti Menaxhues harton një raport përfundimtar mbi zbatimin e programit IPARD II. Raporti përfundimtar dorëzohet jo më vonë se 6 muaj pas afatit të pranueshmërisë së shpenzimeve në kuadrin e programit IPARD II, sipas nenit 29, pika 4 të MK-së.

(3) Raportet vjetore të zbatimit mbulojnë vitin kalendarik pararendës dhe përfshijnë të dhëna në lidhje me vitin kalendarik para dhe të dhënat kumulative financiare e monitoruese për të gjithë periudhën e zbatimit të programit IPARD II, si dhe tabela monitorimi agregate. Raportet përfundimtare për zbatimin e programit IPARD II mbulojnë të gjithë periudhën e zbatimit dhe mund të përfshijnë raportin vjetor të fundit.

(4) Raportet e referuara në paragrafët (1) dhe (2), pasi shqyrtohen dhe miratohen nga Komiteti Monitorues IPARD II, i dërgohen KKIPA-s për dorëzim pranë Komisionit, me një kopje për ZKA-në dhe Autoritetin Auditues.

(5) Të gjitha raportet vjetore dhe përfundimtare përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- a) çdo ndryshim në kushtet e përgjithshme që lidhen me zbatimin e programit IPARD II, në veçanti, tendencat kryesore socio-ekonomike, ndryshimet në politikat kombëtare, rajonale apo sektoriale dhe, nëse është e mundur, implikimet e tyre në përputhshmërinë ndërmjet asistencës IPARD II dhe asistencës nga instrumente të tjerë financiarë të BE-së;
- b) progresi në zbatimin e prioritetëve dhe masave në lidhje me arritjen e objektivave të programit IPARD II, duke iu referuar të dhënave financiare, indikatorëve të përbashkët dhe atyre specifike për programin, vlerave sasiore të synuara, përfshi ndryshimet në vlerën e indikatorëve të rezultateve, ku është e mundur. Të dhënat e përcjella duhet të lidhen me vlerat e treguesve për operacione plotësisht të zbatuara dhe, nëse është e mundur, të lidhen me operacione të caktuara duke pasur parasysh fazën e zbatimit. Gjithashtu, ato japin një sintezë të gjetjeve të të gjitha vlerësimeve të programit që janë mundësuar gjatë vitit kalendarik pararendës, çdo çështje që ndikon në performancën e programit, si dhe masat e marra;
- c) për fondet financiare të alokuara dhe shpenzimet sipas masave, si edhe një përmbledhje të aktiviteteve të realizuar në lidhje me planin e vlerësimit;
- d) masat e marra nga Autoriteti Menaxhues, Agjencia IPARD II dhe Komiteti Monitorues IPARD II për të ndihmuar në garantimin e cilësisë dhe efektivitetit të zbatimit, në veçanti:
 - i) një përmbledhje të ndonjë problemi të qenësishëm të hasur gjatë zbatimit të programit IPARD II dhe masat e ndërmarra, përfshi edhe rekomandimet për rregullime të bëra në zbatim të paragrafit (8);
 - ii) një përmbledhje të rezultateve të verifikimeve të kryera për çdo masë dhe të parregullive të zbuluara;
 - iii) përdorimi i asistencës teknike;
 - iv) hapat e bërë për të përfshirë më shumë organet vendore;
 - v) hapat e marrë për të garantuar publicitetin e programit IPARD II;
 - vi) të dhënat që tregojnë se fondet e BE-së plotësojnë fondet që janë të disponueshme për Shqipërinë.
- e) hapat e bërë për të garantuar koordinimin e të gjithë asistencës së para-anëtarësimit që jep BE-ja, referuar nenit 4;
- f) tabelat financiare që tregojnë shpenzimet e BE-së, kombëtare dhe totale për çdo masë dhe/ose sektor

- g) një përmbledhje të aktiviteteve të realizuar në lidhje me planin e vlerësimit, sipas nenit 56;
- h) një përshkrim të aktiviteteve të kryera për zbatimin e planit me aktiviteteve vizibiliteti dhe komunikimi, referuar në nenin 30.

Përmbajtja dhe paraqitja e raporteve vjetore dhe përfundimtare bazohet në udhëzime të Komisionit.

(6) Komisioni, 15 ditë pune nga data e marrjes së raportit vjetor të zbatimit, informon Shqipërinë nëse nuk është i pranueshëm; ndryshe, raporti konsiderohet i pranuar.

(7) Komisioni informon Shqipërinë për vërejtjet e veta brenda katër muajve nga data e marrjes së raportit vjetor të zbatimit dhe brenda pesë muajve nga data e marrjes së raportit përfundimtar të zbatimit. Nëse Komisioni nuk jep vërejtjet brenda këtyre afateve, raportet konsiderohen të pranuar.

(8) Nëse, pas këtij shqyrtimi, Komisioni i përcjell komente Shqipërisë mbi çështje që ndikojnë në mënyrë të genësishme në zbatimin e programit IPARD II, Shqipëria do të informojë Komisionin brenda tre muajve për masat që ka ndërmarrë në lidhje me këto komente. Nëse Komisioni, pa cenuar Vendimet që merren në zbatim të neneve 48 dhe 49, i jep rekomandime Shqipërisë që të bëjë rregullime që synojnë përmirësimin e efektivitetit të monitorimit Programit apo të modaliteteve menaxhuese të programit IPARD II, Shqipëria më pas demonstron hapat e ndërmarrë për të përmirësuar monitorimin e programit apo modalitetet e menaxhimit, ose shpjegon pse nuk ka vepruar në këtë drejtim brenda tre muajve nga marrja e komenteve të Komisionit. Komiteti Monitorues IPARD II vihet në dijeni për këto veprimtari.

SEKSIONI VII DISPOZITA SPECIFIKE PËR PROGRAMET E VEPRIMIT SHUMËVJEÇARE ME FONDE TË PËRBASHKËTA

[Nuk ka dispozita plotësuese.]

SEKSIONI VIII DISPOZITA SPECIFIKE PËR PROGRAMET E BASHKËPUNIMIT

NDËRKUFITAR

[S'ka dispozita plotësuese.]

SEKSIONI IX DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Nenet 81 deri 86 dhe 88 deri 90 të MK-së zbatohen *mutatis mutandis* në këtë Marrëveshje.

Neni 60 Zbatueshmëria e marrëveshjeve sektoriale për IPA-n

Marrëveshjet Sektoriale të nënshkruara në kuadrin e IPA-s ndërmjet Komisionit dhe Shqipërisë mbeten të zbatueshme për asistencën e miratuar në kuadër të instrumenteve të mëparshme të para-anëtarësimit, derisa kjo asistencë të përfundojë sipas kushteve të Marrëveshjeve Sektoriale përkatëse. Megjithatë, nenet 45 deri 49 të kësaj Marrëveshjeje zbatohen në lidhje me shpenzimet në kuadrin e IPA-s, kur verifikimi financiar i apo procedura e verifikimit të konformitetit ka iniciuar pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

Neni 61 Adresa për komunikimet

Për sa i përket nenit 85 të MK-së, adresat janë si më poshtë:

(1) Për të gjitha korrespondencat të tjera nga ato të referuara në pikën (2).

Për Bashkimin Europian:

Komisioni Europian

Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

Njësia për Asistencën Para-Anëtarësimit për Bujqësinë

Rue de la Loi 130

BE-1049 Bruxelles

Për Shqipërinë :

Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave

Drejtoria e Programimit dhe Vlerësimit të Politikave Rurale(Autoriteti Menaxhues)

Sheshi "Skënderbej"

AL – 1001 Tirana

(2) Për korrespondencat që shërbejnë për informacionin e parashikuar në nenin 51, pika 2 të MK-së, adresat janë si më poshtë:

Për Bashkimin Europian:

Komisioni Europian

OLAF – Zyra Europiane kundër Mashtrimit

Drejtoria C

30, Rue Joseph II

BE – 1049 Bruxelles

Faqja e internetit: http://ec.europa.eu/anti_fraud/index_en.htm

Për Shqipërinë

Ministria e Integritetit Europian

Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës nga BE

Bulevardi Dëshmorët e Kombit

Tiranë - Shqipëri

Neni 62 Mosrespektimi dhe zgjidhja e marrëveshjes

Pa cenuar nenin 90 të MK-së, nëse Komisioni ka identifikuar mosrespektim të detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni:

- a) njofton Shqipërinë për qëllimet e veta, me argument(e), dhe
- b) ka të drejtë, për sa i përket programit IPARD II dhe pa cenuar Vendimet e referuara në nenet 48 dhe 49:
- i) të kryejë korigjime financiare ndaj Shqipërisë;
 - ii) të ndalojë transferimin e parave drejt Shqipërisë;
 - iii) të mos marrë më angazhime financiare të reja në emër të BE-së;
 - iv) nëse është e përshtatshme, të zgjidhë Marrëveshjen me efekt nga momenti kur është zbuluar mosrespektimi i detyrimeve.

Neni 63 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur njëra Palë informon tjetrën me shkrim për miratimin e saj në përputhje me legjislacionin e brendshëm ekzistues ose procedurën e saj.

Neni 64 Nënshkrimi

Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje në gjuhën angleze.

E nënshkruar për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në Tiranë në datën.....

Nga Zoti. Edmond P ANARITI

Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

E nënshkruar për dhe në emër të Komisionit European, në Bruksel në datën -----

nga Z. Jerzy PLEWA

Drejtor i Përgjithshëm për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

I deleguar si Zyrtar i Autorizuar

SHTOJCA 1 - FUNKSIONET KRYESORE TË SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Sipas përcaktimit të neneve 10 (1) (c) dhe 10 (2) të Marrëveshjes Kuadër (MK), strukturat, autoritetet dhe organet e sistemit të kontrollit të brendshëm kanë një strukturë organizative që i lejon ato të kryejnë funksionet kryesore në lidhje me shpenzimet IPARD:

Përfaqësja themelore për ndarjen e funksioneve dhe përgjegjësi përcaktohet në përputhje me tabelën e mëposhtme:

Funksionet e përgjithshme	Funksionet e veçanta	Struktura menaxhuese		Struktura Operuese	
		Zyra mbështetëse ZKA	Fondi Kombëtar	Agjencia IPARD	Autoriteti Menaxhues
Funksioni Menaxhues	Zgjedhja e masave				*
	Monitorimi i programit				*
	Menaxhimi i operacioneve financiare dhe llogarive IPA II		*		
	Vlerësimi				*
	Raportimi			*	

					*
	Koordinimi				*
Funksionet e Pagesës	Autorizimi dhe kontrolli i detyrimeve financiare			*	
	Autorizimi dhe kontrolli i pagesave		(*)	*	
	Ekzekutimi i pagesave			*	
	Kontabiliteti për shlyerjen e detyrimeve financiare dhe pagesave		*	*	
	Menaxhimi i borxhit		*	*	
	Thesari		*		
Funksionet Zbatuese	Përzgjedhja e projekteve			*	
	Publikimi			*	*
	Garancia për funksionimin efikas të sistemit të kontrollit të brendshëm		*		
Funksionet e Auditimit	Auditimi i brendshëm		*	*	*

Në rast se shënohet si fakultative (*), funksioni mund të përcaktohet në varësi të masës, përgjegjësi dhe karakteristikave të tjera të veçanta të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Përveç rasteve kur Komisioni shprehimisht dhe në mënyrë eksplicite parasheh ndryshe, ndarjet e funksioneve dhe përgjegjësi nuk duhet të jenë në kundërshtim me përjashtjen themelore siç tregohet në këtë Shtojcë.

Funksionet menaxhuese

(a) *Përzgjedhja e masave*: qëllimi i këtij funksioni është të garantojë se në bazë të nenit 10 (1) (c) (i) të MK, Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për përzgjedhjen e masave dhe publikimin e tyre duke përfshirë edhe përzgjedhjen e masave nën secilën thirrje në përputhje me nenin 8 (2) (c) të kësaj Marrëveshjeje.

(b) *Monitorimi i programit*: qëllimi i këtij funksioni është të monitorojë efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit të programit IPARD II. Ai zbatohet duke iu referuar treguesve përkatës fizikë, mjedisorë dhe financiarë. Ai garanton gjithashtu se operacionet përzgjidhen për financim në përputhje me kriteret dhe mekanizmin e zbatueshëm për programin, dhe në përputhje me rregullat relevante kombëtare dhe të BE-së.

(c) *Menaxhimi i operacioneve financiare dhe llogarive IPA II*: qëllimi i këtij funksioni është të garantojë një menaxhimin e qetë financiar duke përfshirë regjistrimin e aktiviteteve, transferimin e fondeve dhe bërjen e rregullimeve financiare kur është e nevojshme.

(d) *Vlerësimi*: qëllimi i këtij funksioni është të përmirësojë cilësinë, efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e asistencës nga fondet e Bashkimit Europian, si edhe strategjinë dhe zbatimin e programit IPARD II. Vlerësimet shqyrtojnë shkallën e shfrytëzimit të burimeve, të efektivitetit dhe efikasitetit të programit dhe ndikimin e tij social-ekonomik të objektivat dhe prioritetet e përcaktuara dhe, si rregull i përgjithshëm, shoqërohen me kriteret dhe treguesit e arritjeve.

(e) *Raportimi*: qëllimi i këtij funksioni është të garantojë se zbatimi i programit dhe progresi i operacioneve dhe masave të veçanta raportohet në një mënyrë e cila ndihmon për të siguruar zbatimin efektiv dhe efikas të masës, duke përdorur informacionin dhe sistemet e duhura të komunikimit.

(f) *Koordinimi*: qëllimi i këtij funksioni është të drejtojë dhe monitorojë punën e komitetit monitorues IPARD II në përputhje me nenin 53 të MK, veçanërisht duke siguruar dokumentet e nevojshme për monitorimin e cilësisë së zbatimit të programeve.

Funksionet e pagesës

(a) *Autorizimi dhe kontrolli i detyrimeve financiare dhe pagesave*: qëllimi i këtij funksioni është të tregojë se kërkesat për miratimin e operacioneve dhe shuma e ardhshme që do t'i paguhet pretenduesit ose përfituesit(ve) të tyre është në përputhje me marrëveshjet dhe e pranueshme për asistencën e pretenduar të BE-së, që përfshin, *ndër të tjera*, verifikimet administrative dhe, sipas rastit, verifikimet në vend, në veçanti ato në lidhje me rregullsinë dhe ligjshmërinë e shpenzimeve:

- (i) kontrollon pranimin e kërkesave për miratim dhe kërkesën për pagesë,
- (ii) kontrollon përputhshmërinë e angazhimeve të marra, lidhur me miratimet e projektit,
- (iii) sipas rastit, kontrollon procedurat e tenderimit dhe kontraktimit dhe verifikimin e punës së kryer apo shërbimet e ofruara,
- (iv) aplikon verifikimet e nevojshme.

Verifikimet mund të përfshijnë kontrollet e përzgjedhjes para-projektit, ri-matjet, kontrollet për sasinë dhe cilësinë e mallrave ose shërbimeve të ofruara, analizë apo kontroll me mostër testi, kontrollet e para-pagesave, kontrollet e pagesave *ex-post* dhe çdo dispozitë të veçantë për zbatimin e marrëveshjeve si për rregullsinë dhe ligjshmërinë e shpenzimeve. Për të përcaktuar rregullsinë dhe ligjshmërinë, verifikimet përfshijnë, sipas rastit, ekzaminimet e një natyre teknike, të cilat mund të përfshijnë vlerësimet ekonomike financiare dhe kontrollet e një natyre specifike bujqësore, teknike ose shkencore.

(b) *Ekzekutimi i pagesave*: qëllimi i këtij funksioni është nxjerrja e një udhëzimi për bankierët e strukturës operuese, ose, në raste të përshtatshme, për zyrën e pagesave qeveritare, t'u paguajnë shumën e autorizuar pretenduesit (ose përfituesit(ve) të tyre).

(c) *Kontabiliteti për detyrimet financiare dhe pagesat*: qëllimi i këtij funksioni është regjistrimi i të gjitha detyrimeve financiare dhe pagesave në librat e ndara të llogarive për shpenzimet e IPARD II, të cilat normalisht do të jenë në formën e një sistemi elektronik të përpunimit të të dhënave, dhe përgatitja e përmbledhjeve periodike të shpenzimeve, përfshi deklaratat e shpenzimeve për Komisionin. Librat e llogarisë regjistrojnë edhe asetet e financuara nga fondet e IPARD II, në veçanti në lidhje me debitorët e pasigurt.

(d) *Menaxhimi i borxhit*: qëllimi i këtij funksioni është funksionimi i sistemit për pranimin e të gjithë shumave për t'u paguar dhe regjistrimin në librin e debitorëve e të gjitha borxheve, përfshi parregullsitë, para marrjes së tyre.

(e) *Thesari*: qëllimi i këtij funksioni është të organizojë llogaritë bankare, kërkesat për fonde nga Komisioni, verifikimin e saktësisë së elementeve bashkë-financuese, që autorizon transferimin e fondeve IPARD II nga Komisioni te Agjencia IPARD ose te përfituesit dhe komunikimin financiar me Komisionin, përfshi aplikimet e pagesës tremujore dhe deklaratat vjetore.

Struktura organizative garanton qartësisht funksionin e autoritetit dhe përgjegjësisë të të gjitha niveleve operuese dhe, ndarjen e funksioneve të pagesës të referuara në pikat (a), (b) dhe (c), përgjegjësitë e të cilëve përcaktohen në një tabelë/organogramë.

Funksionet zbatuese

(a) *Përzgjedhja e projekteve*: qëllimi i këtij funksioni është të përzgjedhë projektet në përputhje me kriteret, mekanizmat dhe rregullat që zbatohen për programin IPARD II. Në mënyrë të veçantë, ky funksion mund të kryhet nga Autoriteti Menaxhues për masat "Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - përqasja LEADER' dhe "Asistenca teknike '.

(b) *Publikimi*: qëllimi i këtij funksioni është:

(i) të shpallë thirrjet për aplikime dhe të publikojë termat dhe kushtet për pranueshmërinë, përfshi informacionin mbi detyrimet kontraktuale dhe sanksionet e mundshme në rast të mosrespektimit të këtyre detyrimeve dhe, ku është e nevojshme, të japë miratimin për të filluar punën;

(ii) të theksojë rolin e Bashkimit Europian dhe të garantojë transparencën e asistencës së BE-së.

(c) *Garancia për funksionimin efikas të sistemit të kontrollit të brendshëm*: qëllimi i këtij funksioni është të kontrollojë vazhdimisht performancën e mirë të sistemit të kontrollit të brendshëm, përfshi edhe masat e nevojshme si ndjekja e rezultateve të vlerësimit të auditimit dhe parregullsive të identifikuara.

Funksionet e auditimit

Auditimi i brendshëm: objektivi i këtij funksioni është të sigurojë se aktivitetet specifike të rregullta kryhen për të garantuar menaxhimin më të lartë nëpërmjet rishikimit të pavarur të sistemeve vartëse.

SHTOJCA 2 - KUADRI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Për qëllime të shtojcës B të Marrëveshjes Kuadër (MK), zbatohen dispozitat e mëposhtme:

1. Mjedisi i kontrollit

Dispozitat e përgjithshme plotësuese për nenin 1 të Shtojcës B të MK-së

Delegimi

Një pjesë ose të gjitha funksionet e vlerësimit, raportimit, autorizimit dhe kontrollit mund t'u delegohen organeve të tjera me kusht që të përmbushen kushtet e mëposhtme:

- (1) Të lidhet një marrëveshje me shkrim që përcakton qartë, përveç detyrave të deleguara, natyrën e informacionit dhe dokumentet mbështetëse që do t'i paraqiten subjektit delegues, si edhe afati kohor brenda të cilit ato duhet të dorëzohen. Marrëveshja duhet t'i mundësojë subjektit delegues pajtueshmërinë me kërkesat nga shtojca B e MK-së dhe kësaj shtojce. Të garantohet mjaftueshëm gjurmë auditi.
Marrëveshja garanton nga agjentët e autorizuar ose përfaqësuesit e Shqipërisë apo të Bashkimit Europian aksesin në informacionet e mbajtura nga organet e deleguara dhe hetimin nga zyrtarët e aplikimeve, përfshi kryerjen e kontrolleve për projektet dhe përfituesit e ndihmës, si edhe çdo informacion tjetër që u nevojitet për kryerjen e detyrave të tyre.
- (2) Strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të Sistemit të Menaxhimit dhe Kontrollit (referuar më tej si "SMK") mbeten në të gjitha rastet përgjegjëse për menaxhimin efikas dhe të shëndoshë të asistencës IPARD në fjalë. "SMK" është plotësisht përgjegjës për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve përkatëse, përfshi mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Europian
- (3) Të përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrimet e organit tjetër, sidomos në lidhje me kontrollin dhe verifikimin e pajtueshmërisë me marrëveshjet dhe udhëzimet përkatëse.
- (4) Strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të "SMK"-së garantojnë se organi tjetër ka sisteme efektive për të siguruar përmbushjen e detyrave të tij në mënyrë të mjaftueshme.

(5) Organi u konfirmon në mënyrë të qartë strukturave, autoriteteve dhe organeve përkatëse të “SMK”-së se ai në fakt i përmbush detyrat e tij dhe përshkruan mjetet e përdorura.

⁵ Në asnjë rast nuk duhet të delegohen funksionet e ekzekutimit të pagesës, si edhe të kontabilitetit të detyrimeve financiare të pagesës.

(6) Strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të “SMK”-së rishikojnë rregullisht detyrat e deleguara për të vërtetuar se puna e kryer është e një standardi të kënaqshëm dhe në pajtim me marrëveshjet.

(7) Autoriteti i Auditit raporton për funksionet e deleguara si të ishin të menaxhuara nga vetë subjekti delegues.

Kushtet e përcaktuara në pikat (1), (2), (3) dhe (5) zbatohen *mutatis mutandis* (me ndryshimet e nevojshme që janë bërë) në rastet kur funksionet e subjektit delegues kryhen nga një organ tjetër si pjesë e detyrave të tij të rregullta në bazë të legjislacionit kombëtar.

Dispozitat specifike plotësuese për nenin 1 të Shtojcës B të MK-së

Referenca bëhet për nenin 1 të Shtojcës B të MK-së.

(d) Planifikimi, rekrutimi, mbajtja, trajnimi dhe vlerësimi i stafit:

Për qëllime të pikës (d) të nenit 1 të shtojcës B të MK-së, është i nevojshëm trajnimi i stafit në të gjitha nivelet operuese duke përfshirë ndërgjegjësimin dhe parandalimin e mashtrimit.

Për sa i përket nën-pikës së tretë të pikës (d) të nenit 1 të shtojcës B të MK-së, përshkrimet e punës përfshijnë vendosjen e limiteve financiare të detyrimeve dhe pagesave për autoritetin e punë-mbajtësit.

2. Menaxhimi i riskut

[Nuk ka dispozita plotësuese]

3. Aktivitetet e kontrollit

Dispozitat e përgjithshme plotësuese për nenin 3 të Shtojcës B të MK-së

Garantimi i një kontrolli të brendshëm të shëndoshë kërkon procedurat e mëposhtme:

A. Procedurat për autorizimin e aplikimeve dhe kërkesë-pagesën:

(1) Strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të "SMK"-së përcaktojnë procedurat e detajuara për marrjen, regjistrimin dhe përpunimin e kërkesave për miratimin e projektit, kërkesë- pagesat dhe faturat duke përfshirë një përshkrim të të gjitha dokumenteve që do të përdoren.

(2) Çdo zyrtar përgjegjës për autorizimin ka në dispozicion të tij/saj një listë të detajuar të verifikimeve që do të kryhen, dhe vërteton në dokumentet mbështetëse të kërkesë-pagesës se këto verifikime janë kryer. Ky vërtetim mund të bëhet me mjete elektronike. Do ketë dëshmi të rishikimit sistematik të punës nga një anëtar i lartë i stafit. Analiza e projektit udhëhiqet nga parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar

(3) Një kërkesë-pagesë autorizohet për t'u paguar vetëm pasi të jenë kryer verifikimet e mjaftueshme për të garantuar pajtueshmërinë me marrëveshjet. Këto verifikime përfshijnë verifikimet e kërkuara nga rregullorja për përcaktimin e masës specifike në kuadër të se cilës kërkohet ndihma, si edhe ato të kërkuara sipas nenit 51 të MK-së për të parandaluar dhe zbuluar parregullsitë dhe mashtrimin veçanërisht lidhur me rreziqet e vërejtura.

(4) Menaxhimi informohet në nivelin e duhur rregullisht dhe në kohë për rezultatet e verifikimeve të kryera administrative dhe në vend, në mënyrë që mjaftueshmëria e këtyre verifikimeve të mund të merret gjithmonë parasysh përpara zgjidhjes se një kërkesë për pagesë.

(5) Verifikimi administrativ i kryer detajohet në një listë (shih (2) që shoqëron çdo kërkesë-pagesë apo grupin e kërkesë-pagesave). Lista shoqërohet me një vërtetim për pranueshmërinë e kërkesë-pagesave të miratuara dhe natyrën, qëllimin dhe afatet e punës së bërë. Përveç kësaj, garantohet se kriteret për dhënien e ndihmës, përfshi kontraktimin, janë respektuar dhe se të gjitha rregullat e zbatueshme kombëtare dhe të Bashkimit Europian, përfshi edhe ato në lidhje me programin e zhvillimit rural, janë përmbushur. Verifikimi i kryer në vend detajohet në një raport në përputhje me nenin 15 ose nenin 21 të kësaj marrëveshjeje. Nëse ndonjë verifikim administrativ ose verifikim në vend nuk është i plotë, por është

kryer në bazë të një modeli të kërkesë-pagesave, atëherë identifikohen kërkesë-pagesat e përzgjedhura, metoda e marrjes së mostrave e përshkruar, rezultatet e të gjitha inspektimeve dhe masat e marra në lidhje me mospërputhjet dhe parregullsitë e raportuara. Dokumentet mbështetëse janë të mjaftueshme për të garantuar se të gjitha verifikimet e kërkuara për pranueshmërinë e kërkesë-pagesave të autorizuara janë kryer.

(6) Kur dokumentet (në letër ose në formë elektronike) në lidhje me kërkesë-pagesat e autorizuara dhe verifikimet e bëra mbahen nga organet e tjera, të dy organet dhe strukturat përkatëse krijojnë procedura për të garantuar se vendndodhja e këtyre dokumenteve relevante me pagesat specifike është e regjistruar.

(7) Aplikimet nga kërkuesit përpunohen në kohën e duhur.

(8) Kriteret për vlerësimin e aplikimeve dhe renditja e tyre sipas prioritetit përcaktohet dhe dokumentohet në mënyrë të qartë.

B. Procedurat për pagesën

(1) Strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të "SMK"-së, siç përcaktohet në nenin 10 (1) dhe (2) të MK-së miratojnë procedurat e nevojshme për të garantuar se autoritetet kombëtare mund të përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale pavarësisht vonesave apo ndërprerjeve të financimit nga Komisioni.

(2) Autoritetet kombëtare miratojnë procedurat e nevojshme për të garantuar se pagesat janë bërë vetëm te llogaritë bankare që u përkasin përfituesve ose marrësve. Pagesa bëhet nga banka e agjencisë IPARD, ose, sipas rastit, zyra e pagesave qeveritare, brenda tri ditëve pune nga data e borxhit kundrejt llogarisë në euro të IPARD. Procedurat miratohen për të siguruar se të gjitha pagesat për të cilat nuk është bërë transferi nuk deklarohen për rimbursim. Nëse këto pagesa janë deklaruar tashmë, ato duhet t'i rikreditohen Fondit nëpërmjet deklaratave të ardhshme mujore/tremujore, ose në llogaritë vjetore jo më vonë se koha e specifikuar. Pagesat bëhen me anë të një transferimi në llogarinë bankare në emër të përfituesit. Miratimi i zyrtarit të autorizuar dhe/ose mbikëqyrësit të tij/saj mund të bëhet në mënyrë elektronike, me kusht që të jetë siguruar niveli i duhur i sigurisë për këto mjete, dhe identiteti i nënshkruesit të futet në dosjen elektronike.

C. Procedurat për kontabilitetin financiar

(1)Strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të “SMK”-së miratojnë procedura të plota dhe transparente të kontabilitetit financiar duke ndjekur parimet e kontabilitetit të pranuar ndërkombëtarisht dhe çdo udhëzim tjetër të zbatueshëm. Procedurat e kontabilitetit financiar garantojnë se deklaratat tremujore dhe vjetore janë të plota, të sakta dhe të bëra në kohën e duhur, dhe se është zbuluar dhe korrigjuar çdo gabim ose pakujdesi, sidomos nëpërmjet verifikimeve dhe rakordimeve të kryera në intervale të rregullta. Të sigurohet gjurmë auditi për çdo element që hyn në sistemet e kontabilitetit.

(2)Procedurat e kontabilitetit të autoriteteve kombëtare garantojnë se sistemi i kontabilitetit mund të paraqesë në euro dhe monedhë kombëtare koston totale, shpenzimet e kryera, pagesat e pjeshme dhe pagesat e bilancit për çdo projekt, kontratë ose masë. Të përcaktohen afatet për anulimin e detyrimeve financiare kur puna nuk është përfunduar brenda një afati të rënë dakord. Këto anulime duhet të regjistrohen siç duhet në sistemet e kontabilitetit.

D. Procedurat për parapagesat dhe garancitë (nëse është e zbatueshme)

Pagesat e avancuara ose parapagesat kualifikohen si shpenzime të pranueshme deri në 10% të ndihmës publike në lidhje me projektin dhe i nënshtrohen krijimit të një garancie bankare apo një garancie ekuivalente që përputhet pothuajse me 110% të shumës së parapaguar. Pagesat e avancuara nuk mund të paguhen në kombinim me parafinancimin siç parashikohet në nenin 11 (3) (a).

Procedurat miratohen për të garantuar që:

(1) Parapagesat ose pagesat e avancuara identifikohen veçmas në regjistrat e kontabilitetit ose regjistrat suplementarë.

(2) Garancitë merren vetëm nga institucionet financiare që janë miratuar nga autoritetet përkatëse dhe mbeten të vlefshme deri sa të merren ose të kërkohen, me kërkesën e thjeshtë të agjencisë IPARD.

(3) Parapagesat merren brenda afateve të parashikuara, ndërsa atyre që u ka kaluar afati i marrjes identifikohen menjëherë dhe kërkohen garancitë.

E. Procedurat për borxhet

Të gjitha kërkesat e parashikuara në nenet A deri në D zbatohen *mutatis mutandis* për garancitë, pagesat e rimbursuara, të ardhurat e caktuara etj., të cilat agjencia IPARD i mbledh në emër të programit IPARD II. Agjencia IPARD ngre një sistem për pranimin e të gjitha shumave për t'u paguar dhe për regjistrimin e të gjithë borxheve në një libër të vetëm të debitorit para vërtetimit të tyre. Libri i debitorit kontrollohet në intervale të rregullta dhe merren masa për të mbledhur borxhet që janë vonuar.

F. Gjurma e auditit

Informacioni në lidhje me evidencat dokumentare të autorizimit, kontabilitetit, pagesës së kërkesë-pagesave dhe trajtimi i parapagesave, letrave me vlerë dhe borxheve do të jetë në dispozicion për të siguruar në çdo kohë gjurmë auditit mjaftueshëm të hollësishëm.

Menaxhimi duhet të informohet në nivelin e duhur rregullisht dhe në kohë për rezultatet e verifikimeve të kryera, në mënyrë që mjaftueshmëria e këtyre verifikimeve të mund të merret gjithmonë parasysh përpara zgjidhjes së një kërkesë për pagesë.

Për këto qëllime, strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të "SMK"-së krijojnë procedura të nevojshme për të siguruar mbajtjen e të gjitha dokumenteve që kërkohen për të garantuar gjurmë të mjaftueshme auditit.

Dispozitat specifike plotësuese për nenin 3 të Shtojcës B të MK-së

Referenca bëhet për nenin 3 të Shtojcës B të MK-së

(b) Aktivitetet e kontrollit të sigurisë

Për sa i përket pikës (b) të nenit 3 të shtojcës B të MK-së, siguria e sistemeve të informacionit bazohet në kriteret e përcaktuara në një version të zbatueshëm në vitin financiar në fjalë të standardit të mëposhtëm:

Organizata Ndërkombëtare e Standardeve 27002: Kodi i praktikës për Kontrollin e Sigurisë së Informacionit (ISO);

4. Informimi dhe komunikimi

Dispozitat specifike plotësuese për nenin 4 të Shtojcës B të MK-së

Referenca bëhet për nenin 4 të Shtojcës B të MK-së.

(c) Komunikimi i jashtëm:

Për qëllime të pikës (c) të nenit 4 të shtojcës B të MK-së, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

(i) çdo ndryshim të marrëveshjet, përfshi normat e ndihmës të zbatueshme ose termat dhe kushtet duhet të regjistrohet, dhe udhëzimet, bazat e të dhënave e listat e kontrollit duhet të përditësohen rregullisht në kohën e duhur;

(ii) të gjitha ndryshimet e konsiderueshme në SMK pas akreditimit dhe ngarkimit të tyre me zbatimin e buxhetit i paraqitet autoritetit/autoriteteve kompetente kombëtar/e dhe Komisionit, me kopje për Autoritetin e Auditimit, për shqyrtim dhe miratim para zbatimit të tyre.

5. Monitorimi i kuadrit të kontrollit të brendshëm

Dispozitat specifike plotësuese për nenin 5 të Shtojcës B të MK-së

Referenca bëhet për nenin 5 të Shtojcës B të MK-së.

(a) Monitorimi i vazhdueshëm dhe specifik

Për qëllime të pikës (a) të nenit 5 të shtojcës B të MK -së, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

- (i) operacionet e përditshme dhe aktivitetet e kontrollit të autoriteteve kombëtare monitorohen në të gjitha nivelet mbi një bazë të vazhdueshme për të siguruar gjurmë auditi mjaftueshëm të hollësishëm.;
- (ii) monitorimi i shërbimeve teknike dhe organeve deleguese përgjegjëse për kryerjen e verifikimeve dhe funksioneve të tjera për të garantuar zbatimin e duhur të rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave;
- (iii) procedurat e monitorimit për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit dhe parregullsive veçanërisht lidhur me ato zona të shpenzimeve nën kompetencën e agjencisë IPARD të cilat janë të ekspozuara ndaj një rreziku të konsiderueshëm të mashtrimit ose parregullsive të tjera serioze.

Për qëllime të paragrafit të katërt të pikës (a) të nenit 5 të shtojcës B të MK-së, shërbimi i kontrollit të brendshëm është i pavarur nga departamentet e tjera të autoriteteve kombëtare, dhe i raporton drejtpërdrejt drejtorit të subjektit. Shërbimi i kontrollit të brendshëm verifikon se procedurat e miratuara nga subjekti janë adekuate për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e Bashkimit Europian, dhe se llogaritë janë të sakta, të plota dhe në kohë. Verifikimet mund të kufizohen për masat e përzgjedhura dhe modelet e transaksioneve me kusht që një plan auditimi t'u japë garanci për një periudhë jo më shumë se pesë vjet të gjitha zonave të rëndësishme, përfshi këtu edhe departamentet përgjegjëse për autorizimin. Puna e shërbimit të kontrollit të brendshëm kryhet në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht, regjistrohet në dokumentet e punës dhe rezulton në raportet dhe rekomandimet e adresuara për menaxhimin e lartë të agjencisë.

SHTOJCA 3 - DOKUMENTET E KËRKUARA PËR APLIKIMIN E BESUESHMËRISË PËR DETYRAT E ZBATIMIT TË BUXHETIT

Kjo shtojcë i ofron subjekteve dokumentet e kërkuara për aplikimin e besueshmërisë për detyrat e zbatimit të buxhetit.

Shqipëria garanton:

(a) kërkesën e nënshkruar për besueshmërinë në letër dhe në format elektronik, dhe

(b) dokumentet e rekomanduara në këtë shtojcë dhe në të gjitha dokumentet e tjera relevante mbështetëse vetëm në format elektronik, me mbështetje fizike (CD/DVD/USB ose me mjete të tjera të ngjashme që përdoren zakonisht).

Nr.	Evidencat/Dëshmitë
1	Përcaktimi formal ligjor, konfirmimi i gatishmërisë dhe procedurave
1.1	Përcaktimi formal ligjor i KKIPA-s, ZKA-së dhe AA.
1.2	Konfirmimi i gatishmërisë së KKIPA-s, ZKA-së dhe AA.
1.3	<p>Procedurat me anë të të cilave zbatohen funksionet kryesore të KKIPA-s</p> <p>Komisioni nxjerr udhëzime dhe sqarime të mëtejshme në lidhje me dokumentet e kërkuara, formatin dhe nivelin e tyre të detajuar.</p> <p style="text-align: center;">MARRËVESHJE SEKTORIALE</p>

NDËRMJET

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TË PËRFAQËSUAR NGA

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

KOMISIONIT EVROPIAN

QË PËRCAKTON

DISPOZITAT E MENAXHIMIT DHE ZBATIMIT TË ASISTENCËS FINANCIARE
TË BE-së PËR REPUBLIKEN E SHQIPËRISË NË KUADËR TË INSTRUMENTIT
PËR ASISTENCËN E PARA-ANËTARËSIMIT
NË FUSHËN "BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL" (IPARD)

Pasqyra e Lëndës

SEKSIONI I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	7
Neni 1	Objekti.....	7
Neni 2	Respektimi i marrëveshjeve	7
Neni 3	Vendimet Financuese dhe Marrëveshjet e Financimit	7
Neni 4	Përputhshmëria me masa dhe instrumente të tjera.....	8
SEKSIONI II	RREGULLAT E MENAXHIMIT INDIREKT NGA SHQIPËRIA	8
TITULLI 1:	NGRITJA E SISTEMEVE TË MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT	8
Neni 5	Parimet zbatuese	8
Neni 6	Funksionet dhe përgjegjësitë e përbashkëta të strukturave dhe autoriteteve	8
Neni 7	Funksionet dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues	8
Neni 8	Funksionet dhe përgjegjësitë e Autoritetet Menaxhues	9
Neni 9	Funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë IPARD	10
TITULLI 2:	SISTEMET E KONTROLLIT	11
Neni 10	Dispozita të përgjithshme për aplikimet për mbështetje kërkesë-pagesat dhe deklaratat e tjera	11
Neni 11	Verifikimet administrative	12
Neni 12	Verifikimet në vend	13
Neni 13	Përmbajtja e verifikimeve në vend.....	14
Neni 14	Verifikimet ex-post	14
Neni 15	Raporti i kontrollit.....	15
Neni 16	Matjet e zonës	16
Neni 17	Verifikimi administrativ i matjeve të zonës.....	16
Neni 18	Elementët e verifikimeve në vend të matjeve të zonës	16
Neni 19	Matja e zonës	16
Neni 20	Verifikimi i kushteve të pranueshmërisë dhe alokimeve për matjet e zonës	17
Neni 21	Raporti i kontrollit për matjet e zonës.....	17
Neni 22	Reduktimet dhe përjashtimet sipas përmasave të zonës	18
TITULLI 3:	DISPOZITA SPECIFIKE PËR T'Ë DHËNË SHQIPËRISË DETYRA TË ZBATIMIT TË BUXHETIT	19
Neni 23	Kërkesat kryesore.....	19
Neni 24	Përgatitjet për dërgimin e kërkesës për të marrë detyra të zbatimit të buxhetit.....	20
Neni 25	Kërkesa dhe shtojcat mbështetëse.....	21
SEKSIONI III	RREGULLAT E PROGRAMIMIT	21
Neni 26	Programi IPARD II.....	21
Neni 27	Masat e Programit IPARD II	22
SEKSIONI IV	RREGULLAT E ZBATIMIT	22
TITULLI 1	RREGULLAT E PËRGJITHSHME DHE PARIMET E ZBATIMIT	22
Neni 28	Rregullat për prokurimin.....	22
TITULLI 2	TRANSPARENCA DHE VIZIBILITETI.....	23
Neni 29	Informimi, publiciteti dhe transparenca	23
Neni 30	Vizibiliteti dhe komunikimi	24
SEKSIONI V	RREGULLAT E MENAXHIMIT FINANCIAR TË ASISTENCËS IPA II ..	25
TITULLI 1	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	25

Neni 31	Rregulla të përgjithshme për asistencën financiare.....	25
Neni 32	Intensiteti i ndihmës dhe norma e kontributit të BE-së.....	25
TITULLI 2:	PRANUESHMËRIA.....	26
Neni 33	Pranueshmëria e shpenzimeve	26
TITULLI 3:	FINANCIMI DHE PAGESAT	28
Neni 34	Anulimi i fondeve të papërdorura	28
Neni 35	Plani i financimit për programin IPARD II	29
Neni 36	Pagimi i kontributit të BE-së.....	29
NENI 37	KËRKESË-PAGESAT NGA SHQIPËRIA.....	31
Neni 38	Parafinancimi	32
Neni 39	Llogaritja e shumës që duhet të paguhet.....	33
Neni 40	Pagimi i bilancit përfundimtar	33
Neni 41	Pagesat që iu bëhen përfituesve	34
Neni 42	Kursi i këmbimit dhe interesat	36
TITULLI 4	MBYLLJA E PROGRAMIT.....	38
Neni 43	Mbyllja e programit IPARD II.....	38
Neni 44	Ruajtja e dokumenteve.....	38
TITULLI 5:	KORRIGJIMET FINANCIARE SI DHE SHQYRTIMI E PRANIMI I LLOGARIVE...	39
Neni 45	Përmbajtja e llogarive vjetore	39
Neni 46	Përcjellja e informacionit të nevojshëm për shqyrtimin dhe pranimin e llogarive ..	39
Neni 47	Forma dhe përmbajtja e informacionit kontabël	40
Neni 48	Procedura e shqyrtimit dhe miratimit të llogarive	41
Neni 49	Verifikimi i konformitetit.....	42
Neni 50	Rikuperimi i fondeve	43
SEKSIONI VI	MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI	45
TITULLI I:	MONITORIMI I PROGRAMIT	45
Neni 51	Monitorimi i Programit dhe treguesit e programit	45
Neni 52	Komiteti Monitorues i IPARD-it	45
Neni 53	Indikatorët	47
TITULLI 2	VLERËSIMI.....	47
Neni 54	Parimet për zbatimin e programit IPARD II.....	47
Neni 55	Vlerësimi ex ante i programit IPARD II.....	48
Neni 56	Plani i vlerësimit për programin IPARD.....	48
Neni 57	Vlerësimi i ndërmjetëm.....	49
Neni 58	Vlerësimi ex-post	49
TITULLI 3	RAPORTIMI	50
Neni 59	Raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit	50
SEKSIONI VII	DISPOZITA SPECIFIKE PËR PROGRAMET E VEPRIMIT	52
SHUMËVJEÇARE	ME FONDE TË PËRBASHKËTA	52
Neni 60	Zbatueshmëria e marrëveshjeve sektoriale për IPA-n	53
Neni 61	Adresa për komunikimet.....	53
Neni 62	Mosrespektimi dhe zgjidhja e marrëveshjes	54
Neni 63	Hyrja në fuqi	55
Neni 64	Nënshkrimi.....	55
SHTOJCA 1 - FUNKSIONET KRYESORE TË SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM		56

SHTOJCA 2 - KUADRI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM.....	61
SHTOJCA 3 - DOKUMENTET E KËRKUARA PËR APLIKIMIN E BESUESHMËRISË PËR DETYRAT E ZBATIMIT TË BUXHETIT	69
SHTOJCA 4 - RREGULLAT PËR PROGRAMIMIN	139
SHTOJCA 5 - FORMULARI D 1 – PASQYRA E SHPENZIMEVE DHE BURIMIT TË TË ARDHURAVE	153
SHTOJCA 6 - FORMULARI D 2 - PASQYRA VJETORE E LLOGARIVE PËR	155
VITIN FINANCIAR (.....).....	155
SHTOJCA 7 - PARASHIKIMET E PAGESAVE	159
SHTOJCA 8 - INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI PËR MBËSHTETJEN E ASISTENCËS IPA II	160
SHTOJCA 9 - LISTA E PAGESAVE TË KRYERA PËR VITIN FINANCIAR 20XX- PËR PROGRAMIN IPARD II Shqipëria	167

○

Komisioni Evropian, më poshtë i referuar si **“Komisioni”** që vepron për dhe në emër të Bashkimit Evropian

nga njëra anë,

dhe

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë që vepron për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë, më poshtë i referuar si **“Shqipëria”**,

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht referuar si **“Palët”**.

Duke marrë parasysh se:

(9) Më 11 mars 2014, Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratuan Rregulloren (BE) Nr. 231/2014 për krijimin e instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit⁶ (më poshtë e referuar si “Rregullorja IPA II”). Ky instrument përbën bazën ligjore për dhënien e asistencës financiare përfituesve të renditur në Shtojcën I të Rregullores IPA II (më poshtë referuar si “Përfituesit IPA II”), për t'i ndihmuar në miratimin dhe zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike që kërkohen nga këto përfitues për të qenë në përputhje me vlerat e BE-së dhe për të përafruar gradualisht rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së, me synimin për t'u bërë anëtarë të BE-së;

(10) Më 2 maj 2014, Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratuan Rregulloren (BE) Nr. 447/2014⁷ që përcakton procedura dhe rregulla të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të BE-së për financimin e masave të jashtme (më poshtë e referuar si Rregullorja e Përbashkët Zbatuese”);

(11) Në përputhje me Nenin 5 të Rregullores Zbatuese IPA II, marrëveshjet kuadër mund të parashikohen nga marrëveshje sektoriale që përcaktojnë dispozita specifike për menaxhimin dhe zbatimin e asistencës IPA II në fushat ose programet e politikave specifike.

(12) Shqipëria është e pranueshme për asistencë sipas Rregullores IPA II.

Në datën 09.04.2015 u nënshkrua (u lidh) një⁸ marrëveshje kuadër ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit për masat për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë sipas IPA II (më poshtë e referuar si “MK”)

(13) u lidh një marrëveshje kuadër ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit për masat për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë sipas IPA II (më poshtë e referuar si “MK”)

(14) Programet e zhvillimit rural duhet të zbatohen nga Shqipëria mbi bazën e menaxhimit të tërthortë në përputhje me Nenin 58 (1) (c) të Rregullores (BE, EURATOM) nr. 966/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit⁹ dhe duhet të përcaktojnë masat që do të financohen me asistencën e IPA II. Llojet e përzgjedhura të masave duhet të jenë të një natyre të ngjashme me ato të parashikuara sipas Rregullores (BE) nr. 1305/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit¹⁰.

1.1.5. ⁶ Rregullorja (BE) Nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014 për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II) (GZ L 77, 15 mars 2014, faqe 11).

1.1.6. ⁷ Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 447/2014 e datës 2 maj 2014 për rregullat specifike për Rregulloren zbatuese (BE) nr. 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që përcakton një Instrument për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II) (GZ L 132, 3.5.2014, fq. 32)

⁸ Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, ligji nr. 37/2015, date 9.4.2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II)”

1.1.7. ⁹ Rregullorja (BE, EURATOM nr. 966/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 25 tetorit 2012 për rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 1605/2002 (GZ L 298, 26. 10. 2012, fq. 1)

1.1.8. ¹⁰ Rregullorja (BE) nr. 1305/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 17 dhjetorit 2013 për mbështetjen për zhvillimin rural nga Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural (FBEZHR) dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1698/2005 (GZL 347, 20. 12. 2013, fq. 487)

(15) Në disa pjesë të Marrëveshjes Kuadër niveli i hollësisë së rregullave për zbatimin e programeve të zhvillimit rural nuk është i mjaftueshëm. Si rezultat, është e nevojshme të përcaktohen hollësisira të mëtejshme për zbatimin dhe menaxhimin e asistencës në fushën e politikës së zhvillimit rural të IPA II në një marrëveshje sektoriale në përputhje me Nenin 9 të Marrëveshjes Kuadër.

(16) Ndërsa një marrëveshje sektoriale duhet të plotësojë Marrëveshjen Kuadër, struktura e kësaj Marrëveshjeje ndjek strukturën e Marrëveshjes Kuadër,

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

SEKSIONI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Kjo Marrëveshje përcakton dispozita specifike për menaxhimin dhe zbatimin e asistencës në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural të Shqipërisë, sipas nenit 9 të Marrëveshjes së Financimit Kuadër (MK).

Kjo Marrëveshje plotëson MK-në të lidhur me Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë sipas nenit 5, pikat 1 dhe 2, të Rregullores Zbatuese IPA II për zbatimin e IPA II. Në rast përplasjeje ndërmjet kësaj Marrëveshjeje dhe MK-së, precedencë kanë dispozitat e MK-së.

Neni 2 Respektimi i marrëveshjeve

(3) Shqipëria zotohet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e duhur të të gjitha aktiviteteve të asistencës si edhe për të lehtësuar zbatimin e programit IPARD II, në përputhje me MK-në dhe këtë marrëveshje (më poshtë të referuara si "marrëveshjet"). Shqipëria zotohet edhe që të respektojë programin IPARD II dhe Marrëveshjen e Financimit përcaktuar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

(4) Në rast konflikti mes marrëveshjes dhe programit IPARD II, kanë përparësi dispozitat e marrëveshjeve.

Neni 3 Vendimet Financuese dhe Marrëveshjet e Financimit

Në vijim të hyrjes në fuqi të MK-së dhe kësaj Marrëveshjeje, si edhe pas miratimit nga Komisioni të një vendimi financues që miraton programin IPARD II, palët lidhin një Marrëveshje Financimi sipas nenit 6, pika 3 të Rregullores

Zbatuese IPA.

Marrëveshja e Financimit bën ndarjen e alokimeve ligjore shumëvjeçare dhe periudhën e vlefshmërisë së këtyre alokimeve, që ndahen në lote njëvjeçare përgjatë disa vitesh.

Marrëveshja e Financimit rishikohet çdo vit për të pasqyruar shumat e disponueshme në buxhetin e BE-së dhe, sipas rastit, për të pasqyruar ndryshimet që i bëhen kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4 Përputhshmëria me masa dhe instrumente të tjera

(3) Përveç nenit 5(1)(b) të MK-së, Komisioni dhe Shqipëria garantojnë përputhshmërinë dhe koordinimin e asistencës brenda dhe ndërmjet programit IPARD II, masave në fushat e tjera në kuadrin e Rregullores IPA II dhe asistencës së Bankës Europiane të Investimeve dhe instrumenteve financiarë ndërkombëtarë të tjerë, në nivelet e planifikimit, programimit dhe zbatimit.

(4) Çdo mbivendosje e masave që financohen prej asistencës IPA duhet të shmanget.

SEKSIONI II RREGULLAT E MENAXHIMIT INDIREKT NGA SHQIPËRIA

TITULLI 1: NGRITJA E SISTEMEVE TË MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT

Neni 5 Parimet zbatuese

Shqipëria e zbaton programin IPARD II me menaxhim indirekt.

Neni 6 Funkcionet dhe përgjegjësitë e përbashkëta të strukturave dhe autoriteteve

Strukturat dhe autoritetet e përcaktuara në nenin 10, pika 1), germa (c) dhe në nenin 10, pika 2 të MK-së ngrihen me një akt formal dhe ushtrojnë të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7 Funkcionet dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues

(4) Zyrtari Kombëtar Autorizues (më poshtë e referuar si "ZKA") është përgjegjës për ngritjen e strukturës menaxhuese sipas nenit 10, pika 2 të MK-së;

(5) Përveç Klauzolës 2 të Shtojcës A të MK-së, ZKA-ja vepron si interlokutor i vetëm me Komisionin për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me IPARD-in në lidhje me:

(d) shpërndarjen e udhëzimeve dhe teksteve të BE-së që lidhen me sistemet e menaxhimit dhe kontrollit si edhe me organe të tjera përgjegjëse për zbatimin e tyre, si edhe për aplikimin e tyre të harmonizuar;

(e) kërkesën për marrjen e detyrave të zbatimit të buxhetit, sipas nenit 13, pika 1 të MK-së;

(f) informacionin e plotë kontabël për qëllime statistikore dhe kontrolli, që i dorëzohet Komisionit.

(6) ZKA-ja vlerëson ndonjë ndryshim të propozuar për zbatimin apo modalitetet e pagesave të strukturës operuese dhe strukturës menaxhuese. ZKA-ja informon Komisionin, me një kopje për të vënë në dijeni Autoritetin Auditues, për ndonjë ndryshim thelbësor, përfshi vlerësimin e ZKA-së, shpjegimet, justifikimet dhe dokumentet mbështetëse të përshtatshme për shqyrtimin dhe miratimin paraprak të zbatimit të tyre.

Neni 8 Funksionet dhe përgjegjësitë e Autoritetet Menaxhues

(9) Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e programit IPARD II, në përputhje me Shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje.

(10) Autoriteti Menaxhues kryen funksionet duke siguruar zbatim efektiv të programit IPARD II.

Në përputhje me nenin 10, pika 1, germa c) të MK-së, është përgjegjës për:

(f) përgatitjen e programit IPARD II dhe ndryshimeve të mundshme të tij, përfshi ato që kërkohen prej Komisionit;

(g) kontrollin dhe verifikimin e masave që do të përcaktohen në programit IPARD II në bashkëpunim me Agjencinë IPARD;

(h) përzgjedhjen e masave nën secilën thirrje për aplikime në kuadrin e programit IPARD II si edhe kohën e

zbatimit, kushtet e pranimit dhe alokimin financiar për çdo masë, nën çdo thirrje. Vendimet merren bashkërisht me Agjencinë IPARD;

- (i) miratimin e bazës ligjore kombëtare të përshtatshme për zbatimin e IPARD II si edhe rishikimin e saj sipas nevojës;
- (j) mbështetjen e Komitetit Monitorues IPARD, sipas nenit 52 të kësaj Marrëveshjeje, kryesisht duke ofruar dokumentet e nevojshme për monitorimin e cilësisë dhe zbatimit të programit IPARD II.

(11) Autoriteti Menaxhues, sipas Klauzolës 4(3)(a)(i) të Shtojcës A të MK-së, ngre një sistem raportimi dhe informimi për të mbledhur informacion financiar dhe statistikor mbi progresin e programit IPARD, bazuar edhe në informacionin që pret të marrë nga Agjencia IPARD; këto të dhëna ia përcjell Komitetit Monitorues IPARD II, sipas modaliteteve të rëna dakord ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit, duke përdorur – ku është e mundur – sisteme kompjuterike që mundësojnë shkëmbim të dhënash me Komisionit dhe të lidhur me sistemin e raportimit dhe informimit të ngritur prej ZKA-së sipas Klauzolës 2(4)(f) të Shtojcës A të MK-së. Sistemi i raportimit dhe informimit duhet të kontribuojë edhe për raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit të parashikuara në nenin 59 të kësaj Marrëveshjeje.

(12) Autoriteti Menaxhues i propozon Komisionit ndryshime në programin IPARD II, duke vënë në dijeni edhe Koordinatorin Kombëtar IPA (më poshtë e referuar si “KKIPA”), pas konsultimit me Agjencinë IPARD dhe pasi ka marrë pëlqimin e Komitetit Monitorues IPARD II. Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për informimin e autoriteteve përkatëse mbi nevojën e bërjes së ndryshime administrative të nevojshme, kur këto ndryshime kërkojnë një vendim të Komisionit që ndryshon programin IPARD II.

(13) Çdo vit, Autoriteti Menaxhues harton një plan veprimi për operacionet e synuara të realizohen me Asistencën Teknike, që i dorëzohet Komitetit Monitorues IPARD II për miratim.

(14) Siç parashikon Klauzola 4(3)(a)(iv) e Shtojcës A të MK-së, Autoriteti Menaxhues harton një plan veprimi sipas nenit 56 të kësaj Marrëveshjeje. Plani i dorëzohet Komitetit Monitorues sipas nenit 52 të kësaj Marrëveshjeje, jo më vonë se një vit pas miratimit të programit IPARD II prej Komisionit. Autoriteti Menaxhues raporton te Komiteti Monitorues IPARD II dhe te Komisioni mbi progresin e bërë me zbatimin e këtij plani.

(15) Autoriteti Menaxhues harton një plan koherent me aktivitetet për vizibilitetin dhe komunikimin, sipas nenit 24 të MK-së, si dhe konsultohet me informon Komisionin, pasi është këshilluar me Komitetin Monitorues IPARD II. Plani, mbi të gjitha, tregon nismat e marra dhe që do të merren për informimin e publikut të gjerë për rolin e luajtur prej BE-së dhe programimit IPARD II dhe për rezultatet e tij.

(16) Nëse Autoriteti Menaxhues delegon një pjesë të detyrave të një organ tjetër, ai mban përgjegjësinë e plotë për menaxhimin dhe zbatimin e atyre detyrave, në përputhje me parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar.

Neni 9 Funksonet dhe përgjegjësitë e Agjencisë IPARD

- (4) Agjencisë IPARD i ngarkohen funksionet dhe përgjegjësitë sipas Shtojcës 1. Sipas nenit 10(1) të MK-së, ajo ka edhe këto përgjegjësi:
- (k) i jep konfirmim Autoritetit Menaxhues mbi kontrollin dhe verifikimin e masave të programit IPARD II;
 - (l) organizon thirrjet për aplikime dhe publikon kushtet e pranueshmërisë, pasi merr pëlqimin e Autoritetit Menaxhues mbi çështjet e ngritura në zbatim të nenit 8(2)(c) të kësaj Marrëveshjeje;
 - (m) përzgjedh projektet për zbatim;
 - (n) përcakton me shkrim detyrimet kontraktuale ndërmjet Agjencisë IPARD dhe përfituesve, përfshi informacion mbi sanksionet e mundshme në rast mospërbushjeje të detyrave dhe, sipas rastit, lëshon miratimin për nisjen e punës. Agjencia IPARD mund të vazhdojë të kontraktojë apo të marrë përsipër zotime në zbatim të kësaj Marrëveshjeje për një masë specifike deri në datën kur Shqipëria fillon të kontraktojë apo të marrë përsipër zotime për këtë masë në kuadrin e ndonjë programi pasues të IPARD II;
 - (o) merr masa ndjekëse për të garantuar progresin e projekteve në zbatim;
 - (p) raporton mbi progresin e masave në zbatim, kundrejt disa indikatorëve;
 - (q) garanton që përfituesi të sensibilizohet për kontributin e BE-së në projekt;
 - (r) garanton raportimin e parregullsive në nivel kombëtar;
 - (s) garanton që ZKA-ja, struktura menaxhuese dhe Autoriteti Menaxhues të marrin të gjithë informacionin që u nevojitet për kryerjen e detyrave të tyre;
 - (t) garanton respektim të detyrimeve në lidhje me publicitetin, sipas nenit 23 të MK-së.
- (5) Për investime në projekte infrastrukturore të tipit që pritet të gjenerojnë të ardhura neto të konsiderueshme, Agjencia IPARD vlerëson nëse ky projekt është i këtij tipi, para se të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me një përfitues potencial. Nëse konstatohet se është i tillë, Agjencia IPARD sigurohet që ndihma publike nga të gjitha burimet nuk tejkalon 50% të kostos totale të lidhur me projektin dhe të konsideruar të pranueshme për bashkëfinancim të BE-së.
- (6) Agjencia IPARD siguron që për çdo projekt të programit IPARD II, akumulimi i ndihmës publike të dhënë nga të gjitha burimet të mos tejkalojë tavanet maksimale për shpenzimet publike të përcaktuara në nenin 32.

TITULLI 2: SISTEMET E KONTROLLIT

Neni 10 Dispozita të përgjithshme për aplikimet për mbështetje kërkesë-pagesat dhe deklaratat e tjera

- (4) Shqipëria miraton procedurat e përshtatshme për dorëzimin e aplikimeve për mbështetje, të kërkesë-pagesave dhe të deklaratave të tjera që lidhen me masat e zhvillimit rural.
- (5) Rezultatet e verifikimeve administrative dhe në vend vlerësohen për të përcaktuar nëse ekziston risku për operacione të tjera të ngjashme, përfitues apo organe tjera që të mos respektojnë kriteret e përshtatshmërisë dhe detyrimet e tjera të imponuara nga Marrëveshjet dhe programi IPARD II, si edhe nëse aplikohet niveli i duhur i kontrollit dhe nëse janë të nevojshme masa korigjuese dhe parandaluese.
- (6) Kur është rasti, verifikimet administrative dhe në vend për pranueshmërinë do të marrin në konsideratë rastet e dyshuara të mosrespektimit të raportuara nga shërbimet, organet apo organizata të tjera.

Neni 11 Verifikimet administrative

- (7) Verifikimet administrative kryhen për çdo aplikim për mbështetje, kërkesë-pagesë apo deklarata të tjera që kërkohet të dorëzohen nga përfituesi, dhe përfshijnë të gjithë elementët që mund të kontrollohen dhe duhet të kontrollohen me anë të verifikimeve administrative. Kjo procedurë përfshin regjistrimin e punës së kontrollit të ndërmarrë, rezultatet e verifikimit dhe masat e marra në rast mospërputhesh.
- (8) Verifikimet administrative të aplikimeve për mbështetje duhet të sigurojnë që operacioni përputhet me detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjeje, përfshi ato të standardeve dhe kërkesave të tjera të detyrueshme. Verifikimet përfshijnë veçanërisht:
 - (h) pranueshmërinë e operacionit për të cilin kërkohet mbështetje;
 - (i) kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në programin IPARD II, zotimet dhe detyrimet e tjera të operacionit për të cilin kërkohet mbështetje;
 - (j) pajtueshmërinë me kriteret e përzgjedhjes;
 - (k) pranueshmërinë e kostove të operacionit;
 - (l) pajtueshmërinë e operacionit për të cilin kërkohet mbështetje me rregullat e zbatueshme të brendshme dhe të BE-së, në veçanti, dhe, aty ku është e nevojshme, me rregullat e prokurimit publik, ndihmës publike dhe standardeve të tjera të detyrueshme të imponuara nga legjislati i brendshëm apo Marrëveshjet e nënshkruara (përfshi programin IPARD);

(m) arsyetimin e kostove të propozuara, që vlerësohen me anë të një sistemi vlerësimi të përshtatshëm, të tilla si kostot referuese, kostot standarde për njësi, krahasimi i ofertave të ndryshme apo nga një komision vlerësimi;

(n) besueshmërinë e përfituesit, bazuar në informacione prej palëve të treta si vendime gjykatash, ndjekje penale të filluara nga prokuroria, apo procedura falimentimi të filluara.

(9) Verifikimet administrative të kërkesë-pagesave përfshijnë:

(e) dhënien e produkteve apo shërbimeve të bashkëfinancuara. Parafinancimi kontraktual i Autoritetit Kontraktues mund të cilësohet shpenzim i pranueshëm deri në masën 10% të vlerës së kontratës;

(f) vërtetësinë e shpenzimeve të pretenduara;

(g) operacionin e përfunduar dhe përmbushjen e kushteve, krahasuar me operacionin për të cilin është dorëzuar aplikimi dhe është dhënë mbështetja;

(h) arsyetimin e kostove të pretenduara, që vlerësohen me anë të një sistemi vlerësimi të përshtatshëm, si edhe pagesat e bëra.

(10) Verifikimet administrative përfshijnë procedura për shmangien e financimit të dyfishtë me të tjera skema financimi të BE-së apo skema kombëtare. Në rast se ka financim nga burime të tjera, këto verifikime sigurojnë që mbështetja totale e marrë të mos kapërcejnë tavanet maksimale të lejueshme për ndihmën.

(11) Verifikimet administrative përfshijnë edhe dokumentet e përcaktuara në nenin 36(7).

(12) Indiset për parregullsi ndiqen me një procedurë administrative të përshtatshme.

Neni 12 Verifikimet në vend

(6) Për të gjitha aplikimet kryhen verifikime në vend, për mbështetjen dhe kërkesë-pagesat që duhet të dorëzohen nga përfituesi, që mbulojnë të gjithë elementet që mund të kontrollohen në momentin e vizitës. Por, në raste të jashtëzakonshme, të regjistruara dhe të shpjeguara siç duhet, Shqipëria mund të vendosë se verifikimi në vend nuk është i nevojshëm.

(7) Përfituesi mund të njoftohet paraprakisht për verifikimin në vend, me kusht që të mos vihet në rrezik qëllimi i kontrollit. Nëse njoftimi paraprak bëhet më shumë se 48 orë para verifikimit në vend, informacioni

duhet të jetë i kufizuar aq sa duhet, në varësi të natyrës së masës dhe operacionit që po bashkëfinancohet.

- (8) Kur është e mundur, verifikimet në vend që parashikohen në këtë Marrëveshje kryhen në të një kohë si çdo kontroll që parashikohet në legjislacionin e BE-së apo në atë të brendshëm. Kontrolli në vend zgjat rreptësisht vetëm aq sa është i nevojshëm.
- (9) Inspektorët që kryejnë kontrollin në vend nuk duhet të jenë përfshirë në verifikime administrative të të njëjtit operacion.
- (10) Marrëveshja e Financimit e lidhur ndërmjet Komisionit dhe Shqipërisë, si edhe çdo ndryshim i saj, mund të parashikojë që verifikimi në vend për një masë e caktuar të bëhet me bazë kampionimi. Në këtë rast, Marrëveshja e Financimit përcakton madhësinë minimale të kampionit, kriteret për përzgjedhjen e kampionit dhe si rritet madhësia e kampionit nëse verifikimi zbulon numër të lartë parregullsish.

Neni 13 Përmbajtja e verifikimeve në vend

- (4) Verifikimi në vend verifikon që operacioni është përgatitur dhe është zbatuar në përputhje me rregullat e zbatueshme, si dhe mbulon të gjitha kriteret e pranueshmërisë, alokimet dhe detyrimet që lidhen me kushtet për dhënien e mbështetjes, që janë të mundura të kontrollohen në momentin e vizitës. Verifikimi siguron edhe që operacioni është i pranueshëm për financim.
- (5) Verifikimi në vend verifikon saktësinë e të dhënave të deklaruara nga përfituesi përkundër dokumenteve mbështetëse. Kjo përfshin verifikimin që aplikimet dhe kërkesë-pagesat e dorëzuara prej përfituesit janë të mbështetura me kontabilitet apo dokumente të tjera, duke përfshirë, kur është e nevojshme, një kontroll mbi saktësinë e të dhënave në kërkesë-pagesë, në bazë të të dhënave apo dokumenteve tregtare që disponohen nga palë të treta.
- (6) Verifikimi në vend verifikon nëse dobia apo dobia e synuar i operacionit është në përputhje me dobinë e përshkruar në aplikimin për mbështetje, si dhe për të cilën është dhënë mbështetja. Verifikimi në vend përfshin një vizitë në vendin ku po zbatohet operacioni ose, nëse operacioni është jokonkret, te promovuesi i operacionit.

Neni 14 Verifikimet *ex-post*

- (6) Verifikimi *ex post* kryhet për operacionet e investimit për të verifikuar respektimin e alokimeve të përcaktuara në nenin 33, pika 6 të Programit IPARD II.
- (7) Kontrollorët e verifikimit *ex post* nuk duhet të kenë qenë të përfshirë në verifikimin *ex ante* të të njëjtit operacion të investimit, me përjashtim të rastit kur kontrollorët kanë kryer të paktën një verifikim në vend në periudhën mes këtyre dy verifikimeve.

- (8) Verifikimi *ex post* kryhet brenda pesë viteve nga data kur përfituesi merr pagesën e fundit. Gjatë periudhës pesëvjeçare, të gjitha investimet kontrollohen të paktën një herë.
- (9) Verifikimi *ex post* që kryhet përgjatë periudhës pesëvjeçare, bazohet në analizën e riskut dhe implikimeve financiare të operacioneve, grupeve të operacioneve apo masave të ndryshme.
- (10) Kur zgjidhet kampioni i operacioneve të miratuara që do të kontrollohet në zbatim të paragrafëve (3) dhe (4) merr parasysh në veçanti:
- (d) nevojën për të kontrolluar numrin e përshtatshëm të operacioneve sipas tipeve dhe përmasave;
 - (e) çdo faktor risku që është identifikuar nga verifikimi kombëtar apo i BE-së;
 - (f) nevojën për të ruajtur balancën ndërmjet masave.

Neni 15 Raporti i kontrollit

- (4) Për çdo verifikim në vend nën këtë Titull përgatitet një raport kontrolli që bën të mundur shqyrtimin e hollësive të verifikimit të kryer. Raporti përcakton në veçanti:
- f) masat dhe aplikimet apo kërkesë-pagesat që janë kontrolluar;
 - g) personat e pranishëm;
 - h) nëse i është dërguar njoftim paraprak përfituesit dhe kur;
 - i) rezultatet e verifikimit dhe, kur është e nevojshme, ndonjë vërejtje;
 - j) matje të tjera kontrolli që do të kryhen.
- (5) Në rastin e verifikimit në vend, përfituesit i jepet mundësia të firmosë raportin gjatë kontrollit që të vërtetohet prania e tij gjatë kontrollit, si edhe të shkruajë vërejtje. Kur nuk konstatohet ndonjë mospërputhje, përfituesit i jepet një kopje e raportit të kontrollit.
- (6) paragrafi (1) dhe nënparagrafi i dytë i paragrafit 2 aplikohen *mutatis mutandis* për verifikimet *ex post* nën këtë titull.

Neni 16 Matjet e zonës

- (3) Për qëllime të këtij Titulli, “matjet e zonës” nënkuptojnë ato matje që mbështeten mbi bazën e madhësisë së zonës së deklaruar.

- (4) Pa cenuar nenin 11, pika 1 dhe nenin 12, verifikimi i matjeve të zonës respekton rregullat e përcaktuara në nenet 17-22.

Neni 17 Verifikimi administrativ i matjeve të zonës

- (4) Verifikimi administrativ synon gjetjen e mospërputhjeve. Verifikimi mbulon të gjithë elementët që mund dhe duhet të kontrollohen nga verifikimi administrativ, me qëllim që të konstatohet se:

(e) kriteret e pranueshmërisë, alokimet dhe detyrimet e tjera janë përmbushur;

(f) nuk ka financim të dyfishtë përmes skemave të tjera të BE-së;

(g) aplikimi për mbështetje apo kërkesë-pagesa është e plotë dhe e dorëzuar brenda afatit dhe, kur është e mundur, dokumentet mbështetëse janë dorëzuar dhe vërtetojnë pranueshmërinë;

(h) ka përputhje me alokimet afatgjata, kur është e nevojshme.

- (5) Kur është e nevojshme, verifikimi administrativ përfshin verifikim të kryqëzuar ndërmjet parcelave bujqësore siç janë deklaruar në aplikim dhe/ose në kërkesë-pagesë dhe informacion që përmban një sistem identifikimi i parcelave bujqësore për parcelat referuese, me qëllim që të verifikohet pranueshmëria e tyre;

- (6) Kur nga verifikimi i kryqëzuar konstatohen të dhëna për mospërputhje, kryhet ndonjë procedurë administrative të përshtatshme dhe, kur është e nevojshme, një verifikim në vend.

Neni 18 Elementët e verifikimeve në vend të matjeve të zonës

- (3) Verifikimi në vend kryhet për të gjitha parcelat bujqësore për të cilën është kërkuar mbështetje.

- (4) Verifikimi në vend kryen matjen e zonës dhe verifikon kriteret e pranueshmërisë, alokimet dhe detyrimet e tjera të përfituesit në kuadrin e masave.

Neni 19 Matja e zonës

- (6) Verifikimi në vend mat parcelat bujqësore për të cilat është dorëzuar një aplikim për mbështetje dhe/ose kërkesë-pagesë.

- (7) Marrëveshja e Financimit e lidhur ndërmjet Komisionit dhe Shqipëria, si edhe çdo ndryshim i saj, mund të

parashikojë që matja e zonës në kuadrin e verifikimit në vend të bëhet me bazë kampionimi të rastësishëm të parcelave. Në këtë rast, Marrëveshja e Financimit përcakton madhësinë minimale të kampionit. Kur ky verifikim kampioni zbulon ndonjë mospërputhje, maten të gjitha parcelat bujqësore ose pranohen rezultatet e kampionit të matur.

- (8) Zonat me parcela bujqësore maten me mjete që garantojnë cilësi të paktën të njëjtë me atë të Sistemit Global të Navigimit Satelitor (GNSS) apo të ortoimazherisë.
- (9) Për matjet e kryera me GNSS dhe/ose ortoimazheri, përcaktohet një marzh tolerance njëshifror. Për këtë qëllim, mjetet matëse që përdoren, duhet të jenë të kalibruara për vlerat poshtë maksimales. Sidoqoftë, toleranca është deri 1.25m.

Toleranca maksimale për çdo parcelë bujqësore nuk duhet të tejkalojë 1.0 ha në terma absolutë.

- (10) Matja mund të përfshijë tërë parcelën bujqësor ku përmbush plotësisht kriteret e pranueshmërisë. Në raste të tjera, matja kryhet për pjesën e parcelës që është e pranueshme për financim.

Neni 20 Verifikimi i kushteve të pranueshmërisë dhe alokimeve për matjet e zonës

- (3) Verifikimi kryhet me çdo mjet që mundëson kontrollin e alokimeve të ndryshme dhe detyrimeve të përfituesit.
- (4) Kur vetëm një metodë kontrolli është e pamjaftueshme për qëllimin e paragrafit (1), sistemi i kontrollit parashikon disa mjete kontrolli të cilat, së bashku, mundësojnë arritjen e qëllimit të paragrafit (1).

Neni 21 Raporti i kontrollit për matjet e zonës

- (3) Për çdo verifikim në vend të matjeve të zonë, përgatitet një raport kontrolli që bën të mundur shqyrtimin e hollësive të verifikimit të kryer dhe nxjerrjen e përfundimeve në lidhje me respektimin e kriterëve të pranueshmërisë, alokimet dhe detyrimet e tjera. Raporti përcakton në veçanti:
- (i) masat dhe aplikimet apo kërkesë-pagesat që janë kontrolluar;
 - (j) personat e pranishëm;
 - (k) parcelat bujqësore që janë kontrolluar, parcelat bujqësore që janë matur përfshi, sipas rastit, rezultatit e matjeve për parcelë bujqësore të matur dhe metodën matëse të përdorur;
 - (l) kur është e nevojshme, rezultatet e matjeve të tokës jobujqësore për të cilën është kërkuar mbështetje në kuadrin e masave të zhvillimit rural, si edhe metodën matëse të përdorur;

(m) nëse është dhënë njoftimi i kontrollit për përfituesin dhe nëse po, periudhën e njoftimit paraprak;

(n) të dhëna të ndonjë mase specifike kontrolli që duhet të kryhet në kontekstin e masave individuale;

(o) matje të tjera kontrolli që do të kryhen.

(p) të dhëna të ndonjë mospërputhjeje të konstatuar që kërkon ndjekje gjatë vitet pasardhëse;

(4) Përfituesit i jepet mundësia të firmosë raportin gjatë kontrollit që të vërtetohet prania e tij gjatë kontrollit, si edhe të shkruajë vërejtje. Kur nuk konstatohet ndonjë mospërputhje, përfituesit i jepet një kopje e raportit të kontrollit.

Neni 22 Reduktimet dhe përjashtimet sipas përmasave të zonës

(3) Nëse nga matjet rezulton që zona është më e madhe sesa është deklaruar në kërkesë-pagesë, për llogaritjen e mbështetjes merret zona e deklaruar.

Nëse zona e deklaruar në kërkesë-pagesë tejkalon zonën e përcaktuar, mbështetja llogaritet mbi bazën e zonës së përcaktuar.

Megjithatë, nëse diferenca mes totalit të zonës së përcaktuar dhe totalit të zonës së deklaruar në kërkesë-pagesë për një masë është jo më shumë se 0.1 hektarë, zona e përcaktuar konsiderohet e barabartë me zonën e deklaruar.

Nënparagrafi i tretë nuk zbatohet nuk aplikohet kur diferenca është mbi 20% e totalit të zonës së deklaruar për pagesa.

Nëse është vendosur kufi apo tavan për zonën përfituese të mbështetjes, numri i hektarëve të deklaruar në kërkesë-pagesë reduktohet në atë kufi apo tavan.

(4) Në rastin e parashikuar në nënparagrafin e dytë të paragrafit (1), mbështetja llogaritet mbi bazën e zonës së përcaktuar të reduktuar me dyfishin e diferencës së konstatuar, nëse kjo diferencë tejkalon ose 3%, ose tejkalon dy hektarë, por jo më shumë sesa 20% të zonës së përcaktuar.

Nuk jepet mbështetje nëse diferenca tejkalon 20% të zonës së përcaktuar.

TITULLI 3: DISPOZITA SPECIFIKE PËR T'I DHËNË SHQIPËRISË DETYRA TË ZBATIMIT TË BUXHETIT

Neni 23 Kërkesat kryesore

(4) Në momentin e dërgimit të kërkesës për t'i dhënë përfituesit detyra të zbatimit të buxhetit, strukturat dhe autoritetet e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit - siç përcaktohet në nenet 10 dhe 11 të Marrëveshjes Kuadër - duhet të kenë organizim administrativ të mirëpërcaktuar dhe sistem verifikimi të brendshëm me një rregullore të brendshme të plotë, përgjegjësi institucionale dhe personale të qarta, që përmbushin kriteret e parashikuara në Shtojcën B të Marrëveshjes Kuadër dhe në Shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me fushat e mëposhtme:

(f) mjedisi i kontrollit;

(g) menaxhimi i riskut

(h) aktivitetet e kontrollit

(i) informimi dhe komunikimi;

(j) monitorimi i kuadrit të kontrollit të brendshëm.

Për Autoritetin Menaxhues, nuk aplikohen kriteret e parashikuara në Shtojcën 2 të Marrëveshjes së Financimit dhe në Shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me menaxhimin e riskut, aktivitetet e kontrollit dhe monitorimin e kuadrit të kontrollit të brendshëm.

Roli i Autoriteti Menaxhues në kuadrin e masës "Asistencë Teknike", nëse është i zbatueshëm, përshkruhet në Programin IPARD II.

(5) Shqipëria mund të përcaktojë kriteret më të hollësishme që kanë parasysh madhësinë, përgjegjësitë dhe veçoritë e tjera specifike të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit.

(6) Kërkesa për marrjen e detyrave të zbatimit të buxhetit dhe shtojcat mbështetëse i dorëzohet Komisionit pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër dhe kësaj Marrëveshjeje dhe pasi Komisioni miraton vendimin financiar që miraton Programin IPARD II.

Neni 24 Përgatitjet për dërgimin e kërkesës për të marrë detyra të zbatimit të buxhetit

(1) Para dërgimit të kërkesës për të marrë detyra të zbatimit të buxhetit, ZKA-ja bindet që Agjencia IPARD dhe modalitetet administrative, kontabël, të pagesave dhe të kontrollit të brendshëm ofrojnë garancitë e mëposhtme:

(g) pranueshmëria e aplikimeve dhe përputhshmëria me Marrëveshjet verifikohen para se të

nënshkruhen kontratat me kërkuesit dhe para se të regjistrohen fondet e alokuara;

(h) pranueshmëria e kërkesë-pagesave dhe përputhshmëria e tyre me Marrëveshjet verifikohen para se të jepet autorizimi për kryerjen e pagesës;

(i) fondet e alokuara dhe pagesat e kryera regjistrohen saktë dhe plotësisht në kontabilitet;

(j) kryhen verifikohet e parashikuara në Marrëveshje;

(k) dokumentet e kërkuara dorëzohen brenda afatit dhe në formën e parashikuar nga Marrëveshjet apo nga procedurat e miratuara;

(l) dokumentet mund të gjenden dhe mbahen në mënyrë të tillë që garanton plotësinë, vlefshmërinë dhe lexueshmërinë e tyre me kalimin e kohës, përfshi edhe dokumentet elektronike sipas kuptimit të Marrëveshjeve.

(2) Nëse ZKA-ja nuk është i bindur se struktura menaxhuese dhe struktura operuese respektojnë kriteret e përcaktuara në Shtojcat A dhe B të MK-së si dhe të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje, i drejton instruksione organit përkatës ku specifikon kushtet që duhen përmbushur para se të dërgojnë te Komisioni kërkesën për të marrë detyra zbatimi.

(3) Agjencia IPARD mban dokumentet që justifikojnë pagesat e kryera dhe dokumente në lidhje me kryerjen e verifikimeve të parashikuara administrative dhe fizike. Në rastet kur dokumentet përkatëse mbahen nga zyra vendore apo organe të deleguara, këto zyra apo organe i dërgojnë rregullisht raporte Agjencisë IPARD mbi numrin e verifikimeve të kryera, përmbajtjen e tyre dhe masat e marrë nën dritën e rezultateve.

(4) ZKA-ja garanton që sistemet kontabël të Fondit Kombëtar dhe të Agjencisë IPARD përmbushin parimet kontabël të pranuar ndërkombëtarisht.

(5) ZKA-ja bindet që modalitetet administrative dhe të kontrollit të brendshëm të Autoritetet Menaxhues ofrojnë garancitë e mëposhtme:

(c) dokumentet e kërkuara dorëzohen brenda afatit dhe në formën e parashikuar nga Marrëveshjet apo nga procedurat e miratuara;

(d) dokumentet mund të gjenden dhe mbahen në mënyrë të tillë që garanton plotësinë, vlefshmërinë dhe lexueshmërinë e tyre me kalimin e kohës, përfshi edhe dokumentet elektronike sipas kuptimit të Marrëveshjeve.

(6) Shqyrtimet e nevojshme për qëllimet e nënparagrafit (1) dhe (5) kryhen sipas metodave kryesisht të barasvlershme me standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht.

(7) Kërkesa për marrjen e detyrave të zbatimit të buxhetit i dorëzohet Komisionit, në pajtim me nenin 25. Kërkesa përmban rezultatet e shqyrtimeve të nevojshme për qëllimet e paragrafit (1) dhe (5) të këtij neni.

(8) ZKA-ja garanton që çfarëdo ndryshimi thelbësor në modalitetet e punës të përcaktuara në nenin 7, pika 3, para se të zbatohen, t'i dorëzohet Komisionit, me një kopje për Autoritetin Auditues, për shqyrtim dhe miratim.

Ndryshim thelbësor cilësohet çfarëdo ndryshimi që iu bëhet sistemeve kombëtare përkatëse pas marrjes së detyrave të zbatimit të buxhetit, ndryshime këto që mund të prekin qenësisht strukturat zbatuese dhe sistemet e paraqitura fillimisht si pjesë e kërkesës.

(9) ZKA-ja mban strukturën menaxhuese dhe strukturën operuese nën mbikëqyrje të vazhdueshme, në përputhje me nenin 14, pika 1 të MK-së.

(10) Shqipëria ngre një sistem që garanton njoftimin e menjëhershëm të ZKA, nëse ka informacione që sugjerojnë se struktura menaxhuese apo struktura operuese nuk respektojnë kriteret.

Neni 25 Kërkesa dhe shtojcat mbështetëse

ZKA-ja ia dërgon kërkesën Komisionit për të marrë detyrat e zbatimit të buxhetit sipas nenit 13 të MK-së, bashkë me dokumentet e përcaktuara në Shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje. Një kopje e kësaj kërkesë dhe e dokumenteve mbështetëse i dërgohet Autoritetit Auditues.

SEKSIONI III RREGULLAT E PROGRAMIMIT

Neni 26 Programi IPARD II

Sipas nenit 16, pika 5 të MK-së, masat e zhvillimit rural që i përkasin fushës së bujqësisë dhe zhvillimit rural janë subjekt i një programi që hartohet në nivel kombëtar dhe që përfshin të gjithë periudhën e zbatimit të asistencës IPA II. Programi përgatitet nga autoritetet përkatëse të autorizuar nga Shqipëria dhe i dorëzohet Komisionit pas konsultimit me palët e interesuara. Programet e zhvillimit rural zbatohen nga Shqipëria mbi bazën e menaxhimit indirekt, sipas nenit 58, pika 1, germa c) e Rregullores (BE, EURATOM) nr. 966/2012 dhe përcaktojnë masat që do të financohen prej asistencës IPA II. Tipet e përzgjedhura të masave duhet të kenë natyrë të ngjashme me ato të parashikuara në Rregulloren (BE) nr. 1305/2013.

Neni 27 Masat e Programit IPARD II

(1) Në përputhje me objektivat e përcaktuar në nenin 16, pika 5 të MK-së, programi IPARD II mund të mbështetë masat e mëposhtme për adresimin e prioritetëve tematike të parashtruara në germat (j), (k) dhe (l) të Shtojcës I të MK-së:

- (12) investime në aktive fizike të njësive ekonomike bujqësore;
- (13) mbështetje për ngritjen e grupeve të prodhuesve;
- (14) investime në aktive fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe të peshkimit;
- (15) masa agro-mjedisore-klimatike dhe të bujqësisë organike;
- (16) zbatimi i strategjive të zhvillimit vendor – përfaqja LEADER;
- (17) investime në infrastrukturën publike rurale;
- (18) diversifikim të fermës dhe zhvillim biznesi;
- (19) përmirësim të trajnimit;
- (20) asistencë teknike;
- (21) shërbime këshillimore;
- (22) pyllëzim dhe mbrojtje të pyjeve.

Informacion i mëtejshëm për masat jepet në Shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD përcaktojnë vlerësimin *ex ante* që duhet bërë verifikueshmërinë dhe kontrollueshmërinë e masave që do të përfshihen në programin IPARD II. Gjithashtu, Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD marrin përsipër vlerësimin e verifikueshmërisë dhe kontrollueshmërisë së masave gjatë zbatimit të programit IPARD II. Vlerësimi *ex ante* dhe vlerësimi gjatë periudhës së zbatimit merr parasysh, sipas rastit, rezultatet e verifikimeve gjatë periudhës së programimit aktuale dhe të mëparshme. Kur nga vlerësimet rezultojnë se nuk janë përmbushur kërkesat e verifikueshmërisë dhe kontrollueshmërisë, masat në fjalë rregullohen si është e nevojshme.

SEKSIONI IV RREGULLAT E ZBATIMIT

TITULLI 1 RREGULLAT E PËRGJITHSHME DHE PARIMET E ZBATIMIT

Neni 28 Rregullat për prokurimin

(1) Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, autoriteti kontraktues i përcaktuar në nenin 190, pika 2 të Rregullores (BE, Euroatom) nr. 966/2012 është një organ kombëtar i sektorit publik, që është përfituesi i asistencës në kuadrin e programit IPARD II.

Megjithatë, prokurimi publik mund të bëhet për llogari të përfituesit nga një organ kombëtar i sektorit publik që i akordohet posaçërisht kjo detyrë.

(2) Për prokurimet në kuadrin e programeve IPARD II sipas nenit 18, pika 5 të MK-së, e drejta e brendshme

konsiderohet e barasvlershme me rregullat e zbatuara prej Komisionit në zbatim të Rregullores (BE, EUROATOM) nr. 966/2012 nëse saktësia e transpozimit konfirmohet nga shërbimi përkatës i Komisionit.

TITULLI 2 TRANSPARENCA DHE VIZIBILITETI

Neni 29 Informimi, publiciteti dhe transparenca

(1) Shqipëria jep informacion dhe bën publicitet të programit IPARD II dhe të kontributit të BE-së, sipas Shtojcës 8. Grupi i synuar për t'u informuar është publiku i gjerë. Informacioni nënvizon rolin e BE-së dhe garanton transparencë të asistencës së BE-së.

(2) Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për:

(d) hartimin e një plani me aktivitetet për vizibilitetin dhe komunikimin, sipas nenit 30;

(e) ngritjen e një faqeje interneti apo portali interneti që jep informacion dhe akses në programin IPARD II të Shqipërisë, përfshi informacion për afatet e zbatimit të programimit dhe çdo proces konsultimi publik për këtë qëllim;

(f) informimin e përfituesve potencialë për mundësitë e financimit që ofron programi IPARD II.

(3) Me qëllim që të garantohet transparenca për mbështetjen e IPARD, Agjencia IPARD është përgjegjëse për publikimin e listës së operacioneve dhe përfituesve të asistencës IPA II, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 23, pika 2 të MK-së.

Publikimi bëhet në format Excel, që mundëson ndarjen, kërkimin, nxjerrjen, krahasimin dhe publikimin e lehtë në internet të të dhënave, për shembull në format CSV apo XML. Lista e operacioneve duhet të gjendet në faqen e internetit apo në portalin e internetit. Informacioni minimal që duhet të përmbajë lista e operacioneve është përcaktuar në Shtojcën 8 të kësaj Marrëveshjeje.

(4) Lista e operacioneve dhe përfituesve përditësohet të paktën çdo gjashtë muaj.

(5) Agjencia IPARD informon përfituesit e asistencës IPARD II për kontributin e BE-së.

(6) Sipas nenit 23, pika 3 të MK-së, vetëm njoftimet për tendera për kontrata publike që janë subjekt i procedurës “ftesë për tender i hapur ndërkombëtar” përgatiten dhe i dërgohen Komisionit për publikim.

Neni 30 Vizibiliteti dhe komunikimi

(1) Aktivitetet për informim dhe publicitet nga Shqipëria për asistencën e dhënë në kuadrin e programit IPARD, sipas nenit 24 të MK-së, zbatohen mbi bazën e një plani me masa vizibilitetit dhe komunikimi që miratohet bashkërisht nga Autoriteti Menaxhues dhe Komisioni. Plani me masa vizibiliteti dhe komunikimi miratohet nga komiteti monitorues i IPARD II, jo më vonë se një vit nga miratimi i programit IPARD II nga Komisioni, dhe përcakton:

- (f) qëllimet dhe grupet e synuara;
- (g) përmbajtjen dhe strategjinë e masave të komunikimit dhe informimit, duke përcaktuar masat që do të ndërmerren;
- (h) buxhetin indikativ të planit;
- (i) departamentet administrative apo organet përgjegjëse për zbatimin e tij;
- (j) kriteret për vlerësimin e ndikimit që kanë masat e informimit dhe publicitetit, në lidhje me transparencën, ndërgjegjësimin rreth programeve IPARD II dhe rolin që luan BE-ja.

Ky plan që mbulon tërë periudhën e programit IPARD II zbatohet mbi bazën e një liste vjetore masash.

(2) Shuma e akorduar për informimin dhe publicitetin mund të jetë pjesë e masave të asistencës teknike të programit IPARD II.

(3) Në mbledhjet e komitetit monitorues të IPARD II, kryetari raportin mbi ecurinë e zbatimit të aktiviteteve të zbatimit dhe informimit, si dhe u paraqet anëtarëve të komitetit shembuj të këtyre aktiviteteve.

(4) Nëse zbatimi i këtij neni kërkon aktivitete specifike zbatimi dhe publiciteti në nivel projekti, këto aktivitete janë përgjegjësi e përfituesve të asistencës IPA II dhe financohet nga shuma e akorduar për projektin përkatës.

SEKSIONI V RREGULLAT E MENAXHIMIT FINANCIAR TË ASISTENCËS IPA II

TITULLI 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 31 Rregulla të përgjithshme për asistencën financiare

(1) Shqipëria bashkëfinancon të gjitha aktivitetet që marrin asistencë prej programit IPARD II. Nëse ekzekutimi i aktiviteve varet nga kontributi financiar prej burimeve vetjake të Shqipërisë apo nga burime të tjera financimi, financimi nga BE-ja bëhet i disponueshëm në momentin kur ky kontribut financiar i Shqipërisë dhe/ose nga burime të financimit bëhet i disponueshëm. Megjithatë, nëse përfituesit i përkasin sektorit publik, kontributi i BE-së mund të jepet më vonë sesa ai i organeve publike të tjera. Në asnjë rast, kontributi i BE-së nuk jepet para kontributit të organeve publike të Shqipërisë.

(2) Kontributi i BE-së bashkëfinancon shpenzimet publike që i janë paguar përfituesit.

(3) Financimi i BE-së është objekt i përmbushjes nga Shqipëria të detyrimeve të përcaktuara në Marrëveshje dhe në Marrëveshjen e Financimit, sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

(4) Llogaria në euro e hapur nga Fondi Kombëtar për Llogari të Shqipërisë, sipas nenit 33, pika 6 të MK-së, bashkë me interesat e gjeneruara nga kjo llogari, nuk i nënshtrohet taksave apo tarifave të tjera

(5) Shqipëria i përcjell Komisionit një kampion të firmave të gjithë aktorëve të përfshirë në kërkesë-pagesë që do të paguhet prej BE-së, siç përcaktohet në nenin 37 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 32 Intensiteti i ndihmës dhe norma e kontributit të BE-së

(4) Për qëllime të programit IPARD II, kontributi i BE-së i parashikuar në nenin 30, pika 2 të MK-së, llogaritet në raport me shpenzimet e pranueshme.

(5) Intensiteti i ndihmës dhe norma e kontributit të BE-së llogaritet në përputhje me normat dhe tavanet e përcaktuara në Shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje.

(6) Për llogaritjen e pjesës së shpenzimeve publike si përqindje e kostot totale të pranueshme të investimit, merret parasysh ndihma kombëtare për të lehtësuar aksesin në huamarrje.

TITULLI 2: PRANUESHMËRIA

Neni 33 Pranueshmëria e shpenzimeve

(1) Çdo kontratë apo shtesë e nënshkruar ose shpenzime të bëra nga përfituesit dhe pagesat e kryera nga Shqipëria Para nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit, nuk janë të pranueshme për financim prej programit IPARD II.

Nënparagrafi i parë nuk zbatohet për masat në kuadër të Asistencës Teknike dhe shpenzimet që lidhen me aktivitete të përcaktuara në paragrafin (5), pika c), në rastet kur shpenzimet janë bërë prej përfituesve para 1 janarit 2014.

(2) Shqipëria i përcjell Komisionit listën e shpenzimeve të pranueshme për çdo masë. Komisioni njofton Shqipërinë që pranon listën, ose i përcjell komentet e veta.

(3) Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme për programin IPARD II:

- m) taksat, përfshi taksat mbi vlerën e shtuar;
- n) detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo detyrim tjetër;
- o) blerjet, dhëniet me qira ose me kredi të truallit dhe godinave ekzistuese, pavarësisht nëse qiradhënia rezulton në transferim të pronësisë të përfituesit të qerasë, përveç se kur parashikohet prej dispozitave të programit IPARD II;
- p) gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;
- q) kostot operacionale;
- r) makineri dhe pajisje të përdorura;
- s) detyrime bankare, kostot për vënie garancie dhe detyrime të ngjashme;
- t) kostot për shkëmbime, detyrime dhe humbje të llogarisë në euro për IPARD, si edhe shpenzime të tjera tërësisht financiare;
- u) kontribute në natyrë;
- v) blerja e të drejtave të prodhimit bujqësor, kafshëve, bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre;
- w) çfarëdo kosto mirëmbajtjeje, zhvlerësimi dhe kosto qiramarrjeje, përveç se kur justifikohet siç duhet nga natyra e masës në programin IPARD II;
- x) kosto dhe pagesa të bëra nga administrata publike në menaxhimin dhe zbatimin e asistencës, përfshi ato të strukturës menaxhuese dhe strukturës operuese dhe, në veçanti, shpenzimet administrative, qiratë dhe pagat e personelit të punësuar për aktivitetet e menaxhimit, zbatimit, monitorimit dhe kontrollit, përveç se kur justifikohet siç duhet nga natyra e masës në programin IPARD II.

(4) Përveç se kur Komisioni shprehet dhe vendos qartësisht ndryshe, edhe shpenzimet e mëposhtme nuk janë të pranueshme:

- d) shpenzimet për projekte që, para përfundimit, u kanë ngarkuar tarifa përdoruesve apo disa përfituesve, përveç rasteve kur tarifat e arkëtuara janë zbritur nga kostot e pretenduara;

- e) kostot promocionale, përveç atyre për interesin kolektiv;
- f) shpenzimet e bëra nga një përfitues, kapitali i të cilit zotërohet mbi 25% nga një apo disa organe publike, përveç se kur Komisioni e ka miratuar në një rast specifik mbi bazën e një kërkesë të argumentuar plotësisht nga Shqipëria. Komisioni e merr vendimin brenda tre muajsh nga marrja e kërkesës. Ky përjashtim nuk aplikohet për shpenzimet në infrastrukturë, përqasjen LEADER apo kapitelin njerëzor.

(5) Pa cenuar paragrafët (2) dhe (3), në rastin e investimeve:

- d) ndërtimi ose përmirësimi i pasurive të paluajtshme është i pranueshëm, deri në vlerën e tregut të aktivitetit, siç përcaktohet në nenin 11, pika 2, germa f) dhe në nenin 11, pika 3 dhe germa d);
- e) blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja, përfshi softuerët kompjuterikë, është e pranueshme, deri në vlerën e tregut të aktivitetit, siç përcaktohet në nenin 11, pika 2, germa f) dhe në nenin 11, pika 3, germa d);
- f) kostot e përgjithshme që lidhen me shpenzimet e përcaktuara në pikat a) dhe b) siç janë tarifatat e arkitektëve, inxhinierëve dhe konsulencave të tjera dhe studimeve të fizibilitetit janë të pranueshme deri në tavanin prej 12% të kostove të përcaktuara në pikat a) dhe b) nën këto kushte:
 - v) shuma e pranueshme e kostove të përgjithshme nuk duhet të tejkalojë kostot e arsyeshme të përcaktuara, siç përcaktohet në nenin 11, pika 2, germa f) dhe në nenin 11, pika 3, germa d);
 - vi) për projektet me shpenzime të pranueshme të investimeve të përcaktuara në pikat a) dhe b) prej mbi 3 milion EURO, kostot e përgatitjes së planit të biznesit nuk duhet të tejkalojnë 3% të shpenzimeve të pranueshme të këtyre investimeve;
 - vii) për projektet me shpenzime të pranueshme të investimeve të përcaktuara në pikat a) dhe b) prej të paktën 1 milion EURO por jo më shumë se 3 milion EURO, kostot e përgatitjes së planit të biznesit nuk duhet të tejkalojnë 4% të shpenzimeve të pranueshme të këtyre investimeve;
 - viii) për projektet me shpenzime të pranueshme të investimeve të përcaktuara në pikat a) dhe b) prej më pak se 1 milion EURO, kostot e përgatitjes së planit të biznesit nuk duhet të tejkalojnë 5% të shpenzimeve të pranueshme të këtyre investimeve.

Dispozitat e hollësishme në lidhje me shumën maksimale të pranueshme që parashikohet në këtë paragraf, përcaktohen në programin IPARD II mbi bazën e një vlerësimi të nivelit të kostove për masa të ngjashme në Shqipëri.

(6) Për qëllime të nenit 31, germa b) të MK-së, modifikime thelbësore të një projekti janë ato që rezultojnë në:

- d) ndërprerjen apo zhvendosjen e një aktiviteti prodhues jashtë zonës gjeografike të mbuluar prej programit IPARD II;
- e) ndryshim të pronësisë që i jep avantazh të padrejtë një firme apo organi publik;
- f) ndryshim thelbësor që prek natyrën, objektivat apo kushtet e zbatimit, që çojnë në cenimin e objektivave fillestarë.

Nëse një modifikim i tillë zbulohet nga Shqipëria, ky i fundit informon menjëherë Komisionin dhe fillon rikuperimin

e kontributit IPARD II sipas nenit 50, pika 1 të kësaj Marrëveshjeje.

(7) ZKA-ja mban përgjegjësinë e përgjithshme dhe detyrimin për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve përkatëse, si dhe aplikon rregullimet financiar sipas nenit 42 të MK-së. Në rast se Komisioni vendos se shpenzimet e deklaruar nuk janë plotësisht në përputhje me Marrëveshjet dhe veçanërisht me parimet e përcaktuara në këtë nen, vlerëson shumat që duhen përjashtuar nga financimi i BE-së sipas nenit 49 të kësaj Marrëveshjeje.

TITULLI 3: FINANCIMI DHE PAGESAT

Neni 34 Anulimi i fondeve të papërdorura

(1) Komisioni automatikisht anulon çdo pjesë të fondit buxhetor të akorduar për programin IPARD II që, deri më 31 dhjetor të vitit të tretë pas vitit buxhetor kur është akorduar, më poshtë e referuar si “n+3”, nuk është përdorur për qëllimin e parafinancimit sipas nenit 38 të Marrëveshjes apo për bërjen e pagesave të ndërmjetme sipas nenit 37 të kësaj Marrëveshjeje, ose për të cilën ZKA-ja - të cilit i janë dhënë detyra të zbatimit të buxhetit - nuk ka paraqitur kërkesë-pagesë që përfshin një deklaratë shpenzimesh të certifikuar sipas nenit 35, pika 1 të MK-së dhe nenit 37, pika 1 të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Në rastet e justifikuara siç duhet, me pëlqimin e Komisionit, kjo periudhë prej tre vitesh e përcaktuar në paragrafin (1) mund të zgjerohet deri në pesë vite në Marrëveshjen e Financimit që parashikohet në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

(3) Jo më vonë se fundi i muajit mars të vitit aktual financiar, Komisioni informon Shqipërinë për çdo risk anulimi fondesh nisur nga informacioni i marrë prej Shqipërisë, sipas nenit 33, pika 3 të MK-së dhe mbi bazën e nevojës për marrjen e vendimeve për korrigjimin e kësaj situate.

(4) Bazuar në kërkesë-pagesat që Shqipëria dorëzon sipas nenit 37, pika 4, germat b) dhe c), Komisioni sërish informon Shqipërinë në kohën e duhur për çdo risk anulimi automatik fondesh.

(5) Pas marrjes së kërkesë-pagesës së përcaktuar në nenin 37, pika 4, germat d), në janarin e vitit pas vitit n+3, Komisioni informon Shqipërinë për shumën që preket nga rregulli i anulimit automatik, mbi bazën e informacioni që ka në dispozicion Komisioni.

(6) Deri në fund të marsit të vitit pas vitit n+3, Komisioni i përcjell një letër Shqipërisë ku i kërkon të konfirmojë shumën që preket nga rregulli i anulimit automatik, ose të dërgojë brenda dy muajsh komente në lidhje me letrën bashkë me planin e financimit të rishikuar.

Neni 35 Plani i financimit për programin IPARD II

(1) Plani i financimit i programit IPARD II përcakton, në veçanti, shumën maksimale të kontributit të BE-së, ndarjen e tij për çdo vit, normat e bashkëfinancimit të zbatueshme për çdo masë dhe, për qëllime të monitorimit të Programimit, ndarjen sipas masave.

(2) Agjencia IPARD fillon kontraktimin dhe kryerjen e pagesave vetëm pasi programi IPARD II të miratohet nga Komisioni dhe pasi të hyjë në fuqi Marrëveshja e Financimit e përcaktuar në nenin 3, bashkë me dhënien e detyrave të zbatimit të buxhetit.

Neni 36 Pagimi i kontributit të BE-së

(1) Objekt i bashkëfinancimit nga BE-ja është vetëm asistenca e dhënë nga programi IPARD II sipas marrëveshjes dhe e paguar nga Agjencia IPARD.

(2) Në zbatim të dispozitave të çdo mase të programit dhe për opsionet me thjeshtim të kostove sipas pikave b), c) dhe d) dhe siç përcakton Agjencia IPARD para thirrjes për aplikime, pagesat që bën Komisioni nga kontributi i BE-së mbulojnë:

- e) kostot e pranueshme të paguara prej përfituesve;
- f) kostot e njësisë standard;
- g) shuma të plota që nuk tejkalojnë 100 000 EURO, për përfitues, për vit, të kontributit publik;
- h) financim me normë fikse, e përcaktuar nga aplikimi i një përqindjeje ndaj një apo disa kategori kostosh.

(3) Nëse ndihma jepet në bazë të opsioneve të kostove të thjeshtuara sipas paragrafëve (2) pikat b), c) dhe d) ose kostove shtesë dhe mosrealizim të të ardhurave, Shqipëria garanton që llogaritjet përkatëse janë të mjaftueshme dhe të sakta dhe të bëra paraprakisht mbi bazë të drejtë, të barabartë dhe të verifikueshme. Për këtë qëllim, duhet konfirmimi për mjaftueshmërinë dhe saktësinë e llogaritjeve nga një organ funksionalisht i pavarur nga autoritetet

përgjegjëse për zbatimin e programit IPARD II dhe që zotëron ekspertizën e duhur. Për qëllime informimi, dokumentet përkatëse i vihen në dispozicion Komisionit para zbatimit të opsioneve të kostove të thjeshtuara.

(4) Pagesat e kontributit të BE-së nga Komisioni bëhen brenda kufijve të fondeve në dispozicion, sipas Marrëveshjes së Financimit të përmendur në nenin 3. Çdo pagesë autorizohet për kërkesë-pagesat më të vjetra që janë bërë për programin IPARD II.

(5) Totali i parafinancimit dhe i pagesave të ndërmjetme nuk duhet të tejkalojë 95% të kontributit të BE-së, siç parashikohet në tabelën e financimit të programit IPARD II.

(6) Nëse arrihet taveni i përcaktuar në paragrafin (5), ZKA-ja vazhdon t'i përcjellë Komisionit kërkesë-pagesat bashkë me deklaratën e shpenzimeve të certifikuar sipas nenit 37, si edhe informacion mbi shumat e mbuluara.

(7) Shpenzimet e paguara nga përfituesit duhet të mbështeten me faturat përkatëse, ose dokumente kontabël që vërtetojnë pagesën. Nëse asistenca nuk është funksion i shpenzimeve, mund të pranohen dokumente të tjera të përshtatshme që specifikohen në programin IPARD II. Në çdo rast, shpenzimet duhet të certifikohen prej ZKA-së.

NENI 37 KËRKESË-PAGESAT NGA SHQIPËRIA

(1) Kërkesë-pagesat për programin IPARD II bëhen nga ZKA-ja. Këto kërkesa duhet të kenë deklaratat e shpenzimeve të certifikuar, siç përcakton Klauzola 2, pika 3 e Shtojcës A të MK-së dhe mbulojnë, për çdo masë të programit IPARD II, shumën e pranueshme të shpenzimeve publike për të cilën Agjencia IPARD ka paguar kontributin përkatës të BE-së gjatë periudhës referuese.

(2) Kërkesë-pagesat hartohen sipas modelit në Shtojcën 5. Ato duhet të jenë të firmosura dhe të certifikuar, dhe ZKA-ja ia përcjell Komisionit për llogari të Shqipërisë, duke i dërguar kopje edhe Autoritetit Auditues.

(3) Në mbyllje të programit, ZKA-ja përgatit një deklaratë përfundimtare të shpenzimeve.

(4) Sapo përmbushen kushtet e nenit 35, pika 2, Shqipëria i dorëzon Komisionit kërkesë-pagesat e veta brenda

afateve të mëposhtme:

- e) deri maksimumi më 30 prill, në rastin e shpenzimeve në periudhën 1 janar – 31 mars;
- f) deri maksimumi më 31 korrik, në rastin e shpenzimeve në periudhën 1 prill – 30 qershor;
- g) deri maksimumi më 31 tetor, në rastin e shpenzimeve në periudhën 1 korrik – 30 shtator;
- h) deri maksimumi më 31 janar, në rastin e shpenzimeve në periudhën 1 tetor – 31 dhjetor.

Shqipëria mund të modifikojë të dhënat e deklaruara në kërkesë-pagesa në deklaratën vjetore të shpenzimeve që dorëzohet deri më 15 shkurt të vitit financiar pas vitit në të cilin është bërë shpenzimi. Në raste të justifikuara siç duhet, Komisioni mund të lejojë Shqipërinë që, në deklaratën përfundimtare të shpenzimeve, të deklarojë shpenzime nga vite financiare të mëparshme, sipas paragrafit (3). Shpenzime nga vite financiare të mëparshme duhet të shoqërohen me një opinion dhe raportin e Autoritetit Auditues dhe përfshirja e tyre në deklaratën përfundimtare nuk cenon pranimin e vendimeve për llogaritë, në zbatim të neneve 48 dhe 49.

Kërkesat dërgohen edhe për rastet kur nuk kërkohet rimbursim.

(5) Shqipëria duhet të japë informacion shtesë kur ka mosmarrëveshje, apo diferenca në interpretim apo në lidhje me kërkesë-pagesat për një periudhë referuese, që rezultojnë veçanërisht nga mospërcjellja e informacionit të kërkuar në Marrëveshjet dhe këto kërkojnë kontrolle shtesë. Ky informacion jepet në zbatim të nenit 33 të MK-së dhe nenet 38 dhe 40 të Marrëveshjes.

Afati për pagesën i përcaktuar në paragrafin (6) mundet, në raste të tilla, të ndërpritet për të gjithë apo një pjesë të shumës që kërkohet rimbursim, dhe kjo ndërprerje përfshin periudhën nga data kur është dërguar kërkesë për informacion deri në marrjen e informacionit të kërkuar.

Nëse nuk gjendet një zgjidhje gjatë këtij afati, Komisioni mund të ndërpresë apo të pezullojë pagesat në zbatim të neneve 39 dhe 40 të MK-së.

(6) Pagesat e ndërmjetme bëhen prej Komisionit brenda 90 ditësh nga regjistrimi i kërkesë-pagesës për të cilën janë përmbushur kërkesat e parashikuara në nenin 35 të MK-së, pa cenuar vendimet e përcaktuara në nenet 48 dhe 49 të kësaj Marrëveshjeje, me kusht që:

- e) shpenzimet e deklaruara të jenë të pranueshme për financim nga BE-ja, sipas nenit 33 të kësaj Marrëveshjeje;

- f) kontrollet në nenin 41 të kësaj Marrëveshjeje nuk kanë konstatuar ndonjë problem;
- g) nuk është vendosur ndërprerje apo pezullim i pagesave në lidhje me masa që janë objekt i aplikimit në fjalë;
- h) ka fonde në dispozicion.

Neni 38 Parafinancimi

(1) Pagesat e parafinancimit të përcaktuara në nenin 34 të MK-së mund të arrijnë në 30% të kontributit të BE-së për tre vitet më të fundit të programit IPARD II, siç parashikon Marrëveshja e Financimit. Parafinancimi mund të paguhet në dy apo më shumë kështe, me kusht që të ketë fonde buxhetore në dispozicion.

(2) Komisioni bën një pagesë fillestare parafinancimi, si kështu i parë, që është të paktën sa 50% e shumës së përcaktuar në paragrafin (1).

Kështu shtesë mund të paguhet mbi bazën e kërkesës së Shqipërisë, në zbatim të kërkesave që parashikojnë paragrafët (1) dhe(4).

(3) Nëse pagesat e parafinancimit të parashikuara në paragrafin (1) mund të rriten, nëse nuk janë të mjaftueshme për të garantuar pagimin në kohë të kërkesë-pagesave të përfituesve. Kjo rritje bëhet deri në shumën e nevojshme për këtë qëllim. Ajo bazohet në shumën e shpenzimeve të vërtetuara që kanë bërë përfituesit, por që nuk janë shlyer akoma për shkak të mbarimit të fondeve të BE-së në llogarinë IPARD në euro. Sidoqoftë, shuma kumulative e pagesave për parafinancimit nuk duhet të tejkalojë 30% të kontributit të BE-së për tre vitet më të fundit të përcaktuara prej Marrëveshjes së Financimit.

(4) Shuma totale e paguar si parafinancim i rimbursohet Komisionit, nëse nuk dorëzohet asnjë kërkesë-pagesë për programin IPARD II brenda 15 muajsh nga data kur Komisioni ka bërë të parën pagesë të parafinancimit. Kontributi i BE-së për programin IPARD II nuk cenohet nga rimbursimi i tillë.

Neni 39 Llogaritja e shumës që duhet të paguhet

(1) Kontributi i BE-së që paguhet në lidhje me shpenzimet publike të pranueshme të deklaruara për secilën masë dhe për çdo periudhë referuese llogaritet në bazë të planit të financimit në fuqi në ditën e parë të asaj periudhe.

(2) Shumat e kontributit të BE-së që rikuperohen prej përfituesve në kuadrin e programit IPARD II gjatë secilës periudhë referuese dhe borxhet që nuk janë mbledhur brenda dy vitesh nga regjistrimi i tyre në librin kontabël, siç parashikon neni 47, pika 6 e kësaj Marrëveshjeje dhe Klauzola 4(3)(b)(ix) e Shtojcës A të MK-së, zbriten nga shuma që duhet të paguajë Komisioni në kërkesë-pagesën për atë periudhë, në zbatim të nenit 50 të kësaj Marrëveshjeje.

(3) Pa cenuar tavanin 95% siç parashikohet në nenin 36, pika 5, kur totali i shpenzimeve tejkalon totalin e programuar për një masë të caktuar, paguhet maksimumi i shumës që është programuar për atë masë në planin e financimit në fuqi. Shpenzimet e përjashtuara si rezultat i kësaj, mund të merren parasysh në një kërkesë-pagesë pasuese, me kusht që Shqipëria të dorëzojë pranë Komisionit një plan financimi të modifikuar dhe ky i fundit ta ketë pranuar.

Neni 40 Pagimi i bilancit përfundimtar

(1) Për pagimin e bilancit përfundimtar të përcaktuar në nenin 37 të MK-së, zbatohet afati i përcaktuar në nenin 34, pika 2 të kësaj Marrëveshjeje, siç parashikon Marrëveshja e Financimit.

(2) Pagimi i bilancit përfundimtar nuk cenon miratimin e vendimeve pasuese në zbatim të nenit 49.

(3) Pagimi nuk cenon as ndjekjen e dispozitave të nenit 41, pika 4, nenit 44 dhe nenit 50.

(4) Pas dërgimit të kërkesë-pagesës së fundit Komisionit, Shqipëria nuk mund të bëjë më transaksione financiare me llogarinë IPARD në euro. Shqipëria garanton respektimin e kërkesave të përcaktuara në nenin 37, pika 1 të MK-së, deri në përmbushjen e kërkesave të parashtruara në nenin 44 të Marrëveshjes. Për sa i përket nenit 50 të kësaj Marrëveshjeje, i jepet informacion Komisionit kurdo që shumat e rikuperuara regjistrohen në llogaritë kombëtare.

(5) Shqipëria ngre një sistem i mundëson ndjekjen e zbatimit të kërkesave të paragrafit (4). Shqipëria identifikon organin përgjegjës dhe informon Komisionin për modalitetet praktike në lidhje me transferimin e përgjegjësve këtij organi.

Neni 41 Pagesat që iu bëhen përfituesve

(1) Shqipëria garanton që pagesat iu bëhen përfituesve:

- c) në monedhën kombëtare dhe përmes llogarisë IPARD në euro. Si rregull, urdhër-pagesat apo çdo dokument tjetër që vërteton se përfituesi(t) apo të autorizuarit e tij/e tyre lëshohen brenda tre ditëve pune të kësaj debie;
- d) bazuar në deklaratat e shpenzimeve që përfituesi ka bërë dhe të evidentuara me fatura origjinale. Nëse asistenca nuk është funksion i shpenzimeve, mund të pranohen dokumente të tjera të përshtatshme që specifikohen në programin IPARD II.

(2) Shpenzimet janë të pranueshme kur përmbushin kërkesat e nenit 33, pika 1.

(3) Pagesat bëhen me transfertë bankare te llogaria në emër të përfituesit. Pagesat për përfituesit nuk mund të konfiskohen, bllokohen ose rregullohen në asnjë mënyrë në vend të detyrimit të borxhit të një marrësit. Agjencia IPARD mund që/ edhe të vendos pezullimin e pagesave, për çdo shumë të mbuluar nga përfituesi që lidhen me asistencën financiare në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit.

(4) Nëse Agjencia IPARD merr fatura origjinale dhe dokumente të tjera të përcaktuara në paragrafin (1), pika b) por nuk i mban ato, Agjencia IPARD sigurohet që të mbajë kopjet dhe që origjinalet do të vihen në dispozicion për qëllime auditi dhe inspektimi.

(5) ZKA-ja dhe Agjencia IPARD garantojnë që totali i shpenzimeve publike të të gjitha organeve publike të Shqipërisë për çdo masë dhe projekt të jenë të identifikueshme në llogaritë kontabël të Agjencisë IPARD.

(6) Agjencia IPARD ruan të dhënat për secilën pagesë ku duhet të ketë informacion të paktën mbi:

- c) shumën në monedhën kombëtare;
- d) shumën e barasvlershme në euro.

(7) Raporti i kontributit të BE-së dhe kontributit kombëtar ndaj shpenzimeve publike, si edhe i totalit të shpenzimeve publike ndaj totalit të shpenzimeve të pranueshme, llogaritet në monedhën kombëtare.

(8) ZKA-ja dhe Agjencia IPARD garantojnë se çdo shumë që është paguar më tepër sesa duhet dhe që është përfshirë në deklaratat e shpenzimeve të certifikuara sipas nenit 37, të transferohen brenda dhjetë ditë pune në

Ilogarinë IPARD në Euro dhe të zbriten nga kërkesë-pagesa e radhës që i dorëzohet Komisionit.

(9) ZKA-ja dhe Agjencia IPARD garantojnë trajtimin në kohë të kërkesë-pagesave që marrin prej përfituesve. Në rastet kur intervali ndërmjet marrjes së kërkesë-pagesës dhe nxjerrjes së urdhër-pagesës tejkalon 6 muaj, bashkëfinancimi i BE-së mund të reduktohet sipas këtyre rregullave:

- c) nëse shpenzimet e kryera pas afatit janë jo më shumë se 4% të shpenzimeve të kryera para afatit, nuk bëhen reduktimi, pavarësisht se sa muaj është vonesa;
- d) kur shpenzimet e kryera pas afatit janë më shumë se 4% të shpenzimeve të kryera para afatit, të gjitha shpenzimet e mëtejshme të kryera me vonesë deri në:
 - vi) një muaj, reduktohen me 10%;
 - vii) dy muaj, reduktohen me 25%;
 - viii) tre muaj, reduktohen me 45%;
 - ix) katër muaj, reduktohen me 70%;
 - x) pesë muaj ose më shumë, reduktohen me 100%.

Për qëllime të këtij paragrafi, marrja e kërkesë-pagesës konsiderohet data kur kërkesë-pagesa e bërë prej përfituesit merret nga shërbimet përkatëse të Shqipërisë, pavarësisht nëse kërkesë-pagesave, në momentin e marrjes, ka të gjithë dokumentet mbështetëse të nevojshme për bërjen e pagesave. Agjencia IPARD miraton procedurat që garantojnë se dokumentet e munguara të merren prej përfituesve në kohë për pagesën që bëhet në zbatim të nënparagrafit të parë.

Komisioni mund të aplikojë shkallë kohore të ndryshme dhe/ose reduktime më të ulëta apo zero, nëse për masa të caktuara konstatohen kushte menaxhimi të jashtëzakonshme, apo nëse Shqipëria jep justifikime të mirë-bazuara. Vonesat e përfituesve në dorëzimin e dokumenteve që mungojnë në kërkesë-pagesë nuk konsiderohet justifikim i mirë-bazuar. Shqipëria parashikon dispozitat e përshtatshme në kontratat e nënshkruara me përfituesit, ku të përcaktohen afatet e përshtatshme për dorëzimin e dokumenteve që mungojnë.

Para marrjes së vendimit, Komisioni informon Shqipërinë, duke i mundësuar që të japë argumentet e veta brenda 10 ditësh pune. Komisioni informon Shqipërinë për vendimin përfundimtar që ka marrë, ku shpreh arsyetimin mbi të cilin është bazuar vendimi.

Për çdo shpenzim të kryer pas afateve, Shqipëria i dorëzon Komisionit një justifikim të hollësishëm të vonesës, evidenca të shkruara për të mbështetur këtë justifikim, si edhe një demonstrim të marrëdhënies së drejtpërdrejtë

ndërmjet justifikimit dhe shpenzimit përkatës të kryer pas afatit.

(10) Gjatë marrjes së vendimit për anulimin e plotë apo të pjesshëm të kontributit të BE-së, ZKA-ja dhe Agjencia IPARD mbajnë parasysht natyrën e parregullsisë, sa e rëndë është ajo si edhe humbjen financiare që i është shkaktuar kontributit të BE-së.

Neni 42 Kursi i këmbimit dhe interesat

(1) Shqipëria garanton që kursi i këmbimit ndërmjet euros dhe monedhës kombëtare të regjistruar në kontabilitet është kursi kontabël mujor i euros i përcaktuar prej Komisionit për Shqipërinë në muajin gjatë të cilit shpenzimi është regjistruar në kontabilitetin e strukturës operuese. Megjithatë, rregullat e mëposhtme janë të zbatueshme:

- i) për pagesat e Agjencisë IPARD, data e treguar në kontabilitet është data kur urdhër-pagesa i është lëshuar përfituesit;
- j) për pagesat më tepër sesa duhet nga Agjencia IPARD siç parashikon neni 41, pika 8, norma e muajit që i paraprin muajit gjatë të cilit është vënë re fillimisht se është paguar më shumë;
- k) për borxhe ende të parikuperuara, si edhe borxhe që nuk janë shlyer brenda dy viteve nga regjistrimi i librit kontabël të debitorëve sipas nenit 50, norma e muajit që i paraprin muajit gjatë të cilit është vënë re borxhi fillimisht;
- l) për shumat e fiksuara nga auditi i llogarive dhe/ose vendimet për audit konformiteti, norma e muajit që i paraprin muajit në të cilën është marrë Vendimi;
- m) për borxhet dhe interesin e rikuperuar sipas nenit 50, norma e muajit që i paraprin muajit gjatë të cilit është rikuperuar borxhi;
- n) për shumat të parregullta të rikuperuara sipas nenit 51 të MK-së, norma e muajit që i paraprin muajit në të cilën është rikuperuar shumat;
- o) për interesat e fituara në llogaritë e Fondit Kombëtar dhe të Agjencisë IPARD, norma e muajit kur është interesi është kredituar në llogaritë, që duhet të jetë të paktën mujore.
- p) për kufijtë e shkruara në Euro në programin IPARD II për çdo masë, kursi i këmbimit për konvertimin midis Euros dhe monedhës kombëtare do të jetë norma mujore e kontabilitetit të Euros të përcaktuar nga Komisioni për Shqipërinë për muajin paraprak muaji të cilit është bërë thirrja për aplikim.

Pikat (a) deri (h) janë të zbatueshme edhe për rastet e parashikuara në nenin 33, pika 8 të MK-së.

(2) Nëse norma për një muaj nuk publikohet, përdoret norma për muajin më të fundit për të cilin është publikuar.

(3) Nëse nuk respektohen afatet që përcaktojnë Vendimet e marra sipas neneve 48 dhe 49, çdo shumë e

prapambetur gjeneron interes me normën e barabartë me atë të Euriborit për depozitat tremujore të publikuara nga Banka Qendrore Europiane plus 1.5 pikë përqindje. Si normë merret mesatarja mujore e muajit në të cilën janë marrë këto Vendime.

(4) Çfarëdo interesi i gjeneruar nga llogaria IPARD në Euro i përket Shqipërisë. Interesat e gjeneruara nga financimi i programit IPARD II prej BE-së i bashkëngjiten ekskluzivisht programit IPARD II dhe konsiderohen burim për Shqipërinë në formën e kontributit publik kombëtar dhe i deklarohen Komisionit në momentin e mbylljes së programit IPARD II. Në momentin e mbylljes së Programit, çdo interes që nuk është harxhuar në formën e kontributit publik kombëtar i kthehet Komisionit.

TITULLI 4 MBYLLJA E PROGRAMIT

Neni 43 Mbyllja e programit IPARD II

(1) Përveç kërkesave minimale për pagimin e bilancit përfundimtar të parashikuara në nenin 37, pika 1 të MK-së, programi IPARD II konsiderohet i mbyllur për qëllimet e nenit 48 të MK-së, sapo përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

- d) bazuar në pranimin e llogarive të vitit të fundit në fjalë dhe të totalit të viteve të zbatimit të IPARD II, pagimi i bilancit përfundimtar ose lëshimi i një urdhri rikuperimi prej Komisionit;
- e) Komisioni anulon fondet;
- f) mbyllet libri kontabël i debitorëve përcaktuar në Klauzolën 4(3)(b)(ix) të Shtojcës A të MK-së dhe nenin 47, pika 6 dhe nenit 50, pika 6 të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Mbyllja e programit IPARD II nuk prek detyrimet e Shqipërisë të përcaktuara në nenin 41, pika 9 dhe në nenin 50, dhe as detyrimin për të ruajtur dokumentet, sipas nenit 44, dhe nuk cenon një vendim pasues sipas nenit 49.

Neni 44 Ruajtja e dokumenteve

(1) Agjencia IPARD dhe Fondi Kombëtar garantojnë se nëse nuk i ruajnë vetë dokumentet e përcaktuara në nenin 49 të MK-së, ato të mbahen në dispozicion të Komisionit për periudhën e referuar në atë nen. Në rastin e situatave të parashikuara në nenin 43 të MK-së, dokumentet mbështetëse që parashikon neni 49 i MK-së mbahen në dispozicion të Komisionit për të paktën shtatë vite pas vitit kur shumat janë rikuperuar plotësisht prej përfituesve dhe janë kredituar në programin IPARD II, apo në të cilin pasojat financiare të mosrikuperimit shprehen në nenin 50

të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Në rastin e procedurës së verifikimit të konformitetit që parashikon neni 49 i Marrëveshjes, dokumentet mbështetëse të përcaktuara në paragrafin 1 mbahen në dispozicion të Komisionit për të paktën një vit pas mbylljes së procedurës, ose, nëse vendimi i konformitetit është objekt procedimi gjyqësor, për të paktën një vit nga mbyllja e këtij procedimi.

TITULLI 5: KORRIGJIMET FINANCIARE SI DHE SHQYRTIMI E PRANIMI I LLOGARIVE

Neni 45 Përmbajtja e llogarive vjetore

Llogaritë vjetore, që përbëhen nga raportet financiare vjetore dhe deklarata të përcaktuara në nenin 59, pika 2, germa a) e MK-së, përfshijnë:

- e) të ardhurat dhe shpenzimet e programit IPARD II, ku jepen shpenzimet dhe të ardhurat e BE-së, kombëtare dhe totale të përmbledhura sipas masës, të paraqitura me bazë vjetore dhe të dorëzuara përmes Formularit D 2, sipas Shtojcës 6 të kësaj Marrëveshjeje;
- f) tabelat e diferencave të programit IPARD II sipas masave, ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave të deklaruara në llogaritë vjetore, si dhe ato të deklaruara për të njëjtën periudhë në dokumentet që parashikon neni 37 i Marrëveshjes, shoqëruar me një shpjegim për çdo diferencë;
- g) tabela e shumave që do të rikuperohen në fund të vitit financiar (libri kontabël i debitorëve);
- h) listën e të gjitha pagesave të bëra në vitin financiar, sipas Shtojcës 9 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 46 Përcjellja e informacionit të nevojshëm për shqyrtimin dhe pranimin e llogarive

(1) Për qëllimin e shqyrtimit dhe pranimin të llogarive sipas nenit 36 të MK-së, ZKA-ja i dërgon Komisionit:

- c) raportet financiare vjetore dhe deklaratat e përcaktuara në nenin 45 të kësaj Marrëveshjeje, bashkë me ndonjë raport të autoriteteve që veprojnë nën delegim prej strukturave, autoriteteve dhe organeve përkatëse sipas nenit 19, pika 1 dhe 2 të MK-së;
- d) deklaratën e menaxhimit nga ZKA-ja sipas nenit 59, pika 2, germa b) e MK-së, përfshi një përmbledhje të raporteve sipas nenit 59, pika 2, germa c) e MK-së.

(2) Dokumentet e përmendura në pikat a) dhe b) duhet të kenë firmë dhe datë dhe të jenë të certifikuar, si edhe t'i përcillen Komisionit nga ZKA-ja në emër të Shqipërisë, sipas nenit 59, pika 2 të MK-së, duke i dërguar kopje Autoritetit Auditues. Dokumentet dërgohen në një pako të vetme bashkë me një kopje elektronike, në përputhje

me formatin dhe sipas kushteve të përcaktuara prej Komisionit.

(3) Opinionet dhe raportet e Autoritetit Auditues duhet të kenë firmë dhe datë dhe t'i përcillen Komisionit sipas nenit 59, pika 3 të MK-së, duke i dërguar kopje Autoritetit Auditues. Dokumentet dërgohen në një pako të vetme bashkë me një kopje elektronike, në përputhje me formatin dhe sipas kushteve të përcaktuara prej Komisionit.

(4) Me kërkesë të Komisionit apo me nismë të ZKA-së, informacioni shtesë për shqyrtimin dhe pranimin e llogarive i përcillet Komisionit brenda afatit të përcaktuar prej Komisionit, duke pasur parasysh volumin e punës që kërkon mundësimi i atij informacioni. Në mungesë të informacionit, Komisioni mund të shqyrtojë dhe të pranojë llogaritë mbi bazën e informacionit që ka në dispozicion.

Neni 47 Forma dhe përmbajtja e informacionit kontabël

(1) Forma dhe përmbajtja e informacionit kontabël referuar në nenin 46, pika 1, germa a) përcaktohet mbi bazën e parimeve kontabël të pranura ndërkombëtarisht dhe garantojnë që totali i shpenzimeve publike të të gjitha organeve publike të Shqipërisë për çdo masë dhe projekt në kuadrin e Programit IPA II të jenë të identifikueshme në librat dhe të dhënat e Fondit Kombëtar dhe të Agjencisë IPARD me anë të një kodi kontabël atë mjaftueshëm.

(2) Shqipëria duhet të japë informacion shtesë kur ka mosmarrëveshje, apo diferenca në interpretim apo përputhshmëri në lidhje me dokumentet dhe informacionin kontabël të referuar në paragrafin (1) për një periudhë referuese, që rezultojnë veçanërisht nga mospërcjellja e informacionit të kërkuar në këtë Marrëveshje, dhe këto kërkojnë kontrolle shtesë.

(3) Nëse pagesat që duhen bërë në kuadrin e programit IPARD II pengohen nga pretendime financiare ndaj përfituesit, ato konsiderohen të kryera në tërësinë e tyre:

- c) në datën e pagimit të shumës që ende i takon përfituesit, nëse pretendimi është më pak sesa shpenzimi i paguar;
- d) në datën e pagimit të shpenzimit, nëse ky i fundit është më pak ose i barabartë me pretendimin.

(4) Komisioni e përdor informacionin kontabël vetëm për këto dy qëllime:

- c) kryerjen e funksioneve të veta në kuadrin e shqyrtimit dhe pranimit të llogarive apo verifikimit të konformitetit;
- d) monitorimin e zhvillimeve dhe dhënien e parashikimeve në sektorin e bujqësisë;

Të drejtë aksesit në këtë informacion kanë Gjykata Europiane e Auditëve dhe Zyra Europiane Anti-Mashtrim (OLAF).

(5) Urdhër-pagesat të paekzekutuara dhe pagesat që i janë debituar llogarisë dhe pastaj janë rikredituar zbriten, sipas Formularit D2 të Shtojcës 6, nga shpenzimet në lidhje me muajin kur Agjencia IPARD ka raportuar mosekzekutimin apo anulimin.

(6) Shqipëria ngre një sistem, për programin IPARD II, për njohjen e të gjitha shumave dhe për regjistrimin në librin kontabël të debitorëve të të gjitha borxheve të tilla, duke përfshirë parregullsitë para marrjes së tyre. Pa cenuar nenin 41, pika 5 apo ndonjë dispozitë kombëtare në lidhje me rikuperimin e borxheve, çfarëdo kontributi financiar që i ngarkohet BE-së në lidhje me këto shuma, duke përfshirë parregullsi, fshihen në fund të vitit të dytë pas regjistrimit të tij në librin kontabël të debitorëve dhe pasi zbritet nga kërkesë-pagesa e radhës, sipas nenit 39, pika 2. Agjencia IPARD dhe Fondi Kombëtar garantojnë që shumat e rikuperuara të kreditohen në llogarinë IPARD në Euro brenda tre ditëve pune nga data e rikuperimit.

Neni 48 Procedura e shqyrtimit dhe miratimit të llogarive

(1) Vendimi për pranimin e llogarive konfirmon se raportet financiare vjetore dhe deklaratat e referuara në nenin 45, geramat a) dhe c) të përfshira në llogaritë vjetore janë të plota, të sakta dhe të vërteta. Vendimi nuk cenon miratimin e ndonjë vendimi pasues për verifikimin e konformitetit, sipas nenit 49. Vendimi për pranimin e llogarive mbulon edhe bilancin e llogarisë IPARD në euro.

(2) Komisioni i komunikon Shqipërisë rezultatet e analizës që i ka bërë informacionit që i është vënë në dispozicion, bashkë me ndonjë ndryshim që propozon, jo më vonë se 15 korriku pas fundit të vitit financiar.

(3) Shuma e cila, si rezultat i vendimit për pranimin e llogarive, që mund të rikuperohet apo paguhet nga Shqipëria, përcaktohet duke zbritur pagesat e ndërmjetme të vitit financiar në fjalë nga shpenzimet e njohura për të njëjtin vit, sipas paragrafit (1). Kjo shumë zbritet prej Komisionit ose i shtohet pagesës së ndërmjetme pasuese apo pagesës përfundimtare.

(4) Nëse shuma e zbritshme në bazë të një vendimi për miratim llogarish tejkalon nivelin e pagesave të mundshme pasuese, ZKA-ja garanton që shuma e pambuluar prej bilancit t'i kreditohet Komisionit në Euro brenda dy muajsh nga njoftimi i atij vendimi. Megjithatë, Komisioni mundet të vendosë, rast pas rasti, që çdo shumë që i takon t'i kreditohet ta zbresë nga pagesat që duhet t'i bëjë Shqipërisë në kuadrin e ndonjë instrumenti të BE-së.

(5) Ky nen zbatohet *mutatis mutandis* për pagesat e parafinancimit sipas kuptimit të nenit 38.

(6) Neni 84 i MK-së nuk zbatohet për verifikimin financiar.

Neni 49 Verifikimi i konformitetit

(1) Nëse Komisioni konstaton se shpenzimet në kuadrin e programit IPARD II janë bërë në shkelje të rregullave të zbatueshme, vendos se cilat shuma të përjashtohen nga financimi i BE-së.

(2) Komisioni vlerëson shumat që do të përjashtohen duke gjykuar se sa e rëndë është shkelja e moskonformitetit të regjistruar. Komisioni mban parasysh natyrën e shkeljes, sa e rëndë është ajo dhe dëmin financiar që i është shkaktuar BE-së.

(3) Nëse, si rezultat i një hetimi, Komisioni gjykon se shpenzimi nuk është kryer në përputhje me rregullat e zbatueshme, ia komunikon gjetjet e veta ZKA-së dhe i përcakton masat korrigjuese të nevojshme për të garantuar respektimin e tyre në të ardhmen.

Komunikimi do t'i referohet këtij neni. ZKA-ja kthen përgjigje brenda dy muajve nga marrja e komunikimit, duke i dërguar kopje Autoritetit Auditues, dhe Komisioni mund të modifikojë qëndrimin e vet si rrjedhojë e kësaj. Në raste të justifikuara siç duhet, Komisioni mund të pranojë të zgjatë periudhën e kthimit të përgjigjes.

Pas skadimit të afatit për kthimin e përgjigjes, Komisioni mund të kërkojë informacion shtesë dhe, kur është e nevojshme, të thërrasë takim dypalësh.

(4) Brenda dy muajve nga data e marrjes së kërkesës për informacion shtesë apo minutat e takimit dypalësh të referuar në nënparagrafin e tretë të paragrafit (3), ZKA-ja përcjell çdo informacion të kërkuar gjatë takimit apo

ndonjë informacion tjetër që e konsideron të dobishëm për shqyrtimin në vazhdim.

Në raste të justifikuara siç duhet dhe me kërkesë të argumentuar prej ZKA-së, Komisioni mund të autorizojë zgjatjen e periudhës së përcaktuar në nënparagrafin e parë. Kërkesa i drejtohet Komisionit, me kopje për Autoritetin Auditues, para skadimit të asaj periudhe.

Pas skadimit të periudhës së referuar në nënparagrafin e parë, Komisioni ia përcjell formalisht konkluzionet ZKA-së, me një kopje për Autoritetin Auditues, mbi bazën e informacionit të marrë në kuadrin e procedurës së verifikimit të konformitetit. Aty Komisioni vlerëson shpenzimet që parashikon të përjashtojë nga financimi i BE-së. Nëse Komisioni propozon korrigjim financiar, ZKA-së i jepet mundësia të japë një vlerësim të ndikimit financiar aktual të parregullsisë. Vlerësimi i përcillet Komisionit brenda dy muajve nga data e marrjes së propozimit të Komisionit për korrigjim financiar. Në raste të justifikuara siç duhet, Komisioni mund të bjerë dakord për të zgjatur periudhën e kthimit të përgjigjes.

(5) ZKA-ja informon Komisionin, me një kopje për Autoritetin Auditues, për masat korrigjuese që ka ndërmarrë për të garantuar respektimin e rregullave të zbatueshme dhe datën efektive të zbatimit të tyre.

(6) Komisioni mund ta ndërpresë procedurën në çdo moment, pa pasoja financiare për Shqipërinë, nëse pret që efekti financiar i mundshëm nga mosrespektimi i konstatuar nga hulumtimi i referuar në paragrafin (1) nuk tejkalon 10 000 EURO dhe 2% të shpenzimeve përkatëse apo të shumave që do të rikuperohen.

(7) Komisioni bën zbritjen nga financimi i BE-së prej pagesës së ndërmjetme të radhës apo prej pagesës përfundimtare. Megjithatë, Komisioni mund të vendosë një datë tjetër për zbritjet, me kërkesë të Shqipërisë apo kur e kërkon materialiteti i zbritjes.

(8) Në zbatim të nenit 45, pika 1 të MK-së, zbritjet e bëra prej Komisionit nuk i akordohen sërish programit IPARD II.

(9) Neni 84 i MK-së nuk zbatohet për verifikimin e konformitetit.

(1) Rregullimet financiare dhe ripërdorimi i kontributit të BE-së ndërmerren nga ZKA-ja dhe i nënshtrohen kushteve të mëposhtme:

- d) kur zbulohen parregullsi, ZKA-ja e shtrin hulumtimin në të gjitha operacionet që mund të jenë prekur nga këto parregullsi;
- e) ZKA-ja njofton Komisionin për rregullimet përkatëse, me një kopje për Autoritetin Auditues;
- f) Shumat e kontributit të BE-së që anulohen dhe shumat e rikuperuara i akordohen sërish programit IPARD II sipas nenit 45, pika 2 e MK-së.

(2) Nëse llogaritë vjetore janë dërguar, siç parashikohet në nenin 46, ZKA-ja i përcjell Komisionit, me kopje për Autoritetin Auditues, një raport përmbledhës mbi procedurat e rikuperimit të ndërmarra në përgjigje të parregullsisë. Raporti duhet të japë ndarjen e shumave ende të parikuperuara, sipas procedimit administrativ dhe/ose gjyqësor, si dhe sipas vitit kur parregullsia është konstatuar në rrugë administrative apo gjyqësore. Çdo interes i rikuperuar nga Shqipëria që i takon programit IPARD II në lidhje me borxhet e rikuperuara, regjistrohet në llogaritë e Shqipërisë.

(3) Nëse Agjencia IPARD nuk arrin të rikuperojë kontributin e BE-së prej përfituesve brenda dy viteve nga regjistrimi në librin kontabël të debitorëve, ZKA-ja e rimburson te buxheti i BE-së. Kur është e mundur, Komisioni zbrit shumën e rikuperuar nga pagesa e ndërmjetme e radhës apo pagesa përfundimtare që i bën Përfituesit IPA II. Shqipëria garanton që çdo shumë e rikuperuar të kreditohet në llogarinë IPARD në euro brenda tre ditë pune nga data e rikuperimit.

(4) Shqipëria garanton që çdo shumë që do të rikuperohet prej përfituesve sipas nenit 51 të MK-së përcaktohet duke mbajtur parasysh natyrën e parregullsisë, sa e rëndë është ajo si edhe humbjen financiare që i është shkaktuar kontributit të BE-së, që pastaj regjistrohen në kohë në librin kontabël të debitorëve. Nëse Komisioni konstaton se regjistrimi me vonesë i borxheve ka rezultuar në fshirje të një sasive më të vogël të borxheve sipas paragrafit (3), përcakton korrigjimin financiar që duhet të aplikohet në bazë të nenit 49 të kësaj Marrëveshjeje.

(5) Kur ka qenë e mundur të ndikojnë në rikuperimin e përmendur në paragrafin (1), kur totali i kombinuar i deklaratave të shpenzimeve tejkalon kufirin prej 95%, siç parashikohet në nenin 36 (5) të kësaj Marrëveshjeje apo pas pagesës përfundimtare nga Bashkimi për programin IPARD II është bërë, ZKA duhet të kthejë shumat rikthehet në buxhetin e Bashkimit, në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 46 të MK-së.

(5) ZKA-ja rimbursion shumat e rikuperuara në buxhetin e BE-së, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 46 të MK-së, nëse ka qenë e mundur të kryhet rikuperimi i referuar në paragrafin 1 kur totali i deklaratave dhe shpenzimeve ka tejkaluar tavanin prej 95%, siç parashikon neni 36, pika 5 e kësaj Marrëveshjeje, ose pasi BE-ja ka kryer pagesën përfundimtare për programin IPARD II.

(6) Çdo kontribut i BE-së për programin IPARD II që nuk është rikuperuar deri në datën e mbylljen përfundimtare siç parashikon neni 48, pika 1 e MF-së dhe neni 43 i kësaj Marrëveshjeje, fshihet nga libri kontabël i debitorëve dhe shuma përkatëse rimburohet në buxhetin e BE-së. Kjo pagesë nuk cenon miratimin e ndonjë vendi më pas në zbatim të nenit 49 të kësaj Marrëveshjeje.

SEKSIONI VI MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI

TITULLI I: MONITORIMI I PROGRAMIT

Neni 51 Monitorimi i Programit dhe treguesit e programit

(1) Autoriteti Menaxhues dhe Komiteti Monitorues për programin IPARD II (më poshtë i referuar si "Komiteti Monitorues IPARD II") monitoron efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit të programit IPARD II. Ato i raportojnë Komisionit mbi ecurinë e masave.

(2) Programi monitorohet mbi bazën e indikatorëve të paraqitur në programin IPARD II.

Neni 52 Komiteti Monitorues i IPARD-it

(1) Komiteti Monitorues IPARD II që ngrihet pas miratimit të programit, kryesohet nga një përfaqësues i lartë i Shqipërisë, me të drejtë vote.

(2) Komisioni, struktura operuese, ZKA dhe KKIPA marrin pjesë në punimet e Komitetit Monitorues IPARD II pa të drejtë vote.

(3) Për qëllime të nenit 53, pika 2 të MK-së, Komiteti Monitorues IPARD II shqyrton rezultatet e programit IPARD II, në veçanti arritjen e objektivave të përcaktuar për masat e ndryshme dhe ecurinë në shfrytëzimin e alokimeve financiare për këto masa. Në këtë drejtim, Autoriteti Menaxhues garanton që i gjithë informacioni të lidhur me

ecurinë e masave t'i vihet në dispozicion Komitetit Monitorues dhe KKIPA-s.

(4) Komiteti Monitorues IPARD II shqyrton periodikisht progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuar në programin IPARD II. Për këtë qëllim, do t'i jepet në veçanti:

- c) informacion për çdo sektor apo fushë ku janë hasur vështirësi;
- d) informacion mbi rezultatet e verifikimeve të realizuara;

(5) Neni 53, pika 3, germa f) i MK-së interpretohet për Komitetin Monitorues IPARD II në një mënyrën që ky Komitet duhet të shqyrtojë dhe të miratojë, kur është e përshtatshme, çdo propozim të hartuar nga Autoriteti Menaxhues për ndonjë ndryshim në programin IPARD, që i dorëzohet Komisioni me një kopje për KKIPA-n dhe AAK-në.

(6) Pa cenuar nenin 8, pika 4, Komiteti Monitorues IPARD II mundet që, pas konsultimit me Autoritetin Menaxhues dhe Agjencinë IPARD, t'i propozojë Autoritetit Menaxhues dorëzimin pranë Komisionit, me një kopje për KKIPA-n dhe ZKA-në, ndryshimet ose shqyrtimet e programit IPARD II, me qëllim që të garantohet arritja e objektivave të Programit dhe të përmirësohet efikasiteti i asistencës së dhënë.

(7) Komiteti Monitorues IPARD II shqyrton dhe miraton raportet vjetore e përfundimtare të zbatimit, para se t'i dërgohen KKIPA-s për dorëzim pranë Komisionit, me një kopje për ZKA-në dhe Autoritetin Auditues.

(8) Komiteti Monitorues IPARD II shqyrton vlerësimet e programit IPARD II referuar në nenin 57.

(9) Komiteti Monitorues IPARD II shqyrton dhe miraton planin me aktivitetet e vizibilitetit dhe komunikimit të përcaktuara në nenin 30, si dhe çdo përditësim të mëvonshëm të planit.

(10) Për aktivitetet e asistencës teknike në kuadrin e programit IPARD II, merret mendimi i Komitetit Monitorues IPARD II. Ai shqyrton dhe miraton çdo vit një plan veprimi vjetor indikativ për zbatimin e aktiviteteve të asistencës teknike, bashkë me shumatat indikative për qëllime informimi.

(11) Çdo vizitë dhe seminar i bashkëfinancuar nga BE-ja nën masën "Asistencën Teknike" të programit IPARD II kërkon dorëzimin e një raporti me shkrim të Komitetit Monitorues IPARD II.

(12) Komiteti Monitorues IPARD II vepron siç duhet, nëse nga programi IPARD II i kërkohet të japë mendim për ndonjë çështje.

(13) Të gjitha dokumentet përfundimtare të mbledhjeve të Komitetit Monitorues IPARD II bëhen publike.

Neni 53 Indikatorët

(1) Progresi, efienca dhe efektiviteti i programit IPARD II, në lidhje me objektivat, matet me indikatorë që bazohen te situata bazë dhe progresi i arritur në ekzekutimin financiar.

(2) Programi IPARD II specifikon një numër të kufizuar indikatorësh shtesë specifike për këtë program.

TITULLI 2 VLERËSIMI

Neni 54 Parimet për zbatimin e programit IPARD II

(1) Për qëllime të nenit 55 të MK-së, vlerësimet synojnë të përmirësojnë cilësinë, efektivitetin dhe përputhshmërinë e asistencës nga fondet e BE-së, si edhe strategjinë dhe zbatimin e programit IPARD II.

(2) Programi IPARD II i nënshtrohet kontrolleve *ex-ante* dhe *ex-post* dhe, kur Komisioni e gjykon të përshtatshme, i nënshtrohet edhe vlerësimeve të ndërmjetme që kryhen nga vlerësues të pavarur nën përgjegjësinë e Shqipërisë.

(3) Vlerësimet vlerësojnë zbatimin e programit IPARD II drejt arritjes së objektivave të përcaktuar në nenin 16, pika 5 të MK-së.

(4) Vlerësimet shqyrtojnë shkallën e shfrytëzimit të burimeve, efektivitetin dhe efikasitetin e programimit, ndikimin e tij socio-ekonomik dhe ndikimin e tij mbi objektivat dhe prioritetet e përcaktuara. Vlerësimet shtrihen mbi qëllimet e programit IPARD II dhe synojnë të nxjerrin mësim në lidhje me politikën e zhvillimit rural. Ato identifikojnë faktorët që kontribuuan në suksesin apo dështimin e zbatimit të programit IPARD II, si edhe në

qëndrueshmërinë e masave dhe identifikimin e praktikave më të mira.

(5) Raportet e vlerësimit shpjegojnë metodologjinë e përdorur, si edhe përmbajnë një vlerësim të cilësisë së të dhënave dhe gjetjet.

(6) Cilësia dhe implikimet e vlerësimeve vlerësohen nga Autoriteti Menaxhues, Komiteti Monitorues IPARD II dhe Komisioni.

(7) Rezultatet e vlerësimeve *ex-ante* dhe të ndërmjetme merren parasysh në ciklin e programimit dhe zbatimit.

Neni 55 Vlerësimi *ex ante* i programit IPARD II

(1) Vlerësimi *ex-ante* bën pjesë e hartimit të programit IPARD II dhe synon të optimizojë shpërndarjen e burimeve buxhetore dhe të përmirësojë cilësinë e programimit. Vlerësimi identifikon dhe vlerëson nevojat afatmesme dhe afatgjata, qëllimet që duhet të arrihen, rezultatet e pritshme, objektivat sasiorë, vlerën e shtuar të BE-së, masën në të cilën janë marrë parasysh objektivat sipas nenit 16, pika 5 të MK-së, mësimet e nxjerra dhe cilësia e procedurave të zbatimit, monitorimit të programit, vlerësimit dhe menaxhimit financiar.

(2) Shqipëria garanton përfshirjen e vlerësuesit *ex-ante* në procesin e përgatitjes së programit IPARD II, në përgatitjen e analizës SËOT, në hartimin e logjikës ndërrhyrëse të programit dhe në caktimin e objektivave të programit.

(3) Vlerësimi *ex-ante* kryhet nën përgjegjësinë e Shqipërisë.

Neni 56 Plani i vlerësimit për programin IPARD

(1) Autoriteti Menaxhues, në konsultim me KKIPA-n, harton një plan vlerësimi për programin IPARD II, sipas nenit 57 të MK-së Plani i vlerësimit i dorëzohet Komisionit Monitorues jo më vonë se një vit pas miratimit të programit IPARD II nga ana e Komisionit.

(2) Autoriteti Menaxhues dhe Komiteti Monitorues IPARD II e përdorin planin e vlerësimit që:

- e) të shqyrtojnë ecurinë e programit IPARD II në lidhje me qëllimet e tij, përkundrejt rezultateve dhe, sipas rastit, indikatorëve të ndikimit;
- f) të përmirësojnë cilësinë e programit IPARD II dhe zbatimin e tij;
- g) të shqyrtojnë propozimet për ndryshime thelbësore në programin IPARD II;
- h) të përgatiten për vlerësimin e ndërmjetëm dhe *ex-post*.

(3) Autoriteti Menaxhues raporton çdo vit pranë Komitetit Monitorues IPARD II, me një kopje për Autoritetin Auditues, mbi rezultatet e arritura në kuadrin e planit të veprimit. Një përmbledhje e aktiviteteve bashkëngjitet në planin vjetor të referuar në nenin 59.

Neni 57 Vlerësimi i ndërmjetëm

(1) Nëse Komisioni e konsideron si të përshtatshme, një vlerësim i ndërmjetëm kryhet në vitin e tretë pas vitit të miratimit të dhënies për herë të parë të detyrave për zbatimin e buxhetit për programin IPARD II.

(2) Vlerësimi i ndërmjetëm propozon masa për të përmirësuar cilësinë e programit IPARD II dhe zbatimin e tij, kur është e përshtatshme. Në veçanti, Shqipëria garanton që vlerësimi i ndërmjetëm të shqyrtojë rezultatet e para të programit IPARD II, përputhshmërinë e tyre me vlerësimin *ex-ante*, rëndësinë e synimeve dhe objektivave dhe masën në të cilën ato janë arritur. Gjithashtu, vlerëson cilësinë e monitorimit dhe zbatimit të Programit, si dhe përvojën e fituar në ngritjen e sistemit për zbatimin e programit IPARD II.

(3) Vlerësimi i ndërmjetëm i dorëzohet Komitetit Monitorues IPARD II dhe Komisionit deri më 31 dhjetor të vitit të referuar në paragrafin (1).

(4) Përveç vlerësimit të referuar në nenin 54, pika 7, Komiteti Monitorues IPARD II, Autoriteti Menaxhues dhe Komisioni marrin parasysh implikimet e vlerësimit, me qëllim rishikimin e programit IPARD II.

(5) Në raportin e vlerësimit, Autoriteti Menaxhues informon Komisionin për ndjekjen e rekomandimeve. Nëse Shqipëria nuk e dorëzon raportin e vlerësimit të ndërmjetëm deri në datën e referuar në paragrafin 3, zbatohet neni 37, pika 5.

Neni 58 Vlerësimi *ex-post*

(1) Shqipëria përgatit për programin IPARD II një vlerësim *ex-post* jo më vonë se fundi i vitit të parë pas periudhës së zbatimit të programit. Ky raport përgatitet dhe i dorëzohet Komisionit jo më vonë se fundi i atij viti.

(2) Mbi bazën e rezultateve të vlerësimit të vënë në dispozicion dhe çështjeve të vlerësimit që lidhen me programin IPARD II, vlerësimi *ex-post* mbulon shfrytëzimin e burimeve dhe efektivitetin e efikasitetin e programit IPARD II, ndikimin e tij dhe përputhshmërinë me vlerësimin *ex-ante*. Ai mbulon faktorët që kontribuuan në suksesin apo dështimin e zbatimit, arritjet e programit IPARD II dhe rezultatet, duke përfshirë qëndrueshmërinë e tyre. Gjithashtu, nxjerrë konkluzione të lidhura me programin IPARD II dhe procesin e zgjerimit.

(3) Nëse Shqipëria nuk e dorëzon raportin e vlerësimit *ex-post* deri në datën e referuar në paragrafin (1), zbatohet neni 37, pika (5).

TITULLI 3 RAPORTIMI

Neni 59 Raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit

(1) Deri më 30 qershor të çdo viti pas një viti të plotë kalendarik të zbatimit të programit IPARD II, Autoriteti Menaxhues, pas konsultimit me Agjencinë IPARD, harton raporte vjetore mbi zbatimin e programit IPARD II gjatë vitit kalendarik pararendës, sipas nenit 60, pika 2 të MK-së. Raporti i parë i dorëzuar mbulon vitet kalendarike nga 2014 e këtej.

(2) Autoriteti Menaxhues harton një raport përfundimtar mbi zbatimin e programit IPARD II. Raporti përfundimtar dorëzohet jo më vonë se 6 muaj pas afatit të pranueshmërisë së shpenzimeve në kuadrin e programit IPARD II, sipas nenit 29, pika 4 të MK-së.

(3) Raportet vjetore të zbatimit mbulojnë vitin kalendarik pararendës dhe përfshijnë të dhëna në lidhje me vitin kalendarik para dhe të dhënat kumulative financiare e monitoruese për të gjithë periudhën e zbatimit të programit IPARD II, si dhe tabela monitorimi agregate. Raportet përfundimtare për zbatimin e programit IPARD II mbulojnë të gjithë periudhën e zbatimit dhe mund të përfshijnë raportin vjetor të fundit.

(4) Raportet e referuara në paragrafët (1) dhe (2), pasi shqyrtohen dhe miratohen nga Komiteti Monitorues IPARD

II, i dërgohen KKIPA-s për dorëzim pranë Komisionit, me një kopje për ZKA-në dhe Autoritetin Auditues.

(5) Të gjitha raportet vjetore dhe përfundimtare përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- i) çdo ndryshim në kushtet e përgjithshme që lidhen me zbatimin e programit IPARD II, në veçanti, tendencat kryesore socio-ekonomike, ndryshimet në politikat kombëtare, rajonale apo sektoriale dhe, nëse është e mundur, implikimet e tyre në përputhshmërinë ndërmjet asistencës IPARD II dhe asistencës nga instrumente të tjerë financiarë të BE-së;
- j) progresi në zbatimin e prioriteteve dhe masave në lidhje me arritjen e objektivave të programit IPARD II, duke iu referuar të dhënave financiare, indikatorëve të përbashkët dhe atyre specifike për programin, vlerave sasiore të synuara, përfshi ndryshimet në vlerën e indikatorëve të rezultateve, ku është e mundur. Të dhënat e përcjella duhet të lidhen me vlerat e treguesve për operacione plotësisht të zbatuara dhe, nëse është e mundur, të lidhen me operacione të caktuara duke pasur parasysh fazën e zbatimit. Gjithashtu, ato japin një sintezë të gjetjeve të të gjitha vlerësimeve të programit që janë mundësuar gjatë vitit kalendarik pararendës, çdo çështje që ndikon në performancën e programit, si dhe masat e marra;
- k) për fondet financiare të alokuara dhe shpenzimet sipas masave, si edhe një përmbledhje të aktiviteteve të realizuar në lidhje me planin e vlerësimit;
- l) masat e marra nga Autoriteti Menaxhues, Agjencia IPARD II dhe Komiteti Monitorues IPARD II për të ndihmuar në garantimin e cilësisë dhe efektivitetit të zbatimit, në veçanti:
 - vii) një përmbledhje të ndonjë problemi të qenësishëm të hasur gjatë zbatimit të programit IPARD II dhe masat e ndërmarra, përfshi edhe rekomandimet për rregullime të bëra në zbatim të paragrafit (8);
 - viii) një përmbledhje të rezultateve të verifikimeve të kryera për çdo masë dhe të parregullsive të zbuluara;
 - ix) përdorimi i asistencës teknike;
 - x) hapat e bërë për të përfshirë më shumë organet vendore;
 - xi) hapat e marrë për të garantuar publicitetin e programit IPARD II;
 - xii) të dhënat që tregojnë se fondet e BE-së plotësojnë fondet që janë të disponueshme për Shqipërinë.
- m) hapat e bërë për të garantuar koordinimin e të gjithë asistencës së para-anëtarësimit që jep BE-ja, referuar nenit 4;
- n) tabelat financiare që tregojnë shpenzimet e BE-së, kombëtare dhe totale për çdo masë dhe/ose sektor
- o) një përmbledhje të aktiviteteve të realizuar në lidhje me planin e vlerësimit, sipas nenit 56;
- p) një përshkrim të aktiviteteve të kryera për zbatimin e planit me aktiviteteve vizibiliteti dhe komunikimi, referuar në nenin 30.

Përmbajtja dhe paraqitja e raporteve vjetore dhe përfundimtare bazohet në udhëzime të Komisionit.

(6) Komisioni, 15 ditë pune nga data e marrjes së raportit vjetor të zbatimit, informon Shqipërinë nëse nuk është i pranueshëm; ndryshe, raporti konsiderohet i pranuar.

(7) Komisioni informon Shqipërinë për vërejtjet e veta brenda katër muajve nga data e marrjes së raportit vjetor të zbatimit dhe brenda pesë muajve nga data e marrjes së raportit përfundimtar të zbatimit. Nëse Komisioni nuk jep vërejtjet brenda këtyre afateve, raportet konsiderohen të pranuar.

(8) Nëse, pas këtij shqyrtimi, Komisioni i përcjell komente Shqipërisë mbi çështje që ndikojnë në mënyrë të genësishme në zbatimin e programit IPARD II, Shqipëria do të informojë Komisionin brenda tre muajve për masat që ka ndërmarrë në lidhje me këto komente. Nëse Komisioni, pa cenuar Vendimet që merren në zbatim të neneve 48 dhe 49, i jep rekomandime Shqipërisë që të bëjë rregullime që synojnë përmirësimin e efektivitetit të monitorimit Programit apo të modaliteteve menaxhuese të programit IPARD II, Shqipëria më pas demonstron hapat e ndërmarrë për të përmirësuar monitorimin e programit apo modalitetet e menaxhimit, ose shpjegon pse nuk ka vepruar në këtë drejtim brenda tre muajve nga marrja e komenteve të Komisionit. Komiteti Monitorues IPARD II vihet në dijeni për këto veprimtari.

SEKSIONI VII DISPOZITA SPECIFIKE PËR PROGRAMET E VEPRIMIT SHUMËVJEÇARE ME FONDE TË PËRBASHKËTA

[Nuk ka dispozita plotësuese.]

SEKSIONI VIII DISPOZITA SPECIFIKE PËR PROGRAMET E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR

[S'ka dispozita plotësuese.]

SEKSIONI IX DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Nenet 81 deri 86 dhe 88 deri 90 të MK-së zbatohen *mutatis mutandis* në këtë Marrëveshje.

Neni 60 Zbatueshmëria e marrëveshjeve sektoriale për IPA-n

Marrëveshjet Sektoriale të nënshkruara në kuadrin e IPA-s ndërmjet Komisionit dhe Shqipërisë mbeten të zbatueshme për asistencën e miratuar në kuadër të instrumenteve të mëparshme të para-anëtarësimit, derisa kjo asistencë të përfundojë sipas kushteve të Marrëveshjeve Sektoriale përkatëse. Megjithatë, nenet 45 deri 49 të kësaj Marrëveshjeje zbatohen në lidhje me shpenzimet në kuadrin e IPA-s, kur verifikimi financiar i apo procedura e verifikimit të konformitetit ka iniciuar pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

Neni 61 Adresa për komunikimet

Për sa i përket nenit 85 të MK-së, adresat janë si më poshtë:

(1) Për të gjitha korrespondencat të tjera nga ato të referuara në pikën (2).

Për Bashkimin Europian:

Komisioni Europian

Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

Njësia për Asistencën Para-Anëtarësimit për Bujqësinë

Rue de la Loi 130

BE-1049 Bruxelles

Për Shqipërinë :

Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave

Drejtoria e Programimit dhe Vlerësimit të Politikave Rurale(Autoriteti Menaxhues)

Sheshi "Skënderbej"

AL – 1001 Tirana

(2) Për korrespondencat që shërbejnë për informacionin e parashikuar në nenin 51, pika 2 të MK-së, adresat janë si më poshtë:

Për Bashkimin Europian:

Komisioni Europian

OLAF – Zyra Europiane kundër Mashtrimit

Drejtoria C

30, Rue Joseph II

BE – 1049 Bruxelles

Faqja e internetit: http://ec.europa.eu/anti_fraud/index_en.htm

Për Shqipërinë

Ministria e Integritetit Europian

Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës nga BE

Bulevardi Dëshmorët e Kombit

Tiranë - Shqipëri

Neni 62 Mosrespektimi dhe zgjidhja e marrëveshjes

Pa cenuar nenin 90 të MK-së, nëse Komisioni ka identifikuar mosrespektim të detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni:

c) njofton Shqipërinë për qëllimet e veta, me argument(e), dhe

d) ka të drejtë, për sa i përket programit IPARD II dhe pa cenuar Vendimet e referuara në nenet 48 dhe 49:

v) të kryejë korrigjime financiare ndaj Shqipërisë;

vi) të ndalojë transferimin e parave drejt Shqipërisë;

vii) të mos marrë më angazhime financiare të reja në emër të BE-së;

viii) nëse është e përshtatshme, të zgjidhë Marrëveshjen me efekt nga momenti kur është zbuluar mosrespektimi i detyrimeve.

Neni 63 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur njëra Palë informon tjetrën me shkrim për miratimin e saj në përputhje me legjislacionin e brendshëm ekzistues ose procedurën e saj.

Neni 64 Nënshkrimi

Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje në gjuhën angleze.

E nënshkruar për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në Tiranë në datën.....

Nga Zoti. Edmond P ANARITI

Ministër i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

E nënshkruar për dhe në emër të Komisionit Europian, në Bruksel në datën -----

nga Z. Jerzy PLEWA

Drejtor i Përgjithshëm për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

I deleguar si Zyrtar i Autorizuar

SHTOJCA 1 - FUNKSIONET KRYESORE TË SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Sipas përcaktimit të neneve 10 (1) (c) dhe 10 (2) të Marrëveshjes Kuadër (MK), strukturat, autoritetet dhe organet e sistemit të kontrollit të brendshëm kanë një strukturë organizative që i lejon ato të kryejnë funksionet kryesore në lidhje me shpenzimet IPARD:

Përçasja themelore për ndarjen e funksioneve dhe përgjegjësi përcaktohet në përputhje me tabelën e mëposhtme:

Funksionet e përgjithshme	Funksionet e veçanta	Struktura menaxhuese		Struktura Operuese	
		Zyra mbështetëse ZKA	Fondi Kombëtar	Agjencia IPARD	Autoriteti Menaxhues
Funksioni Menaxhues	Zgjedhja e masave				*
	Monitorimi i programit				*
	Menaxhimi i operacioneve financiare dhe llogarive IPA II		*		
	Vlerësimi				*
	Raportimi			*	*
	Koordinimi				*

Funksionet Pagesës	Autorizimi dhe kontrolli i detyrimeve financiare			*	
	Autorizimi dhe kontrolli i pagesave		(*)	*	
	Ekzekutimi i pagesave			*	
	Kontabiliteti për shlyerjen e detyrimeve financiare dhe pagesave		*	*	
	Menaxhimi i borxhit		*	*	
	Thesari		*		
Funksionet Zbatuese	Përzgjedhja e projekteve			*	
	Publikimi			*	*
	Garancia për funksionimin efikas të sistemit të kontrollit të brendshëm	*			
Funksionet Auditimit	Auditimi i brendshëm	*	*	*	

Në rast se shënohet si fakultative (*), funksioni mund të përcaktohet në varësi të masës, përgjegjësi dhe karakteristikave të tjera të veçanta të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Përveç rasteve kur Komisioni shprehimisht dhe në mënyrë eksplicite parasheh ndryshe, ndarjet e funksioneve dhe përgjegjësi nuk duhet të jenë në kundërshtim me përfaqshen themelore siç tregohet në këtë Shtojcë.

Funksionet menaxhuese

(a) *Përzgjedhja e masave*: qëllimi i këtij funksioni është të garantojë se në bazë të nenit 10 (1) (c) (i) të MK,

Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për përzgjedhjen e masave dhe publikimin e tyre duke përfshirë edhe përzgjedhjen e masave nën secilën thirrje në përputhje me nenin 8 (2) (c) të kësaj Marrëveshjeje.

(b) *Monitorimi i programit*: qëllimi i këtij funksioni është të monitorojë efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit të programit IPARD II. Ai zbatohet duke iu referuar treguesve përkatës fizikë, mjedisorë dhe financiarë. Ai garanton gjithashtu se operacionet përzgjidhen për financim në përputhje me kriteret dhe mekanizmin e zbatueshëm për programin, dhe në përputhje me rregullat relevante kombëtare dhe të BE-së.

(c) *Menaxhimi i operacioneve financiare dhe llogarive IPA II*: qëllimi i këtij funksioni është të garantojë një menaxhimin e qetë financiar duke përfshirë regjistrimin e aktiviteteve, transferimin e fondeve dhe bërjen e rregullimeve financiare kur është e nevojshme.

(d) *Vlerësimi*: qëllimi i këtij funksioni është të përmirësojë cilësinë, efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e asistencës nga fondet e Bashkimit Europian, si edhe strategjinë dhe zbatimin e programit IPARD II. Vlerësimet shqyrtojnë shkallën e shfrytëzimit të burimeve, të efektivitetit dhe efikasitetit të programit dhe ndikimin e tij social-ekonomik të objektivat dhe prioritetet e përcaktuara dhe, si rregull i përgjithshëm, shoqërohen me kriteret dhe treguesit e arritjeve.

(e) *Raportimi*: qëllimi i këtij funksioni është të garantojë se zbatimi i programit dhe progresi i operacioneve dhe masave të veçanta raportohet në një mënyrë e cila ndihmon për të siguruar zbatimin efektiv dhe efikas të masës, duke përdorur informacionin dhe sistemet e duhura të komunikimit.

(f) *Koordinimi*: qëllimi i këtij funksioni është të drejtojë dhe monitorojë punën e komitetit monitorues IPARD II në përputhje me nenin 53 të MK, veçanërisht duke siguruar dokumentet e nevojshme për monitorimin e cilësisë së zbatimit të programeve.

Funksionet e pagesës

(a) *Autorizimi dhe kontrolli i detyrimeve financiare dhe pagesave*: qëllimi i këtij funksioni është të tregojë se kërkesat për miratimin e operacioneve dhe shuma e ardhshme që do t'i paguhet pretenduesit ose përfituesit(ve) të tyre është në përputhje me marrëveshjet dhe e pranueshme për asistencën e pretenduar të BE-së, që përfshin, *ndër të tjera*, verifikimet administrative dhe, sipas rastit, verifikimet në vend, në veçanti ato në lidhje me rregullsinë

dhe ligjshmërinë e shpenzimeve:

- (i) kontrollon pranimin e kërkesave për miratim dhe kërkesën për pagesë,
- (ii) kontrollon përputhshmërinë e angazhimeve të marra, lidhur me miratimet e projektit,
- (iii) sipas rastit, kontrollon procedurat e tenderimit dhe kontraktimit dhe verifikimin e punës së kryer apo shërbimet e ofruara,
- (iv) aplikon verifikimet e nevojshme.

Verifikimet mund të përfshijnë kontrollet e përzgjedhjes para-projektit, ri-matjet, kontrollet për sasinë dhe cilësinë e mallrave ose shërbimeve të ofruara, analizë apo kontroll me mostër testi, kontrollet e para-pagesave, kontrollet e pagesave *ex-post* dhe çdo dispozitë të veçantë për zbatimin e marrëveshjeve si për rregullsinë dhe ligjshmërinë e shpenzimeve. Për të përcaktuar rregullsinë dhe ligjshmërinë, verifikimet përfshijnë, sipas rastit, ekzaminimet e një natyre teknike, të cilat mund të përfshijnë vlerësimet ekonomike financiare dhe kontrollet e një natyre specifike bujqësore, teknike ose shkencore.

(b) *Ekzekutimi i pagesave*: qëllimi i këtij funksioni është nxjerrja e një udhëzimi për bankierët e strukturës operuese, ose, në raste të përshtatshme, për zyrën e pagesave qeveritare, t'u paguajnë shumën e autorizuar pretenduesit (ose përfituesit(ve) të tyre).

(c) *Kontabiliteti për detyrimet financiare dhe pagesat*: qëllimi i këtij funksioni është regjistrimi i të gjitha detyrimeve financiare dhe pagesave në librat e ndara të llogarive për shpenzimet e IPARD II, të cilat normalisht do të jenë në formën e një sistemi elektronik të përpunimit të të dhënave, dhe përgatitja e përmbledhjeve periodike të shpenzimeve, përfshi deklaratat e shpenzimeve për Komisionin. Librat e llogarisë regjistrojnë edhe asetet e financuara nga fondet e IPARD II, në veçanti në lidhje me debitorët e pasigurt.

(d) *Menaxhimi i borxhit*: qëllimi i këtij funksioni është funksionimi i sistemit për pranimin e të gjithë shumave për t'u paguar dhe regjistrimin në librin e debitorëve e të gjitha borxheve, përfshi parregullsitë, para marrjes së tyre.

(e) *Thesari*: qëllimi i këtij funksioni është të organizojë llogaritë bankare, kërkesat për fonde nga Komisioni, verifikimin e saktësisë së elementeve bashkë-financuese, që autorizon transferimin e fondeve IPARD II nga Komisioni te Agjencia IPARD ose te përfituesit dhe komunikimin financiar me Komisionin, përfshi aplikimet e pagesës tremujore dhe deklaratat vjetore.

Struktura organizative garanton qartësisht funksionin e autoritetit dhe përgjegjësisë të të gjitha niveleve operuese dhe, ndarjen e funksioneve të pagesës të referuara në pikat (a), (b) dhe (c), përgjegjësitë e të cilëve përcaktohen në

një tabelë/organogramë.

Funksionet zbatuese

(a) *Përzgjedhja e projekteve*: qëllimi i këtij funksioni është të përzgjedhë projektet në përputhje me kriteret, mekanizmat dhe rregullat që zbatohen për programin IPARD II. Në mënyrë të veçantë, ky funksion mund të kryhet nga Autoriteti Menaxhues për masat "Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - përfaqësja LEADER' dhe "Asistenca teknike '.

(b) *Publikimi*: qëllimi i këtij funksioni është:

(i) të shpallë thirrjet për aplikime dhe të publikojë termat dhe kushtet për pranueshmërinë, përfshi informacionin mbi detyrimet kontraktuale dhe sanksionet e mundshme në rast të mosrespektimit të këtyre detyrimeve dhe, ku është e nevojshme, të japë miratimin për të filluar punën;

(ii) të theksojë rolin e Bashkimit European dhe të garantojë transparencën e asistencës së BE-së.

(c) *Garancia për funksionimin efikas të sistemit të kontrollit të brendshëm*: qëllimi i këtij funksioni është të kontrollojë vazhdimisht performancën e mirë të sistemit të kontrollit të brendshëm, përfshi edhe masat e nevojshme si ndjekja e rezultateve të vlerësimit të auditimit dhe parregullsi të identifikuara.

Funksionet e auditimit

Auditimi i brendshëm: objektivi i këtij funksioni është të sigurojë se aktivitetet specifike të rregullta kryhen për të garantuar menaxhimin më të lartë nëpërmjet rishikimit të pavarur të sistemeve vartëse.

SHTOJCA 2 - KUADRI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Për qëllime të shtojcës B të Marrëveshjes Kuadër (MK), zbatohen dispozitat e mëposhtme:

1. Mjedisi i kontrollit

Dispozitat e përgjithshme plotësuese për nenin 1 të Shtojcës B të MK-së

Delegimi

Një pjesë ose të gjitha funksionet e vlerësimit, raportimit, autorizimit dhe kontrollit mund t'u delegohen organeve të tjera me kusht që të përmbushen kushtet e mëposhtme:

(8) Të lidhet një marrëveshje me shkrim që përcakton qartë, përveç detyrave të deleguara, natyrën e informacionit dhe dokumentet mbështetëse që do t'i paraqiten subjektit delegues, si edhe afati kohor brenda të cilit ato duhet të dorëzohen. Marrëveshja duhet t'i mundësojë subjektit delegues pajtueshmërinë me kërkesat nga shtojca B e MK-së dhe kësaj shtojce. Të garantohet mjaftueshëm gjurmë auditit.

Marrëveshja garanton nga agjentët e autorizuar ose përfaqësuesit e Shqipërisë apo të Bashkimit Europian aksesin në informacionet e mbajtura nga organet e deleguara dhe hetimin nga zyrtarët e aplikimeve, përfshi kryerjen e kontrolleve për projektet dhe përfituesit e ndihmës, si edhe çdo informacion tjetër që u nevojitet për kryerjen e detyrave të tyre.

(9) Strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të Sistemit të Menaxhimit dhe Kontrollit (referuar më tej si "SMK") mbeten në të gjitha rastet përgjegjëse për menaxhimin efikas dhe të shëndoshë të asistencës IPARD në fjalë. "SMK" është plotësisht përgjegjës për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve përkatëse, përfshi mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Europian

(10) Të përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrimet e organit tjetër, sidomos në lidhje me kontrollin dhe verifikimin e pajtueshmërisë me marrëveshjet dhe udhëzimet përkatëse.

(11) Strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të "SMK"-së garantojnë se organi tjetër ka sisteme efektive për të siguruar përmbushjen e detyrave të tij në mënyrë të mjaftueshme.

(12) Organi u konfirmon në mënyrë të qartë strukturave, autoriteteve dhe organeve përkatëse të "SMK"-së se ai në fakt i përmbush detyrat e tij dhe përshkruan mjetet e përdorura.

5 Në asnjë rast nuk duhet të delegohen funksionet e ekzekutimit të pagesës, si edhe të kontabilitetit të detyrimeve financiare të pagesës.

(13) Strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të "SMK"-së rishikojnë rregullisht detyrat e deleguara për të vërtetuar se puna e kryer është e një standardi të kënaqshëm dhe në pajtim me marrëveshjet.

(14) Autoriteti i Auditit raporton për funksionet e deleguara si të ishin të menaxhuara nga vetë subjekti delegues.

Kushtet e përcaktuara në pikat (1), (2), (3) dhe (5) zbatohen *mutatis mutandis* (me ndryshimet e nevojshme që janë bërë) në rastet kur funksionet e subjektit delegues kryhen nga një organ tjetër si pjesë e detyrave të tij të rregullta në bazë të legjislacionit kombëtar.

Dispozitat specifike plotësuese për nenin 1 të Shtojcës B të MK-së

Referenca bëhet për nenin 1 të Shtojcës B të MK-së.

(d) Planifikimi, rekrutimi, mbajtja, trajnimi dhe vlerësimi i stafit:

Për qëllime të pikës (d) të nenit 1 të shtojcës B të MK-së, është i nevojshëm trajnimi i stafit në të gjitha nivelet operuese duke përfshirë ndërgjegjësimin dhe parandalimin e mashtrimit.

Për sa i përket nën-pikës së tretë të pikës (d) të nenit 1 të shtojcës B të MK-së, përshkrimet e punës përfshijnë vendosjen e limiteve financiare të detyrimeve dhe pagesave për autoritetin e punë-mbajtësit.

2. Menaxhimi i riskut

[Nuk ka dispozita plotësuese]

3. Aktivitetet e kontrollit

Dispozitat e përgjithshme plotësuese për nenin 3 të Shtojcës B të MK-së

Garantimi i një kontrolli të brendshëm të shëndoshë kërkon procedurat e mëposhtme:

A. Procedurat për autorizimin e aplikimeve dhe kërkesë-pagesën:

(1) Strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të "SMK"-së përcaktojnë procedurat e detajuara për marrjen regjistrimin dhe përpunimin e kërkesave për miratimin e projektit, kërkesë- pagesat dhe faturat duke përfshirë një përshkrim të të gjitha dokumenteve që do të përdoren.

(2) Çdo zyrtar përgjegjës për autorizimin ka në dispozicion të tij/saj një listë të detajuar të verifikimeve që do të kryhen, dhe vërteton në dokumentet mbështetëse të kërkesë-pagesës se këto verifikime janë kryer. Ky vërtetim mund të bëhet me mjete elektronike. Do ketë dëshmi të rishikimit sistematik të punës nga një anëtar i lartë i stafit. Analiza e projektit udhëhiqet nga parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar

(3) Një kërkesë-pagesë autorizohet për t'u paguar vetëm pasi të jenë kryer verifikimet e mjaftueshme për të garantuar pajtueshmërinë me marrëveshjet. Këto verifikime përfshijnë verifikimet e kërkuara nga rregullorja për përcaktimin e masës specifike në kuadër të se cilës kërkohet ndihma, si edhe ato të kërkuara sipas nenit 51 të MK-së për të parandaluar dhe zbuluar parregullsitë dhe mashtrimin veçanërisht lidhur me rreziqet e vërejtura.

(4) Menaxhimi informohet në nivelin e duhur rregullisht dhe në kohë për rezultatet e verifikimeve të kryera administrative dhe në vend, në mënyrë që mjaftueshmëria e këtyre verifikimeve të mund të merret gjithmonë parasysh përpara zgjidhjes se një kërkesë për pagesë.

(5) Verifikimi administrativ i kryer detajohet në një listë (shih (2) që shoqëron çdo kërkesë-pagesë apo grupin e kërkesë-pagesave). Lista shoqërohet me një vërtetim për pranueshmërinë e kërkesë-pagesave të miratuara dhe natyrën, qëllimin dhe afatet e punës së bërë. Përveç kësaj, garantohet se kriteret për dhënien e ndihmës, përfshi kontraktimin, janë respektuar dhe se të gjitha rregullat e zbatueshme kombëtare dhe të Bashkimit Europian, përfshi edhe ato në lidhje me programin e zhvillimit rural, janë përmbushur. Verifikimi i kryer në vend detajohet në një raport në përputhje me nenin 15 ose nenin 21 të kësaj marrëveshjeje. Nëse ndonjë verifikim administrativ ose verifikim në vend nuk është i plotë, por është kryer në bazë të një modeli të kërkesë-pagesave, atëherë identifikohen kërkesë-pagesat e përzgjedhura, metoda e marrjes së mostrave e përshkruar, rezultatet e të gjitha inspektimeve dhe masat e marra në lidhje me mospërputhjet dhe parregullsitë e raportuara. Dokumentet mbështetëse janë të mjaftueshme për të garantuar se të gjitha verifikimet e kërkuara për pranueshmërinë e kërkesë-pagesave të autorizuara janë kryer.

(6) Kur dokumentet (në letër ose në formë elektronike) në lidhje me kërkesë-pagesat e autorizuara dhe verifikimet e bëra mbahen nga organet e tjera, të dy organet dhe strukturat përkatëse krijojnë procedura për të garantuar se vendndodhja e këtyre dokumenteve relevante me pagesat specifike është e regjistruar.

(7) Aplikimet nga kërkuesit përpunohen në kohën e duhur.

(8) Kriteret për vlerësimin e aplikimeve dhe renditja e tyre sipas prioritetit përcaktohet dhe dokumentohet në mënyrë të qartë.

B. Procedurat për pagesën

(1)Strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të “SMK”-së, siç përcaktohet në nenin 10 (1) dhe (2) të MK-së miratojnë procedurat e nevojshme për të garantuar se autoritetet kombëtare mund të përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale pavarësisht vonesave apo ndërprerjeve të financimit nga Komisioni.

(2)Autoritetet kombëtare miratojnë procedurat e nevojshme për të garantuar se pagesat janë bërë vetëm te llogaritë bankare që u përkasin përfituesve ose marrësve. Pagesa bëhet nga banka e agjencisë IPARD, ose, sipas rastit, zyra e pagesave qeveritare, brenda tri ditëve pune nga data e borxhit kundrejt llogarisë në euro të IPARD. Procedurat miratohen për të siguruar se të gjitha pagesat për të cilat nuk është bërë transferi nuk deklarohen për rimbursim. Nëse këto pagesa janë deklaruar tashmë, ato duhet t’i ri-kreditohen Fondit nëpërmjet deklaratave të ardhshme mujore/tremujore, ose në llogaritë vjetore jo më vonë se koha e specifikuar. Pagesat bëhen me anë të një transferimi në llogarinë bankare në emër të përfituesit. Miratimi i zyrtarit të autorizuar dhe/ose mbikëqyrësit të tij/saj mund të bëhet në mënyrë elektronike, me kusht që të jetë i siguar niveli i duhur i sigurisë për këto mjete, dhe identiteti i nënshkruesit të futet në dosjen elektronike.

C. Procedurat për kontabilitetin financiar

(1)Strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të “SMK”-së miratojnë procedura të plota dhe transparente të kontabilitetit financiar duke ndjekur parimet e kontabilitetit të pranuar ndërkombëtarisht dhe çdo udhëzim tjetër të zbatueshëm. Procedurat e kontabilitetit financiar garantojnë se deklaratat tremujore dhe vjetore janë të plota, të sakta dhe të bëra në kohën e duhur, dhe se është zbuluar dhe korrigjuar çdo gabim ose pakujdesi, sidomos nëpërmjet verifikimeve dhe rakordimeve të kryera në intervale të rregullta. Të sigurohet gjurmë auditi për çdo element që hyn në sistemet e kontabilitetit.

(2)Procedurat e kontabilitetit të autoriteteve kombëtare garantojnë se sistemi i kontabilitetit mund të paraqesë në

euro dhe monedhë kombëtare koston totale, shpenzimet e kryera, pagesat e pjeshme dhe pagesat e bilancit për çdo projekt, kontratë ose masë. Të përcaktohen afatet për anulimin e detyrimeve financiare kur puna nuk është përfunduar brenda një afati të rënë dakord. Këto anulime duhet të regjistrohen siç duhet në sistemet e kontabilitetit.

D. Procedurat për parapagesat dhe garancitë (nëse është e zbatueshme)

Pagesat e avancuara ose parapagesat kualifikohen si shpenzime të pranueshme deri në 10% të ndihmës publike në lidhje me projektin dhe i nënshtrohen krijimit të një garancie bankare apo një garancie ekuivalente që përputhet pothuajse me 110% të shumës së parapaguar. Pagesat e avancuara nuk mund të paguhen në kombinim me parafinancimin siç parashikohet në nenin 11 (3) (a).

Procedurat miratohen për të garantuar që:

(1) Parapagesat ose pagesat e avancuara identifikohen veçmas në regjistrat e kontabilitetit ose regjistrat suplementarë.

(2) Garancitë merren vetëm nga institucionet financiare që janë miratuar nga autoritetet përkatëse dhe mbeten të vlefshme deri sa të merren ose të kërkohen, me kërkesën e thjeshtë të agjencisë IPARD.

(3) Parapagesat merren brenda afateve të parashikuara, ndërsa atyre që u ka kaluar afati i marrjes identifikohen menjëherë dhe kërkohen garancitë.

E. Procedurat për borxhet

Të gjitha kërkesat e parashikuara në nenet A deri në D zbatohen *mutatis mutandis* për garancitë, pagesat e rimbursuara, të ardhurat e caktuara etj., të cilat agjencia IPARD i mbledh në emër të programit IPARD II. Agjencia IPARD ngre një sistem për pranimin e të gjitha shumave për t'u paguar dhe për regjistrimin e të gjithë borxheve në një libër të vetëm të debitorit para vërtetimit të tyre. Libri i debitorit kontrollohet në intervale të rregullta dhe merren masa për të mbledhur borxhet që janë vonuar.

F. Gjurma e auditit

Informacioni në lidhje me evidencat dokumentare të autorizimit, kontabilitetit, pagesës së kërkesë-pagesave dhe trajtimi i parapagesave, letrave me vlerë dhe borxheve do të jetë në dispozicion për të siguruar në çdo kohë gjurmë auditit mjaftueshëm të hollësishëm.

Menaxhimi duhet të informohet në nivelin e duhur rregullisht dhe në kohë për rezultatet e verifikimeve të kryera, në mënyrë që mjaftueshmëria e këtyre verifikimeve të mund të merret gjithmonë parasysh përpara zgjidhjes së një kërkesë për pagesë.

Për këto qëllime, strukturat, autoritetet dhe organet përkatëse të "SMK"-së krijojnë procedura të nevojshme për të siguruar mbajtjen e të gjitha dokumenteve që kërkohen për të garantuar gjurmë të mjaftueshme auditit.

Dispozitat specifike plotësuese për nenin 3 të Shtojcës B të MK-së

Referenca bëhet për nenin 3 të Shtojcës B të MK-së

(b) Aktivitetet e kontrollit të sigurisë

Për sa i përket pikës (b) të nenit 3 të shtojcës B të MK-së, siguria e sistemeve të informacionit bazohet në kriteret e përcaktuara në një version të zbatueshëm në vitin financiar në fjalë të standardit të mëposhtëm:

Organizata Ndërkombëtare e Standardeve 27002: Kodi i praktikës për Kontrolllet e Sigurisë së Informacionit (ISO);

4. Informimi dhe komunikimi

Dispozitat specifike plotësuese për nenin 4 të Shtojcës B të MK-së

Referenca bëhet për nenin 4 të Shtojcës B të MK-së.

(c) Komunikimi i jashtëm:

Për qëllime të pikës (c) të nenit 4 të shtojcës B të MK-së, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

(i) çdo ndryshim të marrëveshjet, përfshi normat e ndihmës të zbatueshme ose termat dhe kushtet duhet të regjistrohet, dhe udhëzimet, bazat e të dhënave e listat e kontrollit duhet të përditësohen rregullisht në kohën e duhur;

(ii) të gjitha ndryshimet e konsiderueshme në SMK pas akreditimit dhe ngarkimit të tyre me zbatimin e buxhetit i paraqitet autoritetit/autoriteteve kompetente kombëtar/e dhe Komisionit, me kopje për Autoritetin e Auditimit, për shqyrtim dhe miratim para zbatimit të tyre.

5. Monitorimi i kuadrit të kontrollit të brendshëm

Dispozitat specifike plotësuese për nenin 5 të Shtojcës B të MK-së

Referenca bëhet për nenin 5 të Shtojcës B të MK-së.

(a) Monitorimi i vazhdueshëm dhe specifik

Për qëllime të pikës (a) të nenit 5 të shtojcës B të MK -së, zbatohen dispozitat e mëposhtme:

(i) operacionet e përditshme dhe aktivitetet e kontrollit të autoriteteve kombëtare monitorohen në të

gjitha nivelet mbi një bazë të vazhdueshme për të siguruar gjurmë auditi mjaftueshëm të hollësishëm.;

(ii) monitorimi i shërbimeve teknike dhe organeve deleguese përgjegjëse për kryerjen e verifikimeve dhe funksioneve të tjera për të garantuar zbatimin e duhur të rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave;

(iii) procedurat e monitorimit për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit dhe parregullsive veçanërisht lidhur me ato zona të shpenzimeve nën kompetencën e agjencisë IPARD të cilat janë të ekspozuara ndaj një rreziku të konsiderueshëm të mashtrimit ose parregullsive të tjera serioze.

Për qëllime të paragrafit të katërt të pikës (a) të nenit 5 të shtojcës B të MK-së, shërbimi i kontrollit të brendshëm është i pavarur nga departamentet e tjera të autoriteteve kombëtare, dhe i raporton drejtpërdrejt drejtorit të subjektit. Shërbimi i kontrollit të brendshëm verifikon se procedurat e miratuara nga subjekti janë adekuate për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e Bashkimit Europian, dhe se llogaritë janë të sakta, të plota dhe në kohë. Verifikimet mund të kufizohen për masat e përzgjedhura dhe modelet e transaksioneve me kusht që një plan auditimi t'u japë garanci për një periudhë jo më shumë se pesë vjet të gjitha zonave të rëndësishme, përfshi këtu edhe departamentet përgjegjëse për autorizimin. Puna e shërbimit të kontrollit të brendshëm kryhet në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht, regjistrohet në dokumentet e punës dhe rezulton në raportet dhe rekomandimet e adresuara për menaxhimin e lartë të agjencisë.

SHTOJCA 3 - DOKUMENTET E KËRKUARA PËR APLIKIMIN E BESUESHMËRISË PËR DETYRAT E ZBATIMIT TË BUXHETIT

Kjo shtojcë i ofron subjekteve dokumentet e kërkuara për aplikimin e besueshmërisë për detyrat e zbatimit të buxhetit.

Shqipëria garanton:

(a) kërkesën e nënshkruar për besueshmërinë në letër dhe në format elektronik, dhe

(b) dokumentet e rekomanduara në këtë shtojcë dhe në të gjitha dokumentet e tjera relevante mbështetëse vetëm në format elektronik, me mbështetje fizike (CD/DVD/USB ose me mjete të tjera të ngjashme që përdoren zakonisht).

Nr.	Evidencat/Dëshmitë
-----	--------------------

	1	Përcaktimi formal ligjor, konfirmimi i gatishmërisë dhe procedurave
	1.1	Përcaktimi formal ligjor i KKIPA-s, ZKA-së dhe AA.
	1.2	Konfirmimi i gatishmërisë së KKIPA-s, ZKA-së dhe AA.
1.4	Procedurat me anë të të cilave zbatohen funksionet kryesore të ZKA-së	
	Komisioni nxjerr udhëzime dhe sqarime të mëtejshme në lidhje me dokumentet e kërkuara, formatin dhe nivelin e tyre të detajuar.	
1.5	Procedurat me anë të të cilave zbatohen funksionet kryesore të AA	
	Komisioni nxjerr udhëzime dhe sqarime të mëtejshme në lidhje me dokumentet e kërkuara, formatin dhe nivelin e tyre të detajuar.	
1.6	Raportet e vetë-vlerësimit për të gjithë sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të subjekteve të përgatitura nga auditorët e brendshëm.	
1.7	Mbështetje opinionit dhe raportit të auditimit për strukturën menaxhuese dhe strukturën operuese të hartuar nga një auditues i jashtëm funksionalisht i pavarur nga këto struktura dhe autoritete sipas nenit 10(1) dhe (2) të Marrëveshjes Kuadër dhe të mbështetur në ekzaminimet e kryera në përputhje me standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht.	
2.	STRUKTURA MENAXHUESE	

2.1	Kërkesë me shkrim nga ZKA se struktura menaxhuese plotëson kërkesat për t'u ngarkuar me detyrat e zbatimit të buxhetit
2.2	Emri dhe statuti i strukturave, organeve dhe autoriteteve në fjalë (zyra mbështetëse e ZKA-së, FK), përfshi kopjet e përcaktimit formal ligjor në nivel ministror.
2.3	<p>Përshkrimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përgjegjësitë i jepen zyrës mbështetëse të ZKA-së dhe Fondit Kombëtar, - ndarja e përgjegjësive midis departamenteve të tyre, - marrëdhënia e strukturës menaxhuese me organet e tjera, publike ose private, të cilat gjithashtu mbajnë përgjegjësi për ekzekutimin e masave nën të cilat ajo ngarkon shpenzimet për programin IPARD II, - kërkesat administrative, kontabël dhe të kontrollit të brendshëm sipas të cilave bëhen pagesat në lidhje me zbatimin e programit IPARD II.
2.4	<p>Procedurat me anë të të cilave zbatohen funksionet kryesore të zyrës mbështetëse të ZKA</p> <p>Komisioni nxjerr udhëzime dhe sqarime të mëtejshme në lidhje me dokumentet e kërkuara, formatin dhe nivelin e tyre të detajuar.</p>
2.5	Procedurat me anë të të cilave zbatohen funksionet kryesore të FK

	Komisioni nxjerr udhëzime dhe sqarime të mëtejshme në lidhje me dokumentet e kërkuara, formatin dhe nivelin e tyre të detajuar.
3.	STRUKTURA OPERUESE
3.1	Kërkesë me shkrim nga ZKA se struktura operuese plotëson kërkesat për t'u ngarkuar me detyrat e zbatimit të buxhetit
3.2	Emri dhe statuti i organeve që përbëjnë Strukturën Operuese (Agjencia IPARD, Autoriteti Menaxhues, dhe çdo organ tjetër i deleguar sipas rastit), përfshi kopjet e përcaktimit formal ligjor në nivel ministror.
3.3	<p>Përshkrimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përgjegjësitë i jepen Agjencisë IPARD dhe Autoritetit Menaxhues (përfshi edhe organet e tyre të deleguara, nëse është e aplikueshme), - ndarja e përgjegjësive midis departamenteve të tyre, - marrëdhënia e strukturës operuese me organet e tjera, publike ose private, të cilat gjithashtu mbajnë përgjegjësi për ekzekutimin e masave nën të cilat ajo ngarkon shpenzimet për programin IPARD II, - kërkesat administrative, kontabël dhe të kontrollit të brendshëm sipas të cilave bëhen pagesat në lidhje me zbatimin e programit IPARD II. - marrëveshje me shkrim ndërmjet organeve në sistem, përfshi memorandumit e mirëkuptimit ose protokollet e nënshkruara edhe me organe të tjera të deleguara ose teknike.

	- informacioni mbi mënyrën se si do të mbikëqyren funksionet e deleguara duhet të përfshihet gjithashtu.
3.4	<p>Procedurat me anë të të cilave zbatohen funksionet kryesore të Agjencisë IPARD</p> <p>Komisioni nxjerr udhëzime dhe sqarime të mëtejshme në lidhje me dokumentet e kërkuara, formatin dhe nivelin e tyre të detajuar.</p>
3.5	<p>Procedurat me anë të të cilave zbatohen funksionet kryesore të AM</p> <p>Komisioni do të nxjerrë sqarim të mëtejshëm dhe udhëzime në lidhje me dokumentet e kërkuara, formatin e tyre dhe nivelin e tyre të detajuar.</p>

Kërkesat e paraqitura më sipër duhet të konsiderohen si informuese dhe jo kufizuese. Përgjegjësia për garantimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm në funksion të kërkesës për ngarkimin e detyrave të zbatimit të buxhetit mbetet kryesisht te autoritetet kombëtare.

Shërbimet e Komisionit mund të kërkojnë dokumentacion shtesë para ose në rrjedhën e zbatimit të detyrave të tyre.

SHTOJCA 4 - RREGULLAT PËR PROGRAMIMIN

Intensiteti i ndihmës, norma e kontributit të BE-së dhe pranueshmëria e programeve të zhvillimit rural IPA 2014-2020

1. Përkufizime

1.2.

1.1.

139

Për qëllime të kësaj Shtojce, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- (a) *'standardet e Komunitetit'* do të thotë standardet e përcaktuara nga Bashkimi European kryesisht në fushat e mbrojtjes së mjedisit, shëndetit publik, shëndetin e bimëve dhe kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë në punë;
- (b) *'zonat malore'* do të thotë zonat e përmendura në nenin 32 (2) të Rregullores (BE) Nr. 1305/2013;
- (c) *'fermer i ri'* do të thotë një fermer nën 40 vjeç në kohën kur vendimi për dhënien e grantit është marrë, që zotëron kompetenca dhe aftësi profesionale të mjaftueshme.

2. Programi IPARD II

Secili program përfshin:

- (a) përshkrimi i situatës aktuale, SWOT dhe identifikimi i nevojave, duke siguruar një përshkrim sasior të gjendjes aktuale që tregon pabarazitë, mangësitë dhe potencialin për zhvillim;
- (b) analiza SWOT (pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet) e fokusuar në disa fusha specifike;
- (c) përmbledhje e rezultateve kryesore të ndërhyrjes së mëparshme nga fondet kombëtare, asistenca e BE-së ose asistencë multilaterale;
- (d) përshkrimi i strategjisë ekzistuese kombëtare të zhvillimit rural;
- (e) tabelë indikative e përgjithshme financiare;
- (f) përshkrimi i secilës prej masave të përzgjedhura, përfshi standardet kombëtare minimale, legjislacionin kombëtar relevant për programin, dëshmi të synimeve, konfirmim se verifikueshmëria dhe kontrolli i masave është siguruar.
- (g) përshkrimi i rrjetit ekzistues dhe/ose të planifikuar kombëtar të zhvillimit rural;
- (h) informacioni për komplementaritetin e IPARD-it me masat e financuara nga burime të tjera (kombëtare ose ndërkombëtare);
- (i) përshkrimi i strukturës operative, përfshi monitorimin dhe vlerësimin;
- (j) përshkrimi i strukturës së menaxhimit dhe të kontrollit;
- (k) përshkrimi i rezultateve të konsultimeve për programimin dhe dispozitat që përfshijnë autoritetet dhe organet relevante, si edhe partnerët e duhur ekonomik, social dhe mjedisorë;
- (l) rezultatet dhe rekomandimet e vlerësimit ex-ante të programit;
- (m) përshkrimi i aksioneve të parashikuara në kuadrin e publicitetit, vizibilitetit dhe transparencës në përputhje me legjislacionin e IPA-s, për të informuar përfituesit potencialë, organizatat profesionale, partnerët ekonomikë, socialë dhe mjedisorë, organet e përfshira në promovimin e barazisë midis burrave dhe grave dhe OJQ-ve në lidhje me mundësitë e ofruara nga programi dhe rregullat për të pasur akses në financim;

- (n) përshkrimi i dispozitave lidhur me barazinë midis burrave dhe grave dhe mosdiskriminimit promovuar në faza të ndryshme të programit (të projektimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit);
- (o) përshkrimi i aksioneve të ndërmarra për të siguruar disponueshmërinë e kapacitetit të mjaftueshëm teknik dhe këshillimor për zbatimin e duhur të programit

Të respektohen udhëzimet e ofruara nga Komisioni.

3. Intensiteti i ndihmës

Shpenzimi publik në parim nuk e kalon tavanin prej 50% të kostos totale të pranueshme të investimit, me përjashtimet e mëposhtme:

(a) 60% për investime në asetet fizike të njësive ekonomike bujqësore.

(b) 65% për investime:

- në asetet fizike të pronave bujqësore të bëra nga fermerët e rinj;
- në diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e biznesit.

(c) 70% për investime në asetet fizike të fermave bujqësore në zonat malore.

(d) 100% për investime në mbështetje/për:

- infrastrukturë publike rurale jo e një natyre për të gjeneruar të ardhura të konsiderueshme neto;
- aktivitetet e financuara nën masën e asistencës teknike;
- krijimi dhe mbrojtja e pyjeve;
- zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal – përfaqësues LEADER;
- ngritja e grupeve të prodhuesve;
- masa për agro-mjedisin-klimën dhe bujqësinë organike;
- përmirësimi i trajnimit;
- shërbimet këshillimore.

Një shtesë prej 10% mund të jepet për investimet e lidhura me menaxhimin e rrjedhjeve dhe mbetjeve në:

- asetet fizike të njësive bujqësore;
- asetet fizike lidhur me përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe të peshkimit

4. Normat e kontributit të BE-së

Kontributi Komunitar në parim është 75% i shpenzimeve publike. Megjithatë, do të ngrihet në:

a. 85% për:

- masa për agro-mjedisin-klimën dhe bujqësinë organike;
- krijimi dhe mbrojtja e pyjeve;
- në rastin e aktiviteteve sipas masës së Asistencës Teknike
- përmirësimi i trajnimit;
- shërbimet këshillimore;
- në rastin e projekteve të investimeve të kryera në rajonet ku Komisioni përcakton që fatkeqësitë e veçanta natyrore kanë ndodhur.

b. 90% për "zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal – përqasja LEADER".

5. Pranueshmëria

Janë të zbatueshme për masa të ndryshme më poshtë si vijon:

Investimet në asetet fizike të njësive ekonomike bujqësore

Përfituesit sipas kësaj mase janë fermerët ose grupet e fermerëve, qoftë persona fizikë ose juridikë dhe subjekte të tjera juridike bujqësore (p.sh. ndërmarrjet bujqësore private, grupet e prodhuesve, etj.) përgjegjës për kryerjen dhe financimin e investimeve në njësitë bujqësore (siç përcaktohet nga ligji kombëtar i Shqipërisë dhe të përfshira në regjistrin kombëtar të fermave).

Jo më vonë se para pagesës përfundimtare të investimeve, e gjithë njësia bujqësore duhet të pajtohet me standardet minimale kombëtare të duhura në fuqi lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e kafshëve. Nëse standardet kombëtare janë të ngjashme me standardet e BE-së, në raste të justifikuara siç duhet, shmangia nga ky rregull mund të miratohet nga Komisioni. Kjo duhet të shkruhet në mënyrë të qartë në Programin IPARD II.

Pas përfundimit investimi duhet të respektojë standardet relevante të BE-së në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenien e kafshëve.

Investimi duhet të ketë lidhje me prodhimin e produkteve bujqësore (produktet e renditura në Shtojcën I të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian ("TFEU")).

Kushtet minimale në lidhje me kompetencat dhe aftësitë profesionale të fermerëve duhet të përcaktohen në program.

Qëndrueshmëria ekonomike e njësisë bujqësore demonstron.

Mbështetje për ngritjen e grupeve të prodhuesve

Asistenca jepet për të lehtësuar ngritjen dhe funksionimin administrativ të grupeve të prodhuesve, me synimin për të:

- (a) përshtatur prodhimin dhe rezultatin e anëtarëve të grupeve të prodhuesve me kërkesat e tregut;
- (b) vendosja bashkërisht e mallrave në treg, përfshi përgatitjen për shitje, centralizimin e shitjes dhe furnizimin e pjesës më të madhe të blerësit ;
- (c) përshtatur prodhimin dhe rezultatin e prodhuesve për të përmbushur standardet relevante të BE-së, pajtueshmërinë me *acquis communautaire*;
- (d) përcaktuar rregullat e përbashkëta për informacionin e prodhimit, veçanërisht në lidhje me korrijet dhe disponueshmërinë;

- (e) garantuar standardizimin efikas në të gjitha hapat e marketingut dhe shpërndarjen e produkteve në zinxhirin-ushqim.

Asistenca sipas kësaj mase mund të jepet vetëm për grupet e prodhuesve të njohur zyrtarisht nga autoritetet përkatëse kombëtare të Shqipërisë pas 1 janarit 2014. Grupet e prodhuesve të pranueshëm nën kushtet e Rregullores së Komisionit (KE) Nr. 718/2007 mund të aplikojnë për asistencë nën këtë masë, me kusht që ata të vazhdojnë të përmbushin kushtet për mbështetje në kuadër të programit IPARD 2014-2020.

Organizatrat profesionale dhe/ose ndër-profesionale që përfaqësojnë një ose më shumë sektorë nuk kualifikohen si grupe të prodhuesve.

Aplikantët duhet të përputhen me kushtet e mëposhtme:

- (a) grupet e prodhuesve duhet të krijohen për herë të parë dhe të pranohen zyrtarisht nga autoriteti kompetent kombëtar pas 1 janarit 2014
- (b) grupet e prodhuesve duhet të pranohen nga autoriteti kompetent në bazë të një plan-biznesi.

Asistenca jepet si ndihmë me normë të sheshtë në këste vjetore për pesë vitet e para pas datës në të cilën grupi prodhues është pranuar dhe llogaritet në bazë të prodhimit vjetor që tregtohet. Ajo kufizohet në maksimumin prej 10% të prodhimit që tregtohet për vitin e parë dhe është e lëvizshme për vitet në vijim. Asistenca nuk i tejkalon 100,000 Euro në vit.

Investime në asetet fizike lidhur me përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe të peshkimit

Përfituesit janë ndërmarrje (siç përcaktohet nga ligji kombëtar i Shqipërisë përgjegjëse për kryerjen e projekteve në institucionin(et) e tyre. Një ndërmarrje mund të përbëhet nga një ose më shumë institucione.

Fokusi kryesor duhet të jetë te ndërmarrjet që punësojnë më pak se 250 persona dhe që kanë një qarkullim vjetor jo më shumë se 50 milion Euro, dhe/ose një bilanc vjetor në total që nuk i kalon 43 milion Euro që korrespondon me përkufizimin aktual të NVM-ve dhënë në Rekomandimin e Komisionit 2003/361 / KE⁶.

Qëndrueshmëria ekonomike e ndërmarrjes duhet të tregohet deri në fund të realizimit të investimit.

Jo më vonë se në fund të projektit (para një pagese përfundimtare), e gjithë ndërmarrja duhet të jetë në pajtim me standardet kryesore kombëtare përkatëse minimale në fuqi lidhur me mbrojtjen e mjedisit,

shëndetit publik, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë në punë. Nëse standardet kombëtare të bazuara në standardet e Bashkimit Europian kërkojnë veçanërisht, dhe vetëm në raste të justifikuara siç duhet, shmangien nga ky rregull mund të jepet nga Komisioni. Kjo duhet të jetë e shkruar në mënyrë të qartë në programin IPARD II.

Standardet relevante të BE-së të zbatueshme për investime do të arrihen në fund të projektit.

Investimet mbështetura duhet të lidhen me përpunimin dhe/ose tregtimin e produkteve të mbuluara nga Shtojca I të (TFBE), përfshi produktet e peshkimit, dhe/ose zhvillimin e produkteve të reja, proceset dhe teknologjitë të lidhura me produktet e mbuluara nga Shtojca I të TFBE, përfshi produktet e peshkimit .

6. Rekomandim i Komisionit i datës 6 maj 2003 në lidhje me përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (GZ L 124, 20. 5. 2003, fq. 36)

Masa për agro-mjedisin-klimën dhe bujqësinë organike

Përfituesit mund të jenë fermerët, grupi i fermerëve të cilët, si rregull i përgjithshëm, për pesë vjet minimumi ndërmarrin angazhimin (et) brenda llojit të operacionit (ve).

Shqipëria duhet të paraqesë në programin IPARD II si do të arrihet dimensionin "pilot" i masës/llojit të operacionit (ve).

Shqipëria do të duhet të sigurojë që angazhimet janë të qarta për sa i përket objektivave dhe përmbajtjes, kanë potencial për të siguruar përfitimet mjedisore, dhe janë të verifikueshme dhe të kontrollueshme.

Të pranueshëm për këtë masë do të jenë përfituesit që do të ndërmarrin vullnetarisht llojin e operacionit (ve), që shkojnë përtej standardeve përkatëse të detyrueshme (bazë). Përfituesit do të duhet të respektojnë standardet përkatëse të detyrueshme në të gjithë njësinë bujqësore. Përshkrimi i standardeve përkatëse të detyrueshme do të duhet të paraqitet në programin IPARD II.

Shqipëria duhet të krijojë një madhësi minimale të tokës bujqësore që mund të deklarohet në çdo lloj operacioni, një madhësi minimale të një tufe të racave të kafshëve të rrezikuara.

Përfituesit do të kompensohen për shpenzimet shtesë dhe pagesat e mëparshme të ardhurave që rezultojnë nga detyrimi financiar i bërë brenda llojit të zgjedhur të operacionit (ve).

Për çdo lloj operacioni, Shqipëria do të përgatisë një llogaritje që do të përbëjë një bazë për të krijuar një nivel të pagesës brenda këtij lloj operacioni. Llogaritja duhet të bëhet ose të miratohet nga një organ i certifikuar i pavarur nga organi i cili zbaton masat.

Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasja LEADER

Për qasja LEADER në nivel programi përmban të paktën elementet e mëposhtme:

- (a) strategjitë e zhvillimit lokal në bazë-zone të destinuar për territoret nën-rurale të mirë identifikuar;
- (b) partneritetet publike-private lokale/vendore (grupeve lokale të veprimit);
- (c) qasje nga poshtë-lart me fuqi vendim-marrje për grupet lokale të veprimit në lidhje me hartimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal;
- (d) hartimi dhe zbatimi i strategjisë multi-sektoriale bazuar në ndërveprimin midis aktorëve dhe projekteve të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë lokale;
- (e) rrjetet e partneriteteve lokale;

Përfituesit janë Grupeve Lokale të Veprimit (GLV) që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- (a) ata duhet të propozojnë një strategji të zhvillimit lokal të integruar të bazuar në karakteristikat LEADER siç përcaktohen në pikën (a) deri (e) më sipër.
- (b) ata duhet të përbëhen nga një grup që përfaqëson partnerët nga sektorët e ndryshëm social-ekonomik të bazuar në territorin në fjalë.
- (c) ata duhet të tregojnë aftësi për të përcaktuar dhe zbatuar strategjinë e zhvillimit për zonën.
- (d) ata duhet të kenë aftësinë për të administruar fondet publike.

Zona e mbuluar nga strategjia:

- (a) Të jetë koherente dhe të ofrojë në masë të mjaftueshme kritike në aspektin e burimeve njerëzore, financiare dhe ekonomike për të mbështetur një strategji të qëndrueshme të zhvillimit;

- (b) Popullsia e çdo zone duhet të jetë, si rregull i përgjithshëm, më e madhe se 10,000 banorë dhe nuk i kalon 150,000 banorë, duke përfshirë edhe vendbanimet me një popullsi prej më pak se 25,000;
- (c) E njëjta vendndodhje nuk duhet t'i përkasë më shumë se një GLV, që do të thotë një partneritet, një strategji, një territor;
- (d) Vendet përfituese mund të zgjedhin për të mbuluar ose të gjithë territorin e tyre ose një pjesë të tij duke iu përshtatur në përputhje me rrethanat kritereve për përzgjedhjen e grupeve lokale të veprimit dhe zonat që ata përfaqësojnë.

Qasja LEADER te përfituesit IPA II mbështetet nëpërmjet masave të mëposhtme:

- (a) masa e asistencës teknike (AT) për ngritjen e kapaciteteve të GLV-ve potenciale (aktivitet AT "Përftimi i aftësive dhe gjallërimi i banorëve të territoreve rurale").
- (b) masa "Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasja LEADER" - për GLV-të e përzgjedhura me veprimtaritë e mëposhtme:
 - (i) "Përftimi i aftësive, gjallërimi i banorëve të territoreve të GLV-së" për ngritjen e kapaciteteve dhe gjallërimin e GLV-ve të përzgjedhura;
 - (ii) "kostot operative dhe projektet e vogla" për drejtimin e GLV-ve të zgjedhura dhe zbatimi i projekteve të vogla;
 - (iii) "projektet e bashkëpunimit" për projekte ndër-territoriale ose transnacionale.

Investimet në infrastrukturën publike rurale

Përfituesit janë subjekte administrative në zonat rurale me deri në 10,000 banorë, sipas rezultateve zyrtare të censurit të fundit në dispozicion të popullsisë dhe siç arsyetohet në program.

Projekti duhet të lidhet me infrastrukturën publike të nevojshme për zhvillimin e zonave rurale, përfshi rrugët e komuniteteve, akses lokal në rrugët me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik vendor, akses në fermë dhe tokat pyjore, furnizimi me energji elektrike, menaxhimi i mbeturinave dhe ujit, akses lokal në informacion dhe teknologjitë e komunikimit, etj.

Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve

Përfituesit janë

- (a) fermerët ose anëtarët e familjes së fermës që zgjerojnë aktivitetet bujqësore; fermat dhe/ose anëtarët e tyre familjarë mund të jenë përfitues të pranueshëm pa marrë parasysh nëse këta janë të vendosur në zonat urbane ose në një zonë rurale;
- (b) personat fizikë në zonat rurale; personat fizikë, që drejtojnë një aktivitet ekonomik, të cilët janë përfitues sipas masës duhet të jetojnë në një zonë rurale, që mund të provohet, për shembull, me anë të regjistrimit të tyre. Ata mund të punojnë, për shembull, si të vetëpunësuar (p.sh., në rastin e zanateve);
- (c) personat juridikë privatë në zonat rurale; subjekte juridike private të ngritura ose që veprojnë në zonat rurale përfshijnë ndërmarrje mikro dhe të vogla, përfshi ndërmarrjet artizanale, të cilat kanë potencial për kryerjen e projektit, si edhe çdo lloj personi juridik themeluar nga popullsia rurale në zonat rurale. subjektet juridike private të themeluara jashtë zonave rurale, mund të jetë gjithashtu të pranueshme në qoftë se investimet/aktivitete e mbështetura janë të vendosura në zonat rurale.

Projektet janë në pajtim me standardet kombëtare relevante jo më vonë se koha e specifikuar në fund të investimit.

Aplikuesi duhet të demonstrojë se investimi do të jetë ekonomikisht i zbatueshëm në fund të realizimit të projektit.

Asistenca sipas kësaj mase lidhet vetëm me mbështetje për investime fizike.

Përmirësimi i trajnimit

Përfituesit e asistencës sipas kësaj mase janë organizatat profesionale dhe/ose ndër-profesionale (ofruesit e trajnimit) të aftë dhe përgjegjës për ofrimin e kurseve të trajnimit.

Pjesëmarrësit në trajnim të parashikuar sipas kësaj mase duhet të jenë persona të angazhuar në sektorët bujqësor, të ushqimit dhe pyjeve, si edhe aktorë të tjerë ekonomikë që operojnë në zonat e mbuluara nga programi përkatës i Zhvillimit Rural IPA. Pjesëmarrësve nuk u kërkohet të paguajnë për kurset e trajnimit.

Shqipëria duhet të përpunojë një strategji trajnimi për zbatimin e veprimeve për përmirësimin e aftësive profesionale dhe kompetencat e personave të angazhuar në bujqësi, ushqim, dhe sektorët e pylltarisë dhe aktorëve të tjerë ekonomikë që veprojnë në fushat e mbuluara nga programet e zhvillimit rural të IPA-s. Strategjia e trajnimit duhet të aprovohet nga komiteti monitorues IPARD

Asistenca nuk jepet për kurset e mësimimit ose trajnimit që janë pjesë e programeve normale apo sistemeve të arsimit në nivelet e shkollave të mesme apo të larta.

Të pranueshme janë vetëm shpenzimet për aktivitetet administrative të funksionimit të trajnimit si:

- (a) për organizatat që ofrojnë kurse trajnimi/aksionet për informimin;
- (b) të udhëtimit, akomodimit dhe shpenzimet në ditë, kur është e nevojshme, për të trajnuarit.

Asistenca teknike

Përfituesi sipas kësaj mase është Autoriteti Menaxhues.

Shpenzimi i pranueshëm bazohet në kostot reale të cilat lidhen me zbatimin e operacionit të bashkë-financuar dhe duhet të lidhet me pagesat e kryera nga përfituesi, të mbështetura nga faturat ose dokumenteve kontabël të vlerës ekuivalente dëshmuese.

Aksionet e mëposhtme janë të pranueshme me kusht që ato të mbulohen nga plani i veprimit indikativ të asistencës teknike :

- (a) Shpenzimet për mbledhjet e komitetit të monitorimit;
- (b) shpenzimet e tjera të nevojshme për të përmbushur përgjegjësitë e komitetit të monitorimit;
- (c) Shpenzimet për informimin dhe fushatat publicitare, përfshi kostot e printimit dhe shpërndarjes;
- (d) Kostoja e përkthimit dhe interpretimit e dhënë në përgjigje të kërkesave nga Komisioni;
- (e) Shpenzimet lidhur me vizitat dhe seminare;
- (f) Shpenzimet lidhur me "fitimin e aftësive" për të përgatitur LAG potencial për zbatimin e masës "Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasja LEADER";
- (g) Shpenzimet lidhur me përgatitjen, ose efikasitetin e zbatimit, e masave në program për të siguruar efektivitetin e tyre, përfshi ato masa ku zbatimi parashikohet në një fazë të mëvonshme;
- (h) Shpenzimet për vlerësimet e programit;
- (i) Shpenzimet në lidhje me krijimin dhe funksionimin e një rrjeti kombëtar që mbështet koordinimin e aktiviteteve për përgatitjen dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit rural lokal. IPA II. Administratat dhe organizatat publike të krijuara në Shqipëri dhe aktive në fushën e zhvillimit rural mund të përfitojnë nga veprimet e Rrjetit Evropian për Zhvillimin Rural siç parashikohet në nenin 52 (3) (g) të Rregullores (BE) Nr.1305/2013. Për dispozitat përkatëse të hollësishme bihet dakord me Shqipërinë;

- (j) Niveli i mbështetjes së pagave i cili merr parasysh nivelet e shpërblimit në tregun e punës në mënyrë që të mbajë stafin dhe për të ndërtuar/për të ruajtur ekspertizën në administratë. Futja e këtyre shpenzimeve mund të bëhet vetëm pas miratimit paraprak të Komisionit dhe mund të kufizohet në kohë.

Shërbimet këshillimore

Kjo masë mund të mbulojë:

- (a) grupin këshillimor; shërbimet e grupit këshillimor për fermerët apo ndërmarrjet mikro- dhe të vogla, mund të mbulojë performancën ekonomike, bujqësore dhe mjedisore të pronave bujqësore, pronat pyjore ose ndërmarrjet mikro-dhe të vogla.
- (b) këshillim në përgatitjen e aplikimeve për programin IPARD dhe këshilla për zbatimin e projektit, të tilla si përgatitja e kërkesave të pagesës;
- (c) Trajnimin e këshilltarëve; trajnimi i këshilltarëve duhet të ketë lidhje me fushat në të cilat jepet këshilla.

Autoritetet apo organet, të cilat do të ofrojnë këshilla, janë përfituesit e mbështetjes.

Autoritetet ose organet, të cilat do të ofrojnë këshilla, kanë burimet e duhura në formën e stafit të trajnuar rregullisht dhe të kualifikuar dhe përvojë këshilluese dhe besueshmërinë në lidhje me fushat që ata këshillojnë. Stafi i shërbimit këshillimor duhet të trajnohet rregullisht.

Autoritetet apo organet që ofrojnë këshilla mund të përfshijnë: shërbimet publike këshillimore, organizatat e sektorit (të tilla si dhomat e bujqësisë), agjencitë e zhvillimit, OJQ-të, këshillat bashkiakë, etj).

Këshilla jepet falas për fermerët, ruajtësit e pyjeve dhe NVM-të në zonat rurale.

Normat fikse të pagesës duhet të jepen *për* organizim mbledhje grupi këshillues /*për* zbatim të projektit IPARD/ *për* kërkesë- pagese IPARD.

Niveli i pagesave për kërkesë-pagesë/zbatim projekti duhet të fiksohet në programin IPARD në varësi të masës, llojit të sektorëve/madhësive të projektit të mbështetur, sipas rastit.

Krijimi dhe mbrojtja e pyjeve

Kjo masë synon të kontribuojë në zgjerimin dhe përmirësimin e burimeve pyjore, restaurimin e pyjeve të dëmtuara nga zjarri dhe parandalimin e pyjeve nga zjarri. Veç kësaj, ajo ofron mundësinë për të përmirësuar më tej balancimin midis prodhimit të mallrave (ushqimi, mekanizmi i ushqimit, karburanti, fibrat, etj.) dhe prodhimit të jo-mallrave, të tilla si mbrojtja e mjedisit dhe pajisjet kulturore dhe të peizazhit.

Projektet e mbështetura duhet të jenë në pajtim me Programet/Strategjitë Kombëtare të Pyjeve ose instrumentet ekuivalente dhe, nëse është e aplikueshme, me programin kombëtar të pyllëzimit ose dokumentin udhëzues, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike apo planin zbutës, biodiversitetin ose strategjinë ekuivalente. Secili vend mund të zgjedhë aksionet më të përshtatshme për t'u financuar, duke siguruar justifikimin e duhur. Megjithatë, masa e vetme gjithashtu u lejon përfituesve të zbatojnë projektet e integruara me rritjen e vlerës së shtuar.

Shpenzimet publike sipas kësaj mase mund të shkojnë 100%; kontributi i BE-së - 85% e shpenzimeve publike. Shpenzimet e mirëmbajtjes do të llogariten në bazë të metodologjisë së propozuar në program. Pagesat për hektar të pyllëzuar apo sistemet e agro-pyllumarisë do të përcaktohen në programet. Përfituesit IPA II garantojnë që llogaritjet për ndihmën e dhënë në bazë të kostos standarde ose kostos shtesë janë adekuate dhe të sakta dhe të vërtetuara paraprakisht në bazë të një llogaritje të drejtë, të barabartë dhe të verifikueshme. Për këtë qëllim, një organ që është funksionalisht i pavarur nga autoritetet përgjegjëse për zbatimin e programit dhe zotëron ekspertizën e duhur kryen llogaritjet ose siguron një vërtetim që konfirmon përshtatshmërinë dhe saktësinë e llogaritjeve.

Për sa i përket pyllëzimit, prioritet duhet t'i jepet pyllëzimit që bëhet për qëllime mbrojtëse, si mbrojtja e tokës dhe e ujërave, si edhe pronarëve të tokave private. Vetëm në rastet kur ekziston interesi i kufizuar nga pronarët e tokave private në këtë aktivitet, mbështetja duhet të ofrohet për menaxherët e tokës shtetërore. Aplikuesi për pyllëzimin duhet të përgatisë një plan për pyllëzimin.

Udhëzime të mëtejshme

Të respektohen udhëzimet e ofruara nga Komisioni.

SHTOJCA 5 - FORMULARI D 1 – PASQYRA E SHPENZIMEVE DHE BURIMIT TË TË ARDHURAVE

Masa	Pagesat		Rikuperimet/korrigjimet		Kërkohen për IPARD II	Pranimi i llogarive shumat		Reduktime të përkohshme		Pagesa e llogarituar
	Shp. publike.	IPARD II	Shp. publike	IPARD II		Të ri-përdorshme	Jo të ri-përdorshme	Tejkalim Plani Fin.	Kërkesë informacioni	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
	<i>të plotësohet nga Shqipëria</i>	<i>automatiksht llogaritet nga Komisioni</i>	<i>të plotësohet nga Shqipëria</i>	<i>automatiksht llogaritet nga Komisioni</i>	<i>të plotësohet nga Komisioni</i>				<i>automatiksht llogaritet nga Komisioni</i>	
Investimet në asetet fizike të njësive ekonomike bujqësore										
Mbështetje për ngritjen e grupeve të prodhuesve										
Investimet në asetet										

**SHTOJCA 6 - FORMULARI D 2 - PASQYRA VJETORE E LLOGARIVE PËR
VITIN FINANCIAR (.....)**

(do të dërgohet tek Komisioni së bashku me dokumentet e përmendura në nenet 45 dhe 46)

Programi IPARD II:

Vendimi(et) e Komisionit Nr. dt. (modifikuar për herë të fundit me
Vendimin Nr.dt.....)

Numri i referencës së Komisionit (CCI):

2014AL0614NP001

Unë, i nënshkruari....., Zyrtar Kombëtar Autorizues (ZKA) që përfaqësoj Shqipërinë siç
parashikohet në marrëveshjet e lidhura ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit, deklaroj se shpenzimet totale
të pranueshme në pajtim me programin nga (1/1 / vit deri më 31/12 / vit) arrijnë në Euro.

Detajet në lidhje me këtë shpenzim jepen në tabelën bashkëngjitur këtij dokumenti dhe janë pjesë integrale
e kësaj deklarate.

Unë gjithashtu deklaroj se masat janë duke përparuar me një ritëm të kënaqshëm në pajtim me objektivat
e përcaktuara në program, dhe se dokumentet mbështetëse janë, dhe do të mbeten, në dispozicion siç
parashikohet në nenin 44 të Marrëveshjes Sektoriale.

Unë deklaroj se:

1. Lista e shpenzimeve është e saktë. Ajo bazohet te llogaritë në nivelin e operacioneve
individuale dhe mbështetet me dëshmi të dokumentuara.

2. Pagesat për përfituesit janë bërë pa ndonjë pagesë, zbritje ose ndërprerje specifike të ndonjë sasive që mund të zvogëlojë shumën e asistencës financiare për të cilën është caktuar.
3. Unë kam kontrolluar se shpenzimi që është deklaruar i pranueshëm është kryer në pajtim me Programin IPARD II, Marrëveshjen e Financimit, Vendimin(et) e Komisionit të referuara në nenet 48 dhe 49 të Marrëveshjes Sektoriale dhe parimeve të menaxhimit të qëndrueshëm financiar.
4. Deklarata përfshin të gjitha borxhet që janë regjistruar për një periudhë më pak se dy vjet. Shuma totale e këtyre borxheve në fund të vitit për të cilën kjo deklaratë referohet arrin në Euro.
5. Vëllimi i fondeve të Bashkimit Europian në llogarinë në Euro të IPARD-së, në fund të vitit për të cilin kjo deklaratë referohet arrin në Euro, nga të cilat interesi i llogaritur gjatë viteve arrin në Euro.
6. Shkëmbimet midis monedhës vendase dhe Euros janë kryer në pajtim me dispozitën e nenit 42 të Marrëveshjes Sektoriale.
7. Informacioni i pranimit, siç referohet në nenin 46 të Marrëveshjes Sektoriale, është certifikuar dhe i transmetohet Komisionit në kohë.
8. Forma dhe përmbajtja e llogarive vjetore, siç referohet në nenin 45 të Marrëveshjes Sektoriale, dhe informacioni kontabël, siç referohet në nenin 47 të Marrëveshjes Sektoriale, janë krijuar në pajtim me parimet e kontabilitetit të pranuar ndërkombëtarisht.

9. Dokumentet mbështetëse janë, dhe do të mbeten, në dispozicion siç parashikohet në nenin 46 të Marrëveshjes Sektoriale. Ato janë të hapura për verifikim.

Kjo deklaratë e llogarive përmban faqe të numërtuara.

Kjo deklaratë është hartuar nga:

(Data, Vula dhe nënshkrimi i kryetarit të Fondit Kombëtar)

.....

Deklarata është krijuar në bazë të shumave financiare të ofruara nga:

.....

(Data (t), vula (t) dhe nënshkrimi (et) të kontabilistit të Agjencisë IPARD dhe/ose Fondit Kombëtar)

Certifikuar nga:

(Data, Vula dhe nënshkrimi i Zyrtarit Kombëtar Autorizues në emër të

(Data, Vula dhe nënshkrimi i Zyrtarit Kombëtar Autorizues në emër të Shqipërisë

Nënshkruar në ,, (Data)

FORMULARI D 2 - DEKLARATA VJETORE E LLOGARIVE PËR VITIN FINANCIAR

Programi IPARD II:.....

Numri CCI: 2014AL06I4NP001

Masa	Pjesa e Bashkimit European që deklarohet në Komision në kërkesat tremujore të pagesës për vitin financiar (VITI) në EURO
	<i>të plotësohet nga Shqipëria</i>
Investimet në asetet fizike të njësive ekonomike bujqësore	
Mbështetje për ngritjen e grupeve të prodhuesve	
Investimet në asetet fizike në lidhje me përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe të peshkimit	
Masa për agro-mjedisin-klimën dhe bujqësinë organike	
Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - përqsja LEADER	
Investimet në infrastrukturën publike rurale	
Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit	
Përmirësimi i trajnimit	
Asistenca teknike	
Shërbimet këshillimore	
Krijimi dhe mbrojtja e pyjeve	

Totali	
Shuma e përgjithshme e borxhit të papaguar në 31.12. (VITI)	
Mbyllja e bilancit të llogarive IPARD – në Euro në 31.12. (VITI)	
Prej të cilave interesi shtohet/përlllogaritet gjatë vitit	

SHTOJCA 7 - PARASHIKIMET E PAGESAVE

PARASHIKIMET E SHUMAVE QË PAGUHEN NGA IPARD II
TË DORËZOHEN JO MË VONË SE DATAT 15 JANAR DHE 15 KORRIK

:				
Vlerësimi i shumave në Euro që paguhen nga IPARD II në vitin 'N' për				
Programi	Janar - Mars	Prill - Qershor	Korrik - Shtator	Tetor - Dhjetor
Vlerësimi i shumave në Euro që paguhen nga IPARD II në vitin 'N+1' për				
Programi	Janar - Mars	Prill - Qershor	Korrik - Shtator	Tetor - Dhjetor

**SHTOJCA 8 - INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI PËR MBËSHTETJEN E ASISTENCËS
IPA II**

1. LISTA E OPERACIONEVE

Lista e operacioneve që i referohet nenit 29 (3) përmban fushat e të dhënave të mëposhtme:

- emri i përfituesit (vetëm i subjekteve juridike; jo i personave fizikë);
- emri i operacionit;
- përmbledhje e operacionit;
- data e fillimit të operacionit;
- data e përfundimit të operacionit (data e parashikuar për përfundimin fizik ose zbatimin e plotë të operacionit);
- shpenzimet totale të pranueshme që janë përcaktuar për operacionin;
- shkalla e bashkëfinancimit të Bashkimit Evropian, sipas aksit prioritar;
- kodi postar i operacionit; ose një indikator tjetër i përshtatshëm për vendndodhjen;
- vendi;
- emri i kategorisë së ndërhyrjes për operacionin;
- data e përditësimit të fundit të listës së operacioneve;

Titujt e fushave të të dhënave jepen në gjuhën angleze.

2. MASAT PËR INFORMIMIN DHE KOMUNIKIMIN ME PUBLIKUN

Shqipëria, struktura operuese dhe përfituesit ndërmarrin hapat e nevojshme për të siguruar informacionin dhe për të komunikuar me publikun për operacionet e mbështetura nga programi IPARD II.

2.1. Përgjegjësitë e *Shqipërisë* dhe strukturës operuese

Shqipëria dhe struktura operuese garantojnë që masat e informimit dhe komunikimit zbatohen në përputhje me planin e aktiviteteve të vizibilitetit dhe komunikimit dhe se këto masa synojnë mbulimin më të gjerë të mundshëm nga mediat duke përdorur në nivelin e duhur format dhe metodat e ndryshme të komunikimit.

Shqipëria ose struktura operuese është përgjegjëse për masat e mëposhtme të informimit dhe komunikimit:

- a. organizon një aktivitet të madh informimi për lançimin e programit ose programeve, madje edhe para miratimit të planit relevant të aktiviteteve të vizibilitetit dhe komunikimit;
- b. organizon në vit një aktivitet kryesor informimi i cili promovon mundësitë e financimit dhe strategjitë që ndiqen duke paraqitur arritjet e programit ose programeve, përfshi edhe shembuj nga projektet;
- c. shfaq emblemën e BE-së në ambientet e çdo subjekti të strukturës operuese;

- d. publikon në formë elektronike listën e operacioneve në përputhje me nenin 1 të kësaj Shtojce;
 - e. jep shembuj të operacioneve, nga programi, në faqen e veçantë të internetit ose në faqen e internetit të programit që është e aksesueshme përmes portalit të faqes së veçantë të internetit; shembujt duhet të jenë në gjuhën angleze dhe gjuhën kombëtare në fjalë të *Shqipërisë*;
 - f. përditëson informacionin në lidhje me zbatimin e programit, përfshi kur është e nevojshme, arritjet e tij kryesore në faqen e veçantë të internetit ose në faqen e internetit të programit që është e aksesueshme përmes portalit të faqes së veçantë të internetit.
3. Struktura operuese përfshin palët e interesuara relevante në masat e informimit dhe komunikimit. Këto organe përhapin gjerësisht informacionin e përshkruar në nenin 29 (1).

2.2. Përgjegjësitë e përfituesve

1. Të gjitha masat e informimit dhe komunikimit të ofruara nga përfituesi e pranojnë

mbështetjen e Fondeve për operacionin duke paraqitur:

- a. emblemën e BE-së në përputhje me karakteristikat teknike të përcaktuara në aktin zbatues përkatës të miratuar nga Komisioni⁷, së bashku me një referencë për Bashkimin Evropian;
- b. referencë për Fondin ose Fondet që mbështesin operacionin.

2. Gjatë zbatimit të operacionit përfituesi informon publikun për mbështetjen e marrë nga

Fondet:

- a. duke paraqitur një përshkrim të shkurtër të operacionit në faqen e internetit të përfituesve, kur ekziston një faqe e tillë, në proporcion me nivelin e mbështetjes, përfshi qëllimet dhe rezultatet e tij, duke theksuar mbështetjen financiare nga BE;
- b. duke vendosur, për operacionet që nuk përfshihen në pikat 4 dhe 5, të paktën një poster me informacion rreth projektit (me madhësi minimale A3), përfshi mbështetjen financiare të BE-së, në një vend lehtësisht të dukshëm për publikun, siç është zona e hyrjes së një ndërtese.

3. Çdo dokument, lidhur me zbatimin e operacionit që përdoret për publikun apo për pjesëmarrësit, përfshi çdo pjesëmarrje ose certifikatë tjetër, duhet të përfshijë një deklaratë që dëshmon se programi operacional mbështetet nga Fondi ose Fondet.

4. Kur një operacion nën programin IPARD rezulton në investim, (për shembull në një fermë ose në një ndërmarrje ushqimi) mbështetja totale publike e së cilës tejkalon 20,000 Euro, përfituesi vendos një pllakë

metalike shpjeguese. Një pllakë shpjeguese vendoset gjithashtu në ambientet e grupeve aktive vendore të financuara nga LEADER;

5. Përfituesi vendos në një vend lehtësisht të dukshëm për publikun një stendë afishimi të përkohshme të një madhësie të konsiderueshme për çdo operacion që përbëhet nga financimi i infrastrukturës ose operacionet e ndërtimit, për të cilat mbështetja totale publike për operacionin tejkalon 100 000 Euro;

Jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të këtij operacioni, përfituesi vendos një pllakë të përhershme ose stendë afishimi të një madhësie të konsiderueshme në një vend lehtësisht të dukshëm për publikun për secilin operacion që plotëson kriteret e mëposhtme:

- a. mbështetje totale publike për operacionin që tejkalon 100 000 Euro;
- b. operacioni ka të bëjë me blerjen e një objekti fizik ose të financimit të infrastrukturës ose të operacioneve të ndërtimit.

Kjo stendë përmban emrin dhe objektivin kryesor të operacionit dhe thekson mbështetjen financiare të dhënë nga Bashkimi Evropian.

Stendat, posterat, pllakat (shpjeguese) dhe faqet e internetit, siç përmenden nën pikat 4 dhe 5, duhet të përmbajnë një përshkrim të projektit/operacionit që tregon se projekti mbështetet nga IPARD dhe përfshin emblemën e BE-së. Ky informacion zë të paktën 25% të stendës, pllakës ose faqes së internetit. Ai përgatitet në përputhje me karakteristikat teknike të përcaktuara në aktin zbatues përkatës të miratuar nga Komisioni⁸.

3. MASAT PËR INFORMIMIN E PËRFITUESVE DHE PËRFITUESVE POTENCIALË

3.1. Masat për informimin e përfituesve potencialë

1. Struktura operuese garanton, në përputhje me planin e aktiviteteve të vizibilitetit dhe komunikimit, se strategjia e programit dhe objektivat, si edhe mundësitë e financimit të ofruara përmes mbështetjes së përbashkët nga Bashkimi Evropian dhe përfituesit e IPA II shpërndahen gjerësisht te përfituesit potencialë dhe palët e interesuara me të gjitha detajet e mbështetjes financiare nga fondet në fjalë.

2. Struktura operuese garanton që përfituesit potencialë të kenë akses në informacionin relevant, përfshi informacionin e përditësuar kur është e nevojshme, duke marrë parasysh aksesueshmërinë e shërbimeve elektronike ose formave të tjera të komunikimit për përfituesit e mundshëm potencialë, për sa vijon:

- a. mundësitë e financimit dhe lançimin e thirrjeve të aplikimit;
- b. kushtet për pranueshmërinë e shërbimeve që duhet të plotësohen në mënyrë që të kualifikohen për mbështetjen sipas programit IPARD II;
- c. përshkrimi i procedurave për shqyrtimin e kërkesave për financim dhe të afateve të përfshira;
- d. kriteret për përzgjedhjen e operacioneve që do të mbështeten;
- e. kontaktet në nivel kombëtar, rajonal apo vendor që janë në gjendje të japin informacion mbi programet;
- f. përgjegjësia e përfituesve potencialë për të informuar publikun për qëllimin e operacionit dhe mbështetjen nga Fondet për operacionin në përputhje me pikën 2.2. Struktura operuese mund t'u kërkojë përfituesve potencialë të propozojnë te aplikimet aktivitetet indikative të komunikimit, përpjesëtimisht me madhësinë e operacionit.

3.2. Masat për informimin e përfituesve

1. Struktura operuese informon përfituesit se pranimi i financimit përbën pranimin e përfshirjes së tyre në listën e operacioneve të publikuara në përputhje me nenin 29 (2) të kësaj Marrëveshjeje.

2. Struktura operuese garanton mjetet e informimit dhe të komunikimit, duke përfshirë modelet në format elektronik, për të ndihmuar përfituesit të përmbushin detyrimet e tyre të përcaktuara në pikën 2.2, sipas rastit.

7. Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) Nr. 821/2014 e 28 korrikut 2014 që parashton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) Nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me masat e detajuara për transferimin dhe menaxhimin e kontributeve të programit, të raportimit të instrumenteve financiare, karakteristikat teknike të informacionit dhe masat e komunikimit për operacionet dhe sistemi për të regjistruar dhe të dhënat dyqan (GZ L 233, 20.07.2014, f. 7).

4. ELEMENTE TE PLANIT TË AKTIVITETEVE TË VIZIBILITETIT DHE KOMUNIKIMIT

Plani i aktiviteteve të vizibilitetit dhe komunikimit, hartuar nga struktura operuese dhe kur është e nevojshme nga *Shqipëria*, përmban elementët e mëposhtëm:

1. përshkrimi i qasjes së përdorur, përfshi edhe masat kryesore të informimit dhe komunikimit që do të merren nga Shqipëria ose struktura operuese dhe që kanë për synim përfituesit potencialë, përfituesit dhe publikun më të gjerë, duke pasur parasysh qëllimet e përshkruara në nenin 29 të kësaj Marrëveshjeje;
2. përshkrimi i materialeve që do të vihen në dispozicion në formate të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara;
3. përshkrimi se si përfituesit do të mbështeten në aktivitetet e tyre të komunikimit;
4. buxheti indikativ për zbatimin e planit të aktiviteteve të vizibilitetit dhe komunikimit;
5. përshkrimi i organeve administrative, përfshi burimet e personelit që janë përgjegjëse për zbatimin e masave të informimit dhe komunikimit;
6. marrëveshjet për masat e informimit dhe komunikimit të përmendura në pikën 2, përfshi faqen e internetit ose portalin e internetit ku të dhënat e tilla mund të gjenden;
7. të dhënat se si masat e informimit dhe komunikimit vlerësohen në aspektin e vizibilitetit dhe të ndërgjegjësimit të politikave, programeve dhe operacioneve, si edhe të rolit të luajtur nga Fondet dhe Bashkimi Evropian;
8. Kur është e nevojshme, një përshkrim për përdorimin e rezultateve kryesore të Programit të mëparshëm IPARD II;
9. Përditësimi vjetor që përcakton aktivitetet e informimit dhe të komunikimit që do të kryhen në vitin pasardhës.

* Lutemi përdorni formatimin e mëposhtëm për fushat: data - "2012/12/12" dhe shuma - "999.999,99"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQESISE,
ZHVILLIMIT RURALDHE
ADMINISTRIMIT TE UJËRAVE
MINISTËR**

Nr. Prot.

Tiranë, më / 2016

URDHËR

Nr. _____ Datë ____/____/ 2016

**Për miratimin e strukturave përgjegjëse për zbatimin e Instrumentit të Parazgjerimit të
Zhvillimit Rural IPARD II, për periudhën 2014 - 2020**

Në mbështetje të Nenit 100 të Kushtetutës, Ligjit Nr. 9817, datë 22.10.2007 "Mbi Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural", si dhe të Ligjit Nr. 37/2015 datë 09 Prill, 2015 "Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II).

Urdhëroj:

- **“Miratimin e strukturave përgjegjëse për zbatimin e Instrumentit të Parazgjerimit të Zhvillimit Rural IPARD II, të cilat përgjigjen për menaxhimin, monitorimin dhe implementimin e Programit IPARD II dhe përbëhen nga :**
 - a) Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si njësi e varuar direkt nga Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.
 - b) Autoriteti Menaxhues (AM) që është Drejtoria e Programimit dhe Vlerësimit të Politikave Rurale, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.
- **Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)** do të jetë përgjegjëse për implementimin e programit IPARD II, sipas parimeve të menaxhimit të shëndoshë financiar si dhe zbatimit teknik të masave të specifikuara në Program.
- **Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)**, do të jetë përgjegjëse për ekzekutimin e shpenzimeve të fondeve IPARD II.
- **Drejtori i Drejtorisë së Programimit dhe Vlerësimit të Politikave Rurale, Z.Grigor Gjeçi, do të kryejë funksionin e Drejtuesit të Autoritetit Menaxhues (AM), si dhe autorizohet që të ketë të drejtën e firmosjes për dokumenta teknike të cilat lidhen me IPARD-in.**

Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për: hartimin e programit IPARD II në mënyrë efektive, efçente dhe korrekte, modifikimin e këtij programi, përzgjedhjen e masave, të asistojë Komitetin Monitorues, të përgatisë raportin final vjetor, të cilin e dërgon në Komisionin Evropian, organizon thirrjet për aplikime, monitoron dhe vlerëson Programin, konsultohet rregullisht me Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) si edhe krijon, mirëmban dhe raporton për sistemin e informacionit.

MINISTRI

EDMOND PANARITI

